BULETINI I BANKËS SË SHQIPËRISË

6-MUJORI I DYTË 2013

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Avni Rustemi", Nr.24, Tiranë.
Tel: 355-4-241 93 01/02/ 03; 355-4-241 94 01/2/3;
Faks: 355-4-241 94 08
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

P Ë R M B A J T J A

Editorial
Ekspozita "...Banka për Shqipërinë është i dyti fitim, pas lirisë.."
Besa Prela 5

Fjalime e prezantime të administratorëve të Bankës së Shqipërisë
në aktivitete brenda e jashtë vendit 11

Analiza periodike 59

Analiza e Ndërmjetësimit Financiar, T4 2013
Erjona Suljoti, Sofika Note, Olta Manjani 60

Informacion mbi tregues ekonomikë të vendeve kryesore partnere tregtare, T4 2013
Doriana Lama, Jonida Bollano, Medvin Shehu 70

Analizë e zhvillimeve në sektorin e jashtëm të ekonomisë T3 2013
Eglent Kika, Merita Boka, Olti Mitre 76

Analizë e borxhit të jashtëm bruto T3 2013
Eglent Kika, Merita Boka, Olti Mitre 84

Studime e artikuj 95

Sektori i ndërtimit dhe tregu i pasurive të paluajtshme: Evidenca nga Shqipëria
Delina Ibrahimaj, Gianluca Mattarocci 96

Performanca e eksporteve në Shqipëri 2005-2012: Përqasje CMS
Olti Mitre 109

Efekti i mbartur në ecurinë vjetore të prodhimit të brendshëm bruto
Iris Metani 119

Mbi Njohjen e Institucioneve të Jashtme të Vlerësimit të Kredisë (ECAI)
Lindita Vrioni 124

Kursi real efektiv i këmbimit për vendet e rajonit: ndërtimi i një baze të dhënash
Jonida Bollano, Delina Ibrahimaj 135

Vlerësime të konsumit dhe investimeve private në Shqipëri: Si kanë ecur ato?
Ilir Vika, Esida Abazaj 147

A paraqesin avantazhe konkurruese eksportet shqiptare? Ecuria e eksporteve vendase gjatë viteve të fundit; zhvendosjet në grupmallra dhe partnerë tregtarë
Alban Pllaha 160

Banka e Shqipërisë në harkun kohor korrik-dhjetor 2013 171

Vendimet e Politikës Monetare 179

Ngjarjet Juridike, korrik-dhjetor 2013 180

Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, 31 dhjetor 2013 192

Bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë, deri në 31 dhjetor 2013 193

Publikime të botuara nga Banka e Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2013 197

EDITORIAL

EKSPOZITA "...BANKA PËR SHQIPËRINË ËSHTË I DYTI FITIM, PAS LIRISË.."

BESA PRELA*

Paraja është një gjë e veçantë.
Ajo renditet në të njëjtin nivel me dashurinë, si burimi më i madh i gëzimit për njeriun.Dhe me vdekjen, si burimi më i madh i ankthit.

John Kenneth Galbraith (1908 – 2006)

Në 4 tetor të viti 1913, Ismail Qemal bej Vlora nënshkroi koncesionin e parë për krijimin e një banke kombëtare shqiptare. Nënshkrues të tjerë ishin përfaqësuesit e dy prej grupeve financiare më në zë të kohës, përkatësisht Karol Pitner dhe Oskar Pollak të grupit austro-hungarez, dhe Pietro Fenolio e Guido Ansbaher të atij italian. Në Shqipërinë e trazuar të atij fillimshekulli, por edhe për shkak të tronditjeve që do të vinin shumë shpejt me shpërthimin e Luftës I Botërore, Banka Kombëtare Shqiptare nuk mundi të zhvillojë aktivitet. Por, hartimi dhe nënshkrimi i këtij koncesioni për krijimin e "Bankës Kombëtore të Shqypëniës" mbetet një dokument i rëndësishëm në historinë e bankigut qendror shqiptar, një gur i themelit të këtij institucioni që, në konceptin e vet paraqitës, i përmbahet të gjitha standardeve evropiane të kohës. Jo më kot, themeluesi i shtetit modern shqiptar, bankën kombëtare e ka cilësuar si "...e dyta fitore pas lirisë".

100 vjet më pas, në 4 tetor 2013, Banka e Shqipërisë çeli ekspozitën numizmatike "...Banka për Shqipërinë është i dyti fitim, pas lirisë..".

Në këtë ekspozitë, e cila qëndroi e hapur në Muzeun Historik Kombëtar përgjatë një javë, u ekspozuan kryesisht monedhat dhe kartëmonedhat e qarkulluara në vendin tonë ndër shekuj.

Historia e tërë e një vendi mund të gjurmohet në monedhën e tij. Ekspozita e 4 tetorit 2013 pati për qëllim pikërisht këtë, të sjellë tek vizitorët momente të rëndësishme të qarkullimit monetar në Shqipëri, duke dhënë informacion në mënyrë kronologjike. Ndërkohë, momente të caktuara, si për shembull ai i lidhur me akordimin e një huaje të konsiderueshme financiare prej 50 milionë frangash ari prej grupit financiar italian me mbështetjen e Qeverisë Italiane në vitin 1925, e njohur gjerësisht si fondi SVEA (Societa per lo Sviluppo Economico dell'Albania – Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë) dhe e lidhur ngushtë me krijimin e BKSH-së, u trajtuan përmes një ekspozite

** Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autores dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

fotografike, e cila pasqyroi disa prej punëve publike (ndërtime rrugësh, urash, skelash, godinash qeveritare dhe për zhvillimin e bujqësisë) të realizuara përmes huasë SVEA përgjatë gati një dekade.

Nga Thesari i Torovicës tek sistemi bankar modern ...

Rrugëtimi i ekspozitës nisi me paraqitjen e informacionit për një prej dëshmive më të rëndësishme për dokumentimin e shkëmbimeve në Prehistori (Epokën e Bronzit dhe të Hekurit). I njohur dhe si "Thesari i Torovicës" për numrin e madh të sëpatave (124 copë) të datuara në shekullin e X p.e.s, ai përbëhet nga disa grumbuj me sëpata, të gjetura në territorin e Shqipërisë. Gjatë Epokës së Bronzit, sëpatat ishin objekte nga më të vlefshmet për disa arsye: ato përmbanin një përzierje metalesh me përdorim të gjithanshëm për vegla, armë e stoli. Thesari i Torovicës përbëhet nga dy lloje sëpatash: të tipit shqiptaro-dalmate me përmasa të mëdha dhe "Tullenbeile" të përmasave të vogla, si njësi me vlerë më të vogël. Sëpatat janë të papërfunduara pasi ato nuk janë prodhuar për t'u përdorur si vegla apo si armë, por për qëllim këmbimi, si vlera para monetare. Ato tregojnë për një organizim të këmbimit të prodhimeve në fillim të Epokës së Hekurit mbi bazën e vlerës së metalit (në këtë rast bronzi) me formë (sëpate) dhe peshë të caktuar.[1]

Ekspozimi i monedhave filloi me stendën e monedhave antike, të qarkulluara apo dhe të prera në trojet e hershme shqiptare të banuara nga ilirët dhe epirotët. Kjo stendë i tregonte vizitorëve se rrënjët e monedhës ose thënë ndryshe, zanafilla e historisë së parasë në vendin tonë, shtrihet shumë larg në kohë, rreth 2400 vite të shkuara, kur u pre monedha e parë prej argjendi.

Monedhat e para janë prerë në Dyrrah (Durrësi i sotëm) dhe Apolloni (Pojani i sotëm), koloni greke të themeluara në shekujt VII-VI p.e.s. nga korkyrasit dhe korinthasit. Monedha kanë prerë gjithashtu edhe mbretërit e njohur ilirë si Genti apo Monuni. Pas vitit 167 p.e.s, kur trojet e sotme shqiptare ranë nën sundimin e Romës, prerja e monedhave vendase vazhdoi jo vetëm në periudhën e parë të pushtimit, por edhe gjatë periudhës perandorake romake.

Pas pushtimit romak, në hapësirat e sotme shqiptare monedhat vazhduan të priten edhe në shumë prej qyteteve që më parë kishin prerë drahme. Në periudhën perandorake romake, të karakterizuar nga globalizimi i madh i monedhës, në Iliri dhe Epir, përveç punishteve monetare të Apollonisë, vepronin edhe ato të Butrintit dhe Foinikës. Këto u vunë në shërbim të perandorëve romakë, portretet e të cilëve u gdhendën mbi faqen e parme të monedhës, në shpinë të së cilës vazhduan të ruhen simbolet tradicionale.[2]

Gjatë periudhës disashekullore të sundimit bizantin, kur Shqipëria u bë pjesë e Perandorisë së Lindjes, sipas burimeve arkeologjike, procesi i prerjes së monedhës nuk duket të ketë bërë hapa përpara. Madje, duke nisur nga mesi

[1] *Ilirian Gjipali, "Thesari i Torrovicës", 2014.*
[2] *Shpresa Gjongecaj, Qarkullimi monetar në Shqipëri në shekujt V-I p.e.s, 2010.*

i shekullit VI, edhe vetë qarkullimi i monedhave bizantine filloi të pakësohej në mënyrë të vrullshme. Në periudha të shkëputjes nga Perandoria Bizantine, krahas monedhave perandorake, në territorin tonë kanë qarkulluar më me shumicë ato të Republikës së Venedikut, Principatave Latine, Despotatit të Epirit, Mbretërisë së Sicilisë, Napolit, Serbisë etj. Krahas tyre ka pasur edhe prerje të veçanta nga sovranët vendas që krijuan principata ose zotërime të pavarura si ato të Balshajve e Andrea Gropës.[3] Ndryshe nga ekonomia monetare e shekujve XII-XIV , e cila ndoqi pak a shumë rrugën e zhvillimeve monetare mesdhetare e evropiane viset shqiptare mbetën relativisht mbrapa për sa i përket ndërtimit të institucioneve bankare private dhe publike.[4]

Gjatë periudhës së sundimit të Perandorisë Osmane, në vilajetet shqiptare u përdor monedha perandorake akçe, e cila u bë monedha zyrtare e vendit. E quajtur akçe (bardhoshe) pikërisht pse ishte prej argjendi, e hasim edhe me emrin aspra (nga greqishtja bizantine ασπρα e bardhë). Akçja dominoi tregun e Ballkanit deri në mesin e dytë të shekullit të XV deri në 1585, kur u zhvlerësua së tepërmi. Megjithatë, ajo nuk i nxori nga qarkullimit as monedhat e mëparshme, as edhe ato të shteteve të tjera të kohës. Monedhat e tjera, përveç vlerës intriseke prej ari apo argjendi, i shërbyen më së shumti marrëdhënieve tregtare jashtë vendit. Deri në fillimin e shekullit të XVII-të, fuqitë tregtare evropiane kryesore të Mesdheut i mbushën tregjet ballkanike me monedhat e tyre, të cilat vlerësoheshin shumë nga populli dhe mblidheshin sistematikisht në formë thesaresh. Monedha e huaj më e qëndrueshme ishte dukati venedikas, në atë kohë një monedhë me përdorim pothuajse ndërevropian. Në vitin 1844, Perandoria Osmane e reformoi sistemin monetar duke ndjekur standardet e bimetalizmit, çka solli dhe qarkullimin e gjerë të lirës së arit.[5] Gjatë periudhës osmane kreditë - apo si quheshin në atë kohë e gjenden edhe në zhargonin e sotëm, "borxhet" - jepeshin zakonisht nga kreditorë privatë, të cilët huadhënien në kamatë e kishin profesion. Ata njiheshin si fajdexhinj (nga fjala turke "fajde", që do të thotë kamatë apo interes). Instituti i parë financiar i ndërtuar në bazë të kritereve moderne të veprimtarisë monetare në Perandorinë Osmane u themelua më 4 shkurt 1863, me kapital anglo-francez. Banka Perandorake Osmane, frengjisht "Banque Imperiale Ottomane", me qendër në Stamboll, ishte bankë emetimi dhe krediti. Ajo krijoi degë vetëm në qendrat e vilajeteve që kishte në atë kohë Perandoria Osmane. Si të gjitha bankat evropiane, edhe Banka Perandorake Osmane ishte e detyruar të vinte në qarkullim kartëmonedha me një vlerë jo më tepër se trefishi i rezervave të saj në ar. Ajo gëzonte gjithashtu të drejtën të kryente veprime financiare që ushtronin dhe bankat evropiane të kohës, si në marrëdhëniet me shtetin, ashtu edhe me subjektet parashtetërore dhe private. Pas Bankës Perandorake Osmane, duke filluar prej 1888, në viset shqiptare zhvilloi aktivitet dhe një bankë tjetër turke – Banka Agrare (Ziraat Bankasi), me qendër gjithashtu në Stamboll. Fusha kryesore e veprimtarisë së saj ishte zhvillimi i bujqësisë në perandori. Ajo pati një rrjet më të gjerë se

[3] *Ekonomia dhe qarkullimi monetar në shek. IV-XIV në territorin e Shqipërisë, Skënder Muçaj, 2013.*

[4] *Monedha, krediti dhe banka në Shqipëri gjatë shekujve, Kristo Frashëri, 2011. Historia e Monedhës, botim i Muzeut Numizmatik të Athinës, 2010.*

[5] *Po aty.*

Banka Perandorake Osmane – degë në çdo qendër sanxhaku (prefekturë) dhe arka në çdo qendër kazaje (nënprefekturë ose rreth).

Me shpalljen e Pavarësisë më 1912, vendi vazhdoi të ndiqte sistemin monetar të Perandorisë Osmane, të adoptuar që prej vitit 1844. Monedha bazë e qarkullimit mbeti Lira Osmane Ari, e cila vlerësohej me 100 grosh argjend. Kjo erdhi si pasojë natyrale e fondeve monetare që ruheshin në qarkullim pas shpalljes së Pavarësisë dhe depozitave të zotëruara prej popullit. Zhvillimet politike dhe ekonomike gjatë Luftës I Parë Botërore dhe okupacionit të huaja, u bënë përcaktuese edhe për qarkullimin e monedhave të tjera. Përshkrimit të situatës së qarkullimit monetar të Shqipërisë së viteve 1912-1926 do t'i përshtatej më së miri krahasimi metaforik biblik i kullës së Babelit. Krahas monedhave osmane të arit dhe argjendit, koha e qarkullimit ligjor të të cilave paramendohej të zgjaste deri me emetimin e monedhës kombëtare, në Shqipëri kanë qarkulluar lirisht të gjitha monedhat e arit dhe kartëmonedhat amerikane, franceze, italiane dhe greke. Po ashtu edhe të gjitha monedhat metalike prej argjendi, të cilat, para Luftës I Botërore, kishin vlerë monetare prej 5, 2, 1 dhe ½ franga ari të shteteve të ndryshme të huaja. Në gjuhën popullore, këto monedha u njohën si "Korona Sermi" dhe, ndonëse ishin të zhvlerësuara prej vlerës monetare përkatëse, gëzonin besim të plotë në popull. Si rrjedhojë e mungesës së një kursi bazë këmbimi, e gjithë kjo "Babiloni" monedhash regjistrohej zyrtarisht në të ardhurat dhe shpenzimet e shtetit.[6] Në vitin 1920, me fillimin e organizimit të brendshëm të Shtetit Shqiptar dhe përpunimin e elementeve kryesore të kushtetutës, e cila projektonte institucione të pavarura prej ndërhyrjes së huaj, u ndërmorën masat e para për rregullimin e situatës monetare të vendit. Me vendimin e Këshillit te Ministrave nr. 273, datë 6 maj 1920, u vendos për herë të parë nxjerrja e të ardhurave shtetërore në bazën e frangut ar.

Kartëmonedhat e "emergjencës"...

Një tjetër vështirësi jo e vogël ishte mungesa e monedhës divizionare, e cila, në vitet 1920-1921, kushtëzoi shtypjen e të ashtuquajturave kartëmonedha regjonale, kartëmonedha të shtypura dhe të garantuara prej bashkive të disa qyteteve të vendit. Këto kartëmonedha, gjithashtu të ekspozuara në ekspozitën e Bankës së Shqipërisë, kishin vlerë te ulët dhe shërbyen kryesisht për përballimin e shkëmbimit lokal, vetëm brenda juridiksionit përkatës të tyre. Kjo masë e bashkive nuk u zyrtarizua deri më 1923, kur Qeveria, me një ligj të datës 16.1.1923, përcaktoi nxjerrjen e kartëmonedhës krahinore deri në 80.000 franga ari.

[6] *"Shqipëria më 1937, Veprimi Shtetnor gjatë njëzet e pesë vjetëve të pare të vetqeverrimit", Vëllimi 1, botimet e Komisionit të Kremtimeve të Vetqeverrimit, 1937.*

Kjo ekspozitë paraqiti gjithashtu për publikun monedhat dhe kartëmonedhat kryesore të emetuara nga "stërgjyshja" e Bankës së Shqipërisë, Banka Kombëtare e Shqipnis (1925-1944) dhe nga gjyshja e saj Banka e Shtetit Shqiptar (1945- 1991). Ashtu si edhe në periudhat paraardhëse histroike emetimet e këtyre institucioneve dëshmojnë për çdo ndryshim të vendit, në përputhje të plotë me kushtet shoqërore, ekonomike dhe histroike të periudhës kur ato kanë qarkulluar.

Një përshkrim të sintetizuar të punës së dy paraardhseve të Bankës së Shqipërisë mund ta lexoni në vijim të këtij editoriali.

Monedha e parë kombëtare, frangu ar...

Pas ripohimit me akte ndërkombëtare të Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1921, u bënë diskutime të shumta për ngritjen sërish të një banke kombëtare, çka u bë realitet në vitin 1925, në bazë të marrëveshjes së përfunduar nga Mufid Libohova në emër të Qeverisë Shqiptare dhe Mario Alberti në emër të një grupi financiar italian. Qendra administrative e Bankës Kombëtare të Shqipnis do të ishte qyteti i Durrësit, ndërsa Komiteti Administrativ do ta kishte qendrën në Romë. Kjo bankë u themelua më 2 shtator 1925, dhe në vitin 1926 hodhi në qarkullim monedhën e parë kombëtare shqiptare, të cilën e quajti franga ar. Frangu ar ishte monedhë e rëndë për tregun shqiptar, i cili kishte me tepër nevojë për monedha divizionale. Si monedhë divizionale banka llogariti qindarkën. Pra 1 frang = 100 qindarka. Midis frangut ar dhe qindarkës ekzistonte një zbrazëti e madhe monetare. Për të mbushur këtë zbrazëti qindëshe, lindi nevoja për një monedhë ndërmjetëse. Pikërisht për të përmbushur këtë nevojë, u vu në rend të ditës leku. Raporti mes lekut dhe frangut ar ishte 5 me 1 (pesë lekë - një frang) dhe në raport me qindarkën: 20 me 1 (njëzet qindarka një lek).

BKSH-ja, duke mos qenë vetëm një bankë emisioni, e shtriu veprimtarinë edhe në lëmin e kreditit, ku gjatë një periudhe 10-vjeçare veproi në kushte monopoli, ndërsa prej vitit 1938 u gjend në një konkurrencë të fortë me degën e Bankës së Napolit në Shqipëri. Konventa ekonomiko-doganore e prillit 1939, e realizuar menjëherë pas pushtimit fashist të Shqipërisë, i dha mundësi BKSH-së të bëjë ndryshime thelbësore në politikën e saj monetare. Karakteristikë dalluese e kësaj periudhe ishte kalimi nga politika deflacioniste në atë inflacioniste në lëmin e monedhës. Ajo qe aktive në fushën e kreditit ku, në konkurrencë me Bankën e Napolit dhe me Bankën Kombëtare të Punës, rriti shumë kreditimin dhe mbajti pozita sunduese në tregun shqiptar.[7]

Nga Frangu te Leku....

Pushteti që doli nga Lufta Nacional-Çlirimtare në nëntor 1944, nisi menjëherë procesin e shtetëzimit. Më 13 janar 1945 u miratua ligji mbi

[7] *Historia e bankës qendrore në Shqipëri, Banka e Shqipërisë, 2003.*

anulimin e konvencionit të Bankës Kombëtare të Shqipnis dhe të aksioneve të saj. Po në këtë datë u miratua edhe ligji organik i Bankës së Shtetit Shqiptar. Kjo bankë u krijua si një institucion i rëndësishëm i sistemit financiar të Shtetit Shqiptar. Gjatë vitit 1945, Banka e Shtetit Shqiptar nisi ta zhvillojë veprimtarinë e saj në lëmin e emetimit të monedhës dhe të kreditit. Me Dekretligjin nr. 445, datë 07.07.1947 "Mbi heqjen nga qarkullimi të banknotave të quajtura franga dhe emetimin e një emisioni të ri", si njësia bazë e monedhës në vend të Frangut u caktua Leku. Që nga shkurti i vitit 1946 e deri në fund të vitit 1990, Banka e Shtetit mbështeti procesin e zhvillimit të ekonomisë socialiste. Gjatë kësaj periudhe, në Shqipëri kanë vepruar një numër i kufizuar bankash. Karakteristika kryesore e kohës mbetet centralizimi i skajshëm i këtij sistemi në duart e shtetit. Banka e Shtetit Shqiptar, si bankë qendrore ishte qendër e emisionit të monedhës. Ajo grumbullonte mjetet përkohësisht të lira dhe u jepte ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore dhe personave të veçantë kredi afatshkurtër dhe afatgjatë, kryente shërbimin e arkës unike, mbante llogaritë e të ardhurave dhe të shpenzimeve, ruante fondet në valutë të shtetit, kryente veprimet ekonomike e financiare të shtetit me vendet e tjera dhe me bankat e huaja.[8]

Me fillimin e viteve '90, ndërrimi i sistemit politik në Shqipëri solli ndryshime thelbësore edhe për sistemin bankar. Tiparet kryesore të këtij ndryshimi ishin: ndarja e funksioneve të bankës qendrore nga funksionet e bankave të nivelit të dytë (bankat tregtare); rritja e numrit të bankave; shtrirja e veprimtarisë së tyre të kreditit në disa degë të ekonomisë shqiptare; si dhe hyrja e kapitalit të huaj në tregun bankar. Në cilësinë e autoritetit monetar e mbikëqyrës të vendit, Banka e Shqipërisë, e cila u krijua me miratimin e ligjit nr. 7559 "Për Bankën e Shqipërisë", datë 22 prill 1992, gëzon funksione të mirëfillta të një banke qendrore klasike, me objektivin kryesor që të garantojë arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe mbarëvajtjen e sistemit financiar. Banka e Shqipërisë dallon përmbi të gjitha nga bankat e tjera të sistemit bankar, pasi ajo nuk ushtron të njëjtat funksione dhe nuk ofron të njëjtat shërbime me bankat tregtare. Thënë më thjeshtë, ajo nuk u shërben drejtpërdrejt individëve dhe bizneseve, nuk u jep atyre kredi, në të nuk mund të hapen llogari personale dhe nuk lëshon as karta debiti, as karta krediti. Banka qendrore është një banke pa sportele. "Klientët" e saj janë bankat tregtare dhe Qeveria.

[8] *Po aty.*

FJALIME E PREZANTIME TË ADMINISTRATORËVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË AKTIVITETE BRENDA E JASHTË VENDIT

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në takimin me Kryetarin e Partisë Socialiste, z. Edi Rama,
dhe drejtues e përfaqësues të sistemit bankar shqiptar
25 korrik 2013

I nderuar zoti Rama,
I nderuar zoti Pencabligil,
Të nderuar drejtues të sistemit bankar,

Më lejoni në fillim t'ju falënderoj për ftesën tuaj. Kjo tryezë vjen natyrshëm në vazhdimësi të filozofisë sonë të trialogut midis Bankës së Shqipërisë, sistemit bankar dhe qeverisë, për të diskutuar mbi politikat ekonomike që i shërbejnë rritjes së shpejtë, të shëndetshme e të qëndrueshme të vendit. Prania e zotit Rama, si kryeministër i ardhshëm i vendit, i jep një rëndësi të veçantë këtij takimi.

Sektori bankar është jo vetëm kontribuuesi më i madh dhe më efektiv në rritjen ekonomike të vendit, por njëkohësisht është dhe kujdestari i kursimeve të familjeve shqiptare dhe përcaktuesi i destinacionit të fondeve në ekonomi. Tryeza e sotme i paraprin diskutimeve mbi programin ekonomik dhe buxhetin e vendit që do të ndjekë qeveria e ardhshme.

Të nderuar pjesëmarrës,

Banka e Shqipërisë sapo ka përfunduar analizën e saj periodike të ekonomisë shqiptare. Gjithashtu, në kuadrin e programit FSAP, ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me institucionet ndërkombëtare për vlerësimin e shëndetit financiar të vendit. Duke përfituar nga ky rast, dëshiroj të ndaj sot me ju disa konkluzione paraprake, si dhe t'ju paraqes vizionin e bankës qendrore mbi politikat e ardhshme të zhvillimit.

***

Ekonomia shqiptare është duke u përballur me sfida të mëdha. Këto sfida kanë natyrë jo vetëm ciklike, por edhe strukturore. Dobësia ciklike e kërkesës agregate kufizon rritjen ekonomike të vendit në afat të shkurtër e të mesëm, ndërsa zgjidhja e problemeve strukturore do të përcaktojë zhvillimin afatgjatë të tij. Përballimi i tyre kërkon një aksion të përbashkët, të koordinuar, të guximshëm dhe largpamës. Banka e Shqipërisë gjykon se ky aksion duhet të mbështetet në katër kolona veprimi: (i) ruajtja e stabilitetit makrofinanciar të vendit dhe ndjekja e politikave ekonomike stimuluese; (ii) zbutja e pasigurisë në ekonomi; (iii) vazhdimi i reformës strukturore dhe (iv) konvergjenca me Bashkimin Evropian.

1. Kolona e Parë: Stabiliteti makroekonomik dhe nxitja ekonomike

Sikurse është tashmë e ditur, zhvillimi ekonomik i vendit është në një fazë delikate. Në kontekstin e krizës së gjithanshme botërore, ritmet e zhvillimit ekonomik janë ngadalësuar, duke krijuar jo pak vështirësi, si për sektorin publik dhe për atë privat – për bizneset, familjet e për sistemin financiar.

Në terma më të thjeshtë, kërkesa agregate është e dobët dhe nuk arrin të vërë në përdorim të plotë kapacitetet prodhuese të vendit. Shpenzimet konsumatore janë të ulëta, kryesisht si pasojë e pasigurisë së familjeve për të ardhmen, por, së fundi, edhe në reflektim të ngadalësimit të të ardhurave. Dy përbërës të tjerë të kërkesës agregate shfaqin po ashtu aftësi të kufizuara për t'i dhënë impulse të qëndrueshme rritjes ekonomike të vendit: shpenzimet publike janë të kufizuara nga mungesa e hapësirës fiskale si pasojë e rritjes së borxhit publik, ndërsa eksportet vuajnë kërkesën e dobët të tregjeve botërore dhe shkallën e ulët të diversifikimit. Së fundi, investimet e biznesit paraqiten të zbehta, duke reflektuar hapësirat e pakta që kanë bizneset për të rritur shitjet dhe kushtet më të shtrënguara të financimit që gjejnë në banka.

Ekonomia është një mekanizëm kompleks dhe i ndërvarur. Të gjithë faktorët që përmenda më sipër kanë sjellë ngadalësim të tregut të punës dhe kanë rritur presionin mbi financat publike. Po ashtu, ato kanë shtuar vështirësitë për shumë biznese dhe kanë rritur kreditë me probleme në sistemin bankar.

Opinioni i Bankës së Shqipërisë është se kjo situatë kërkon ndjekjen e politikave makroekonomike stimuluese. Teoria e praktika ekonomike sugjerojnë se ndjekja e këtyre politikave ka si parakusht të domosdoshëm ruajtjen e balancave makroekonomike. Vazhdimisht kam theksuar se këto balanca ekzistojnë në ekonominë shqiptare dhe se ato përbëjnë një nga pikat e forta të zhvillimit të ardhshëm të saj. Presionet inflacioniste janë të ulëta, balancat e huaja të ekonomisë janë në përmirësim dhe sistemi financiar i vendit është i shëndetshëm. Por, ekuilibrat makroekonomikë duhet të ruhen e të forcohen më tej në të ardhmen. Ky objektiv është filtri paraprak që duhet të kalojë çdo nismë makroekonomike.

Çdo stimul makroekonomik duhet të marrë në konsideratë edhe një ekuilibër tjetër vital: atë të stabilitetit financiar të vendit, përndryshe ai rrezikon të bëhet joproduktiv. Kriza globale ka rritur ndjeshëm ekspozimin e çdo vendi ndaj rreziqeve që lidhen me stabilitetin financiar. Për këtë arsye është e domosdoshme që ky ekuilibër të vazhdojë të jetë një prioritet konstant dhe në harmoni të plotë me politikat nxitëse zhvillimore. Sa më të shëndetshëm të jemi financiarisht, aq më të mëdha do të jenë hapësirat që do të kemi për stimul zhvillimor të vendit.

Duke patur parasysh sa më sipër dhe duke përfituar nga fakti se të tre aktorët kryesorë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave makroekonomike janë të pranishëm në këtë sallë, më lejoni të ndaj me ju opinionin e Bankës së Shqipërisë për nxitjen në afat të shkurtër të zhvillimit të vendit.

Banka e Shqipërisë, si institucion i pavarur, përgjegjës për politikën monetare, për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sistemit bankar, ka ndërmarrë masa konkrete për nxitjen e kërkesës në ekonomi. Ne kemi ulur normën e interesit në nivele minimale historike dhe po shohim hapësirat e mëtejshme që ekzistojnë në këtë drejtim. Gjithashtu, kemi furnizuar sistemin bankar me likuiditetin e kërkuar për funksionimin normal të tregjeve financiare. Së fundi, kemi prezantuar dhe një paketë masash rregullative në mbështetje të kreditimit. Politikat tona kanë qenë të suksesshme në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë, çka përbën dhe objektivin e punës së Bankës së Shqipërisë. Por, transmetimi i tyre në nxitjen e aktivitetit ekonomik kërkon një reflektim më të mirë nga sistemi bankar.

Sistemi bankar ka bërë një punë të mirë për ruajtjen e shëndetit të tij. Ai ka mbështetur ekonominë shqiptare në fazën e zgjerimit dhe ka ndarë me të një pjesë të kostove të ngadalësimit ekonomik. Në ndryshim nga shumë eksperienca të tjera, sistemi bankar shqiptar arriti të përballojë me sukses krizën e madhe botërore, duke mos përdorur në asnjë rast fonde publike. Përkundrazi, u arrit që në kulmin e krizës shumë banka të sillnin kapital të ri në vend, në kushtet e një kontraktimi fiskal dhe tërheqjes së fondeve nga grupet bankare evropiane dhe rritjes së kredive me probleme.

Megjithatë, opinioni jonë është se ai mund të bëjë më tepër për nxitjen e kreditimit. Së pari, sistemi bankar duhet të punojë më shumë për pastrimin e bilanceve të veta, nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve dhe vlerësimit realist të cilësisë së kredimarrësve. Së dyti, pa cënuar kulturën e respektimit të detyrimeve kontraktuale, ai duhet të jetë më aktiv në procesin e ristrukturimit të kredive për t'i dhënë më shumë frymëmarrje bizneseve që e meritojnë. Së treti, ne gjykojmë se brenda kontekstit shqiptar ekzistojnë projekte biznesi e zhvillimi, të cilat kanë interes afatgjatë dhe që meritojnë vëmendje më të madhe. Mungesa e kërkesës për kredi është një problem i njohur dhe i mirëkuptuar nga ana jonë, por sistemi bankar duhet të jetë më fleksibël në vlerësimin e kërkesave ekzistuese.

Në të gjitha daljet e mia publike kam theksuar kujdesin që duhet treguar për shëndetin e financave publike të vendit. Ne gjykojmë se paradigma ekonomike e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit kërkon marrjen e masave të shpejta për shëndoshjen e financave publike. Përtej sfidave afatshkurtra për buxhetin e këtij viti, e domosdoshme është vendosja e një rregulli fiskal të besueshëm e transparent, i cili do të disiplinojë politikën fiskale në afat të gjatë dhe do të garantojë besimin e tregjeve financiare në borxhin publik shqiptar.

Në përfundim, Banka e Shqipërisë gjykon se stimuli makroekonomik duhet të vazhdojë të bazohet në një politikë monetare stimuluese dhe në një sistem bankar më të vëmendshëm ndaj nevojave të ekonomisë. Gjithashtu, ne besojmë se politika fiskale nuk ka hapësirë për veprime të tilla. Kjo rrugë veprimi ruan stimulin makroekonomik dhe shëndetin e balancave makroekonomike, duke i dhënë formë dhe kolonës së parë të politikave zhvillimore.

2. Kolona e dytë: Zbutja e pasigurisë në ekonomi

Kolona e dytë (edhe kjo me veprim afatshkurtër), ka të bëjë me uljen e pasigurisë në ekonomi. Kjo pasiguri ka shumë dimensione dhe një ndikim kompleks në vendimmarrjen e sektorit privat, por rezultantja e saj është stepja e konsumatorit dhe e biznesit nga ndërmarrja e konsumit dhe e investimeve.

Jo e gjithë pasiguria lidhet me zhvillimet e brendshme, por një pjesë e konsiderueshme e saj origjinon aty. Disa nga nismat që listova më sipër – si riangazhimi në terma konkretë për ruajtjen e shëndetit të financave publike dhe rritja e transparencës në bilancet e ekonomisë shqiptare – janë hapat e duhur në këtë drejtim. Nisma të tjera që do të mbështesnin uljen e pasigurisë do të ishin:

- forcimi i planeve të kontigjencës dhe i marrëdhënieve me institucionet financiare ndërkombëtare;
- rritja e transparencës dhe e konsistencës së programeve të zhvillimit, si në nivel kombëtar dhe në nivel sektorial;
- forcimi i kuadrit ligjor, rregullator e fiskal, si dhe minimizimi i luhatjeve të tyre;
- përmirësimi i klimës së biznesit, në marrëdhëniet e tij me administratën tatimore dhe në marrëdhëniet me sistemin gjyqësor;
- Ndërmarrja e këtyre hapave do të ishte një progres i rëndësishëm në rrugën e zhvillimit.

3. Kolona e tretë: Reformat strukturore

Kolona e tretë e zhvillimit, ajo e reformave strukturore të ekonomisë, duhet të forcohet e thellohet më tej. Duke mos dashur të dal jashtë axhendës së takimit të sotëm, dëshiroj të theksoj se kjo reformë duhet t'i hapë rrugë një ekonomie më të shëndoshë, më konkurruese e me një zhvillim më të balancuar midis sektorëve. Vendosmëria dhe suksesi jonë në zbatimin e këtyre reformave do të përcaktojnë edhe zhvillimin afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

4. Kolona e katërt: Konvergjenca me Bashkimin Evropian

Do të ishte produktive mendoj unë, që identifikimi, hartimi dhe zbatimi i paketës së reformave strukturore të kryhej në një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e specializuara ndërkombëtare. Vlerësoj se tashmë Shqipëria i plotëson të gjitha kushtet për një konvergjencë të shpejtë me Bashkimin Evropian. Mendoj se mënyra më e mirë për të përballuar krizën aktuale dhe për të garantuar një rritje të qëndrueshme ekonomike në afat të gjatë, është integrimi evropian. Banka e Shqipërisë, si pjesë përbërëse e Nismës së Vjenës 2.0, është e angazhuar maksimalisht në procesin e rimodelimit të strukturës financiare që mbështet zhvillimin e vendeve të Evropës Juglindore.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe mbetem i hapur për diskutime të mëtejshme.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
31 korrik 2013

Sot, në datën 31 korrik 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Deklaratën e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të ulë normën bazë me 0.25 pikë përqindje, duke e çuar atë në nivelin 3.50%. Ulja e normës bazës krijon kushte më të mira për rritjen e kërkesës agregate, duke ndihmuar në kthimin e inflacionit pranë objektivit tonë prej 3.0%. Gjithashtu, lehtësimi i mëtejshëm i politikës monetare faktorizon pritjet për një politikë fiskale të përmbajtur në gjysmën e dytë të vitit dhe krijon hapësira për një korrektim më të shpejtë e me kosto më të ulët të financave publike.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Muajt e parë të vitit 2013 kanë konfirmuar vlerësimet tona për rritje të ngadaltë të ekonomisë shqiptare dhe për presione të ulëta inflacioniste në të. Aktiviteti ekonomik në vend vazhdon të vuajë nga ecuria e dobët e kërkesës agregate, e cila nga ana e saj reflekton pasigurinë e agjentëve ekonomikë mbi të ardhmen, kushtet relativisht të shtrënguara të financimit, si dhe dobësinë ekonomike të partnerëve tanë kryesorë tregtarë. Megjithatë, ndonëse në një kontekst makroekonomik sfidues, stabiliteti ekonomik e financiar i vendit mbetet i qëndrueshëm. Inflacioni qëndroi në nivele të ulëta gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, si pasojë e presioneve të dobëta nga ana e kërkesës por edhe në reflektim të pritjeve të ankoruara për inflacionin. Këto të fundit pasqyrojnë politikën e kujdesshme monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë.

Kjo politikë ka bërë të mundur uljen e normave afatgjata të interesit dhe ka ndihmuar në ruajtjen e parametrave të shëndetit të sistemit bankar. Gjithashtu, përmirësimi i pozicionit të jashtëm të vendit, i shoqëruar me qëndrueshmërinë e monedhës vendase ,si dhe bilancet përgjithësisht të shëndosha të sektorit financiar të ekonomisë, kanë forcuar më tej stabilitetin financiar dhe kanë siguruar një nga shtyllat e nevojshme për rritjen afatgjatë të vendit.

Inflacioni i tremujorit të dytë rezultoi mesatarisht në nivelin 2.2%, duke u reduktuar në krahasim me tremujorin e parë. Reduktimi i inflacionit të

produkteve bujqësore dhe qëndrueshmëria e çmimeve të artikujve të tjerë të shportës e zhvendosën për poshtë inflacionin e këtij tremujori. Ecuria e çmimeve bujqësore vazhdon të përcaktojë rreth 90% të inflacionit total, duke reflektuar si luhatjet e çmimeve të këtyre produkteve ashtu edhe peshën relativisht të lartë që kanë ato në shportën tonë të konsumit.

Në aspektin makroekonomik, ecuria e inflacionit vazhdon të përcaktohet kryesisht nga prania e kapaciteteve të pashfrytëzuara të prodhimit. Rritja e ngadaltë e kërkesës agregate është shoqëruar me rritje të ulët të investimeve, të punësimit dhe të pagave e të kostove të punës në ekonomi. Ky zinxhir faktorësh është përkthyer më tej në presione të ulëta për rritjen e çmimeve të konsumit. Ai është konfirmuar edhe nga vlerat minimale historike që ka shënuar inflacioni bazë gjatë kësaj periudhe. Nga ana e ofertës, stabilizimi i çmimeve në tregjet botërore, si dhe pritjet e ankoruara të agjentëve ekonomikë për inflacionin, janë reflektuar në rritje të ulëta të çmimeve në tregun e brendshëm.

Duke u ndalur te zhvillimet ekonomike, të dhënat e INSTAT-it tregojnë se rritja ekonomike e tremujorit të parë rezultoi rreth 1.7%, duke mbetur në linjë me nivelin e regjistruar në fundin e vitit të kaluar. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik gjatë tremujorit të parë u mbështet kryesisht nga rritja e sektorit të industrisë, ndërkohë që sektori i bujqësisë dhe ai i shërbimeve patën gjithashtu një rritje pozitive por më të dobët.

Në të kundërt, sektori i ndërtimit vijoi të tkurret. Informacioni i disponuar për tremujorin dytë të vitit sugjeron për një përmirësim të ecurisë së ekonomisë, kryesisht në reflektim të stimulit të lartë fiskal të kësaj periudhe.

Nga pikëpamja e përbërësve të kërkesës, rritja ekonomike gjatë gjashtëmujorit i atribuohet kryesisht rritjes së eksporteve dhe shpenzimeve publike të kësaj periudhe, ndërkohë që kontributi i konsumit dhe i investimeve private vlerësohet të ketë qenë i dobët. Ndonëse stimujt monetarë janë rritur gjatë tremujorëve të fundit, konsumi dhe investimet private janë frenuar nga pasiguria për të ardhmen. Kjo pasiguri reflektohet në një sjellje më të kujdesshme nga biznesi dhe familjet shqiptare, si dhe në një gatishmëri më të ulët të tyre për të marrë përsipër rrezik. Rritja e prirjes për kursim dhe ulja e shkallës së huamarrjes përmirësojnë bilancet e sektorit privat, por ato kanë një ndikim negativ në kërkesën agregate dhe rritjen ekonomike afatmesme.

Ecuria e treguesve fiskalë në gjashtë muajt e parë të vitit ka reflektuar një politikë fiskale ekspansioniste, të manifestuar në rritjen e shpenzimeve buxhetore dhe të deficitit fiskal. Kjo sjellje ka qenë veçanërisht e spikatur në tremujorin e dytë. Rritja e shpenzimeve buxhetore ka patur një impakt pozitiv në rritjen ekonomike të kësaj periudhe, por efekti tërësor i politikës fiskale do të varet nga shkalla e respektimit të treguesve të miratuar buxhetorë për vitin 2013. Shpenzimet publike kanë shënuar rritje vjetore prej 12.2% në gjashtë muajt e parë të këtij viti, të nxitura në një masë të madhe nga shpenzimet kapitale. Nga ana tjetër, të ardhurat buxhetore për këtë periudhë rezultuan 2.9% më të ulëta nga një vit më parë, duke reflektuar ecurinë e dobët të të

ardhurave tatimore. Këto zhvillime janë materializuar në rritje të ndjeshme të deficitit buxhetor, i cili ka rezultuar më shumë se dy herë më i lartë në krahasim me një vit më parë.

Dinamika e deficitit buxhetor është reflektuar në rritjen e borxhit publik gjatë kësaj periudhe.

Në fund të tremujorit të parë, raporti i borxhit publik ndaj PBB-së vlerësohet në 63.3%. Borxhi publik përbën një nga dobësitë më të mëdha të ekonomisë e të sistemit financiar shqiptar. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë sugjeron se marrja e masave të menjëhershme për kontrollin e këtij borxhi do të përbënte një kontribut të rëndësishëm për reduktimin e pasigurive dhe të primeve të rrezikut në ekonomi. Ne gjejmë rastin të sugjerojmë edhe një herë vendosjen e një rregulli fiskal transparent e të besueshëm. Kjo është rruga më e mirë për të disiplinuar politikën fiskale dhe për të ruajtur besimin e tregjeve financiare ndaj borxhit publik shqiptar në afat të gjatë.

Të dhënat e sektorit të jashtëm të ekonomisë dëshmojnë për kontribut pozitiv të kërkesës së huaj në rritjen e aktivitetit ekonomik në vend dhe për ngushtim të mëtejshëm të deficitit tregtar, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Kjo sjellje është diktuar nga rritja vjetore me 17.4% e eksporteve dhe nga rënia vjetore me 6.3% e importeve për të njëjtën periudhë. Për pasojë, deficiti tregtar është ulur me 22.2%, gjatë kësaj periudhe.

Korrektimi i deritanishëm i bilancit tregtar është një zhvillim pozitiv për ekonominë shqiptare, por reduktimi i këtij deficiti i dedikohet në masë të madhe faktorëve me natyrë jo të qëndrueshme. Analiza e detajuar e shkëmbimeve tregtare konfirmon përqendrimin e lartë të eksporteve shqiptare, në rajone të caktuara gjeografike apo në grup-produkte të ngushta, si dhe vlerën e shtuar të ulët të tyre. Për një rritje të qëndrueshme të eksporteve dhe korrektim të shëndetshëm të deficitit tregtar, vëmendja e politikbërësve duhet të orientohet drejt rritjes së konkurueshmërisë së mallrave vendase dhe zgjerimit të bazës së eksporteve, nëpërmjet përshpejtimit të reformave strukturore.

Zhvillimet në tregjet financiare kanë reflektuar prime të ulëta të rrezikut dhe të inflacionit, duke mundësuar përcjelljen më të mirë të sinjaleve lehtësuese të politikës monetare, të ndërmarra në fillim të këtij viti. Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë qëndruar pranë normës bazë dhe kanë shfaqur luhatshmëri të ulët.

Në tregun primar, yield-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë shënuar rënie të ndjeshme, veçanërisht në segmentin e maturiteteve më të gjata. Rënia e normave të interesit ka qenë më e shpejtë gjatë muajve të fundit edhe në tregun e depozitave, por mbetet e pakët në atë të kredive. Normat e interesit për kreditë po shfaqin një reagim të ngadaltë kundrejt normave të tjera të tregut, duke u ndikuar edhe nga kreditimi i pakët i ekonomisë gjatë muajve të fundit.

Zhvillimet monetare tregojnë për vazhdimësi të presioneve të ulëta inflacioniste në ekonomi. Përshpejtimi i rritjes vjetore të ofertës monetare ka

reflektuar kryesisht kërkesën e shtuar të sektorit publik për financim, gjatë këtyre dy muajve. Nga ana tjetër, kërkesa e bizneseve dhe e individëve për para ka vijuar të mbetet e dobët. Kredia për sektorin privat është ngadalësuar ndjeshëm dhe në fund të muajit maj, ajo është 0.2% më e ulët se një vit më parë. Krahas kushteve të shtrënguara të ofertës, ecuria e dobët e kreditimit po reflekton gjithnjë e më shumë rënien e kërkesës së bizneseve për kredi.

Ndërkohë, në tre muajt e fundit është regjistruar rritje e kërkesës së individëve për financim, duke sinjalizuar kështu për një gjallërim të mundshëm të kësaj kredie.

Projeksionet tona për ecurinë e ekonomisë në të ardhmen mbështesin vlerësimin për një rritje të ngadaltë të aktivitetit ekonomik gjatë tremujorëve në vazhdim, në nivele të krahasueshme me ato të gjysmës së parë të vitit. Kërkesa e huaj do të jetë burim i rritjes ekonomike edhe në tremujorët e ardhshëm, ndërkohë që stimuli fiskal i gjashtëmujorit të parë pritet të mungojë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Të dhënat e tërthorta nuk mbartin ende sinjale për gjallërim të konsumit dhe të investimeve private. Rritja nën potencial e ekonomisë do të shoqërohet me presione të ulëta inflacioniste nga kahu i kërkesës dhe në mungesë të goditjeve të paparashikuara të ofertës, çmimet e konsumit pritet të rriten me norma të ulëta. Inflacioni vjetor pritet të luhatet në intervalin 1.1% - 3.8% pas 4 tremujorëve, me një probabilitet ndodhjeje 90%. Në këto rrethana, politika jonë monetare do të vazhdojë të ruajë natyrën e saj stimuluese edhe përgjatë tremujorëve në vijim.

Po kështu, ne do të vazhdojmë të furnizojmë sistemin bankar me të gjithë likuiditetin e kërkuar për funksionimin normal të tregjeve financiare.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të ulë normën bazë me 0.25 pikë përqindje, duke e çuar atë në nivelin 3.50%. Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se kjo ulje krijon kushte më të mira monetare për përmbushjen e objektivit tonë të inflacionit, në një periudhë afatmesme. Respektimi i këtij objektivi do të vijojë të mbetet orientuesi i vetëm i politikës tonë monetare.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
28 gusht 2013

Sot, në datën 28 gusht 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3,50%.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Sipas të dhënave të INSTAT-it, inflacioni vjetor i muajit korrik rezultoi 1.6%, duke shënuar rënie krahasuar me muajin e kaluar dhe duke qëndruar poshtë objektivit tonë prej 3%. Rënia e fortë e inflacionit në këtë muaj pritet të jetë e përkohshme. Ajo u shkaktua kryesisht nga çmimet e ulëta të produkteve ushqimore të stinës, si dhe nga dinamika rënëse e çmimeve të disa mallrave të tjerë të shportës. Megjithatë, grupet dhe artikujt kryesorë të shportës së mallrave të konsumit vazhdojnë të karakterizohen nga norma të ulëta inflacioni vjetor.

Konteksti ekonomik dhe financiar i zhvillimit të vendit ka gjeneruar norma të ulëta inflacioni. Kërkesa agregate dhe rritja ekonomike mbeten të dobëta, duke mos arritur të vënë në shfrytëzim të plotë kapacitetet prodhuese të vendit.

Kjo situatë nuk mbështet rritjen e punësimit dhe krijon presione të ulëta për rritjen e pagave, të kostove të prodhimit, dhe të marxheve të fitimit. Gjithashtu, presionet inflacioniste me origjinë të huaj shfaqen të përmbajtura, në reflektim të ecurisë së moderuar të çmimeve në tregun botëror dhe të qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit. Së fundi, inflacioni i pritur nga sektori real dhe ai financiar shfaqet i ulët, ndërsa situata e likuiditetit është në linjë me një rritje të moderuar çmimesh në afat të mesëm. Banka e Shqipërisë gjykon se, në vija të përgjithshme, këto tendenca zhvillimi do të vijojnë të jenë të pranishme edhe në periudhën e ardhshme dhe do të përcaktojnë norma të ulëta inflacioni gjatë horizontit afatmesëm.

Përditësimi me informacion të ri i analizës ekonomike sugjeron se aktiviteti ekonomik është zgjeruar me ritme të ulëta gjatë gjashtëmujorit të parë.

Kërkesa agregate dhe rritja ekonomike duket se kanë shënuar një përmirësim të lehtë në tremujorin e dytë, në përgjigje të rritjes së stimulit

fiskal dhe të një ecurie më të mirë të shpenzimeve konsumatore, ndërkohë që investimet private mbeten të dobëta.

Gjithashtu, kërkesa e huaj ka vazhduar të kontribuojë pozitivisht në nxitjen e aktivitetit ekonomik. Të dhënat më të fundit të sektorit të jashtëm të ekonomisë, tregojnë një reduktim vjetor prej 14.6% të deficitit tregtar në muajin korrik. Ky ngushtim u ndikua nga rritja me 23.9% e eksporteve, ndërsa importet totale shënuan një rritje të lehtë prej 1.2%.

Politika fiskale ka patur një natyrë stimuluese gjatë shtatë muajve të parë të vitit, duke u karakterizuar nga rritja e shpejtë e shpenzimeve publike dhe nga ulja e drejtpërdrejtë apo indirekte e disa taksave. Gjatë periudhës në fjalë, shpenzimet buxhetore u rritën me 10.4%, ndërkohë që të ardhurat buxhetore u reduktuan me 2.6%. Kjo situatë u reflektua në një deficit buxhetor rreth 2.3 herë më të lartë se e njëjta periudhë e vitit të shkuar.

Zgjerimi i deficitit ka mbështetur kërkesën agregate në këtë periudhë, por ai nënkupton ndjekjen e një politike fiskale të kujdesshme në pjesën e mbetur të vitit, në kushtet e ezaurimit të hapësirave për huamarrje në gjysmën e dytë.

Kahu lehtësues i politikës monetare, reduktimi i kërkesës për financim të sektorit publik, si dhe situata e mirë e likuiditetit në sektorin bankar, kanë mundësuar një rënie të mëtejshme të normave të interesit gjatë muajve korrik e gusht. Në veçanti, normat e interesit të letrave me vlerë të qeverisë dhe të depozitave në lekë kanë njohur një rënie të mëtejshme, ndërkohë që normat e interesit të kredive në lekë kanë reflektuar më pak. Ky zhvillim vazhdon të tregojë për praninë e primeve relativisht të larta të rrezikut në tregun financiar dhe ilustron gjithashtu politikat konservatore të bankave në kreditim. Ashtu si dhe në eksperiencën e shumë ekonomive të tjera, ai tregon se përcjella e plotë e lehtësimit të politikës monetare në kushte më të mira financimi për sektorin privat mbetet problematike.

Nga ana tjetër, edhe sektori privat shfaq një elasticitet kërkese ndaj kostos së kredisë relativisht të ulët, duke reduktuar përcjelljen e stimulit monetar në ekonomi.

Në këto rrethana, zgjerimi i kredisë për ekonominë ka vijuar të shënojë norma të ulëta rritjeje. Në fundin e tremujorit të dytë, kredia për ekonominë rezultoi rreth 0.9% më e lartë, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Së bashku me aktivitetin e dobët ekonomik, perceptimi i pasigurisë nga agjentët ekonomikë vazhdon frenon kërkesën për kredi të sektorit privat. Megjithatë, në muajin qershor, kredia akorduar sektorit privat shfaqi shenja të lehta përmirësimi, në krahasim me dy muajt paraardhës. Në fund të muajit qershor, agregati i parasë së gjerë, M3, regjistroi rritje vjetore me 4.5%.

Duke parë nga e ardhmja, Banka e Shqipërisë gjykon se burimet e rritjes ekonomike mbeten të dobëta dhe të pasigurta.

Në veçanti, konsumi dhe investimet private vuajnë nga pasiguria dhe hezitimi i familjeve dhe bizneseve në ndërmarrjen e angazhimeve afatgjata.

Gjithashtu, kushtet e financimit, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, vijojnë të mbeten relativisht të shtrënguara dhe nuk favorizojnë rritjen e kredisë dhe të investimeve. Performanca e këtyre komponentëve do të përcaktojë ecurinë e ardhshme të ekonomisë.

Në një horizont afatmesëm, skenari bazë i zhvillimeve të pritura karakterizohet nga një rritje ekonomike e dobët dhe nën potencial - në linjë me atë të vënë re gjatë dy viteve të fundit. Në mungesë të presioneve të huaja inflacioniste, apo të goditjeve të tjera nga ana e ofertës, presionet inflacioniste priten të jenë të dobëta dhe rritja vjetore e çmimeve të konsumit pritet të jetë në gjysmën e poshtme të objektivit.

Ky skenar zhvillimi kërkon ruajtjen e një kahu stimulues për politikat ekonomike, në interes të mbështetjes së kërkesës agregate dhe të rikuperimit të ritmeve potenciale të rritjes. Në terma të politikave makroekonomike, Banka e Shqipërisë gjykon se politika fiskale në të ardhmen duhet të ketë si objektiv të saj primar ruajtjen dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik. Ky kurs veprimi do të forcojë besimin e tregjeve financiare në financat publike të vendit dhe do të reduktojë kostot e shërbimit të borxhit në periudhën afatgjatë. Konteksti makroekonomik i gjeneruar prej tij do të krijonte kushte më të përshtatshme për zhvillimin e sektorit privat dhe do të linte më shumë hapësirë për përcjelljen dhe forcimin e stimulit monetar në ekonomi.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3,50%. Në gjykimin e Këshillit, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme. Njëkohësisht, këto kushte ofrojnë stimulin e nevojshëm monetar për mbështetjen e kërkesës së brendshme. Këshilli Mbikëqyrës gjykon se dinamika e pritur e zhvillimeve ekonomike dhe financiare do të kërkojë ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare deri në një horizont afatmesëm.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën "Forcimi i lidhjeve në Evropën Juglindore: Ankorat politike dhe perspektivat e biznesit"
19 shtator 2013

I nderuar z. Kryeministër,
Të nderuar miq nga Universiteti i Oksfordit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj të trupit diplomatik, akademikë dhe të ftuar.

Kam kënaqësinë dhe nderin e veçantë të hap këtë konferencë të përbashkët të Bankës së Shqipërisë dhe Universitetit të Oksfordit, mbi forcimin e lidhjeve ndërmjet ekonomive të rajonit tonë. Tre vite më parë, në shtator të vitit 2010, ftuam Universitetin e Oksfordit të mbështeste diskutimin akademik të Bankës së Shqipërisë mbi modelin e rritjes ekonomike dhe karakterin e tij rajonal. Në atë kohë pati edhe keqinterpretime të këtij debati, si një diskutim mbi përparësinë e sistemit të ekonomisë së tregut dhe të filozofive alternative të organizimit ekonomik të një shoqërie. Megjithatë, tre vjet më vonë, të gjithë konstatojmë se modeli i rritjes ekonomike është kthyer në temën qendrore të debatit akademik dhe ekonomiko-politik.

Prej një periudhe disavjeçare, ekonomia jonë është nën ndikimin e krizës globale, ndikim ky i shprehur kryesisht në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik. Ai ka frenuar investimet dhe kreditimin e ekonomisë, duke çuar njëkohësisht në përkeqësimin e bilanceve të sektorit publik e atij privat.

Me gjithë këto zhvillime, ekonomia shqiptare ka arritur të ruajë stabilitetin e çmimeve dhe ekuilibrat e përgjithshëm makroekonomikë e financiarë të vendit. Sistemi financiar shqiptar ka treguar një shkallë të lartë imuniteti. Pavarësisht ngadalësimit të rritjes ekonomike, ai mbetet në tërësi likuid, i mirëkapitalizuar dhe fitimprurës, duke pasqyruar punën e kujdesshme të Bankës së Shqipërisë në vitet që i paraprinë krizës dhe gjatë saj.

Politikat e kujdesit të Bankës së Shqipërisë, por edhe reagimi i sektorit bankar, mundësuan që sistemi të mos përballej me probleme ekstreme, të cilat do të kërkonin përdorimin e fondeve publike. Mos harrojmë që në Shqipëri kemi të pranishme grupe bankare nga vende të Bashkimit Evropian që u preken thellë nga kriza.

Banka e Shqipërisë, gjatë punës së saj, ka pasur në qendër të vëmendjes qëndrueshmërinë e sektorit bankar, si në drejtim të stabilitetit financiar e mbikëqyrjes bankare, ashtu dhe në atë të politikës monetare dhe administrimit të likuiditetit.

Banka e Shqipërisë është përpjekur të jetë proaktive dhe t'u paraprijë problemeve, duke përshtatur veten dhe rolin e politikave të saj, në përputhje me zhvillimet globale dhe situatën në tregun e brendshëm.

Situata e paqartë ekonomike e financiare globale, ka diktuar në vazhdimësi nevojën për të ridimensionuar rolin e institucioneve, përfshirë dhe atë të bankës qendrore. Aktualisht, bankat qendrore u janë drejtuar masave makroprudenciale, sepse mekanizmat tradicionalë të transmetimit të politikës monetare po vuajnë prej bilanceve të rënduara të agjentëve ekonomikë, publikë e privatë. Për të koordinuar më mirë këtë rol dhe për të monitoruar më mirë ekonominë, bankat qendrore në botë po e mbështesin politikën e tyre monetare me ndërmarrjen e masave të nevojshme makroprudenciale. Këto zhvillime globale e gjejnë Bankën e Shqipërisë të përgatitur dhe me përvojën e nevojshme. Ajo ka një strukturë të ngjashme me atë që po adaptohet nga Banka Qendrore Evropiane dhe bankat e tjera qendrore të vendeve te zhvilluara. Për më tepër, Banka e Shqipërisë ka tashmë një eksperiencë të suksesshme disavjeçare në përdorimin e masave kundërciklike, si një mënyrë për menaxhimin e ekuilibrit makroekonomik e financiar të vendit.

Pa dashur t'i radhis të gjitha, dëshiroj të veçoj ndryshimin e koeficientëve të rrezikut, për të kontrolluar zgjerimin e kreditimit në valutë dhe vendosjen e limiteve në raportet kredi ndaj kolateralit për të kontrolluar shkallën e borxhit në ekonomi.

Një nga mësimet më të rëndësishme të krizës botërore është se trajtimi në mënyrë të pavarur i çështjeve të stabilitetit monetar (domethënë, i qëndrueshmërisë së çmimeve) dhe të stabilitetit financiar, jo vetëm që nuk është një zgjidhje optimale, por është e prirur të prodhojë kriza. Ekonomia funksionon si një mekanizëm kompleks, me ekuilibra shpesh të brishtë e të ndërvarur, i cili nuk respekton kufijtë e ndarjeve institucionale të përgjegjësive. Për çdo ekonomi ka vetëm një normë interesi, ka vetëm një masë kritike të ndërmjetësimit financiar dhe një ekuilibër të brishtë të bilanceve të sektorit financiar që garanton zhvillimin e qëndrueshëm e afatgjatë të vendit. Harmonizimi i këtyre tre objektivave është kusht i domosdoshëm për ruajtjen e ekuilibrit financiar të ekonomisë. Rrjedhimisht, identifikimi dhe harmonizimi i tyre nën një çati të përbashkët vlerësohet si zgjidhja optimale për të garantuar stabilitetin ekonomik e financiar të vendit. Për këtë arsye, një nga praktikat më të ndjekura për rregullimin institucional të paskrizës është jo thjesht unifikimi i mbikëqyrësve të sistemit financiar, por integrimi institucional i tyre me rolin dhe funksionet e tjera të bankës qendrore.

***

I nderuar z. Kryeministër,
Të nderuar pjesëmarrës,

Në mënyrë të pakontestueshme, në afat të gjatë, rritja ekonomike e një vendi përcaktohet nga fuqia e tij punëtore dhe shkalla e kualifikimit të saj; produktiviteti, teknologjia dhe aftësia e tij për inovacion; si dhe nga shkalla e akumulimit të kapitalit, e cila në vetvete reflekton, si preferencat sociale ashtu edhe stimujt fiskalë dhe shkallën e zhvillimit të sistemit financiar. Të tre këta grupe faktorësh kushtëzohen nga struktura ekonomike e një vendi dhe nxitja e stimulimi i tyre realizohet nëpërmjet reformave strukturore. E ritheksoj se,

në afat të gjatë, rritja ekonomike përcaktohet vetëm nga reformat strukturore dhe nga shkalla e konkurrencës së ekonomisë sonë kundrejt partnerëve tregtarë dhe kundrejt tregut botëror. Nga ana tjetër, detyra e politikave fiskale e monetare është të evitojnë devijimet afatshkurtra të ekonomisë nga ky trend afatgjatë dhe të krijojnë një ambient të qëndrueshëm për zhvillimin ekonomik e financiar të vendit.

Ekonomia shqiptare ka nisur tashmë rrugën drejt integrimit në Bashkimin Evropian. Ky proces ka si rezultat final rritjen e mirëqenies ekonomike, por ai nënkupton edhe integrimin e plotë në zinxhirët tregtarë, industrialë e financiarë, si dhe adoptimin një filozofie të vetme të menaxhimit ekonomik, një praktikë të vetme rregullatore e institucionale, dhe pranimin e rregullave të harmonizuara të lojës në të gjithë hapësirën evropiane.

Në këtë kontekst dua të theksoj dy momente kryesore:

Së pari, procesi i integrimit evropian duhet të jetë ankora jonë më e fortë e reformave strukturore, qofshin këto ligjore, rregullative, institucionale, infrastrukturore apo politike. Natyrisht që Shqipëria ka shumë për të bërë dhe veçoritë e ekonomisë sonë lejojnë gjithë hapësirat e duhura për kalibrimin e këtyre modeleve, në përshtatje me avantazhet krahasuese dhe nevojat parësore të vendit. Por, besoj se do të ishte e dobishme që të gjithë këto reforma të integroheshin në këtë vizion unik integrimi. Së dyti, biznesi shqiptar duhet të bëjë më shumë për të nxitur procesin e integrimit. Ai duhet të jetë më aktiv në adoptimin e teknologjive dhe proceseve prodhuese e menaxhuese të përparuara.

Po kështu, edhe sektori financiar ka vend të jetë më vizionar në politikat e prioritetet e tij të shpërndarjes së burimeve financiare, si dhe të punojë më shumë për nxitjen e tërheqjes së investitorëve të huaj dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit me biznesin lokal.

Gjykoj se me të drejtë, kemi theksuar se integrimi rajonal është një hap i domosdoshëm që duhet t'i paraprijë integrimit evropian. Ekonomitë e rajonit janë të vogla në terma krahasuese me partnerët tanë tregtarë, por krijimi i zonave të unifikuara në terma të tarifave doganore, sistemeve ligjore e praktikave juridike, integrimit financiar dhe politikave zhvillimore, krijon nxitjen e duhur për thithjen e investimeve të huaja dhe rrit fuqinë tonë negociuese me partnerët ndërkombëtarë.

***

Në mbyllje të fjalës sime, dëshiroj të ritheksoj se Banka e Shqipërisë e shikon stabilitetin ekonomik e financiar të vendit si një kusht të domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Tashmë kjo nuk është më një çështje teorike e disiplinimit të sjelljes së politikës ndaj ekonomisë apo diskutim mbi respektimin e barazisë midis brezave, por një mësim i hidhur nga kriza e fundit dhe një realitet i prekshëm për shumë vende të Eurozonës. Ne i kemi ftuar në vazhdimësi të gjithë politikëbërsit dhe agjentët ekonomikë në vend të bëhen pjesë e këtij vizioni.

Si autoriteti monetar i vendit, i mandatuar për të garantuar stabilitetin e çmimeve në vend, ne kemi punuar dhe do të vazhdojmë të punojmë për t'i dhënë vendit një mjedis me inflacion të ulët. Ky ambient rrit garancinë e kursimtarëve dhe të investuesve në planet e tyre afatgjata dhe mundëson zhvillimin e sistemit financiar. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë është një politikë moderne, e cila bazohet në parimet më të avancuara të bankingut qendror dhe përdor një kuadër instrumentesh, e një aparat komunikimi në linjë me praktikat e BQE-së. Angazhimi i Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve është ylli polar i punës sonë. Hartimi dhe zbatimi në mënyrë të pavarur i politikës monetare, ekskluzivisht në funksion të stabilitetit të çmimeve, është një nga ankorat e brendshme të ekonomisë shqiptare, e cila duhet të ruhet e të forcohet më tej.

Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia shqiptare ka nevojë edhe për dy ankora të tjera: stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë fiskale.

Funksioni jonë rregullues e mbikëqyrës i sistemit bankar, i cili përbën dhe rreth 95% të sistemit financiar në Shqipëri, ka qenë i suksesshëm në garantimin e stabilitetit financiar të vendit. Edhe ky funksion është zhvilluar dhe kryhet në linjë me praktikat më të mira botërore, në bashkëpunim të vazhdueshëm me institucione homologe apo partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

Mundësia për të patur një vizion të integruar të zhvillimeve ekonomike e financiare, si dhe mundësia për të kombinuar, por jo përzierë politikën monetare me masat makroprudenciale, ka rritur efektivitetin e aksionit të Bankës së Shqipërisë dhe ka ndihmuar në përmbushjen më të mirë të dy objektivave individuale të stabilitetit financiar dhe të stabilitetit të çmimeve. Ky rregullim institucional, i cili është provuar efektiv dhe është në përputhje me tendencat më të fundit në rang botëror, duhet të vazhdojë të funksionojë si një ankorë e dytë e politikave të brendshme ekonomike.

Së fundi, Banka e Shqipërisë gjykon se Shqipëria duhet të ketë sa më shpejt një rregull fiskal, jo vetëm të qartë e transparent, por edhe efektiv në disiplinimin e politikës fiskale dhe në ruajtjen e besimit të tregjeve financiare ndaj shëndetit të financave publike.

Kjo ankorë e tretë do të plotësonte kuadrin e ankorave të brendshme të politikave ekonomike. Së bashku me bashkëpunimin e ngushtë me institucionet financiare ndërkombëtare, ajo do të mundësonte një kuadër konsistent dhe transparent për zhvillimin e vendit. Garantimi i likuiditetit dhe aftësisë paguese të ekonomisë shqiptare, përmes partnershipeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, është prioriteti i politikave të bankës qendrore. Ky vizion dhe partneritet duhet të bëhet boshti i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kombëtare.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
25 shtator 2013

Sot, në datën 25 shtator 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë, në nivelin 3.5%.

Në gjykimin e Këshillit, presionet inflacioniste që vijnë nga sektori real dhe financiar i ekonomisë janë dhe do të vazhdojnë të mbeten të ulëta. Këto rrethana e bëjnë të nevojshme ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare edhe për periudhën në vijim.

Stimuli monetar, i transmetuar nëpërmjet normave të ulëta të interesit bazë dhe injektimit të vazhdueshëm të likuiditetit, krijon kushtet e duhura për respektimin e objektivit tonë të inflacionit në një periudhë afatmesme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Sipas të dhënave të INSTAT-it, inflacioni vjetor zbriti në vlerën 1.2% në muajin gusht. Rënia e shpejtë e inflacionit gjatë dy muajve të fundit ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së ulët të çmimeve të ushqimeve, veçanërisht të atyre të stinës. Gjithashtu, në kahun rënës kanë ndikuar inflacionet negative të çmimeve të mallrave të konsumit joushqimor dhe të çmimeve të strehimit. Inflacioni i mallrave dhe shërbimeve të kategorive të tjera të shportës ka qëndruar në vlerat e ulëta pozitive të muajve të mëparshëm.

Ndonëse presionet e përgjithshme inflacioniste mbeten të dobëta, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se normat e ulëta të inflacionit, gjatë dy muajve të fundit, janë shkaktuar nga faktorë me veprim të përkohshëm të ofertës.

Analiza e faktorëve makroekonomikë sugjeron se ecuria e përmbajtur e çmimeve të konsumit vijon të reflektojë në një masë të madhe kërkesën e ulët në ekonomi dhe hendekun negativ të prodhimit. Nivelet e ulëta të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese kanë frenuar rritjen e pagave, të kostove të prodhimit dhe të marzheve të fitimit. Në të njëjtën kohë, inflacioni i importuar paraqitet i ulët, si pasojë e normave të ulëta të inflacionit në vendet partnere dhe e ecurisë së qëndrueshme të kursit të këmbimit. Së fundi, edhe ecuria

e likuiditetit dhe e pritjeve inflacioniste është në linjë me normën e ulët të inflacionit.

Informacioni i ri mbi zhvillimet në ekonominë reale gjatë tremujorit të dytë e të tretë të vitit, është i pakët. Analiza e të dhënave indirekte të disponuara sinjalizon për rritje ekonomike pozitive, por të ulët.

Në ndryshim nga tremujorët e mëparshëm, sektori publik ka qenë nxitësi kryesor i rritjes së kërkesës agregate në tremujorin e dytë, në një kohë që kontributi i eksporteve neto ka qenë lehtësisht negativ. Ecuria e kërkesës së sektorit privat mbetet ende e dobët, duke sinjalizuar për rritje të plogësht të konsumit dhe për tkurrje të investimeve.

Ecuria e treguesve buxhetorë ka reflektuar politikën fiskale ekspansioniste të ndjekur gjatë gjashtëmujorit të parë. Deri në muajin gusht, shpenzimet buxhetore kanë rezultuar 9.2% më të larta se një vit më parë, të nxitura në një masë të konsiderueshme nga rritja e shpenzimeve kapitale. Nga ana tjetër, të ardhurat kanë regjistruar performancë të dobët, duke shënuar rënie vjetore prej 3.8%. Kjo ecuri është materializuar në një deficit buxhetor rreth 1.3 herë më të lartë se viti i mëparshëm. Rritja e deficitit është reflektuar në rritjen e mëtejshme të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së; në fund të tremujorit të dytë ky raport vlerësohet të ketë arritur në nivelin 63.5%.

Për të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se adoptimi i një rregulli fiskal, i cili do të mbështeste në mënyrë efektive dhe transparente qëndrueshmërinë e borxhit publik, do të ishte një hap i duhur drejt reduktimit të primeve të rrezikut dhe drejt disiplinimit afatgjatë të politikës fiskale. Gjithashtu, rregulli fiskal do të krijonte një kuadër konsistent për hartimin e trajektoreve afatmesme të shpenzimeve dhe deficitit buxhetor, të cilat do të mundësonin përmbushjen e njëkohshme të nevojave ciklike të ekonomisë dhe të objektivit afatgjatë të stabilitetit fiskal.

Të dhënat e sektorit të jashtëm të ekonomisë dëshmojnë për kontribut negativ të kërkesës së huaj në rritjen e aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit, si pasojë e rritjes me 1.5% të deficitit të eksporteve neto në këtë tremujor. Nga ana tjetër, të dhënat e muajit korrik tregojnë për një tkurrje nominale me 14.6% të deficitit tregtar, të shkaktuar kryesisht nga rritja e lartë vjetore e eksporteve, prej 23.9%. Pavarësisht luhatshmërisë afatshkurtër, pozicioni i jashtëm i ekonomisë shqiptare mbetet një nga dobësitë strukturore të saj.

Ai reflekton si konkurrueshmërinë e ulët të produkteve tona në tregjet botërore, ashtu edhe nevojën për një balancë më të mirë afatgjatë të kursimeve dhe të investimeve në ekonomi.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga prime në rënie rreziku të inflacionit e të likuiditetit, si dhe nga një përcjellje më e plotë e reduktimeve të normës bazë të interesit në segmente të ndryshme të tregut. Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë qëndruar pranë normës bazë dhe kanë shfaqur

luhatshmëri të ulët. Në tregun primar, yield-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë shënuar një rënie të shpejtë për të gjitha maturitetet, veçanërisht për ato më të gjata, duke zbutur pjerrësinë e kurbës së yield-eve. Rënie të normave të interesit janë shënuar edhe në tregun e depozitave, ndërkohë që normat e interesit për kreditë në lekë vijojnë të shfaqin përgjigje të zbehtë ndaj stimulit monetar të Bankës së Shqipërisë. Përcjellja e plotë e sinjaleve të politikës monetare në tregun e kredive frenohet nga prania e primeve të larta të rrezikut të moskthimit, si dhe nga oreksi i ulët për rrezik nga ana e bankave dhe e bizneseve.

Për rrjedhojë, kredia për sektorin privat është tkurrur me 1.5% në terma vjetorë, e ndikuar nga disa rregullime në bilanc të bankave individuale, por edhe nga ecuria e dobët e kredisë për individë dhe tkurrja e kredisë për biznese.

Duke u ndalur në ecurinë e ekonomisë në të ardhmen, informacioni i ri i disponuar lë të pandryshuara projeksionet tona bazë. Në tremujorët e ardhshëm, ekonomia pritet të rritet me norma të ulëta pozitive, por ndjeshëm nën potencial. Në mungesë të hapësirave për një stimul të qëndrueshëm fiskal, rritja e kërkesës agregate në afat të shkurtër pritet të mbështetet nga kërkesa e huaj, ndërkohë që në një afat më gjatë, ecuria e konsumit dhe investimeve private do të përcaktoj në madhësinë e rritjes ekonomike. Rritja nën potencial e ekonomisë do të kushtëzojë prezencën e presioneve të dobëta inflacioniste nga kahu i kërkesës. Gjithashtu, edhe presionet e kahut të ofertës vlerësohen të përmbajtura. Në mungesë të goditjeve të paparashikuara të ofertës, inflacioni vjetor pritet të shënojë vlera të ulëta në tremujorët e ardhshëm.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë, në nivelin 3.5%. Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se kushtet aktuale monetare sigurojnë përmbushjen e objektivit tonë të inflacionit në periudhën afatmesme, duke ofruar njëkohësisht edhe stimulin e nevojshëm monetar për riaktivizimin e kërkesës private në vend. Në veçanti, rënia e shpejtë e yield-eve gjatë muajit të fundit reflekton nivelin e ulët të normës bazë të interesit, pritjet për inflacion të ulët në të ardhmen, si dhe huamarrjen më të ulët të qeverisë në tregjet e brendshme. Kjo rënie krijon hapësira për reduktimin e normës së interesit të kredisë për sektorin privat. Projektimi i këtij ambienti edhe në të ardhmen do të mundësonte një transmetim më të mirë të politikës monetare në ekonomi.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në çeljen e ekspozitës së Bankës së Shqipërisë
4 tetor 2013

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar pjesëmarrës, në kërkim të alternativave për paraqitjen e rrugëtimit 100-vjeçar të bankingut qendror, Banka e Shqipërisë hap sot këtë ekspozitë me tematikë "Paraja dhe edukimi financiar përmes saj". Historia e konsolidimit të shtetit dhe monedhës kanë ecur dorë më dorë ndër shekuj. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për rëndësinë e parasë në ngjarjet e përditshme të qytetërimit tonë. Para, lekë, franga, ecu, euro, dollarë ... mjete. Sido që ta quajmë, paraja është e rëndësishme! E rëndësishme jo vetëm për funksionet e saj, për të paguar, për të kursyer apo për të depozituar, por edhe si një dëshmi historike dhe artistike e kombeve ndër shekuj. Për ata me besim fetar, dashuria për para ishte rrënjë e gjithë të këqijave. Për gjeneralët, ajo ishte arma më e fortë e luftës. Për revolucionarët, pranga e punëtorëve. Por çfarë janë paratë? Një mal me argjend apo pllaka prej qeramike dhe copa letrash? Si arritëm në kohën kur paraja është, në të shumtën e rasteve, e padukshme? Pak a shumë një grupim numrash në ekrane kompjuterësh? Nga erdhi paraja dhe si evoloi ajo? Ashtu si do e shihni pas pak, kjo ekspozitë synon t'i japë përgjigje këtyre pyetjeve në një gjuhë sa më të kuptueshme për të gjithë, por së pari ajo përkujton një datë të shënuar historike.

Data e çeljes së ekspozitës "...Banka për Shqipërinë është një i dyti fitim, pas lirisë.." është 4 tetori 2013. Si sot 100 vite të shkuara, në emër të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, Ismail Qemal bej Vlora nënshkroi koncesionin e parë për krijimin e një banke kombëtare shqiptare. Jam i lumtur dhe i emocionuar, jo vetëm si Guvernator i Bankës Qendrore por edhe si qytetar shqiptar, për çeljen e kësaj ekspozite. Ajo sjell në vëmendjen e publikut një ndër meritat e babait të Pavarësisë, të cilat e vendosin atë në piedestalin e merituar për shkak të aktivitetit dhe vizionit të tij si shtetar.

Historia na mëson se bankingu qendror nuk ka lindur në një ditë të vetme. Ai nuk është i lidhur me një ngjarje të veçantë dhe për më tepër nuk është produkt i një ndodhie rastësore. Bankingu qendror ka lindur si nevojë e shteteve për të pasur një institucion që do të krijonte dhe garantonte furnizimin e ekonomisë me para.

Ai lindi si nevojë për të mbushur arkat e boshatisura të mbretërive, për të financuar fushatat luftarake, për të zgjeruar territoret dhe rritur numrin e kolonive, si dhe për të absorbuar pasojat e krizave ekonomike dhe financiare me qëllim kthimin e ekonomisë në ekuilibër.

Përkundrejt këtij konteksti, bankingu qendror shqiptar, ka një histori të ndryshme. Ismail Qemali, ky burrë i zgjuar, ideoi krijimin e bankës qendrore duke e bazuar atë në konceptin e lirisë, asaj që i kishte munguar kahera këtij populli. Në përurimin e bankës, ai shprehet: "E themi me lavdërim se puna e bankës, për Shqipërinë është një i dyti fitim pas lirisë, dhe nga pikëpamja ekonomike dhe nga ajo politike."

Sa herë që lexoj këtë thënie, kuptoj se sa thjesht Ismail Qemali ka arritur ta sintetizojë domosdoshmërinë për të konsoliduar pavarësinë e fituar një vit më parë me një bazë solide financiare për krijimin e një shoqërie të begatë. Ismail Qemali e konceptoi krijimin e bankës si një institucion financiar, i cili duhej t'i jepte jetë zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të shtetit të pavarur shqiptar.

Nuk është e rastësishme që në fjalimin e tij, të mbajtur disa ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes mbi krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, Ismail Qemali u shpreh: "Shqipëria, që atë ditë kur pati fatin e bardhë të bëhet një shtet në mes të shteteve të Ballkanit e të Evropës, ka të drejtë të ketë një edhe më tepër banka për të siguruar kreditin e botshëm si popull edhe kreditin e veçantë për secilin shqiptar, si njeri."

Fjalët e tij vizionare qëndrojnë po aq të vlefshme edhe sot. Jam krenar që sot, njëqind vjet më pas, falë përpjekjeve të shumta kemi një bankë qendrore moderne që gëzon besimin e publikut dhe të aftë për të përmbushur misionin e saj kryesor: stabilitetin e çmimeve dhe atë financiar të vendit. Përgjatë njëzet viteve të fundit, shumë gra dhe burra, nëna dhe baballarë, dhe tashmë të rinj dhe të reja apo nipër dhe mbesa të profesionistëve të parë, kanë kontribuar dhe kontribuojnë me gjithë shpirt për t'i dhënë jetë një institucioni modern e të suksesshëm siç është Banka e Shqipërisë. Ajo që mendoj se karakterizon punën e tyre mund të përmblidhet në tre fjalë të thjeshta: përkushtim, profesionalizëm dhe integritet.

Gjej rastin që t'i falënderoj të gjithë punonjësit e Bankës së Shqipërisë për punën e kryer deri më tash, duke shprehur besimin se përkushtimi i tyre do të jetë i pakursyer edhe në të ardhmen.

Kriza ekonomike dhe financiare, rishtazi na dëshmoi se roli i bankave qendrore është themeltar për stabilitetin dhe mirëqenien e një vendi. Besoj se Banka e Shqipërisë e ka përmbushur këtë mision me profesionalizëm duke bërë të mundur një ambient të qëndrueshëm veçanërisht përsa i takon stabilitetit të sistemit bankar. Kjo nuk ka qenë e rastësishme. Nuk dua të përsëris veten, por e gjykoj të domosdoshme të ritheksoj se Banka e Shqipërisë ka qenë vigjiliente në monitorimin skrupuloz të shëndetit financiar të sistemit, si para edhe pas shpërthimit të krizës.

Me profesionalizëm, dedikim dhe largpamësi kemi arritur të konsolidojmë pavarësinë e institucionit, në sajë të një komunikimi të vazhduar me gjithë aktorët e tregut, duke ruajtur raportin "pavarësi – llogaridhënie". Transparenca është baza e vendimmarrjes në fushën e politikës monetare ashtu edhe në

atë të stabilitetit financiar. Në sintezë të të gjitha qëndrimeve tona ka qenë përpjekja jonë për të injektuar optimizëm racional në lidhje me sjelljen e agjentëve ekonomikë, gjatë periudhës së vështirë që na ka imponuar kriza globale.

Besoj se është e domosdoshme që në të ardhmen kjo frymë të përqafohet dhe të përcillet në ekonomi nga të gjithë politikëbërësit, agjentët ekonomikë, tregu financiar, përfshirë dhe individët e thjeshtë. Në thelbin e kësaj filozofie qëndrojnë reformat strukturore të gjithanshme, për të fituar kohë drejt ritmeve të qëndrueshme të zhvillimit afatgjatë të vendit.

Të nderuar pjesëmarrës,

Bankingut qendror shqiptar i duhet një datë lindjeje. Kjo datë i jep atij mundësi të nderojë përpjekjet e baballarëve të kombit për krijimin e bankës qendrore dhe konsolidimin e Shtetit Shqiptar; të kujtojë përpjekjet e të gjithë atyre që përmes punës kanë kontribuar në zhvillimin dhe lartësimin e këtij institucioni; si dhe të vështrojë sfidat e së ardhmes dhe të gjejë rrugët për përballimin e tyre. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbetet një aktor i përgjegjshëm dhe i besueshëm, në përmbushje të misionit të saj ligjor dhe në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Ky 100-vjetor i parë i bankingut tonë qendror, vjen sot si një urim i mirë për të gjithë ne.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
30 tetor 2013

Sot, në datën 30 tetor 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.5%.

Në gjykimin e Këshillit, presionet inflacioniste që vijnë nga sektori real dhe financiar i ekonomisë janë dhe do të vazhdojnë të mbeten të ulëta. Këto rrethana e bëjnë të nevojshëm ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare edhe për periudhën në vijim. Stimuli monetar, i transmetuar nëpërmjet normave të ulëta të interesit bazë dhe injektimit të vazhdueshëm të likuiditetit, krijon kushtet e duhura për respektimin e objektivit tonë të inflacionit, në një periudhë afatmesme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Ekonomia shqiptare është karakterizuar nga rritja e ngadaltë ekonomike dhe nga presione të ulëta inflacioniste, gjatë vitit 2013. Rritja ekonomike u ngadalësua në 1,1% në tremujorin e dytë të vitit, ndërkohë që informacionet e disponuara sugjerojnë për një aktivitet të dobët ekonomik edhe gjatë tremujorit të tretë.

Ecuria e dobët e kërkesës private ka kompensuar impulset pozitive në rritje, të gjeneruara nga stimuli fiskal dhe nga kërkesa e huaj, në gjashtëmujorin e parë. Konsumi dhe investimet e sektorit privat vlerësohen të kenë patur një ecuri të dobët, ndërsa kërkesa e huaj ka vijuar të frenohet nga situata ekonomike e partnerëve tanë tregtarë.

Pasiguria e agjentëve privatë mbi të ardhmen është reflektuar në gatishmëri të ulët për të shpenzuar dhe në kërkesë të ulët për kredi. Kjo pasiguri ka penguar përcjelljen e stimulit monetar në ekonomi. Gjithashtu, edhe politikat konservatore të sistemit bankar kanë ruajtur kushte të shtrënguara kreditimi dhe kanë penguar funksionimin normal të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare.

Pavarësisht këtij konteksti, stabiliteti ekonomik e financiar i vendit është ruajtur. Pritjet e agjentëve privatë për inflacionin janë ruajtur pranë objektivit

të Bankës së Shqipërisë, duke treguar një perceptim të mirë të sinjaleve të politikës monetare dhe komunikimit të Bankës së Shqipërisë. Sistemi bankar mbetet i shëndetshëm, i mirëkapitalizuar dhe me likuiditetin e nevojshëm për të siguruar rikthimin e ndërmjetësimit financiar në nivele të kënaqshme, me gjithë problemet që lidhen me cilësinë e kredisë.

Inflacioni mesatar vjetor vijoi prirjen ngadalësuese edhe në tremujorin e tretë të vitit, duke qëndruar në nivelin 1.5%. Profili i inflacionit u përcaktua thuajse tërësisht nga kontributi i inflacionit të çmimeve të produkteve bujqësore.

Reduktimi i këtyre çmimeve përtej efektit sezonal të lidhur me plotësimin e kërkesës nga prodhimi bujqësor vendas, është ndikuar edhe nga rënia e çmimeve të importit të ushqimeve të përpunuara në vendet e origjinës. Çmimet e kategorive të tjera të mallrave të konsumit kanë dhënë kontribute të ulëta në inflacionin total, duke u kompensuar ndërmjet tyre.

Niveli i ulët i inflacionit dhe veçanërisht i komponentit afatgjatë të tij, tregon për praninë e hendekut negativ të prodhimit. Dobësia e kërkesës së brendshme ka krijuar kapacitete të pashfrytëzuara në ekonomi dhe ka sjellë presione të dobëta për rritjen e kostove të prodhimit dhe të pagave. Gjithashtu, qëndrueshmëria e çmimeve në tregjet botërore dhe e kursit të këmbimit ka rezultuar në presione të përmbajtura nga inflacioni i importuar. Zhvillimet në ekonominë reale, në veçanti dobësia e kërkesës së brendshme dhe ekspansioni i ulët monetar, kushtëzojnë ruajtjen e normave të ulëta të inflacionit, edhe për periudhën në vijim. Pritjet inflacioniste qëndrojnë të ankoruara dhe në linjë me stabilitetin e çmimeve.

Rritja ekonomike, gjatë tremujorit të dytë, u mbështet nga kërkesa e sektorit publik, ndërkohë që komponentët e tjerë rezultuan të dobët. Shpenzimet konsumatore, ndonëse vlerësohet të kenë qenë më të larta se në tremujorin e parë, nuk kanë arritur të japin një kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Ecuria e këtij komponenti të kërkesës së brendshme vijon të ndikohet nga pasiguria e lartë dhe nga burimet e kufizuara të financimit.

Të përballur me një kërkesë të ulët konsumatore, si dhe në prani të kapaciteteve të pashfrytëzuara dhe të kushteve relativisht të shtrënguara të kreditimit, edhe investimet private kanë mbetur të ulëta.

Zhvillimet në treguesit fiskalë, në 9 muajt e parë të vitit, dëshmojnë për një politikë fiskale stimuluese, veçanërisht në gjysmën e parë të tij. Tiparet stimuluese kanë qenë të pranishme si në kahun e shpenzimeve, ashtu edhe në atë të ardhurave. Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet buxhetore janë rritur me 8.3% kundrejt vitit të kaluar, të nxitura si nga shpenzimet korrente ashtu edhe nga ato kapitale. Në të njëjtën kohë, të ardhurat kanë shënuar rënie vjetore prej 4%, duke reflektuar rënien e një pjese të madhe të zërave përbërës të tyre. Kjo ecuri e të ardhurave dhe shpenzimeve ka sjellë në një deficit buxhetor rreth 1.25 herë më të lartë se në vitin e kaluar, pjesa më e madhe e të cilit është financuar me instrumente të brendshme afatgjata. Dinamika e deficitit buxhetor është reflektuar në rritjen e mëtejshme të borxhit publik.

Të dhënat e sektorit të jashtëm të ekonomisë evidentojnë ecuri të dobët të kërkesës së huaj neto, gjatë tremujorit të dytë të vitit. Eksportet reale neto u ngushtuan me 1.5% gjatë kësaj periudhe, duke kontribuar negativisht në kërkesën agregate.

Ecuria e tyre është përcaktuar në mënyrë të njëkohshme nga rritja e importeve dhe ngadalësimi i eksporteve në terma realë. Të dhënat e tregtisë së jashtme të mallrave për muajt korrik dhe gusht, tregojnë për ngushtim nominal vjetor të deficitit tregtar, në masën 15.1%, gjatë kësaj periudhe. Eksportet shënuan një rritje vjetore prej 15.8% gjatë periudhës në fjalë, ndërsa importet ranë me 3.0%.

Tregjet financiare vijojnë të reflektojnë prime të ulëta të rrezikut dhe inflacionit. Në tregun ndërbankar, vëllimi i tregtimit është rritur dhe normat e interesit kanë shënuar rënie, duke shfaqur njëkohësisht edhe luhatshmëri më të ulët. Në tregun primar, yield-et e letrave me vlerë kanë regjistruar rënie të mëtejshme, veçanërisht ato me maturitet më të lartë. Kurba e yield-eve është zhvendosur poshtë dhe pjerrësia e saj është reduktuar. Rënia e normave të interesit ka vijuar edhe në tregun e depozitave, ndërkohë që në muajin gusht u regjistrua rënie edhe në normat e interesit të kredisë. Pavarësisht këtij zhvillimi, ecuria e kredisë ka qenë e dobët gjatë këtyre muajve.

Kredia për sektorin privat, pas ngadalësimit të vazhdueshëm gjatë pjesës së parë të vitit, është tkurrur në muajt korrik dhe gusht. Në fund të muajit gusht, ajo është 2.0% më e ulët se një vit më parë. Ecuria e kreditimit ka reflektuar kërkesën e dobët të bizneseve dhe individëve për financim, por edhe kushtet e shtrënguara të ofertës për kredi.

Një faktor pozitiv i vënë re gjatë muajve të fundit dhe i inkurajuar nga Banka e Shqipërisë, është pastrimi i bilanceve të bankave nga kreditë me probleme pa shpresë rikuperimi. Përtej ndikimit statistikor të tij në afat të shkurtër, pastrimi i bilanceve të bankave është pjesë e një procesi kompleks të administrimit të portofolit të kredive me probleme.

I zbatuar me eficiencë dhe në mënyrë aktive, në afat të gjatë, ky proces krijon premisat për çlirimin e kapaciteteve të kredidhënies në ekonomi dhe për rikuperimin e rritjes së shëndetshme të kredisë.

Analiza e treguesve monetarë tregon për presione të ulëta inflacioniste me natyrë monetare në ekonomi. Rritja vjetore e ofertës monetare është ngadalësuar ndjeshëm, duke zbritur në nivelin 2.7% në muajin gusht. Ky ngadalësim ka ardhur si pasojë e ecurisë më të dobët të prurjeve valutore dhe kërkesës më të ulët për financim të sektorit privat. Nga ana tjetër, rritja e financimit të sektorit publik nëpërmjet bankave, gjatë këtij viti, ka mbështetur rritjen e parasë në ekonomi.

Rritja ekonomike pritet të jetë e dobët në vitin në vazhdim, në prani të dobësimit të kërkesës së huaj dhe mungesës së stimulit fiskal. Ndërkohë, të dhënat e disponuara deri tani nuk japin sinjal për gjallërim të konsumit dhe investimeve në të ardhmen e afërt.

Rritja nënpotencial e ekonomisë do të kushtëzojë rritjen e përmbajtur të çmimeve të konsumit në periudhën e ardhshme. Në mungesë të goditjeve të papritura nga kahu i ofertës, inflacioni vjetor pas 12 muajve pritet të luhatet në intervalin 0.4% - 3.1%, me një probabilitet ndodhjeje 90%.

Parashikimet e mësipërme kushtëzojnë ruajtjen e natyrës stimuluese të politikës monetare edhe përgjatë tremujorëve në vijim. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të furnizojë sistemin bankar me të gjithë likuiditetin e nevojshëm për funksionimin normal të tregjeve financiare.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë, në nivelin 3.5%. Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se kushtet aktuale monetare mundësojnë arritjen e objektivit tonë të inflacionit në periudhën afatmesme, duke ofruar njëkohësisht edhe stimulin e nevojshëm monetar për riaktivizimin e kërkesës private në vend.

FJALA E Z. ARDIAN FULLANI, GUVERNATOR I BANKËS SË SHQIPËRISË

Në Forumin e 7-të të Biznesit Greqi-Shqipëri
"Roli i bankave, si ura drejt zhvillimit"
13 nëntor 2013

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Është kënaqësi për mua të marr pjesë në këtë forum ekonomik, i cili mbledh së bashku përfaqësues të sipërmarrjeve shqiptare dhe greke, dhe gjithashtu të bankave që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendet tona. Jam veçanërisht i kënaqur që kemi me ne sot Guvernatorin e Bankës së Greqisë, z. Provopoulos, pjesëmarrja e të cilit tregon vëmendjen që ai personalisht dhe Banka e Greqisë po i kushtojnë mbështetjes së sektorit të biznesit në përgjithësi dhe marrëdhënies ekonomike midis Greqisë dhe Shqipërisë, në veçanti. Kjo përqasje është ajo e duhura. Sektori privat i biznesit është kontribuuesi kryesor në PBB-në e vendeve përkatëse. Sektori i biznesit po kalon disa vështirësi serioze kohët e fundit në Greqi, gjë që lidhet me nevojën për uljen e ndërmjetësimit financiar dhe ristrukturimin, me qëllim përmirësimin e produktivitetit dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Këto janë sfida të mëdha që lidhen me kostot e larta ekonomike dhe shoqërore. Megjithatë, besoj se këto sakrifica të popullit grek do të shpërblehen në të ardhmen, duke i hapur rrugë një ekonomie më të gjallë dhe më të fortë, si dhe një sektori biznesi më konkurrues.

Edhe sektori i biznesit në Shqipëri përballet me sfida. Bizneset shqiptare duhet të ristrukturohen për t'u bërë më konkurrues. Kjo duhet të ndodhë në një kohë kur Shqipëria shënon rritje ekonomike të frenuar dhe kërkesë të dobët. Këtë vit presim që rritja ekonomike të jetë rreth 1.9%. Shifra mund të jetë pak më e lartë vitin tjetër, megjithatë, ende mbetet më e kushtëzuar nga kërkesa e jashtme, e cila në vetvete, është mjaft e pasigurt. Sektori ynë i biznesit duhet të gjejë rrugë dhe tregje të reja për të mbështetur veprimtarinë dhe rritjen e tij.

Përvoja jonë ka treguar se bizneset ose industritë me tregje produktesh më të diversifikuara, dhe që u kujdesën për strukturat e kostove dhe për bilancet e tyre, e përballuan më mirë periudhën e rënies ekonomike dhe kanë parashikime më të mira lidhur me rritjen e pritshme ekonomike. Kjo shërben për të treguar se, ashtu si dhe në fusha të tjera të jetës, një përqasje afatgjatë ndaj biznesit jep rezultate më të mira.

Financimi është i rëndësishëm në periudha të rritjes ekonomike, por ai nevojitet gjithashtu dhe në kohë të vështira për të lehtësuar ristrukturimin e biznesit dhe për të siguruar qëndrueshmërinë në kohë të zbatimit të ndryshimit. Si në Greqi dhe Shqipëri, ashtu dhe në Evropë, sektori bankar është burimi mbizotërues i financimit.

Ky fakt nxjerr në pah rëndësinë e një sistemi bankar të shëndoshë për ekonomitë tona dhe ka ngritur shqetësime të thella në Evropë, lidhur me mundësitë e rimëkëmbjes ekonomike pa kreditim, duke pasur parasysh rritjen aktuale shumë të dobët të kredisë. Ndërsa objektivi afatgjatë duhet të jetë krijimi i kushteve për një sistem financiar më të ekuilibruar dhe më të diversifikuar, objektivat më afatshkurtra duhet të përqendrohen për të pasur një sistem financiar të qëndrueshëm, që ofron shërbime financiare të mjaftueshme për klientët e tij, si depozitues të kursimeve ashtu dhe huamarrës, duke ruajtur kështu peshën përkatëse të kontributit të këtij sistemi në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Sektori bankar në Shqipëri e ka ndjerë ndikimin e krizës financiare ndërkombëtare, pasi standardet më të lehtësuara të kredidhënies para krizës dhe rritja më e dobët ekonomike pas krizës janë përkthyer në cilësi më të ulët të aktiveve dhe vështirësi për të ruajtur në mënyrë të vazhdueshme rezultate financiare pozitive. Përballë rrezikut më të lartë të kredisë, kushtet e kredisë janë shtrënguar dhe rritja e saj ka qenë e ngadaltë. Në shtator 2013, kredia shënoi rritje negative, shkaktuar nga kredia në monedhë të huaj dhe ajo për bizneset.

Megjithatë, sistemi bankar mbetet i mirëkapitalizuar dhe likuid. Bankat kanë qenë të afta të sjellin kapital të ri dhe mbështetje financiare nga bankat e tyre mëma. Veçanërisht, bankat greke që veprojnë në Shqipëri kanë pasur mbështetje të fuqishme nga bankat e tyre mëma deri tani, dhe ne presim që kjo të vazhdojë dhe në të ardhmen, nëse do të jetë e nevojshme. Në shtator 2013, kapitali i ponderuar me rrezikun i sektorit bankar ishte 17.8%, ndërkohë që raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra ishte 36.5%. Sektori ka treguar preferencë të lartë për investime në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë shqiptare dhe në vendosjet jashtë vendit.

Banka e Shqipërisë ka marrë një sërë masash për të mbështetur rritjen e kreditimit dhe për të trajtuar problemet e lidhura me cilësinë e saj. Duke marrë në konsideratë presionet e përmbajtura inflacioniste, ne e kemi ulur normën bazë të interesit në nivelin më të ulët historik prej 3.5%. Normat e interesit të kredisë kanë ndjekur prirje të njëjtë, ndonëse me ritëm më të ngadaltë. Duke patur parasysh dobësinë e kanalit të kredisë në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, jemi përpjekur që të forcojmë ndikimin tonë me miratimin e disa masave kundërciklike për të nxitur rritjen e kreditimit. Në këtë drejtim, kemi rritur përkohësisht kërkesat për kapital për vendosjet e bankave jashtë vendit dhe kemi ulur ato për kreditimin në ekonominë vendase.

Gjithashtu, ne po nxisim ristrukturimin e kredisë në fazë të hershme, duke i ulur kërkesat për provigjonim, nëse është e nevojshme. Në bashkëpunim me autoritete të tjera dhe me industrinë bankare, janë marrë disa masa ligjore dhe rregullatore për përmirësimin e procesit të ekzekutimit të kolateralit dhe lehtësimit të fshirjes së huave nga bilanci.

Rezultati i këtyre masave ka qenë i ndryshëm deri tani, por në muajt e ardhshëm presim që ndikimi i tyre të jetë i dukshëm. Kjo lidhet edhe me

angazhimin e qeverisë për të shlyer detyrimet e prapambetura ndaj sektorit privat gjatë vitit të ardhshëm. Megjithatë, është e rëndësishme që industria bankare të vazhdojë të mbështesë propozime të shëndetshme biznesi nga ana e huamarrësve. Është e vërtetë që veprimtaria bankare mund të nxitet nga fitimi, por, nga ana tjetër, ajo mbështetet në marrëdhënien me klientët. Ky është momenti kur kjo marrëdhënie po vihet në provë, dhe një menaxhim i mirë i bankës duhet të shohë përtej sfidave aktuale, për ta ruajtur dhe për ta forcuar këtë marrëdhënie.

Fokusi ynë si mbikëqyrës i sektorit bankar do të mbetet që të kemi institucione të mirëkapitalizuara dhe likuide, dhe që vazhdimisht i përmirësojnë standardet për administrimin e rrezikut. Në komunikimet tona të ardhshme me bankat, do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë mënyrës se si ato vlerësojnë dhe monitorojnë kredinë, rrezikun e tregut dhe atë të likuiditetit, dhe se si i përfshijnë rezultatet e këtij procesi në vendimet e tyre administruese.

Së fundi, doja të ritheksoja rëndësinë e reformave ekonomike që do të siguronin rritje ekonomike më të fortë në periudhë afatmesme, si dhe veprimtari bankare më të efektshme. Objektivi i këtyre reformave duhet të jetë përmirësimi i produktivitetit dhe i konkurrueshmërisë së ekonomisë sonë nëpërmjet: reduktimit të pasigurive në lidhje me drejtimin e zhvillimeve të ardhshme, duke identifikuar politikat dhe reformat e duhura; krijimit të një klime të favorshme fiskale, ligjore, biznesi dhe politike, e cila do të nxiste investimet në ekonomi; përmirësimit të edukimit dhe specializimit të fuqisë punëtore; gjenerimit të përfitimeve nga ekonomitë e shkallës nëpërmjet integrimit të bizneseve në tregun rajonal apo evropian; dhe rritjes së eficiencës së sektorit publik dhe atij privat me anë të përmirësimit të qeverisjes. Në sistemin financiar, reformat duhet të përqendrohen në thellimin dhe zgjerimin e tregut financiar, me objektiv përmirësimin e aksesit në financë, përmirësimin e eficiencës dhe reduktimin e rreziqeve.

Shpresoj që nga ky forum të dalin ide të reja për mënyrat e kapërcimit të sfidave aktuale me të cilat po përballen ekonomia reale dhe sektori financiar. Në çdo rast, këto ide mund të jenë të zbatueshme vetëm nëse nuk përqendrohen në një sektor të vetëm, por pranojnë, gjithashtu, nevojën për një marrëdhënie dhe lidhje të ngushtë midis sektorëve të ndryshëm në ekonomi.

Ju faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
27 nëntor 2013

Sot, në datën 27 nëntor 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit. Pas kësaj uljeje, norma bazë e interesit zbret në nivelin 3.25 për qind.

Reduktimi i normës bazë të interesit reflekton projeksionet tona për një inflacion të ulët në periudhën e ardhshme, si pasojë e rritjes së ngadaltë ekonomike në vend dhe e presioneve rënëse në inflacion të ardhur nga ekonomia e jashtme. Ky reduktim përforcon stimulin monetar në ekonomi dhe krijon kushte më të përshtatshme për përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Inflacioni vjetor rezultoi 1.7% në muajin tetor, duke qëndruar në të njëjtin nivel me një muaj më parë. Pas reduktimit të shpejtë në muajt korrik e gusht, inflacioni shënoi rritje në dy muajt pasardhës, duke konfirmuar natyrën e përkohshme të rënies së fortë të inflacionit gjatë muajve të verës, por duke mbetur në linjë me vlerësimin e përgjithshëm për presione të ulëta inflacioniste. Luhatjet e inflacionit, gjatë vitit 2013, kanë ardhur kryesisht nga ecuria e çmimeve të produkteve ushqimore - kontributi i tyre formon pothuajse tërësisht vlerën e inflacionit total. Nga ana tjetër, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të tjera të shportës së konsumit kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme dhe kanë dhënë një ndikim fare të ulët në inflacion.

Në këndvështrimin makroekonomik, profili i ulët i inflacionit vijon të përcaktohet nga presione të dobëta inflacioniste, si nga kahu i kërkesës dhe nga ai i ofertës. Informacioni i muajve të fundit konfirmon vlerësimin tonë për një rritje nën potencial të ekonomisë shqiptare. Prania e kapaciteteve të pashfrytëzuara të prodhimit shoqërohet me rritje të ngadaltë të punësimit, të pagave dhe të kostove të prodhimit, duke u reflektuar më tej në nivele të ulëta të inflacionit bazë. Paralelisht me të, rënia e inflacionit tek partnerët tanë tregtarë dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit, kanë ndikuar në ngadalësimin e presioneve të importuara inflacioniste. Së fundi, pritjet për inflacionin qëndrojnë të ankoruara dhe në linjë me stabilitetin e çmimeve.

Të dhënat makroekonomike në dispozicion tregojnë për rritje të ulët ekonomike gjatë tremujorit të tretë të vitit, dhe një përmirësim të lehtë të saj gjatë tremujorit të katërt. Luhatjet e ritmeve të rritjes gjatë vitit të fundit, kanë ardhur në masën më të madhe nga luhatjet në ritmet e realizimit të shpenzimeve buxhetore.

Nga ana tjetër, kërkesa e huaj ka dhënë një ndikim të ulët pozitiv në rritjen ekonomike, ndërsa konsumi dhe investimet private mbeten të dobëta.

Konsumi dhe investimet private vazhdojnë të frenohen nga pasiguria e lartë dhe nga kushtet relativisht të shtrënguara të financimit. Lehtësimi i vazhduar i politikës monetare nuk është reflektuar në masën e pritur në rritjen e konsumit dhe të investimeve në vend. Sikurse e kemi theksuar edhe më parë, konsumatori dhe biznesi shqiptar shfaqen mjaft hezitues në marrjen e vendimeve afatgjata të konsumit e të investimeve. Banka e Shqipërisë vlerëson se zbutja e pasigurisë dhe lehtësimi i kushteve të financimit do të krijonin parakushtet për një ecuri më të mirë të këtyre dy përbërësve të rëndësishëm të kërkesës agregate.

Stimuli fiskal u zbeh dukshëm gjatë tremujorit të tretë. Pas një rritjeje të shpejtë në gjysmën e parë të vitit, shpenzimet buxhetore u ngadalësuan në tremujorin e tretë. Stimuli fiskal i nëntëmujorit të parë është reflektuar në një deficit buxhetor rreth 1.2 herë më të lartë se ai i së njëjtës periudhe të vitit paraardhës.

Rritja e pritur e shpenzimeve dhe e deficitit buxhetor, në tremujorin e katërt, e zhvendos përsëri në territor pozitiv kontributin e stimulit fiskal në rritjen ekonomike. Megjithatë, nivelet e larta të borxhit publik kufizojnë mundësinë e politikës fiskale për të mbështetur aktivitetin ekonomik në të ardhmen. Banka e Shqipërisë vlerëson se korrektimi fiskal në vitin e ardhshëm është i domosdoshëm për rikthimin e borxhit publik në parametra më të qëndrueshëm. Korrektimi i pritur fiskal për vitin 2014 dhe në vazhdim do të ushtrojë ndikimin e vet në aktivitetin ekonomik. Ndërkohë, reduktimi i huamarrjes publike në tregjet e brendshme financiare do të krijojë më shumë hapësirë për zgjerimin e financimit të sektorit privat.

Të dhënat mbi tregtinë e huaj flasin për një kontribut pozitiv të kërkesës së huaj në rritjen e aktivitetit ekonomik, gjatë tremujorit të tretë. Gjatë kësaj periudhe, deficiti tregtar u tkurr me 17.7% në terma vjetorë, duke reflektuar ecurinë e mirë të eksporteve dhe rënien e importeve. Eksportet shënuan një rritje vjetore prej 13.6% në tremujorin e tretë të vitit, ndërkohë që importet ranë me rreth 5.2%.

Periudha në fjalë është karakterizuar nga ecuria rënëse e normave të interesit në tregjet financiare. Normat e interesit të letrave me vlerë të borxhit publik kanë rënë, si pasojë e reduktimit të huamarrjes së qeverisë në këtë periudhë. Ecuria e yield-eve dhe ajo e normave të interesit në tregun ndërbankar janë në linjë me ciklin lehtësues të politikës monetare. Nga ana tjetër, normat e interesit të depozitave dhe të kredive kanë reaguar më ngadalë, si pasojë e

primeve të larta të rrezikut të përfshira në çmimin e kredisë. Sistemi bankar ka adoptuar një përqasje konservatore ndaj kreditimit, në përgjigje të politikave më të shtrënguara të imponuara nga bankat mëma dhe të rritjes së kredive me probleme në bilancet e tyre. Kjo përqasje është reflektuar në kushte më të shtrënguara kreditimi dhe në norma interesi, të cilat nuk kanë ndjekur lehtësimet e politikës monetare. Në prani edhe të kërkesës së ulët për kredi, ajo është reflektuar në rënien e kredisë gjatë muajve të fundit. Në fund të muajit shtator, kredia për sektorin privat rezultoi 2.6% më e ulët se një vit më parë.

Primet e larta të rrezikut të kredisë, si dhe reagimi i pakët i konsumatorit dhe biznesit ndaj normave të interesit, kanë zbehur transmetimin e stimulit monetar në ekonomi. Rikthimi i pritur i këtyre dy treguesve në parametra më normalë do të forcojë transmetimin e stimulit monetar dhe do të krijojë kushte për rimëkëmbjen e kërkesës së brendshme në ekonomi.

Banka e Shqipërisë vlerëson se presionet inflacioniste do të mbeten të dobëta edhe në periudhën e ardhme. Zhvillimet e faktuara deri më tani nuk kanë ndryshuar ndjeshëm projeksionet tona makroekonomike, por kanë shtuar rreziqet në kahun rënës. Rritja ekonomike pritet të mbetet e dobët dhe të mos gjenerojë presione inflacioniste. Ky parashikim reflekton edhe efektin frenues të korrektimit të pritur fiskal për vitin e ardhshëm. Po ashtu, inflacioni i importuar pritet të mbetet i ulët, ndërsa pritjet për inflacionin janë të ankoruara.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit. Reduktimi i normës bazë të interesit pritet të përcillet në norma më të ulta interesi për kreditimin e ekonomisë. Duke patur parasysh edhe kahun e pritur fiskal për vitin e ardhshëm, ky veprim synon të ruajë stimulin makroekonomik në ekonomi dhe të krijojë kushte më të përshtatshme për përmbushjen e objektivit tonë të inflacionit. Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se zhvillimet e pritura ekonomike e financiare, brenda dhe jashtë vendit, do të kërkojnë ruajtjen e natyrës lehtësuese të politikës monetare, në periudhën e ardhshme. Në varësi të kahut dhe të intenstitetit të politikës fiskale në të ardhmen, Banka e Shqipërisë mbetet vazhdimisht e gatshme të vlerësojë dhe të reagojë në kohë përmes politikës monetare.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën e nivelit të lartë "Bashkëpunimi ndërkombëtar mes bankave qendrore, para, gjatë dhe pas krizës", organizuar nga Banka Qendrore Evropiane
09 dhjetor 2013

Të nderuar pjesëmarrës,

Është nder për mua të marr pjesë në këtë konferencë të rëndësishme dhe gjej rastin të falënderoj organizatorët për ftesën. Në fjalën time do të përqendrohem te mënyra se si kriza e fundit financiare ka ndryshuar punën e bankës qendrore, në lidhje me miratimin e politikës makroprudenciale dhe marrëdhënies së saj me politikën monetare. Më pas, do të ndaj disa mendime nga përvoja e vendeve të Evropës Juglindore (EJL) gjatë krizës, dhe do të theksoj disa nga sfidat me të cilat ato po përballen duke pasur parasysh zhvillimet e fundit ekonomike, financiare dhe rregullatore në BE.

Kriza që po kalojmë, duke qenë kaq e thellë dhe e zgjatur në kohë, do të lërë shenjën e saj në shkencën ekonomike në përgjithësi, dhe në bankingun qendror në veçanti. Deri para Recesionit të Madh, politika monetare jetonte në një botë që mund ta quajmë si "epoka e shënjestrimit të inflacionit". Në shumë mënyra, shënjestrimi i inflacionit e bëri relativisht të thjeshtë punën e bankës qendrore, për sa kohë ajo e ndiqte politikën në mënyrë korrekte. Banka qendrore, e konsideruar nga publiku si një institucion i pavarur, duhej të angazhohej në mënyrë të besueshme për një objektiv eksplicit për inflacionin, me qëllim ankorimin e pritjeve afatmesme për inflacionin. Pritshmëritë vetëpërmbushëse nga agjentët ekonomikë dhe përcaktuesit e çmimit do të ndihmonin, në këmbim, për arritjen e objektivave të politikës monetare. Ekonomistët besonin se duke stabilizuar çmimet konsumatore, do të ndikonin edhe që mjetet financiare të silleshin në mënyrë të qëndrueshme dhe të parashikueshme. Kriza na kujton me dhimbje se sjellja në tregjet financiare nuk është gjithmonë racionale dhe mungesa e besimit te tregjet mund të dalë jashtë kontrollit, duke dërguar valë goditëse në të gjithë ekonominë. Çmimet në rritje të mjeteve dhe rënia e papritur e tyre pati ndikim domethënës mbi sjelljen dhe bilancet e agjentëve ekonomikë, si dhe sfidoi stabilitetin e sistemit financiar. Në këtë drejtim, koncepti i stabilitetit financiar u pa si një nënprodukt i stabilitetit monetar.

Mbikëqyrja mikroprudenciale u përqendrua te shëndeti i institucioneve financiare të veçanta, me bindjen se kjo do të mjaftonte për të siguruar stabilitetin e përgjithshëm të sistemit financiar. Përsëri, kriza e fundit financiare e bëri të qartë se mbikëqyrja mikroprudenciale nuk ishte e mjaftueshme për të zbuluar dhe trajtuar akumulimin e rreziqeve në të gjithë sistemin financiar për shkak të: a) konsiderimit të pamjaftueshëm të efekteve të tërthorta; b) përfshirjes se institucionit financiar në veprime që diktoheshin nga lëvizjet sektoriale apo ato të konkurrencës dhe jo nga interesat më të mira individuale

në qëndrimin ndaj rreziqeve; c) ekspozimeve të përbashkëta me nivel të lartë rreziku; d) dhe prociklikalitetit në veprimtarinë e sistemit financiar. Më tej, institucionet financiare me rëndësi sistemike vërtetuan se ishin "tepër të mëdha për të dështuar" ndaj duheshin marrë masa për t'i trajtuar institucionet aktualisht me rëndësi sistemike në nivel vendor dhe botëror. Kompetencat e autoriteteve për rigjallërimin dhe zgjidhjen e institucioneve financiare, po forcohen.

Kufizimi i rrezikut sistemik, si në dimensionin e zhvillimit të tij përgjatë kohës edhe në atë strukturor, është objektivi i politikës makroprudenciale. Në tre vitet e fundit, në rang ndërkombëtar, ka pasur progres domethënës për identifikimin e një sërë instrumentesh, të konceptuara:

- për trajtimin e zgjerimit të shpejtë dhe përqendrimit në aktivitetin kreditues;
- për të siguruar që bankat të kenë likuiditet të mjaftueshëm për përballimin e goditjeve të ndryshme;
- dhe për të dekurajuar sjellje që mbartin rrezik nga ana e institucioneve financiare, duke rritur kërkesën për kapital për këto veprimtari.

Këto masa mund të kenë natyrë kundërciklike dhe mund të zbatohen për institucionet financiare sipas rëndësisë së tyre sistemike.

Këto standarde kërkojnë ndërtimin e një kuadri institucional që identifikon qartë autoritetin/autoritetet që do të kenë kompetenca makroprudenciale, në përputhje me strukturën dhe nivelin e zhvillimit të tregut. Banka qendrore shfaqet e pozicionuar më mirë, në krahasim me autoritete të tjera, për të luajtur rolin makroprudencial. Përveç përgjegjësisë ekskluzive për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, banka qendrore ka përparësi të tjera në lidhje me:

- përfshirjen në zhvillimin e infrastrukturës së sistemeve të pagesave;
- aksesin në të dhëna të shumta për tregun dhe sistemin financiar;
- dhe, në shumë raste, rolin e saj si rregullatore dhe mbikëqyrëse e bankave.

Në ditët e sotme, pranohet gjerësisht se është bërë progres i madh në gjithë botën për të siguruar pavarësi ligjore dhe operacionale për bankat qendrore. Kjo është një arsye tjetër e rëndësishme pse asaj mund t'i besohet politika makroprudenciale.

Për ta përkufizuar si duhet funksionin makroprudencial të bankës qendrore, është e rëndësishme të vendoset një marrëdhënie e drejtë me politikën monetare. Kjo mund të realizohet duke kuptuar se të dyja politikat, nëse hartohen dhe zbatohen si duhet, plotësojnë njëra-tjetrën. Kështu, politika monetare mund të vijojë kursin e vet duke ndjekur presionet e ulëta inflacioniste, ndërsa masat makroprudenciale mund të përdoren për të trajtuar në kohë të hershme rreziqet që zhvillohen në një mjedis me norma të ulëta interesi. Nga ana tjetër, masat makroprudenciale mund të përdoren edhe

për të zbutur rreziqet që vijnë nga flukset hyrëse të kapitalit, në një mjedis me norma interesi reale relativisht të larta.

Shembuj të konfliktit midis dy politikave nuk duhen shpërfillur, gjithsesi. Këta shembuj mund të jenë më të theksuar nëse objektivat e dy politikave hartohen në mënyrë të gabuar në një situatë të caktuar financiare, ose kur instrumentet respektive përdoren jashtë qëllimit të tyre. Për këtë arsye, besoj se mund të jetë me vend që të mbahet politika monetare si objektivi parësor i bankës qendrore. Stabilizimi i inflacionit duhet të jetë diçka për të cilën bankierët qendrorë mund të jenë krenarë, diçka që duhet ta inkurajojnë dhe të vijojnë të përpiqen ta arrijnë. Megjithatë, duhet të kuptojmë se çështjet e stabilitetit financiar dhe masat përkatëse makroprudenciale duhet të fitojnë ndjeshëm më shumë terren në diskutimet dhe vendimet e bankave qendrore. Është e qartë se kursi i politikës monetare do të vijojë të diskutohet gjerësisht në të ardhmen, mbështetur në të kuptuarit më mirë të rolit të çmimeve të mjeteve dhe të përkimeve financiare. Përfshirjen e objektivave të stabilitetit financiar në regjimin e shënjestrimit të inflacionit, në Shqipëri e kemi konsideruar si një mundësi për të kuptuar dhe trajtuar zhvillimet ekonomike dhe rreziqet e mundshme makrofinanciare, me qëllim ruajtjen e stabilitetit ekonomik afatgjatë.

Ndërsa mandati i politikës markroprudenciale dhe instrumentet e saj duhet të jenë të qarta, duhet kuptuar që ajo mund të ketë efekte më të gjera në sistemin financiar dhe ekonominë reale. Për këtë arsye, diskutimet për politikën dhe masat makroprudenciale duhet të përfshijnë edhe autoritete të tjera, përfshirë atë fiskal. Shumë vende kanë ngritur tashmë një organ ndërinstitucional, me kompetenca të buta ose të forta, për të hartuar dhe zbatuar politikat makroprudenciale për zbutjen e rrezikut sistemik. Roli i bankës qendrore në këto organe ndërinstitucionale do të pasqyrojë legjislacionin dhe traditën e tyre dhe objektivin e pavarësisë. Ndonëse bankat qendrore mund të mos jenë gjithmonë në rolin drejtues të këtyre organeve, ato mund të luajnë një rol kritik për të mbështetur funksionimin e këtyre organeve duke pasur parasysh informacionin dhe ekspertizën që japin.

Si janë zhvilluar këto politika në rajonin e Evropës Juglindore?

Pavarësisht nga rritja solide në periudhën që i parapriu krizës globale, kjo krizë e gjeti Evropën Juglindore (EJL) në një pozicion të dobët. Më së shumti, modeli i rritjes në rajon mbështetej te nxitja e absorbimit vendas, që nga ana e saj financohej pjesërisht nga huamarrja e jashtme. Flukset hyrëse financiare u kanalizuan në ekonomitë e EJL-së kryesisht nëpërmjet filialeve të bankave nga BE-ja. Në EJL, ato inkurajuan investime në sektorin e pasurive të paluajtshme dhe atë të shërbimeve dhe u reflektuan në deficite të mëdha të llogarisë korrente. Konkurrueshmëria e jashtme dhe reformat strukturore u anashkaluan disi në axhendën e politikëbërësve, ndërsa pozicionet fiskale u lejuan të përkeqësohen dhe masat mbrojtëse financiare ishin të dobëta.

Për rrjedhojë, kur goditi kriza, EJL-ja u përball si me probleme strukturore edhe me probleme ciklike. Struktura e përgjithshme ekonomike nuk ishte

konkurruese, ndërsa rritja u zvogëlua me kolapsin e kërkesës së jashtme dhe kërkesa e brendshme vuajti nga pasiguri më të larta, prime më të larta rreziku dhe mungesë financimi. Në aspektin financiar, ekonomitë tona vuajtën uljen e ndërmjetësimit financiar, të njohur si deleveraging, nga bankat e huaja, të cilat e ulën ekspozimin e tyre në EJL. Përveç kësaj, disa vende u përballën me dobësi të mëdha në sistemin financiar, kur kreditë me probleme u rritën me shpejtësi, për shkak të kombinimit të rritjes së dobët dhe kredive në monedhë të huaj ndaj huamarrësve të pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Natyrisht që kjo tablo është një përgjithësim. Vende të ndryshme kanë pasur përvoja të ndryshme, në varësi të kushteve fillestare dhe reagimit të politikës ekonomike. Megjithatë, kriza ekspozoi disa dobësi të këtij modeli ekonomik. Në të njëjtën kohë, për sa kohë ekzistojnë diferenca midis vendeve, mund të arrijmë në më shumë përfundime nga përvoja jonë. Konkretisht:

- Vendet me kushte fillestare të favorshme vuajtën më pak. Shqipëria ishte një rast i tillë. Ne nuk e shmangëm krejtësisht akumulimin e zhbalancimeve, po kemi qenë të kujdesshëm sa duhet për të shmangur kreditimin nga bankat në një monedhë tjetër të pambështetur nga burime të qëndrueshme; për të nxitur një model biznesi të kujdesshëm për sistemin bankar; për të shmangur flukse hyrëse afatshkurtra të monedhës; dhe për t'u fokusuar në stabilitetin e përgjithshëm si parakusht për rritje afatgjatë.

- Vendet me stabilitet dhe politika të orientuara drejt afatit të gjatë kanë performuar më mirë. Dilema e politikës në EJL-së lidhej kryesisht me faktin nëse duhet mbështetur rritja ekonomike nëpërmjet politikave kundërciklike apo të vendoset si përparësi stabiliteti ekonomik dhe financiar nëpërmjet veprimeve të vendosura korrektuese. Në rastin kur ekonomia është e orientuar drejt importeve, dhënia e stimulit makroekonomik mund të vërtetohet të jetë një veprim pa efekt. Si rrjedhojë, në Shqipëri kemi rritur përpjekjet për të ristrukturuar ekonominë. Banka e Shqipërisë ka kërkuar, gjithashtu, të rrisë transparencën në sistemin bankar dhe të forcojë bilancet e tij, si nëpërmjet rritjes së kapitalit edhe nëpërmjet trajtimit të borxheve të këqija. Kjo e fundit është bërë duke promovuar ristrukturimin e kredive apo fshirjen e tyre. Në këtë drejtim, fokusi i Bankës së Shqipërisë do të ndalet në një përqasje mikro të analizës së debitorëve të këqinj të cilët paraqesin rëndësi sistemike.

- Bashkëpunimi ndërkombëtar është parakusht për zbutjen e efekteve zinxhir dhe për administrimin e suksesshëm të krizës. Në veçanti, Nisma e Vjenës ka pasur rol kyç për kufizimin e procesit të uljes së ndërmjetësimit financiar të sistemit bankar privat në ekonomitë tona.

Kuadri institucional dhe i veprimeve mbrojtëse për situata të jashtëzakonshme financiare, duhet të përmirësohen, për t'i bërë më eficiente dhe më të qëndrueshme.

Megjithatë, mbeten ende disa çështje për t'u zgjidhur. Ekonomitë e EJL-së kanë zgjedhur me të drejtë integrimin në BE si qëllim kryesor. Kjo ndihmon për ankorimin e sistemit të tyre politik, reformave strukturore, mjedisit ligjor dhe rregullator, dhe politikave makroekonomike dhe financiare. Megjithatë, modeli i rritjes ekonomike duhet të ndryshojë. Fokusi kryesor i autoriteteve kombëtare në EJL duhet të lehtësojë shpërndarjen e kapitalit në sektorë më produktivë, duke siguruar incentivat e duhura, reforma strukturore, mjedisin ligjor, politikat e përshtatshme të taksimit dhe stabilitet ekonomik.

Në sistemin financiar të këtyre vendeve, të mbizotëruar nga bankat, ulja e ndërmjetësimit financiar është nën presionin e përkeqësimit të cilësisë së kredisë. Kreditimi është zvogëluar pasi bankat janë bërë më të ndjeshme ndaj rrezikut dhe ngurrojnë t'u japin hua kredimarrësve të mundshëm, duke shtrënguar kushtet e kreditimit. Ndaj, agjentët e sektorit real - sidomos bizneset që operojnë në sektorët 'e sëmurë' në ekonomi - po përballen me vështirësi në rritje për financim afatshkurtër dhe kanë humbur disi vizionin për objektivat e tyre për të ardhmen. Procesi i ristrukturimit në këto kompani duhet të gjejë mënyra që biznesi i tyre të ndryshojë e të bëhet eficient, në mënyrë që të mbijetojnë dhe që të rimëkëmben. Fondet financiare dhe ekspertiza janë veçanërisht të rëndësishme gjatë fazës së ristrukturimit.

Cili është roli i sistemit financiar në këtë proces? Duhet të jemi të qartë për dy çështje: (1) ne kemi ndërtuar një sistem financiar dhe kemi ndjekur një strategji integrimi financiar që mbështetet te bankat. Në fakt, ato përbëjnë mbi 90% të sistemit financiar në të gjithë rajonin. Ne mendojmë se ky model është i suksesshëm dhe se, me disa rishikime të vogla, ai duhet t'u shërbejë ekonomive tona në të ardhmen. Bankat e huaja sjellin ekspertizë dhe më së shumti stabilitet për sistemin financiar. Megjithatë, përvoja e kohëve të fundit e ka zbutur këtë argument; (2) bankat duhet të jenë mjeti kryesor i flukseve hyrëse financiare. Si ekonomi konverguese, EJL-ja pritet të ketë deficite të llogarisë korrente. Si i tillë, ky është një rajon i uritur për kapital, të cilin bankat ndërkombëtare duhet ta ndërmjetësojnë. Një model i ri biznesi që mbështetet plotësisht te depozitat e gjeneruara në vend është një reagim i gabuar ndaj ekstremit të mëparshëm të flukseve të mëdha hyrëse. Duhet kërkuar një mjet më i përshtatshëm, një zgjidhje e bazuar në flukse hyrëse të kujdesshme dhe të qëndrueshme të fondeve.

Si do të ndikojë Mekanizmi i Vetëm Mbikëqyrës në punën e bankave qendrore në rajon?

Besoj se Mekanizmi i Vetëm Mbikëqyrës (Single Supervisory Mechanism - SSM) do të ketë ndikim pozitiv mbi bankat qendrore (dhe autoritetet rregullatore) në rajon për përmbushjen e përgjegjësive të tyre në lidhje me mbikëqyrjen dhe politikat makroprudenciale. Rregullatorët në rajon do të flasin tani me një mbikëqyrës të vetëm "të vendit të origjinës", dhe kjo pritet të sjellë më shumë vëmendje te shqetësimet e tyre për mbikëqyrjen. Ky proces mund të forcohet më tej, nëse bankat qendrore në rajon përmirësojnë bashkëpunimin midis tyre dhe janë në gjendje të identifikojnë pozicione të përbashkëta në komunikimin me Bankën Qendrore Evropiane. Ky bashkëpunim mund t'i

përgjigjet më mirë shqetësimit se një mbikëqyrës i vetëm mund të jetë më i largët sa u takon shqetësimeve të rregullatorëve të vendeve të vogla të rajonit.

Mundësia për të bashkëpunuar me një mbikëqyrës të vetëm të "vendit të origjinës" do të ketë rëndësi kyçe për të ecur më shpejt në procesin e konvergjencës rregullatore dhe për të krijuar një terren më të përshtatshëm për institucionet financiare në rajon. Kjo është diçka që po udhëhiqet me kujdes nga Nisma e Vjenës 2.0. Përveç përgatitjes për zbatimin e standardeve të ndryshme rregullatore lidhur me instrumente kundërciklike dhe makroprudenciale, një çështje me rëndësi afatshkurtër është ajo që ka të bëjë me njohjen dhe trajtimin e kredive me probleme.

Vetëm pak kohë më parë, disa vende në rajon u prekën nga procesi i uljes së ndërmjetësimit financiar që filloi në sistemin financiar të BE-së. Kjo u ndje më shumë gjatë vitit 2012, pas kërkesave për rritje të kapitalit, që shoqëruan ushtrimin e provës së rezistencës (stress test) të nëntorit 2011 nga Autoriteti Bankar Evropian dhe hapat përkatës të ndërmarrë nga autoritetet kombëtare "të vendeve të origjinës" për të përmbushur këto kërkesa. Së afërmi do të kryhet Analiza e Cilësisë së Aktiveve nga BQE-ja. Shpresa dhe bindja jonë është që këtë herë, shqetësimet e vendeve të EJL-së, për ulje të mundshme e të mëtejshme të ndërmjetësimit financiar, do të shqyrtohen më me kujdes dhe në mënyrë më specifike, për të shmangur ulje të mundshme e të mëtejshme të ndërmjetësimit financiar. Më lejoni të ritheksoj se ekonomitë në rajonin tonë mbështeten shumë te financimi nga bankat dhe se ka një nevojë në rritje për të drejtuar fluksin e kredisë drejt ekonomisë.

Si konkluzion, më lejoni të theksoj rëndësinë e krijimit të një kuadri të qëndrueshëm për politikën makroprudenciale, si në aspektin e instrumenteve ashtu edhe të qasjes institucionale, për parandalimin me eficiencë dhe në kohë të rrezikut sistemik. Kjo duhet të shoqërohet me masa për forcimin e kuadrit për administrimin e krizave financiare. Nëse hartohet si duhet, politika makroprudenciale jo vetëm do të shmangë çdo konflikt me politikën monetare, por do ta plotësojë atë si duhet. Vendet e EJL-së duhet të përfitojnë nga sinergjitë që lidhen me ngritjen e Mekanizmit të Vetëm Mbikëqyrës. Këto përfitime mund të bëhen më të mëdha nëse arrijmë të forcojmë bashkëpunimin rajonal. Ne mbetemi ende të shqetësuar për një ulje të mundshme e të mëtejshme të ndërmjetësimit financiar pas procesit të pritshëm të Analizës së Cilësisë së Aktiveve të grupeve bankare evropiane dhe shpresojmë që BQE-ja dhe autoritete të tjera në Eurozonë dhe BE të mund ta konceptojnë atë në mënyrë të tillë që ta kufizojnë sa më shumë këtë ndikim.

Ju faleminderit për vëmendjen!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
16 dhjetor 2013

Sot, në datën 16 dhjetor 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin 3.0%.

Reduktimi i normës bazë të interesit – i dyti në radhë pas atij të muajit të shkuar - reflekton projeksionet tona për presione të dobëta inflacioniste në afat të mesëm. Kërkesa agregate dhe rritja ekonomike parashikohet të mbeten nën potencial, duke u shoqëruar me rritje të ngadalta të kostove të prodhimit dhe të çmimeve të konsumit. Po kështu, presionet inflacioniste nga tregu i huaj pritet të jenë të ulëta dhe në rënie. Duke reflektuar edhe korrektimin e pritur fiskal gjatë vitit të ardhshëm e në vazhdim, lehtësimi i politikës monetare synon të mbështesë kërkesën agregate nëpërmjet përmirësimit të kushteve të financimit dhe të krijojë kushtet e duhura për respektimin e objektivit tonë të inflacionit në afat të mesëm.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

* * *

Inflacioni vjetor rezultoi 1.0% në muajin nëntor, duke pësuar një rënie të ndjeshme kundrejt vlerës së shënuar gjatë muajit paraardhës. Ky reduktim ka ardhur thuajse tërësisht si pasojë e rënies së inflacionit të ushqimeve gjatë këtij muaji. Në një plan më të gjerë krahasimi, ngadalësimi i rritjes së çmimeve të ushqimeve në gjysmën e dytë të këtij viti është një fenomen i vërejtur edhe në vendet e tjera të rajonit, në reflektim të konjukturës globale të çmimeve. Çmimet e mallrave të tjera të shportës kanë dhënë kontribute mjaft të ulëta në inflacionin total, me një efekt rezultant të papërfillshëm.

Nga këndvështrimi i faktorëve makroekonomikë, vlerat e ulëta të inflacionit gjatë muajve të fundit reflektojnë një rënie të përgjithshme të presioneve inflacioniste në ekonomi. Ecuria e dobët e kërkesës agregate vazhdon të kushtëzojë një shfrytëzim të pjesshëm të kapaciteteve prodhuese të ekonomisë, duke u përcjellë më tej në rritje të ngadalta të kostove të prodhimit të mallrave e shërbimeve në vend.

Po ashtu, ngadalësimi i ndjeshëm i rritjes së çmimeve të huaja dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit kanë shkaktuar rënien e inflacionit të

importuar. Nga ana tjetër, pritjet inflacioniste dhe situata e likuiditetit në ekonomi përmbajnë sinjale për rritje të moderuara çmimesh në periudhën afatmesme.

Të dhënat mbi ecurinë e ekonomisë reale në gjysmën e dytë të vitit mbeten të pakta. Informacioni i ri i përftuar gjatë javëve të fundit mbështet projeksionet tona të mëparshme për një rritje të ulët pozitive të ekonomisë shqiptare në këtë periudhë. Megjithatë, një sërë treguesish të rinj të marrë gjatë muajit të fundit sinjalizojnë një ecuri edhe më të ngadaltë të ekonomisë, krahasuar me vlerësimet tona fillestare.

Ecuria e sektorit të jashtëm të ekonomisë tregon për dobësimin e kontributit të kërkesës së huaj në rritjen e kërkesës agregate. Në terma realë, deficiti i eksporteve neto vlerësohet të jetë zgjeruar gjatë tremujorit të tretë të vitit, kryesisht si rrjedhojë e ecurisë së dobët të turizmit gjatë kësaj periudhe. Nga ana tjetër, të dhënat më të fundit mbi tregtinë e jashtme konfirmojnë vazhdimësinë e ngushtimit nominal vjetor të deficitit tregtar në muajin tetor, në masën 12.2%, të shkaktuar kryesisht nga rritja vjetore e eksporteve prej 17.1%, ndërkohë që importet kanë rënë me 0.3%.

Kontributi i sektorit publik, i cili mbështeti rritjen e kërkesës në pjesën e parë të vitit, ka qenë më i zbehtë në gjysmën e dytë të tij. Politika fiskale në dhjetë muajt e parë të vitit ka shfaqur natyrë ekspansioniste, të përqendruar kryesisht në tremujorin e dytë të vitit. Shpenzimet buxhetore janë rritur me 7.1% kundrejt vitit të kaluar, të nxitura kryesisht nga rritja e shpenzimeve korrente. Nga ana tjetër, të ardhurat fiskale kanë shënuar rënie vjetore prej 2.7% gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar dobësimin e aktivitetit ekonomik dhe të importeve në vend. Pavarësisht ngadalësimit të shpenzimeve në gjysmën e dytë të vitit dhe rënies më të ulët të të ardhurave, deficiti buxhetor ka vijuar të rritet. Deri në muajin tetor, ky deficit rezultoi rreth dy herë më i lartë se një vit më parë.

Duke u nisur nga shkalla e lartë e borxhit publik, Banka e Shqipërisë gjykon se trajektoret e tanishme fiskale nuk janë të përballueshme në afat të mesëm. Për këtë arsye, ne kemi mbështetur dhe mirëpresim masat për një korrektim sa më të shpejtë dhe të qëndrueshëm fiskal.

Dy komponentët e rëndësishëm të kërkesës së brendshme, konsumi dhe investimet private, mbeten të dobët, në përgjigje të pasigurive për të ardhmen, shfrytëzimit jo të plotë të kapaciteteve, besimit të ulët konsumator dhe burimeve të kufizuara të financimit.

Në prani të presioneve të ulëta inflacioniste, Banka e Shqipërisë forcoi më tej natyrën lehtësuese të politikës së saj monetare në muajin nëntor, duke ulur normën bazë të interesit dhe duke e çuar atë në nivelin 3.25%. Sinjalet e politikës monetare janë përcjellë shpejt në pjesën më të madhe të segmenteve të tregut financiar, të ndihmuara edhe nga primet e ulëta të likuiditetit në to.

Kështu, normat e interesit në tregun ndërbankar, yield-et në tregun primar dhe normat e interesit të depozitave në lekë, kanë vijuar prirjen rënëse në

ndjekje të uljes së normës bazë në ekonomi. Rënie kanë shënuar së fundi edhe normat e interesit të kredisë, por me një intensitet dhe shpejtësi më të vogël. Reagimi i plogësht i tyre, krahas kohëvonesave të zakonshme të mekanizmit të transmisionit, reflekton kryesisht primet e larta të rrezikut të kredisë dhe politikat mjaft konservatore të imponuara nga zhvillimet në tregun financiar evropian.

Ecuria e treguesve monetarë ka qenë në linjë me zhvillimet në ekonominë reale dhe dëshmon për presione të ulëta inflacioniste me natyrë monetare në ekonomi. Rritja vjetore e ofertës monetare është ngadalësuar në 2.3% në muajin tetor, në reflektim të kërkesës së ulët të ekonomisë për para. Përqasja e kujdesshme e bankave në kreditimin e ekonomisë, por edhe kërkesa e dobët e sektorit privat për financim, janë materializuar në përkeqësimin e ecurisë së kredisë. Në veçanti, në muajin tetor, kredia për ekonominë thelloi në 2.2% tkurrjen vjetore të saj, duke reflektuar një ecuri të dobët në të gjitha segmentet.

Projeksionet tona bazë për të ardhmen mbeten përgjithësisht të pandryshuara. Rritja ekonomike në tremujorët e ardhshëm pritet të jetë pozitive, por nën potencialin prodhues të ekonomisë. Në kushtet e dobësimit të kërkesës së huaj neto dhe të konsolidimit të pritur të financave publike, rritja ekonomike do të përcaktohet në një masë të madhe nga ecuria e konsumit dhe investimeve private, të cilat ende nuk japin sinjale gjallërimi. Vazhdimësia e hendekut negativ të prodhimit do të kushtëzojë presione të ulëta mbi çmimet në afatin e mesëm, ndërkohë që edhe presionet e ofertës pritet të jenë të përmbajtura. Në mungesë të goditjeve të paparashikuara, inflacioni parashikohet të luhatet në vlera të ulëta gjatë tremujorëve të ardhshëm.

* * *

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të reduktojë me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin 3.0%. Vlerësimet tona tregojnë se përcjellja e stimulit monetar në tregjet financiare dhe në ekonominë reale do të ndihmojë në kthimin gradual të inflacionit afër objektivit tonë prej 3%. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ruajë kahun lehtësues të politikës monetare deri në përmbushjen e objektivit tonë të inflacionit.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z. ARDIAN FULLANI

Në takimin përmbyllës të vitit me Shoqatën Shqiptare të Bankave,
17 dhjetor 2013

Të nderuar drejtorë të bankave,
Shkëlqesia juaj Ambasador Sequi,
I nderuar z. Ilahi,
I nderuar z. Pencabligil,

Pjesë e kënaqësisë që të krijon pjesëmarrja në këtë takim të fund vitit është edhe momenti i reflektimit për sfidat dhe arritjet me të cilat u përballëm këtë vit, dhe përpjekja për të identifikuar ato që na presin gjatë vitit të ardhshëm. Koha dhe karakteri festiv i këtij takimi, nuk më lejojnë të zgjatem në të gjitha momentet që do të dëshiroja. Megjithatë, me lejoni që të ndaj me ju opinionin për dy çështje të cilat i gjykoj të rëndësishme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së sektorit bankar gjatë vitit të ardhshëm.

Por përpara kësaj, duhet të pranojmë që viti që po lëmë pas ishte një vit i vështirë për veprimtarinë e sektorit bankar. Gjatë ciklit të zhvillimit të tij, të më shumë se një dekade, sektori përjetoi këtë vit ngadalësimin e theksuar të rritjes së veprimtarisë dhe tkurrjen e nivelit vjetor të kreditimit.

Dobësia e cilësisë së aktiveve, e diktuar nga kredia, ka ndikuar në rënien e rezultatit financiar, për shkak të nevojës për rritjen e provigjioneve. Këto zhvillime kanë pasqyruar ngadalësimin e përgjithshëm të ekonomisë dhe rënien e kërkesës së brendshme, për shkak të uljes së konsumit dhe investimeve nga sektori privat. Megjithatë, disa zhvillime të tjera, kanë treguar aftësinë e sektorit bankar për të reaguar dhe për t'u përballur me këto sfida në mënyrën e duhur. Kështu, sektori ka ruajtur nivele mjaft të mira të likuiditetit dhe të kapitalit, në vijim të rritjes së mëtejshme të depozitave të publikut dhe shtimit të kapitalit nga grupet bankare zotëruese. Në drejtim të trajtimit të kredive me probleme, janë bërë përpjekje me të dukshme për ristrukturimin, si edhe për tregtimin e tyre tek institucione financiare jobanka. Shoqata e bankave ka luajtur një rol aktiv gjatë diskutimeve me autoritetet mbi problematikën e kredive me probleme dhe gjetjen e zgjidhjeve për trajtimin e tyre përmes anës rregullatore. Ndër këto zgjidhje spikasin ndryshimet ligjore për procesin e ekzekutimit të kolateralit, të cilat hynë në fuqi në shtator të këtij viti.

Nëpërmjet veprimtarisë së saj, industria bankare mund ta bëjë vitin 2014 një vit më të mirë për të dhe për ekonominë shqiptare. Mendoj qe kjo mund të arrihet nëse punohet me një ritëm më të lartë në dy drejtime.

a) Së pari, në drejtim të kthimit të niveleve të përshtatshme të kreditimit për ekonominë shqiptare. Realizimi i këtij objektivi kërkon ndërlidhjen e tri

elementeve të mëposhtme: pastrimi i bilanceve nga kreditë me probleme. Është e domosdoshme që gjatë vitit 2014, të shënoni një progres të dukshëm në fshirjen e kredive të humbura nga bilanci dhe, aty ku është e nevojshme, në ristrukturimin e kujdesshëm të tyre; përmirësimi i afërt i trajtimit fiskal të kredive të fshira, pritet të ofrojë një mbështetje shumë më të mirë të këtij procesi, por kjo nuk e justifikon pasivitetin dhe shtyrjen në kohë të tij; kërkoj nga ju të ofroni angazhimin maksimal për përmbushjen me sukses të projekteve që kanë nisur në këtë drejtim me Bankën Botërore.

Njëkohësisht vlerësoj se objektivat sasiore për uljen e nivelit të kredive me probleme duhet të jenë pjesë e planeve vjetore të punës së institucioneve që drejtoni, për vitin 2014:

b) Përzgjedhja profesionale e kërkesave të reja për financim. Kërkesa për kredi mbetet e dobët, por ajo ekziston dhe duhet analizuar potenciali që ekziston për rritjen e saj në të ardhmen. Në këtë drejtim, industria bankare duhet të forcojë analizën për orientimin e kredisë drejt sektorëve të ekonomisë me potenciale të lartë zhvillimi. Gjithashtu, industria bankare duhet të shohë me përparësi financimin e subjekteve të vogla dhe të mesme, i cili zbut rrezikun e kredititi përmes diversifikimit të portofolit dhe përmirëson qëndrueshmërinë e kthimit nga financimi;

c) Ulja e kostove të financimit. Në këtë drejtim, i referohem kryesisht normës së interesit të kredisë në lekë, e cila, sipas opinionit tonë, nuk ka reflektuar mjaftueshëm ecurinë e normës bazë të interesit dhe pritshmëritë. Nëse vështrojmë rënien e normave të interesit për financimin e nevojave të qeverisë, kuptohet se ngurtësia e lëvizjeve në koston e kreditimit reflekton primet e rrezikut që industria bankare vendos për financimin e sektorit privat. Për 2014, mendojmë se industria bankare duhet të ofrojë një mbështetje më të mirë për sektorin privat, në kushtet kur:

- marrëveshja me FMN-në, do të zbus nevojat për financim të qeverisë;
- pagesat e prapambetura publike ndaj sektorit privat do të fillojnë të shlyhen me ritme të përshpejtuara;
- rënia e treguesve financiarë të industrisë bankare, imponon kthimin gradual drejt kreditimit të sektorit privat, me qellim përmirësimin e gjenerimit të të ardhurave.

Së dyti, dëshiroj të theksoj nevojën për përmirësimin e ndjeshëm të strukturave dhe të kapaciteteve teknike për administrimin e rrezikut. Në këtë drejtim, përfshirja në vendimmarrjen e shqyrtimeve analitike lidhur me performancën e veprimtarisë së institucioneve që drejtoni ndaj skenarëve të ndryshëm, duhet të kërkohet dhe të sigurohet nga ana juaj. Kjo është një kërkesë e kuadrit ekzistues rregullativ, të cilin ne do ta ndjekim me një kujdes të shtuar gjatë vitit të ardhshëm. Për ne, ky element do të jetë një tregues i cilësisë së drejtimit në banka.

Pa e zgjatur me tej, dëshiroj të theksoj që për të gjitha këto procese, Banka e Shqipërisë do të japë, ashtu si deri tani, të gjithë mbështetjen e nevojshme.

Ne e vlerësojmë bashkëpunimin profesional dhe të drejtpërdrejtë me ju, si një element të rëndësishëm në plotësimin e kërkesave që përmban kuadri rregullativ mbikëqyrës.

Me tej, marrëveshja me FMN-në, por edhe mbështetja financiare më e madhe nga Banka Botërore dhe Bashkimi Evropian, do të rikthejnë ekonominë e vendit në shinat e stabilitetit afatgjatë, duke bërë që qëndrueshmëria makroekonomike të përkthehet në ritme më të larta të rritjes ekonomike. Besoj që industria bankare do të shfrytëzojë këtë moment për të identifikuar mundësitë më të mira për ristrukturimin dhe rritjen e veprimtarisë, duke rifituar në këtë mënyrë rolin e saj si një motor i zhvillimit ekonomik të vendit.

Duke ju falënderuar për ftesën, dëshiroj t'i uroj secilit prej të pranishmeve në këtë takim, shëndet dhe suksese profesionale në vitin e ri!

Gëzuar!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën e përbashkët për shtyp me Ministrinë e Financave
dhe Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar
18 dhjetor 2013

Të nderuar përfaqësues të medias,

Ditët e fundit janë zhvilluar negociata intensive me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, për drejtimin e ardhshëm të politikave ekonomike dhe financiare, që do të ndërmarrin autoritetet shqiptare në periudhën afatmesme 2014 – 2016. Me kënaqësi konstatoj se, në tërësi, këto diskutime kanë rezultuar të suksesshme dhe në përfundim të tyre, kemi arritur një marrëveshje me FMN-në për hartimin e një pakete masash të cilat do t'i mundësojnë vendit përballimin e problemeve të menjëhershme, si dhe mbështetjen e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike. Nga këndvështrimi i bankës qendrore, gjykojmë se marrëveshja adreson shqetësimet tona kryesore, të cilat i kemi ndarë me ju në komunikimet tona të mëparshme.

Besoj se gjatë periudhës në vijim do të njiheni me detaje më të plota të marrëveshjes. Megjithatë, në këtë konferencë për shtyp, dëshiroj t'ju paraqes përmbledhtazi pikëpamjet e Bankës së Shqipërisë mbi situatën e ekonomisë dhe të sistemit financiar shqiptar, si dhe të evidentoj pikat kryesore të cilat do të orientojnë politikat tona për tre vitet e ardhshme.

Ekonomia shqiptare karakterizohet nga një rritje e ngadaltë dhe nën potencial. Kjo situatë krijon një sërë problemesh në ekonomi, të tilla si:

- vështirësi në gjendjen financiare të bizneseve;
- ngadalësim të rritjes së punësimit dhe të pagave;
- përkeqësim të treguesve financiarë veçanërisht të kredisë;
- rritje të shkallës së konservatorizmit të agjentëve financiarë; dhe,
- shtim të presioneve mbi treguesit e deficitit dhe të borxhit.

Të gjitha problemet e renditura më sipër janë të pranishme në ekonominë shqiptare. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ka theksuar në vazhdimësi se rritja e ulët është shqetësimi prioritar me të cilin përballet ekonomia shqiptare. Për këtë arsye, kuptimi i drejtë i problemeve të rritjes ofron edhe çelësin për ndërmarrjen e politikave të duhura të zhvillimit.

Ne mendojmë se, ashtu si dhe në vende të tjera të rajonit, problemet e rritjes ekonomike kanë një natyrë të dyfishtë, ciklike dhe strukturore, dhe se vendosja e ekonomisë shqiptare në rrugën e rritjes së qëndrueshme kërkon adresimin e tyre të njëkohshëm.

Në situatën që ndodhemi, gjykoj se marrëveshja me FMN-në ofron një zgjidhje optimale. Në aspektin ciklik, kërkesa agregate shfaqet e ulët dhe nuk arrin të vërë në shfrytëzim të plotë kapacitetet prodhuese të vendit. Arsyet janë të qarta:

- kërkesa e huaj për mallra e shërbime shqiptare shfaqet problematike, pjesërisht edhe si pasojë e problemeve që kanë partnerët tanë tregtarë;
- sektori publik ka mundësi të kufizuara për stimul fiskal, si pasojë e nivelit të lartë të borxhit publik; ndërsa
- sektori privat shfaqet hezitues dhe përballet me kushte të shtrënguara financimi nga sistemi financiar.

Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë gjykon se marrëveshja me FMN-në i shërben pozitivisht zgjidhjes së këtij ngërçi. Së pari, nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shërben si garanci për konsistencën e politikave tona ekonomike dhe ofron garanci financiare me kosto të ulët për vendin.

Si e tillë, ajo forcon besimin e investitorëve të brendshëm e të huaj në ekonominë shqiptare dhe ka efekte pozitive në investime dhe në konsum. Së dyti, marrëveshja i hap rrugë një korrektimi më të butë fiskal se ai të cilin mund të ishim të detyruar të bënim në mungesë të saj. Me fjalë të tjera, asistenca financiare e parashikuar shmang një tkurrje më të fortë fiskale, të cilën mund të na e impononin tregjet financiare. Së treti, mbështetja financiare e FMN-së dhe e Bankës Botërore nënkupton reduktim të huamarrjes së qeverisë në tregun e brendshëm, duke krijuar më shumë hapësirë likuiditeti për kreditimin e sektorit privat.

Në aspektin strukturor, ekonomia shqiptare duhet të adoptojë një model të ri rritjeje, për të krijuar një profil më konkurrues, më të zhdërvjellët dhe më imun ndaj luhatjes së konjukturave globale. Ky objektiv kërkon rialokimin e burimeve financiare, sipërmarrëse dhe njerëzore në ekonomi, nga industritë e orientuara drejt tregut të brendshëm në ato industri të cilat kanë një këndvështrim rajonal e global. Gjithashtu, ky objektiv do të kërkojë vazhdimin e reformës strukturore nëpërmjet përmirësimeve të kuadrit ligjor e rregullativ, nëpërmjet investimeve në infrastrukturë dhe nëpërmjet rritjes së kualifikimit të fuqisë punëtore. Të gjitha këto aksione kërkojnë kohë, burime financiare dhe ekspertizë teknike. Marrëveshja me FMN-në besoj se i adreson ato në mënyrë të strukturuar dhe të kënaqshme.

Në gjykimin tonë, këto politika i hapin rrugë një rritjeje ekonomike progresive gjatë viteve të ardhshme. Ato do të kërkojnë natyrisht vëmendje, qartësi dhe fleksibilitet të vazhdueshëm për të përputhur dinamikat e realitetit ekonomik e financiar, me objektivat dhe politikat tona.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i politikave ekonomike dhe financiare do të jetë mbajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit.

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbetet e fokusuar në respektimin e objektivit të saj të stabilitetit të çmimeve. Në dy mbledhjet e fundit të Këshillit

Mbikëqyrës, ne kemi ndërmarrë dy ulje të njëpasnjëshme të normës bazë të interesit, duke e zbritur atë në 3%. Këto lëvizje janë kryer ekskluzivisht në funksion të respektimit të objektivit tonë prej 3% të inflacionit. Ato synojnë të lehtësojnë kreditimin e ekonomisë dhe të nxisin konsumin e investimet në vend, duke i shërbyer kthimit të normës aktualisht të ulët të inflacionit në objektiv. Ne kemi qenë dhe do të mbetemi gjithnjë të vëmendshëm ndaj këtij treguesi, të gatshëm të ndërmarrim masat përkatëse për garantimin e stabilitetit të çmimeve në ekonomi.

Së fundi, sistemi bankar ka qenë dhe vazhdon të mbetet i shëndetshëm dhe fitimprurës. Programi i vlerësimit të sistemit financiar, FSAP, vlerëson se sistemi bankar shqiptar është i shëndetshëm, i aftë të përballojë goditje, i mbikëqyrur dhe i rregulluar sipas parimeve të shëndosha. Banka e Shqipërisë është e angazhuar që, edhe në kuadrin e rekomandimeve të FSAP-it, të përmirësojë më tej infrastrukturën mbikëqyrëse dhe rregullatore, për t'i siguruar ekonomisë një sistem bankar të shëndetshëm. Po ashtu, Banka e Shqipërisë do të synojë që, në kuadrin e nismave shumëpalëshe - si Nisma e Vjenës 2.0 - apo të atyre të bashkëpunimit dypalësh me institucione homologe, të rrisë vëmendjen e institucioneve financiare, publike apo private, ndaj investimit në ekonominë shqiptare.

Këto nisma e projekte, por edhe angazhime të tjera që janë pjesë e punës normale të bankës qendrore, do t'i shërbejnë përmirësimit të kushteve të kreditimit dhe rritjes ekonomike të vendit.

Ju falënderoj për vëmendjen!

ANALIZA PERIODIKE*

** Pikëpamjet e shprehura në këto materiale janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR, T4 2013

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE, OLTA MANJANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, JANAR 2014

1. SEKTORI FINANCIAR DHE BANKAT

Sistemi financiar shqiptar dominohet nga sistemi bankar, i cili përbëhet nga 16 banka tregtare ku mbizotëron kapitali i huaj. Sektori bankar është aktori kryesor i cili mban peshën e aktivitetit ndërmjetësues në ekonomi[1]. Njëkohësisht, sistemi financiar plotësohet dhe nga aktiviteti i korporatave të tjera financiare si shoqëritë e kursim kreditit apo fondet private të investimit. Roli i këtyre të fundit në ekonominë shqiptare ka ardhur në rritje, sidomos gjatë dy viteve të fundit. Prezantimi i institucioneve të reja financiare, e kombinuar edhe me instrumente të reja financiare[2], ka ofruar më shumë mundësi diversifikimi për investimet e kursimeve të individëve, duke ndihmuar në rritjen e rolit të institucioneve jobanka në ekonomi. Njëkohësisht, këto zhvillime kanë ndikuar edhe në zhvendosjen e një pjese të kursimeve të individëve nga bankat drejt këtyre institucioneve, e cila është përkrahur edhe nga rënia e normës së kthimit nga depozitat e sistemit bankar gjatë vitit 2013.

Grafik 1. Investimet në letra me vlerë dhe tregues të ndërmjetësimit bankar (depozitat)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar vijon të mbulojë pjesën më të madhe të ndërmjetësimit financiar në ekonomi, duke zënë rreth 92% të aktiveve të institucioneve financiare në vend në fund të muajit shtator, përkundrejt 93% në fund të tremujorit të dytë. Roli ndërmjetësues i bankave është dobësuar më tej gjatë tremujorit të katërt. Ndërmjetësimi bankar, i matur si raport i portofolit të kredisë për ekonominë

[1] *Për më shumë: "Raporti i Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013".*

[2] *Krijimi i fondit privat të investimeve "Prestigj" në lekë dhe në euro gjatë vitit 2012, si dhe emetimi i obligacioneve 10-vjeçare në lekë dhe atyre 2-vjeçare në euro gjatë vitit 2013.*

ndaj stokut të depozitave, konfirmon reduktim të tij në 56.9% në muajin nëntor, rreth 0.4 pikë përqindje më i ulët se në fund të tremujorit të tretë dhe 2.7 pikë përqindje më poshtë se fundi i vitit të kaluar. Këto zhvillime janë ndikuar kryesisht nga dobësimi i aktivitetit kreditues në vend. Zgjerimi i stokut të depozitave është ngadalësuar, duke pësuar një rritje prej rreth 20.3 miliardë lekë deri në muajin nëntor të vitit 2013. Raporti i depozitave ndaj PBB-së ka mbetur i pandryshuar në fund të tremujorit të tretë të vitit[3], duke shënuar të njëjtën normë prej 70.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Krijimi më i ulët i parasë në ekonomi, flukset më të pakta valutore nga jashtë, si dhe zhvendosja e mbajtjes së kursimeve drejt institucioneve të tjera financiare jobanka kanë ndikuar në grumbullimin më të pakët të depozitave.

Grafik 2. Tregues të ndërmjetësimit të sistemit bankar (kreditimi)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Megjithë monetizimin e mirë të ekonomisë, ku raporti i parasë së gjerë ndaj PBB-së shënoi 85.5% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, aktiviteti kreditues ka rezultuar i plogësht përgjatë gjithë vitit. Kredia për ekonominë ndaj prodhimit të brendshëm bruto rezulton në rreth 40.6% në fund të tremujorit të tretë, ose 1.8 pikë përqindje më pak se një viti më parë. Kredia për ekonominë ka pësuar ngadalësim të përshkallëzuar, duke kaluar në territor negativ në gjysmën e dytë të vitit dhe duke shënuar një ndryshim vjetor prej -2.4% në muajin nëntor. Ritmet e kreditimit të ekonomisë kanë vijuar të ndikohen nga të njëjtat probleme të kërkesës dhe ofertës, të cilat janë bartur edhe gjatë tremujorit të katërt. Aktiviteti i plogësht ekonomik dhe pasiguria për zhvillimet ekonomike në të ardhmen kanë kushtëzuar kërkesën e ulët si të individëve ashtu edhe të bizneseve për mjete financiare. Kjo, e kombinuar dhe me sjelljen e kujdesshme të bankave në vazhdimësi në përzgjedhjen e klientëve dhe projekteve që financojnë kanë ndikuar në përkeqësimin e aktivitetit kreditues në vend edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit. Njëkohësisht, tkurrja e portofolit të kredisë, reflekton në një masë të madhe edhe pastrimin e kredive me probleme nga bilancet e bankave[4].

[3] *Ky raport është llogaritur mbi një vlerësim të përafërt të PBB-së nominale, i cili bazohet në PBB-në e publikuar nga INSTAT dhe në vlerësimet e departamentit të politikës monetare.*

[4] *Gjatë vitit 2013, disa banka të sistemit kanë ndërmarrë masa për pastrimin e bilanceve nga kreditë me probleme. Në mungesë të këtij fenomeni, tkurrja e portofolit të kredisë do të ishte më e ulët.*

Gjatë vitit 2013, është vënë re një pjesëmarrje e lartë e agjentëve ekonomikë jobanka në financimin e deficitit buxhetor nëpërmjet letrave me vlerë të qeverisë. Krahas pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të individëve në këto ankande, investimet e tyre në letra me vlerë të qeverisë në disa raste janë ndërmjetësuar nga fondi privat i investimeve. Një pjesë e konsiderueshme e tyre është siguruar nga kursimet e individëve, ku gjatë dy viteve të fundit vërehet njëkohësisht zhvendosje e pjesshme e kursimeve financiare të individëve nga depozita bankare në letra me vlerë të qeverisë dhe aksione të fondeve të investimit. Njëkohësisht, në këtë zhvendosje ka ndikuar dhe prezantimi i instrumenteve të tjera financiara në treg gjatë vitit 2013, duke pasuruar kështu gamën përzgjedhëse. Këto zhvillime dëshmojnë, përveçse tendencën e diversifikimit të portofolit financiar të familjeve shqiptare, edhe zgjerimin e konceptit të ndërmjetësimit financiar përtej sektorit bankar. Megjithëse ende në nivele të ulëta, kjo është një shenjë e mirë për zhvillimin e sistemit financiar shqiptar.

2. NDËRMJETËSIMI FINANCIAR NË SISTEMIN BANKAR

Ndërmjetësimi financiar në muajt tetor dhe nëntor ka rezultuar i dobët, si në monedhën vendase ashtu edhe në valutë. Aktiviteti ndërmjetësues në lekë ka vijuar të bjerë, duke reflektuar mobilizimin e ulët të depozitave në lekë në kredidhënie. Ndërmjetësimi në valutë ka ruajtur nivelet e ulëta të tremujorit të mëparshëm, i kushtëzuar nga tkurrja e njëkohshme e depozitave dhe kredisë në valutë. Në tërësi kostoja e ndërmjetësimit është rritur për të dy monedhat, duke reflektuar primet e larta të rrezikut dhe koston e provigjoneve[5].

2.1 NDËRMJETËSIMI NË LEKË

Gjatë muajve tetor dhe nëntor, ndërmjetësimi në lekë ka vijuar trendin rënës të nisur që në fillim të vitit 2013. Në muajin nëntor, raporti i kredisë ndaj depozitave në lekë shënoi mesatarisht 42.6%, duke rënë me 0.6 pikë përqindje kundrejt tremujorit të tretë të vitit. Në krahasim me një vit më parë, ky raport është 2.8 pikë përqindje më i ulët. Ecuria në rënie e ndërmjetësimit në lekë ka ardhur si pasojë e ngadalësimit e më pas tkurrjes së kredisë në lekë, ndërkohë që depozitat në monedhën vendase kanë ruajtur ritme të larta të rritjes.

Stoku i depozitave në lekë në fund të muajit nëntor rezulton rreth 5.7% më i lartë se një vit më parë. Ecuria e tyre gjatë vitit ka qenë e qëndrueshme dhe është luhatur në këto nivele mesatare. Zgjerimi i depozitave në lekë është mbështetur gjerësisht nga aktiviteti i shtuar i sektorit publik. Në muajt tetor dhe nëntor, stoku i depozitave në lekë u tkurr me rreth 2.8 miliardë lekë gjithsej, kundrejt rritjes së ulët në tremujorin e tretë. Këto zhvillime janë ndikuar si nga rënia e aktivitetit kreditues në lekë gjatë kësaj periudhe ashtu edhe nga zhvendosja e një pjese të tyre në institucione të tjera financiare jobanka. Kjo periudhë vëren një tendencë zhvendosjeje të depozitave në lekë drejt depozitave pa afat.

[5] *Sikurse mbështetet nga ecuria e raportit të kredive me probleme ndaj totalit të kredisë.*

Grafik 3. Tregues të ndërmjetësimit në lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Depozitat në lekë sipas afateve të maturimit dhe sipas agjentëve ekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2013, struktura e kredisë sipas monedhave ka mbetur e njëjtë me fundin e tremujorit të tretë, ku kredia në lekë përbën 39.2% të totalit të kredisë. Portofoli i kredisë në lekë, pasi shfaqi norma të larta rritjeje, prej mesatarisht 11.3% në gjashtëmujorin e parë të vitit, u ngadalësua shpejt në pjesën e dytë të vitit dhe u tkurr në muajin nëntor me 0.9%. Rënia e kredisë në lekë për biznese me 1.7% në terma vjetorë është faktori kryesor që ka përcaktuar ecurinë e këtij portofoli. Kredia në lekë për biznese përdoret më së shumti me qëllim mbulimin e nevojave për likuiditet (60% e kredisë për biznese në lekë). Në fund të muajit nëntor, ky portofol ka shënuar tkurrje të ndjeshme vjetore prej 1.7%, krahasuar me tkurrjen prej 0.4% të kredisë për investime në lekë.

Paralelisht me këto zhvillime, kreditimi në lekë për individë ka vijuar të ruajë norma pozitive rritjeje, prej rreth 2.7%. Tkurrja vjetore e portofolit të kredisë për konsum me 2.9% është balancuar nga rritja e kënaqshme e kredisë për banesa me 6.7%. Në veçanti kjo e fundit, duket të jetë mbështetur edhe nga politikat e bankave për të promovuar disa produkte për kredi hipotekare me norma favorizuese. Gjithashtu në muajt gusht dhe nëntor të vitit 2013, ecuria e kreditimit në lekë për individë është ndikuar edhe nga politikat e pastrimit të portofolit të kredisë të ndërmarra nga disa banka në sistem.

Grafik 5. Kreditimi në lekë dhe kontributet sipas qëllimit të kredisë
(ndryshim vjetor në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në lekë në muajt tetor dhe nëntor rezultoi mesatarisht 6.93 pikë përqindje, duke shënuar rritje mbi nivelin mesatar prej 6.73% të dy tremujorëve të mëparshëm. Ajo mbetet e luhatshme ndër muaj si rrjedhojë e luhatshmërisë më të lartë të normave të interesit të kredisë. Këto të fundit, në kushtet e nivelit të ulët të kredisë së re, ndikohen ndjeshëm nga normat preferenciale për kredi të veçanta. Në krahasim me një vit më parë, kostoja e ndërmjetësimit rezulton e rritur, si në terma mesatarë për të gjithë vitin, ashtu edhe për tremujorin e fundit të vitit. Kjo sjellje është diktuar nga rënia e shpejtë e normave të interesit të depozitave, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit 2013, në ndjekje të sinjaleve lehtësuese të politikës monetare. Në muajin nëntor, norma mesatare e ponderuar e interesit për depozitat në lekë rezultoi 2.51%, duke rënë me 1.31 pikë përqindje kundrejt fundit të gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Në krahasim me një vit më parë, ajo është 2.02 pikë përqindje më e ulët. Nga ana tjetër, normat e interesit të kredisë kanë përcjellë më pak dhe më ngadalë uljen e normës bazë. Ato kanë filluar të bien në pjesën e dytë të vitit, duke zbritur në nivelin 9.36% në muajin nëntor, nga 10.73% që shënonin në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2013.

Normat e interesit të kredisë në lekë mbeten ndjeshëm më të larta se yield-et e bonove të thesarit 12-mujore, të cilat merren shpesh edhe si normë referencë në përcaktimin e çmimit të kredive. Diferenca mes tyre është thelluar në periudhën shtator-nëntor, si rrjedhojë e rënies së shpejtë të yield-eve në këta muaj. Këto të fundit, për maturitetin 12-mujor, shënuan 3.41% në muajin

nëntor, duke rënë me përkatësisht 1.2 pikë përqindje dhe 1.6 pikë përqindje kundrejt fundit të gjashtëmujorit të parë të vitit 2013 dhe kundrejt një viti më parë. Inercia e lartë e normave të interesit të kredisë reflekton sjelljen e kujdesshme të bankave në kreditim dhe rrezikun më të lartë të kredisë të perceptuar prej tyre.

Grafik 6. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në lekë*



Burimi: Banka e Shqipërisë.
*Marzhi llogaritet si diferencë mes normave të interesit të kredisë dhe atyre të depozitave. Spread-i llogaritet si diferencë mes normës së interesit të kredisë/depozitave dhe asaj referencë (bono thesari 12-mujore për lekun dhe euribor 12-mujor për euron.

2.2 Ndërmjetësimi në valutë

Në muajt tetor dhe nëntor, raporti i ndërmjetësimit në monedhë të huaj shënoi mesatarisht 72.6%, duke qëndruar pranë nivelit të fundit të tremujorit të tretë, dhe duke mbetur 3.7 pikë përqindje më poshtë se niveli mesatar i vërejtur në tremujorin e dytë. Kundrejt një viti më parë, ai ka rënë me 1.6 pikë përqindje. Ecuria e dobët e ndërmjetësimit në valutë ka reflektuar ecurinë e dobët të depozitave dhe kredisë në valutë, me një efekt më të madh të kësaj të fundit.

Grafik 7. Tregues të ndërmjetësimit në valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Stoku i depozitave në valutë në fund të periudhës rezulton rreth 1.3% më i ulët se një vit më parë. Ecuria e tyre gjatë këtij viti është kushtëzuar nga flukset më të ulëta valutore nga jashtë, si dhe nga reduktimi i kreditimit të ekonomisë në monedhë të huaj. Në muajt tetor dhe nëntor depozitat në valutë u reduktuan me rreth 2.1 miliardë lekë. Ky zhvillim lidhet kryesisht me reduktimin e përkohshëm të depozitave të individëve në muajin tetor, të cilat u rikthyen pjesërisht në muajin nëntor. Ndërkohë, në dy muajt e fundit depozitat e biznesit kanë shfaqur sjellje të luhatshme, në reflektim të aktivitetit të tyre ekonomik. Në terma të strukturës kohore, tek stoku i depozitave në valutë vërehet një zhvendosje drejt depozitave pa afat, më e theksuar në muajin nëntor.

Grafik 8. Depozitat në valutë sipas afateve të maturimit dhe sipas agjentëve ekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia në valutë shënoi rënie vjetore me 3.4% në muajin nëntor, duke shfaqur një përmirësim të lehtë krahasuar me tkurrjen prej 6.1% të vërejtur në tremujorin e tretë. Tkurrja e këtij portofoli ka reflektuar pakësimin e kreditimit si për bizneset ashtu edhe për individët. Kështu, portofoli i kredisë në valutë për biznese është tkurrur me 3.7% në terma vjetorë. Moderimi i ritmeve të tkurrjes krahasuar me tremujorin e tretë ka reflektuar shuarjen e efektit të bazës krahasuese, si rrjedhojë e rënies së kredisë një vit më parë. Ndërkohë, për periudhën tetor-nëntor kredia për investime ra me rreth 2 miliardë lekë, ndërkohë që ajo për qëllime likuiditeti regjistroi rritje të moderuar. Krahasuar me një vit më parë, këto dy portofole ishin përkatësisht 2.4% dhe 0.9% më të ulët në muajin nëntor.

Në dy vitet e fundit, struktura e kredisë në valutë për individë ka treguar një rënie të vazhdueshme të kredisë për banesa dhe luhatshmëri të lartë në kredinë për konsum. Gjatë muajve tetor-nëntor 2013, të dy komponentët e kredisë për individë janë reduktuar krahasuar me tremujorin e tretë të vitit. Kjo ecuri, krahas problemeve me kërkesën, reflekton edhe politikat e bankave për të ruajtur përputhshmërinë e monedhës me të cilën jepet kredia me atë të gjenerimit të të ardhurave të kredimarrësit. Në muajin nëntor, kredia për konsum në valutë, pas rritjes pozitive vjetore të shfaqur në tremujorin e tretë të vitit, ishte 4.7% më e ulët se një vit më parë. Ndërkohë, tkurrja vjetore e

kredisë hipotekare në valutë ka ruajtur një normë të njëtrajtshme prej rreth 2.3%. Zhvillimet e portofolit të kredisë për konsum në valutë janë të lidhura me nevojat e financimit për mallra të konsumit afatgjatë, kërkesa për të cilat mund të jetë prekur më shumë se sa ajo për konsumin afatshkurtër. Ndërkohë, tkurrja e kredisë hipotekare në valutë tregon jo vetëm për preferencë të ulët për financimin e blerjes së banesave të reja, por edhe zhvendosjen drejt financimit në lekë të blerjes së pasurive të paluajtshme të individëve.

Grafik 9. Kreditimi në valutë dhe kontributet sipas qëllimit të kredisë (ndryshim vjetor në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në euro[6] është rritur në tremujorin e katërt të vitit, për të tretin tremujor radhazi. Në terma mesatarë, ajo rezultoi 5.47 pikë përqindje, duke qenë 0.48 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë. Si edhe në rastin e ndërmjetësimit në lekë, shkaku i marzhit të lartë të ndërmjetësimit në euro është rënia e shpejtë e normës së interesit të depozitave kundrejt ngurtësisë së normës së interesit të kredisë. Në muajin nëntor, interesi i ponderuar i depozitave në euro rezultoi 1.35%, duke rënë me 0.42 pikë përqindje dhe me 0.87 pikë përqindje përkatësisht kundrejt fundit të gjashtëmujorit të parë dhe kundrejt vitit të kaluar. Kjo rënie është reflektuar edhe në ngushtimin e diferencës së këtyre normave kundrejt normave për monedhën euro në tregjet ndërkombëtare, të cilat janë luhatur rreth niveleve të qëndrueshme gjatë vitit 2013. Normat euribor me maturitet 12-mujor shënuan një nivel mesatar prej 0.54% gjatë këtij viti.

Norma e kredisë në euro është shfaqur e luhatshme në tremujorin e katërt të vitit, sikurse edhe në tremujorët e mëparshëm. Në terma mesatarë, ajo rezultoi 6.89%, duke regjistruar një rënie të lehtë kundrejt dy tremujorëve paraardhës. Krahasuar me vitin 2012, ajo ka rënë me rreth 0.3 pikë përqindje gjatë vitit 2013. Sikurse edhe në rastin e kredisë në lekë, normat e larta të interesit të kredisë në euro faktorizojnë prime të larta të rrezikut të perceptuar të bankave. Ato mbeten ndjeshëm më të larta se normat referencë euribor. *Spread*-i mes tyre është luhatur rreth nivelit mesatar prej 6.4 pikësh përqindje në gjysmën e dytë të vitit 2013.

[6] *Veprimtaria e bankave në valutë është e dominuar nga aktiviteti i tyre në euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.*

Grafik 10. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në euro



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3. ECURIA E KUSHTEVE TË KREDITIMIT

Në tremujorin e katërt të vitit, bankat kanë shtrënguar më tej kushtet e kreditimit për bizneset, ndërkohë që i kanë lehtësuar ato për individët. Shtrëngimi i kushteve është realizuar kryesisht nëpërmjet rritjes së normës së interesit për kreditë të konsideruara me rrezik të lartë, ndërkohë që normat e interesit për kreditë me rrezik normal dhe komisionet janë ulur. Pjesa më e madhe e kushteve joçmim kanë vepruar në kahun lehtësues.

Pasi mbetën të pandryshuara në tremujorin e tretë të vitit, kushtet e kreditimit për bizneset janë shtrënguar në tremujorin e katërt të tij, duke reflektuar shqetësimet për situatën makroekonomike në vend, problemet specifike të disa sektorëve të ekonomisë dhe nivelin e lartë të kredive me probleme.

Grafik 11. Ecuria e kushteve të kreditimit për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas)*.



Burimi: Banka e Shqipërisë.
*Balanca neto e përgjigjeve në këtë vrojtim.

Ndër elementët jokosto të kredisë, bankat kanë forcuar vetëm kërkesat për kolateral, ndërkohë që elementët e tjerë kanë dhënë një ndikim neutral ose në kahun lehtësues.

Standardet e kredisë për individë janë lehtësuar në tremujorin e katërt të vitit 2013. Elementët jokosto që kanë vepruar në krahun lehtësues ishin kërkesat për kolateral dhe maturiteti maksimal i kredisë. Efekt shtrëngues në kushtet e kreditimit për individë ka pasur ulja e nivelit maksimal të raportit këst/të ardhura.

INFORMACION MBI TREGUES EKONOMIKË TË VENDEVE KRYESORE PARTNERE TREGTARE, T4 2013

DORIANA LAMA, JONIDA BOLLANO, MEDVIN SHEHU
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, JANAR 2014

EUROZONA

Ekonomia e Eurozonës ka konfirmuar sinjalet pozitive të vërejtura në tremujorin e dytë, duke vijuar me rritje edhe në tremujorin e tretë të këtij viti. Ndonëse ritmi i rritjes për këtë tremujor ishte disi më i zbutur (0.1% nga 0.3%), performanca e shumë sektorëve tregues të një gjallërimi ekonomik ka rritur besimin tek agjentët ekonomikë dhe financiarë për ecurinë e aktivitetit në të ardhmen. Në një analizë të detajuar vihet re se rritja ekonomike pozitive ka qenë e pranishme tek shumica e shteteve të Eurozonës dhe në rastet më negative shtetet në tkurrje ekonomike kanë paraqitur frenim të saj. Treguesit paraprakë dhe të tërthortë të muajve të fundit (shitjet me pakicë, indeksi PMI për blerjet, porositë e reja për eksport dhe ai për prodhimin) mbështesin idenë se rritja e ekonomike në tremujorin e fundit do të konfirmojë sinjalet pozitive dhe do të përforcohet më tej në 2014. Rezultatet e vrojtimeve si dhe ato të treguesve të besimit të biznesit dhe konsumatorëve gjithashtu anojnë nga ky drejtim. Tregjet financiare dhe politika monetare kanë luajtur rol ndihmues dhe nxitës në këtë periudhë, ndërkohë që në deklaratat e mbledhjeve mujore, guvernatori i BQE-së Mario Draghi ka ritheksuar gatishmërinë e mbajtjes së nivelit të ulët të normave të interesit për një periudhë të gjatë nëse kushtet e përgjithshme ekonomike dhe financiare mbeten të brishta. Inflacioni ka ndjekur një trajektore rënëse muajt e fundit, duke konfirmuar parashikimet e ekspertëve të BQE-së për presione inflacioniste të përmbajtura.

ITALIA

Aktiviteti ekonomik i Italisë ka treguar një frenim të tkurrjes në tremujorin e tretë, ku PBB-ja (0%) nuk ndryshoi krahasuar me tremujorin e dytë. Në terma vjetorë rënia ekonomike ka qenë 1.8% por gjithsesi në përmirësim nga tremujori i kaluar. Faktorët kryesorë që kontribuuan pozitivisht ishin gjallërimi i aktivitetit tregtar dhe i kërkesës së jashtme, si dhe ndryshimi pozitiv i inventarëve, ndërkohë që konsumi vijon të jetë me ndikim negativ. Të dhënat e fundit indirekte për muajt nëntor dhe dhjetor flasin për sinjale rimëkëmbjeje të ekonomisë italiane në tremujorin e fundit. Tregues paraprijës të dinamikës (prodhimi industrial, porositë e reja në industri, besimi i biznesit dhe i konsumatorëve) së PBB-së sinjalizojnë për një gjallërim të aktivitetit ekonomik, i cili pritet të mbështetet edhe nga ana e kërkesës së jashtme. Rritja ekonomike pritet të jetë në territor pozitiv në tremujorin e fundit dhe të përforcohet më tej në 2014. Të dhënat e tregtisë me jashtë shfaqin përmirësim të vazhdueshëm këtë vit dhe pritet të rriten akoma më shumë gjatë këtyre

muajve, duke kontribuar pozitivisht në formimin e PBB-së. Sinjaleve pozitive të shumë treguesve ekonomikë nuk i është bashkangjitur ai i tregut të punës[1], i cili ka konfirmuar ecurinë negative këtë periudhë duke shtuar pasiguritë për forcën dhe kohën e fillimit të ripërtëritjes së konsumit dhe ekonomisë në përgjithësi. Indeksi i çmimeve të konsumit ka ndjekur ecuri rënëse gjatë gjithë vitive dhe bashkë me të edhe ai i çmimeve të prodhimit. Në muajt nëntor dhe dhjetor inflacioni zbriti në 0.7%, ndërkohë që inflacioni i përgjithshëm për vitin 2013 rezultoi 1.3% nga 3.3% që ishte në vitin 2012. Analiza e inflacionit bazë dhe parashikimet e ekspertëve të BQI-së flasin për presione të përmbajtura inflacioniste edhe për periudhën në vazhdim.

GREQIA

Ekonomia e Greqisë në tremujorin e tretë të vitit 2013 ka vijuar të tkurret, ndonëse vlera prej -3.0% është më e vogël se dy tremujorët paraardhës (-3.7% dhe -5.5% përkatësisht) dhe konfirmon prirjen për frenimin e tkurrjes këtë vit. Gjatë këtij tremujori ka vazhduar rënia e konsumit, investimeve dhe e kërkesës së brendshme por gjithsesi ritmet e tkurrjes janë zbutur, ndërkohë që aktiviteti tregtar dhe turizmi kanë performuar më mirë, duke kontribuar pozitivisht në formimin e PBB-së. Problemet e lidhura me konsolidimin fiskal, ndonëse vijojnë të jenë sfida dhe shqetësimi kryesor i qeverisë greke dhe i agjentëve të biznesit, duket të jenë adresuar në kohën kur edhe Trojka ka

Grafik 1. Rritja vjetore e ekonomisë së vendeve në Eurozonë



Burimi: Eurostat.

[1] *Norma e papunësisë në muajin nëntor u rrit me 0.2% nga muaji tetor në 12.7%. Norma e papunësisë tek të rinjtë arriti në 41.6% nga 41.4% në muajin tetor.*

aprovuar kështet e ndihmës këtë vit. Rikthimi në rritje ekonomike parashikohet të ndodhë në fund të vitit 2014 dhe mbetet i rrethuar nga faktorë pasigurie. Procesi i korrektimit të balancave fiskale ka vijuar duke e bërë të mundur dhe më pak të kushtueshme përqasjen e biznesit në tregjet e kapitaleve[2]. Treguesit e ndryshëm për muajt tetor dhe nëntor (prodhimi industrial, indeksi i shitjeve dhe ai i ndërtimit) kanë vijuar të ndjekin trajektore rënëse si në terma mujorë ashtu edhe në ata vjetorë. Inflacioni ka ndjekur trajektore rënëse gjatë gjithë kësaj periudhe, duke regjistruar vlera negative si vjetore ashtu edhe mujore. Në vitin 2013, indeksi i çmimeve të konsumit u zvogëlua në - 0.9% kur një vit më parë shënonte 1.5%.

GJERMANIA

Ekonomia gjermane ka vijuar të shënojë norma pozitive të rritjes ekonomike, ndonëse me ritme më të ulëta se në dy tremujorët e parë të vitit 2013. PBB-ja e vendit u rrit me 0.3% në tremujorin e tretë, krahasuar me një tremujor më parë dhe 0.6% krahasuar me një vit më parë. Aktiviteti ekonomik është mbështetur nga një gjallërim i kërkesës së brendshme, ndërkohë që kërkesa e jashtme nuk ka gjeneruar ende stimuj të rëndësishëm. Kërkesa për importe vijoi të ishte e njëjtë me një tremujor më parë, ku u evidentuar një rritje e importeve të energjisë. Gjithashtu, u vu re një peshë më e lartë e importeve nga vendet joanëtare të BE-së. Shpenzimet konsumatore janë nxitur nga një situatë e qëndrueshme në tregun e punësimit dhe rritje e pagave. Norma e papunësisë shënoi 6.9% në dhjetor dhe mbetet ndër më të ulëtat. Të dhënat e muajve nëntor-dhjetor flasin për ecuri pozitive të ekonomisë dhe në tremujorin e katërt. Indeksi i besimit (Ifo, nëntor) shënoi vlerën më të lartë që nga muaji prill 2012 dhe regjistroi përmirësim në të gjithë sektorët. Rritja e qëndrueshme ekonomike dhe një prirje rritëse e pagave është reflektuar në çmime më të larta. Në dhjetor, inflacioni vjetor u rrit në 1.4% nga 1.3% në nëntor[3].

Tabelë 1. Parashikimi për disa tregues të ekonomisë të vendeve partnere tregtare, KE, nëntor 2013.

Ndryshime	PBB		Inflacion*		Papunësia		Eksporte		Importe	
në përqindje	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Eurozonë	-0.4	1.1	1.5	1.5	12.2	12.2	1.3	4.2	-0.1	3.9
Itali	-1.8	0.7	1.5	1.6	12.2	12.4	0.1	3.6	-3.5	3.6
Greqi	-4.0	0.6	-0.8	-0.4	27.0	26.0	2.5	4.6	-7.1	-1.3
Gjermani	0.5	1.7	1.7	1.7	5.4	5.3	0.3	4.6	1.0	5.7
Spanjë	-1.3	0.5	1.8	0.9	26.6	26.4	4.5	5.2	-1.9	1.5
Kinë	7.5	7.4	2.7	3.0	4.1	4.1	4.1	6.0	4.4	6.3
Turqi	3.5	3.0	7.7	7.2	9.6	9.9	2.2	6.6	8.0	5.7

**Për vendet e Eurozonës është parashikuar ndryshimi i indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit. Në rastin e Kinës është marrë parashikimi i FMN-së.*

[2] *Në muajin nëntor agjencia e vlerësimit Moodys e rriti me dy nivele vlerësimin e saj për Greqinë nga C në Caa3.*

[3] *Inflacioni mbështetur në indeksin vendas të çmimeve të konsumit.*

SPANJA

Përmirësimi gradual i ekonomisë në Spanjë ka vijuar edhe në tremujorin e tretë e të katërt, i favorizuar nga një klimë më e mirë financiare në Eurozonë. Ekonomia u rrit me 0.1% në terma tremujorë, duke shënuar vlerën e parë pozitive pas nëntë tremujorësh. Në terma vjetorë, PBB-ja ra me 1.1% nga 1.6% që ishte një tremujor më parë. Rritja vjetore u ndikua pozitivisht nga kërkesa e huaj, ndonëse me një kontribut më të ulët se tremujorin e kaluar. Në të njëjtën kohë, konsumi privat ndonëse kontribuoi negativisht, ka shënuar përmirësim si pasojë e rritjes së pagave në terma reale dhe e rritjes së besimit konsumator. Indeksi i Besimit të Konsumatorit u rrit me 11 pikë në tremujorin e tretë, duke reflektuar perceptimin për një situatë aktuale dhe të pritshme ekonomike më të mirë.

Inflacioni vjetor zbriti në 0.3% në shtator dhe 0.2% në muajin dhjetor. Krahas rënies së çmimeve të ushqimeve të papërpunuara, kjo ecuri reflekton dhe shuarjen e efektit të rritjes së TVSH-së dhe të disa çmimeve administrative një vit më parë. Norma e papunësisë është stabilizuar në nivelin 26.7% në muajt tetor-nëntor, ndërkohë që numri i të papunëve ka shënuar rënie.

Të dhënat për ekonominë spanjolle tregojnë për shenja stabilizimi dhe rimëkëmbje të ekonomisë në fund të vitit 2013. Prodhimi industrial u rrit me 2.6% në nëntor, vlera më e lartë që nga muaji shkurt i vitit 2011. Në dhjetor të vitit 2013, Indeksi i Ndjesisë Ekonomike shënoi vlerën më të lartë në 6 vitet e fundit (100.0). Gjatë vitit 2014, përmirësimi i treguesve të besimit pritet të rezultojë në rigjallërimin e kërkesës së brendshme të sektorit privat.

Në nëntor, agjencitë e vlerësimit Fitch dhe S&P rishikuan vlerësimet për Spanjën, duke e kategorizuar atë në "të qëndrueshme" nga "negative", por pa ndryshuar renditjen e borxhit. Konsolidimi fiskal, ristrukturimi i sistemit bankar dhe diversifikimi i sektorëve të ekonomisë kanë ndikuar pozitivisht në këtë rivlerësim. Ndërkohë që në fillim të muajit janar 2014, për herë të parë që nga viti 2011 spread-i i bondit spanjoll 10-vjeçar me atë gjerman, ra nën 200 pb.

KINA

Në tremujorin e katërt të vitit 2013, PBB-ja e Kinës shënoi një rritje prej 7.7% në terma vjetorë, nga 7.8% që shënonte në tremujorin e tretë. Për vitin 2013, aktiviteti ekonomik vlerësohet të jetë zgjeruar mesatarisht me 7.7%, duke rezultuar një nga vlerat më të ulëta që nga viti 1999. Rritja e eksporteve dhe investimeve fikse, si dhe përmirësimi i kërkesës së brendshme, mbetën faktorët primar në mbështetje të aktivitetit ekonomik për këtë tremujor. Të dhëna pozitive vijnë edhe nga sektori bujqësor, ndërkohë që norma e punësimit nuk ka ndryshuar. Në muajin dhjetor, inflacioni në vend shënoi 2.5%, duke qëndruar dukshëm poshtë nivelit objektiv prej 3.5%.

Ekonomistët vlerësojnë se rritja e ekonomisë kineze do ta ulë ritmin e saj në 7.7% në vitin 2014. Paketa e reformave e ndërmarrë kohët e fundit për të frenuar zgjerimin e kredisë, edhe pse kërkon të gjenerojë një rritje më të qëndrueshme në kohë, në terma afatshkurtër pritet të dobësojë kërkesën e brendshme.

TURQIA

Në Turqi, rritja reale e PBB-së për tremujorin e tretë të vitit rezultoi mbi parashikimet, duke shënuar normën vjetore prej 4.4%. Ashtu si edhe në tremujorin e dytë, rritja e PBB-së u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme, pesha e të cilës arriti 4.7 pikë përqindje ndaj rritjes totale. Ndërkohë, për të tretin tremujor radhazi, kontributi i eksporteve neto në ecurinë e aktivitetit ekonomik, ishte negativ me 2.2 pikë përqindje nga -3.4 pikë përqindje dhe -0.6 pikë përqindje që shënonte përkatësisht në tremujorin e dytë dhe të parë. Tregues të tërthortë sugjerojnë për rritje të kërkesë së brendshme edhe në muajt tetor-nëntor, ndonëse në ritme më të moderuara. Pavarësisht tensioneve politike në vend gjatë muajve të fundit, treguesi i besimit të biznesit mbeti optimist. Në muajin dhjetor, inflacioni vjetor regjistroi vlerën 7.4% nga 7.3% që shënonte në nëntor, duke përcjellë në mënyrë të plotë efektin e dobësimit të lirës turke në periudhën maj-tetor të vitit 2013[4]. Më qëllim mbrojtjen e monedhës vendase dhe kontrollit të inflacionit, Banka Qendrore e Turqisë ka ndërhyrë në mënyrë të vazhdueshme në tregun valutor, duke mos ndryshuar normën e saj të referencës. Nënçmimi në terma realë vjetorë të lirës turke me rreth 9.6% në muajin dhjetor, nxiti bankën qendrore të shesë rreth 2.5 miliardë euro vetëm në javën e fundit të vitit.

MAQEDONIA

Në tremujorin e tretë, ekonomia maqedonase u zgjerua me 3.3% në terma vjetorë, duke regjistruar një nga normat më të larta në vendet e Evropës juglindore. Zgjerimi i aktivitetit në sektorin e ndërtimit me 33% në bazë vjetore, bazuar kryesisht në investimet publike, pati rolin primar në ecurinë e PBB-së për tremujorin e tretë. Për më tepër, sektori i shërbimeve, i cili përbën 65% të PBB-së, u përmirësua në këtë tremujor (rritje vjetore me 1.5% nga 0.9% që regjistroi në tremujorin e dytë), duke sugjeruar një rritje të kërkesës së brendshme. Kontribut pozitiv ndaj rritjes së përgjithshme shënoi dhe prodhimi bujqësor duke u rritur me 1.1% (vit mbi vit) kundrejt një rënie prej 0.4 % në terma vjetorë dhe një kontribut zero në tremujorin e dytë të vitit 2013. Parashikimet paraprake flasin për rritje të ekonomisë vendase mesatarisht me 2.1% për vitin 2013, duke shënuar nivelin më të lartë që nga viti 2008.

Në muajin dhjetor, inflacioni vjetor rezultoi 1.4% ose 0.3 pikë përqindje më shumë se vlera e regjistruar në muajin nëntor. Rritja e çmimeve të ushqimeve dhe e lëndëve djegëse, në linjë edhe me ecurinë e tyre në tregjet

[4] *Gjatë kësaj periudhe, lira turke vlerësohet të jetë nënçmuar me 11.6% në terma nominal efektiv.*

ndërkombëtare, ishin faktorët primarë që ndikuan në shtimin e presioneve inflacioniste në vend.

SERBIA

Pas një tremujori të dytë të vakët, PBB-ja e Serbisë, në tremujorin e tretë, u përshpejtua dukshëm në terma vjetorë me 3.7%. Kështu, krahas zgjerimit të aktivitetit ekonomik, efekti i një baze të ulët krahasuese për të njëjtën periudhë të vitit 2012, ishte një tjetër faktor shpjegues i vlerës së arritur. Në kontekstin e një kërkese të brendshme të dobët, performanca e ekonomisë serbe gjatë tremujorit në studim u gjenerua kryesisht nga ecuria pozitive e eksporteve (+26.7% vit mbi vit). Përmirësimi i qenësishëm i sektorit industrial (10% vit mbi vit) u mbështet më së shumti nga rritja e lartë e prodhimit të energjisë elektrike dhe zgjerimi i aktivitetit prodhues me 8.7% (vit mbi vit) i cili reflektoi një rikuperim të konkurrueshmërisë në terma të REER-it[5]. Normat e larta të inflacionit, të regjistruara deri në gusht të këtij viti, rezultuan dukshëm në rënie në muajin dhjetor (2.2%), duke përcjellë një rënie të vazhdueshme të çmimeve të ushqimeve. Në tremujorët në vazhdim, Banka Qendrore e Serbisë parashikon një rritje të moderuar të inflacionit vjetor dhe stabilizim të tij në rreth 4%, si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të administruara dhe TVSH-së nga 8% në 10%. Ndërkohë, kostot e ulëta të prodhimit të ushqimeve dhe kërkesa agregate e dobët do të vazhdojnë të prodhojnë presione të ulëta inflacionist.

[5] *Indeksi REER është nënçmuar me 8.3% gjatë 4 viteve të fundit.*

ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË T3 2013

EGLENT KIKA, MERITA BOKA, OLTI MITRE
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, JANAR 2014

1. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE[1]

Vijimësia e reduktimit të deficitit tregtar dhe regjistrimi i një bilanci pozitiv neto në llogarinë e të ardhurave ishin përcaktuesit kryesorë në zvogëlimin vjetor të deficitit të llogarisë korrente gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013. Rritja e kërkesës prej partnerëve tanë tradicionalë tregtarë dhe depërtimi në tregje të reja i eksporteve shqiptare ndihmuan në ruajtjen e pririjes rritëse të eksportit të mallrave gjatë këtij tremujori. Njëkohësisht, bilanci i llogarisë së të ardhurave regjistroi një suficit prej 35.3 milionë eurosh, për herë të parë pas gjashtë tremujorësh të njëpasnjëshëm me bilanc neto negativ. Në të kundërt, përkimi i sezonit turistik me periudhën paszgjedhore, vlerësohet të ketë qenë faktor përcaktues në regjistrimin e një kontraktimi të përshpejtuar vjetor të bilancit pozitiv neto në llogarinë e shërbimeve. Maturimi i ciklit të emigracionit, si dhe kushtet jo të favorshme të tregut të punës në vendet ku emigrantët shqiptarë janë rezident (veçanërisht në Itali dhe Greqi), vlerësohen të kenë ndikuar në vijimësinë e përkeqësimit të bilancit neto të llogarisë së transfertave korrente. Në tremujorin e tretë të vitit, deficiti i llogarisë korrente u zvogëlua me rreth 21.1% në bazë vjetore. Flukset financiare neto në llogarinë kapitale dhe financiare u tkurrën me rreth 54.4% gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013. Ky rezultat u ndikua prej bilancit negativ të regjistruar në llogarinë e investimeve të tjera neto prej 204.7, milionë eurosh megjithë rritjen e përshpejtuar të IHD-ve në vendin tonë. Flukset neto të llogarisë financiare e kapitale arritën të financojnë përafërsisht 41.5% të deficitit korrent gjatë tremujorit të tretë të vitit.

Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave.

	T1 '12	T2 '12	T3 '12	T4 '12	T1 '13	T2 '13	T3 '13
Llogaria Korrente (në mil euro)	-290.4	-251.8	-242.8	-236.3	-224.7	-296.9	-191.6
Ndryshim vjetor	26.7%	-23.9%	-6.2%	-35.5%	-22.6%	17.9%	-21.1%
/ PBB-së	-13.8%	-10.0%	-9.6%	-9.9%	-10.2%	-11.5%	-7.8%
Bilanci tregtar	-465.3	-475.5	-540.5	-517.8	-332.4	-397.6	-437.6
Eksporte, f.o.b.	325.8	394.2	402.5	403.1	381.6	458.8	454.7
Importe, f.o.b.	-791.2	-869.7	-943.0	-920.9	-714.0	-856.4	-892.3
Bilanci i shërbimeve	8.5	26.2	132.6	27.9	-43.9	-37.3	46.6
Kredi	293.8	381.1	578.1	402.1	283.6	346.9	524.7
Debi	-285.4	-354.9	-445.4	-374.2	-327.5	-384.2	-478.1
Shërbime udhëtimi - eksport	185.1	246.4	445.3	268.4	171.2	227.3	361.7
Shërbime udhëtimi - import	-180.8	-240.1	-325.6	-256.1	-205.8	-258.7	-335.7
Shërbime udhëtimi - neto	4.3	6.2	119.7	12.3	-34.6	-31.5	26.1

[1] *Të dhënat më të fundit të bilancit të pagesave i përkasin tremujorit të tretë të vitit 2013.*

Bilanci i të ardhurave	-40.4	-27.7	-20.6	-0.2	-11.3	-23.7	35.3
Kredi	48.2	43.0	57.8	55.3	42.2	47.4	53.1
Debi	-88.6	-70.7	-78.5	-55.5	-53.5	-71.1	-17.8
Të ardhura nga IHD-neto	-54.8	-29.8	-42.0	-26.2	-35.1	-47.6	4.9
Transferta korrente	206.8	225.3	185.8	253.9	163.0	161.7	164.1
Kredi	243.5	265.2	224.1	285.8	195.7	193.8	198.1
Debi	-36.7	-39.9	-38.4	-31.9	-32.6	-32.0	-34.0
Dërgesa nga emigrantët - neto	166.5	171.6	140.8	196.3	122.3	104.4	119.0
Kapitale dhe Financiare (mil euro)	258.3	185.5	174.4	249.1	208.5	338.5	79.5
Ndryshim vjetor	15.1%	-21.3%	-25.2%	-12.5%	-19.3%	82.5%	-54.4%
/ PBB-së	12.3%	7.4%	6.9%	10.4%	9.5%	13.1%	3.2%
Llogaria kapitale	12.9	43.0	9.8	15.6	9.7	4.8	14.8
Llogaria financiare	245.3	142.5	164.6	233.5	198.9	333.7	64.7
A. Detyrime	307.5	277.7	378.4	224.4	229.3	322.3	333.6
IHD	205.5	191.1	164.5	183.7	197.0	249.3	265.6
Inv. portofoli	14.5	19.6	7.8	21.0	21.8	21.9	21.8
Inv. të tjera	87.5	67.0	206.0	19.7	10.5	51.1	46.1
Monedha dhe depozita	69.1	34.8	164.8	3.7	6.1	21.9	41.2
B. Mjete	-62.2	-135.2	-213.8	9.2	-30.4	11.4	-268.9
IHD	-2.7	-0.3	-7.7	-7.0	-2.1	-11.7	-7.5
Inv. portofoli	-61.0	9.9	-26.4	-10.0	-28.9	-106.5	-10.5
Inv. të tjera	1.5	-144.8	-179.7	26.2	0.6	129.6	-250.9
Monedha dhe depozita	-11.0	-133.2	-178.2	67.0	-4.0	92.4	-278.5
Gabime dhe harresa	35.4	73.8	158.0	-36.0	-7.5	44.8	146.5
Mjetet e rezervës	-3.2	-7.5	-89.7	23.1	23.6	-86.4	-34.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.1 LLOGARIA KORRENTE

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 191.6 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2013. Pas zgjerimit të shënuar në tremujorin e dytë të vitit, deficiti korrent iu rikthye prirjes tkurrëse me rreth 21.1% në terma vjetorë. Ky deficit u vlerësua në rreth 7.8% ndaj PBB-së nominale[2] ose rreth 1.8 pikë përqindje më i ulët krahasuar me atë të shënuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Duke përjashtuar të ardhurat nga transfertat zyrtare, deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 8.0% të PBB-së nominale për tremujorin e tretë të vitit 2013. Në të njëjtën periudhë të një viti më parë ky raport ishte rreth 9.9%.

Grafik 1. Kontributi sipas zërave në deficitin korrent (në pikë përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Dinamika e llogarisë korrente, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, vijoi të ndikohet gjerësisht prej ecurisë së bilancit tregtar dhe atij të shërbimeve. Në terma vjetorë, deficiti tregtar u ngushtua me rreth 19.0%, ndërkohë që të ardhurat në llogarinë e shërbimeve u tkurrën me rreth 64.9%, krahasuar me të njëjtën periudhë të

[2] *PBB-ja nominale e përdorur për periudhën 2003 – 2011 është ajo e publikuar nga INSTAT-i. Shpërndarja nëpër tremujorë është bërë në bazë të peshave të PBB-së reale tremujore. Për vitin 2012 dhe 2013 janë përdorur projeksione të Departamentit të Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.*

një viti më parë. Pozicioni i kombinuar i këtyre dy llogarive çoi në ngushtimin e deficitit të eksporteve neto nominale për tremujorin e tretë të vitit 2013, me rreth 4.1% në terma vjetorë. Përmirësimi i bilancit të llogarisë së të ardhurave kontribuoi në ngushtimin vjetor të deficitit korrent. Ngushtimi i suficitit në llogarinë e transfertave korrente ndikoi negativisht në ecurinë e përgjithshme të llogarisë korrente.

Nëse deficiti korrent i regjistruar gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2013 vlerësohet/shihet nga një përqasje e ecurisë së hendekut midis kursimeve dhe investimeve kombëtare, vërehet një ndikim i qenësishëm i sektorit publik mbi formimin e deficitit të llogarisë korrente[3]. Kështu, hendeku midis kursimeve dhe investimeve publike u zgjerua me ritëm të përshpejtuar në terma vjetorë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2013, ku kontributin kryesor e dhanë kursimet më të ulëta publike. Në anën tjetër, hendeku midis kursimeve dhe investimeve private është përgjysmuar në terma vjetorë dhe pesha e sektorit privat në formimin e deficitit të llogarisë korrente vlerësohet të jetë mesatarisht 44.7%. Megjithatë, ndonëse sektori publik dha kontribut të kahut thellues mbi ecurinë vjetore të deficitit të llogarisë korrente, kontraktimi më i përshpejtuar i hendekut midis kursimeve dhe investimeve të sektorit privat ndikoi në zvogëlimin e deficitit të llogarisë korrente në terma vjetorë. Në tremujorin e tretë të vitit, kontributi vjetor i sektorit publik në ngushtimin e deficitit korrent ishte pozitiv, rreth 16.6 pikë përqindje, ndërsa ai i sektorit privat ishte negativ, rreth 37.7 pikë përqindje.

Grafik 2. Hendeku midis kursimeve dhe investimeve private e publike ndaj PBB-së (majtas) dhe kontributi i tyre në ecurinë vjetore të deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.

Treguesi i shkallës së hapjes ekonomike të vendit tonë për tremujorin e tretë të vitit 2013 shënoi vlerën 95.5%, rreth 1.6 pikë përqindje më i lartë krahasuar me nivelin e këtij raporti në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

[3] *Një matje alternative por ekuivalente e pozicionit neto të llogarisë korrente për një periudhë të caktuar është ajo e metodës së hendekut midis kursimeve dhe investimeve kombëtare. Kështu, pozicioni neto i realizuar i llogarisë korrente është i barabartë me shumën e hendekut të realizuar midis kursimeve dhe investimeve publike e private në periudhën t.*

$$CA_t=(S_{publike}-I_{publike})t+(S_{private}-I_{private})t$$

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, flukset financiare neto nga pozicioni i kombinuar i llogarisë së të ardhurave, transfertave korrente dhe shërbimeve shënuan rënie me rreth 17.4% në terma vjetorë. Si rezultat, flukset neto të këtyre tre llogarive së bashku financuan rreth 56.2% të deficitit tregtar të regjistruar gjatë kësaj periudhe, raport ky rreth 1.1 pikë përqindje më i ulët krahasuar me atë të një viti më parë.

Grafik 3. Kontributi i eksporteve neto në PBB-në reale (në pikë përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e sektorit të jashtëm të ekonomisë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, tregon për një kontributit negativ të këtij përbërësi në kërkesën agregate përgjatë periudhës në analizë. Deficiti i eksporteve reale neto u zgjerua me rreth 2.5% në terma[4] vjetorë, ku rol kyç luan rritja e çmimit për njësi të eksportit të mallrave. Si eksportet ashtu edhe importet reale të mallrave dhe shërbimeve shënuan rënie vjetore me përkatësisht 3.5% dhe 1.6%.

Zëra të tjerë të llogarisë korrente

Zhvillimi i zgjedhjeve parlamentare në muajin qershor 2013 dhe përkimi i sezonit turistik me periudhën paszgjedhore, vlerësohet të kenë kushtëzuar prurjet hyrëse financiare në llogarinë e shërbimeve. Kjo llogari në periudhën e konsideruar u mbyll me një suficit neto prej 46.6 milionë eurosh, në rënie me rreth 64.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Flukset valutore u vlerësuan në rreth 1.9% ndaj PBB-së nominale nga 5.3% në të njëjtin tremujor një vit më parë. Ngushtimi në terma vjetorë i flukseve valutore hyrëse me rreth 9.2% dhe rritja e flukseve valutore dalëse me rreth 7.3% përcaktuan një kontribut negativ (në kahun zgjerues) të llogarisë së shërbimeve në ecurinë e përgjithshme të llogarisë korrente.

Grafik 4. Bilanci i shërbimeve (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bilanci neto i llogarisë së shërbimeve u ndikua ndjeshëm prej ecurisë së nënzërit të "shërbimeve të udhëtimit (personale dhe biznesi)". Rënia e prurjeve valutore për shërbime udhëtimi për qëllime turizmi e biznesi të jorezidentëve në vendin tonë, si dhe rritja e daljeve valutore në trajtën e shpenzimeve

[4] *Për kalimin nga terma nominalë në terma realë të importeve dhe eksporteve të mallrave është përdorur Indeksi i Vlerës Njësi llogaritur dhe publikuar nga INSTAT-i. Për tremujorin e tretë të vitit 2013, ky tregues nuk është i disponueshëm dhe është përdorur një indeks i llogaritur mbi vlerat historike të indeksit të vlerës njësi për importet dhe eksportet (ARMA). Ndërsa, për importet dhe eksportet e shërbimeve është përdorur indeksi i çmimeve konsumit dhe indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit të kategorisë së shërbimeve, llogaritur përkatësisht nga Banka e Shqipërisë dhe Eurostat.*

të kryera nga rezidentët për shërbimet personale të udhëtimit jashtë, çuan në zvogëlimin e suficit të këtij nënzëri të llogarisë së shërbimeve në rreth 26.1 milionë euro, nga 119.7 milionë euro që ishte një vit më parë.

Shërbimet e transportit shënuan një ecuri pozitive gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, duke ndikuar pozitivisht në llogarinë e shërbimeve. Shërbimet e sigurimit vijojnë të kontribuojnë negativisht në llogarinë e shërbimeve pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me një vit më parë. Nënzëri "shërbime të tjera", (ku përfshihen shërbimet e komunikimit, e ndërtimit, qeveritare, financiare, kompjuterike dhe të informacionit etj) regjistroi një bilanc pozitiv prej rreth 30.1 milionë eurosh, duke ruajtur kështu pothuajse të njëjtin nivel krahasuar me një vit më parë.

Grafik 5. Bilanci i të ardhurave
(flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pas një periudhe të gjatë ecurie negative, bilanci neto i llogarisë së të ardhurave u mbyll pozitivisht në tremujorin e tretë të vitit 2013. Flukset neto në llogarinë e të ardhurave rezultuan rreth 35.3 milionë euro suficit nga deficiti prej 20.6 milionë eurosh në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kahu i zhvillimeve në këtë llogari, gjatë periudhës së konsideruar u përcaktua nga rënia e ndjeshme e ritmit të riatdhesimit së të ardhurave nga investimet. Gjithashtu, edhe pse në një nivel lehtësisht më të ulët krahasuar me një vit më parë, të ardhurat nga puna kontribuan pozitivisht, me rreth 18.4 milionë euro në bilancin e përgjithshëm të kësaj llogarie.

Grafik 6. Të ardhurat nga FDI-të
(flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nënzëri të ardhura nga investimet shënoi një përmirësim të ndjeshëm me tremujorin e tretë të vitit 2013, si pasojë e zhvillimeve pozitive në tre zërat përbërës të tij. Bilanci i llogarisë së të ardhurave nga investimet e huaja direkte rezultoi në suficit me rreth 4.9 milionë euro nga deficiti prej 42.0 milionë eurosh që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kalimi nga deficit në suficit i llogarisë së të ardhurave nga IHD-të, erdhi si pasojë e rënies së ndjeshme të fluksit dalës të tyre krahasuar me një vit më parë (flukset dalëse ishin vetëm 1.5 milionë euro nga rreth 47.2 milionë euro një vit më parë). Ky është dhe niveli më i ulët i shënuar për këtë zë, që prej vitit 2009.

Bilanci i të ardhurave nga investimet e portofolit rezultoi pozitiv për të tretin tremujor radhazi dhe regjistroi të ardhura për rreth 4.1 milionë euro. Gjithashtu, bilanci i të ardhurave nga investimet e tjera neto shënoi vlera pozitive për të pestin tremujor radhazi, kryesisht si pasojë e pagesave më të ulëta neto të interesit të borxhit privat dhe publik. Këto pagesa rezultuan në 6.9 milionë euro gjatë periudhës së konsideruar.

Llogaria e transfertave korrente neto regjistroi një bilanc pozitiv prej 164.1 milionë eurosh gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, në rënie me rreth 11.6% në terma vjetorë, kryesisht si pasojë e rënies së fluksit hyrës të tyre.

Grafik 7. Dërgesat e emigrantëve
(flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Që prej fillim vitit 2013, flukset financiare në llogarinë e transfertave korrente vijuan të tkurren me ritme të përshpejtuara. Rënia e dërgesave të emigrantëve neto, me rreth 15.5% në terma vjetorë, ishte përcaktuesi kryesor i ecurisë së llogarisë të transfertave korrente në total. Në tremujorin e tretë të vitit 2013, ato u vlerësuan në rreth 4.8% të PBB-së nominale, raport ky rreth 0.7 pikë përqindje më i ulët krahasuar me atë të regjistruar në tremujorin korrespondues të një viti më parë. Zhvillimet gjatë tre viteve të fundit në ecurinë e dërgesave të emigrantëve konfirmojnë edhe një herë trendin rënës të tyre dhe gjendjen në një fazë maturimi të ciklit të emigracionit. Në të njëjtin drejtim vlerësohet të kenë ndikuar dhe vijimësia e vështirësive makroekonomike dhe kufizimet në tregjet e punës në vendet ku përqendrimi i emigrantëve është më i lartë.

1.2 LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Grafik 8. Llogaria kapitale dhe financiare
(flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare regjistruan një bilanc pozitiv prej 79.5 milionë eurosh gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, duke financuar rreth 41.5% të deficitit korrent të regjistruar gjatë kësaj periudhe. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, flukset kapitale dhe financiare shënuan rënie të qenësishme me rreth 54.4% dhe u vlerësuan në rreth 3.2% në raport ndaj PBB-së nominale. Rënia në terma vjetorë e flukseve valutore në këto dy llogari u përcaktua kryesisht nga rënia me rreth 60.7% në terma vjetorë të flukseve neto në llogarinë financiare. Në raport ndaj PBB-së nominale, llogaria financiare u vlerësua rreth 2.6%, raport ky rreth 3.9 pikë përqindje më i ulët krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2012. Flukset neto në llogarinë kapitale shënuan një suficit prej 14.8 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2013.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, llogaria financiare u përball me një tkurrje të flukseve financiare me rreth 60.7% në terma vjetorë. Detyrimet financiare të rezidentëve ndaj jorezidentëve pësuan një rënie prej 11.8% në terma vjetorë, kryesisht si pasojë e rënies së fluksit hyrës të investimeve të jorezidentëve në trajtën e monedhave dhe depozitave në sistemin bankar vendas. Në kahun e mjeteve vendase totale të investuara në ekonomitë e

Grafik 9. Përbërësit e llogarisë financiare
(flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 10. Përbërja e investimeve të huaja direkte
(flukse, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

huaja vërehet një rritje me rreth me 268.9 milionë euro në periudhën e konsideruar. Në kahun e mjeteve tona të investuara në ekonomitë e huaja, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, vërehet një rritje e investimeve në trajtën e monedhave dhe depozitave me rreth 56.2% në terma vjetorë. Ndikimi i kësaj llogarie në llogarinë financiare u zbut disi nga zhvillimet pozitive në investimet e huaja direkte dhe ato të portofolit.

Investimet e huaja direkte neto shënuan një rritje me rreth 64.6% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2012. Ky ndryshim vjen kryesisht si pasojë e rritjes së detyrimeve në formën i IHD-ve (flukseve hyrëse të IHD-ve) me rreth 61.5% e.

Sipas instrumentit të përdorur për investime, IHD-të hyrëse në trajtën e letrave me vlerë të pasurisë (aksione) dhe riinvestim të fitimeve u vlerësuan në rritje me rreth 67.7% në terma vjetorë. Flukset hyrëse në trajtën e kapitaleve të tjera rezultuan rreth 4.5 milionë euro, një rënie kjo nga 8.8 milionë euro të regjistruar në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në tremujorin në analizë, fluksi i të ardhurave nga privatizimet[5] dha një kontribut modest në totalin e investimeve të huaja direkte. Duke përjashtuar nga flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte ato në trajtën e privatizimeve, IHD-të shënuan rritje me rreth 63.4% në terma vjetorë, gjatë periudhës në analizë.

Një paraqitje afatgjatë kohore e ecurisë së IHD-ve ndër vite dëshmon qartazi për rëndësinë e tyre në rritje në financimin e deficitit korrent të vendit. Duke qenë se IHD-të përfaqësojnë një fluks financiar të qëndrueshëm, që nuk krijon rritje të drejtpërdrejtë të borxhit të jashtëm dhe që kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e produktivitetit dhe të tërthortë në shpërndarjen e njohurive të reja teknologjike e prodhuese, një zhvillim i tillë vlerësohet të jetë i mirëpritur për ecurinë ekonomike dhe qëndrueshmërinë e llogarisë korrente të vendit. Në aspektin e financimit të deficitit korrent, duke përjashtuar vitet 2008 dhe 2009 kur deficiti i lartë korrent u financua kryesisht prej flukseve financiare borxh formuese, raporti i IHD-ve neto ndaj deficitit korrent ka vijuar kryesisht një prirje rritëse. Kjo ecuri pozitive vijoi edhe gjatë vitit 2013, kushtëzuar edhe prej privatizimit të mjeteve publike prej kompanive jo rezidente. Për tremujorin e tretë të vitit 2013, raporti i flukseve neto të IHD-ve kundrejt deficitit të regjistruar korrent vlerësohej në nivelin 138.7%, duke arritur në këtë mënyre të financojë tërësisht këtë deficit.

[5] *Sipas të dhënave të Ministrisë të Financave http://www.minfin.gov.al/minfin/Statistika_Fiskale_Mujore_1675_1.php*

Grafik 11. Llogaria korrente dhe IHD-të neto ndaj PBB-së (majtas) dhe mbulimi i deficitit të llogarisë korrente prej IHD-ve (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Investimet e portofolit neto për tremujorin e tretë të vitit 2013 shënuan një bilanc pozitiv prej 11.3 milionë eurosh. Në periudhën e konsideruar, rezidentët kanë investuar rreth 10.5 milionë euro jashtë vendit në tituj borxhi. Flukset hyrëse të investimeve të portofolit rezultuan në rritje të qenësishme krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, kryesisht në tituj borxhi. Gjatë periudhës në analizë, investimet e portofolit të jorezidentëve shënuan vlerën e 21.8 milionë eurove, nga 7.8 milionë euro që ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, llogaria e investimeve të tjera neto kontribuoi me rreth 204.7 milionë euro në rritjen e mjeteve të rezidentëve të investuara jashtë. Në llogarinë e investimeve të tjera, mjetet tona të investuara jashtë rezultuan në rritje me rreth 250.9 milionë euro nga rritja prej 179.7 milionë eurosh, që ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky ndryshim erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së investimeve në trajtën e monedhave dhe depozitave. Në terma sasiorë, sistemi bankar investoi rreth 278.5 milionë euro në trajtën e monedhave dhe të depozitave. Huamarrja private dhe shtetërore regjistroi një bilanc negativ prej 3.7 milionë eurosh gjatë tremujorit në analizë (vlera negative tregon se shlyerjet e detyrimeve kanë qenë më të larta se niveli i huamarrjes për periudhën e konsideruar) nga vlera pozitive 28.5 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë një vit më parë. Rënia në totalin e huamarrjes u përcaktua nga shlyerja e principalit prej sektorit privat. Në total, pagesat e borxhit (privat dhe publik) ulën detyrimet e vendit tonë me rreth 30.6 milionë euro në tremujorin në analizë.

Mjetet e rezervës valutore shënuan rritje me rreth 34.5 milionë euro në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013. Në fund të shtator 2013, stoku i rezervës valutore rezultoi rreth 2,030.2 milionë euro, nivel ky i mjaftueshëm për mbulimin e 4.7 muaj importesh të mallrave dhe të shërbimeve.

ANALIZË E BORXHIT TË JASHTËM BRUTO T3 2013

EGLENT KIKA, MERITA BOKA, OLTI MITRE
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, SHKURT 2014

PËRMBLEDHJE

- Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, stoku i borxhit të jashtëm bruto rezultoi rreth 5.5 miliardë euro dhe u vlerësua në 56.8% në raport ndaj PBB-së nominale.
- Në ndarjen sipas sektorëve, stoku i borxhit të jashtëm paraqet një profil të qëndrueshëm ku qeveria e përgjithshme zë rreth 42.5%, sistemi bankar 20.3%, sektorët e tjerë 18.6%, IHD-të 17.1% dhe autoriteti monetar 1.5%.
- Në ndarjen sipas instrumenteve të investimit, në stokun e borxhit të jashtëm dominojnë "investimet e tjera" (rreth 70.9% e stokut).
- Në ndarjen sipas maturitetit, stoku i borxhit të jashtëm përfaqësohet me rreth 78.6% nga borxhi afatgjatë.
- Në ndarjen sipas monedhës, rreth 56% e borxhit të jashtëm është në Euro dhe 13% e tij në USD.
- Qëndrueshmëria e borxhit të jashtëm, matur prej treguesve të ndryshëm të aftësisë ripaguese afatgjatë, tregon për një rënie të saj që prej vitit 2008.
- Raporti midis ecurisë afatgjatë të borxhit të jashtëm bruto dhe të eksportit të mallrave dhe shërbimeve qëndron më lartë se kufiri hipotetik optimal prej 150% që prej tremujorit të katërt të vitit 2011.
- Tregues të mjaftueshmërisë së likuiditetit për detyrimet imediate të ekonomisë ndaj borxhit të jashtëm dëshmojnë për nivele të ulëta dhe të qëndrueshme të burimeve financiare që veçohen për përmbushjen e amortizimit afatshkurtër të borxhit të jashtëm.
- Si borxhi i jashtëm neto ashtu edhe raporti i rezervës valutore kundrejt borxhit të jashtëm afatshkurtër nuk identifikojnë presione të shtuara që mund të gjenerohen si rrjedhojë e detyrimeve të pritshme të shërbimit të borxhit të jashtëm.
- Megjithatë, vërehet një prirje rritëse e fondeve të nevojshme për shërbimin e borxhit të jashtëm.

1. ANALIZË E DETAJUAR E BORXHIT TË JASHTËM BRUTO

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, stoku i borxhit të jashtëm bruto të Shqipërisë shënoi vlerën totale prej 5,472.6 milionë euro. Në vlerë, ai u rrit me rreth 59.7 milionë euro, krahasuar me tremujorin e mëparshëm, dhe me rreth 230 milionë euro, krahasuar me stokun e tij në fundin e tremujorit të tretë të vitit 2012. Kjo ecuri përfaqëson një zgjerim vjetor të stokut të borxhit të jashtëm bruto me rreth 4.4%, duke arritur në raportin 56.8% ndaj PBB-së

nominale. Ky raport ishte rreth 1.3 pikë përqindjeje më i lartë se ai i regjistruar gjatë të njëjtës periudhë të një viti më parë[1].

Sektori me peshën më të madhe në totalin e stokut të borxhit të jashtëm është qeveria qendrore. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, stoku i borxhit të qeverisë qendrore rezultoi rreth 2,327.6 milionë euro, përafërsisht 24.2% ndaj PBB-së nominale. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2012, pesha e borxhit të qeverisë qendrore ndaj stokut total u rrit me 0.5 pikë përqindjeje.

Stoku i borxhit të jashtëm bruto i sistemit bankar, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, rezultoi në rreth 1.11 miliard euro, në rritje më rreth 1.4 milionë euro, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2012. Borxhi i jashtëm i sektorëve të tjerë rezultoi në rreth 1.02 miliardë euro, duke shënuar një rritje nga tremujori i tretë i vitit 2012 me rreth 5.0 milionë euro. Së fundmi, stoku i borxhit të jashtëm të akumuluar si rezultat i investimeve të huaja gjatë periudhës së konsideruar, u vlerësua në rreth 937.3 milionë euro, në rritje me rreth 57.4 milionë euro, krahasuar me tremujorin të tretë të vitit 2012.

Për periudhën në analizë, rreth 61.5% e stokut të borxhit të jashtëm (duke përjashtuar investimet direkte – hua ndër kompani), vlerësohet të jetë borxh afatgjatë kryesisht në formën e huave. Borxhi afatshkurtër vlerësohet në rreth 21.4% ndaj totalit, i marrë kryesisht në formën e monedhave dhe depozitave nga sektori bankar. Sektori i qeverisë së përgjithshme dhe autoritetit monetar zotëron vetëm borxh afatgjatë, ndërsa sektori bankar dhe sektorët e tjerë zotërojnë një portofol të larmishëm të përbërë prej borxhit afatgjatë dhe afatshkurtër.

a) Borxhi i jashtëm sipas sektorëve të ekonomisë[2]

Në ndarjen sipas sektorëve, stoku i borxhit të jashtëm paraqet një profil të qëndrueshëm ku historikisht qeveria e përgjithshme ka zënë peshën më të madhe. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, qeveria e përgjithshme[3] zotëroi rreth 42.5% të stokut total të borxhit të jashtëm. Pjesa tjetër është shpërndarë midis: sistemit bankar[4] 20.3%, sektorëve të tjerë të ekonomisë[5] 18.6%, IHD-vë[6] 17.1% dhe autoritetit monetar[7] 1.5%.

---

[1] *Shuma rrëshqitëse e PBB-së së katër tremujorëve të fundit.*

[2] *Sektorët e ekonomisë i referohen qeverisë së përgjithshme, sistemit bankar, sektorëve të tjerë të ekonomisë, investimeve të huaja direkte dhe autoritetit monetar.*

[3] *Qeveria e përgjithshme përfshin qeverinë e përgjithshme qendrore dhe atë lokale.*

[4] *Përfshin detyrimet e sistemit bankar.*

[5] *Në stokun e borxhit të klasifikuar nën sektorë të tjerë përfshihen detyrimet e kompanive të tjera private ose shtetërore jofinanciare (ku përfshihet dhe borxhi i garantuar nga qeveria), institucionet financiare jobanka, si dhe detyrimet e individëve.*

[6] *Sipas metodologjisë ndërkombëtare, detyrimet e borxhit lidhur me investimin direkt duhet të veçohen nga detyrimet e tjera të borxhit. Në tabelën e borxhit të jashtëm bruto të Shqipërisë këto detyrime janë pasqyruar veçmas dhe përbëhen nga detyrime të bankave vendase me kapital të huaj ndaj bankave mëma. Për investimet e huaja direkte në sektorë të tjerë nuk është akoma e mundur mbledhja e këtij informacioni dhe pasqyrimi i tij veçmas.*

[7] *Sipas klasifikimit të standardeve ndërkombëtare, të dhënat mbi borxhin e jashtëm të këtij grupi përfshijnë detyrimet me jashtë të Bankës së Shqipërisë. Në përputhje me BPM5, këtu është përfshirë edhe stoku i detyrimeve të krijuara nga përdorimi i Huave dhe Kredive nga FMN.*

Grafik 1. Shpërndarja ndërsektoriale e stokut të borxhit ndaj totalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Stoku i borxhit të jashtëm bruto sipas sektorëve ndaj PBB-së nominale, fundi i tremujorit të tretë 2013



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Struktura sipas instrumenteve e stokut të borxhit të sistemit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori me peshën më të madhe ndaj stokut total të borxhit të jashtëm përfaqësohet nga qeveria e përgjithshme. Gjatë tre viteve të fundit, pesha e borxhit të qeverisë së përgjithshme ndaj stokut total të borxhit vlerësohet mesatarisht 44.0%, duke u luhatur brenda intervalit 42.0%-47.6%. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, stoku i borxhit të jashtëm të këtij sektori shënoi rreth 2.3 miliardë euro, në rritje me rreth 123.3 milionë euro, krahasuar me fundit e tremujorit të tretë të vitit 2012. Qeveria e përgjithshme zotëron vetëm borxh afatgjatë, kryesisht në trajtën e huave afatgjata, dëftesave dhe obligacioneve.

Sektori i dytë me peshën më të madhe ndaj totalit të stokut të borxhit është sistemi bankar. Pas një rritjeje të ndjeshme të stokut të borxhit të sistemit bankar gjatë vitit 2011 dhe 2012, tre tremujorët e parë të vitit 2013 shënuan një ngadalësim të ndjeshëm të ritmit të rritjes. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, borxhi i jashtëm i sistemit bankar rezultoi rreth 20.3% ndaj stokut total të borxhit dhe u vlerësua në rreth 11.5% ndaj PBB-së nominale. Në ndarjen sipas maturitetit vihet re një orientim i qartë i sektorit bankar drejt borxhit afatshkurtër. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, borxhi afatshkurtër i zotëruar prej sistemit bankar përfaqësoi rreth 90.9% të stokut total të borxhit të këtij sektori.

Stoku i borxhit të sektorëve të tjerë të ekonomisë, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, zinte rreth 18.6% e stokut total të borxhit të jashtëm bruto. Pas një rritje të theksuar të borxhit të këtij sektori gjatë dy viteve të mëparshme, gjatë vitit 2013, vihet re një ngadalësim i ndjeshëm. Në fund të periudhës në analizë, borxhi i sektorëve të tjerë të ekonomisë ishte rreth 10.5% ndaj PBB-së nominale. Sipas maturitetit, stoku i borxhit të sektorëve të tjerë përfaqësohet në masën 84.1% nga borxhi afatgjatë dhe 15.9% nga borxhi afatshkurtër.

Stoku i borxhit të huaj në trajtën e investimeve të huaja direkte - hua ndër kompani përfaqëson rreth 17.1% të stokut total të borxhit të jashtëm dhe rreth 9.7% të PBB-së nominale në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013.

Stoku i borxhit të huaj bruto të autoritetit monetar zë peshën më të ulët ndaj totalit, krahasuar me sektorët e tjerë. Ndër vite, detyrimet në trajtë borxhi të autoritetit monetar kanë shënuar një tkurrje të vazhdueshme dhe në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, ato përfaqësojnë rreth 1.5% ndaj stokut total dhe rreth 0.8% ndaj PBB-së nominale. Autoriteti monetar zotëron vetëm borxh afatgjatë, kryesisht në trajtën e detyrimeve të tjera të borxhit dhe huave afatgjata.

b) Borxhi i jashtëm sipas instrumenteve të përdorura

Në ndarjen sipas instrumenteve të përdorura, peshën më të madhe ndaj stokut total të borxhit të jashtëm e zënë investimet në trajtën e investimeve të tjera[8] me rreth 72.9%. Brenda këtij zëri, peshën kryesore e zënë huatë afatgjata dhe afatshkurtra (rreth 70.9% ndaj stokut të investimeve të tjera). Duke filluar prej fillimvitit 2011, pesha e këtij instrumenti në totalin e investime të tjera ka vijuar një pririje të lehtë rënëse në favor të instrumenteve të tjera të investimit, duke u stabilizuar në një mesatare prej 71.3% gjatë vitit 2013. Pesha e investimeve në trajtën e monedhave dhe depozitave ndaj stokut total të investimeve të tjera vlerësohet të jetë rritur me ritme të përshpejtuara, duke filluar prej gjysmës së dytë të vitit 2010. Instrumentet e investimit, si kreditë tregtare dhe detyrimet e tjera të borxhit, vijojnë të zënë një peshë të vogël ndaj stokut total të investimeve të tjera.

Ndër vite, stoku i investimeve të huaja direkte është rritur me ritme të moderuara. Në fund të periudhës në analizë, stoku i investimeve të huaja direkte – huave ndër kompani u vlerësua në rreth 17.1% ndaj stokut total të borxhit dhe në rreth 9.7% ndaj PBB-së nominale.

Grafik 4. Klasifikimi i stokut të borxhit sipas instrumenteve të investimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një trend rritës kanë ndjekur dhe investimet në trajtën e investimeve të portofolit. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, ato zënë rreth 9.9% të stokut total të borxhit të jashtëm bruto dhe u vlerësohen në rreth 5.7% ndaj PBB-së nominale.

c) Borxhi i jashtëm sipas maturitetit

Në ndarjen sipas maturitetit, stoku i borxhit të jashtëm në masën më të madhe përbehet nga borxhi afatgjatë. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, stoku i borxhit afatgjatë (i cili metodologjikisht përfshin dhe IHD-të) përfaqësoi rreth 78.6% ndaj stokut total të borxhit të jashtëm bruto dhe u vlerësua në rreth 44.7% ndaj PBB-së nominale. Pesha e borxhit afatgjatë përjashtuar IHD-të, vlerësohet në rreth 61.5% ndaj stokut total të borxhit të jashtëm.

[8] *Këtu përfshihen: huatë afatgjata e afatshkurtra, monedha e depozita, kredi tregtare dhe detyrime të tjera të borxhit të pa specifikuara.*

Grafik 5. Stoku i borxhit sipas maturitetit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Struktura e borxhit të jashtëm bruto sipas monedhave, T3 2013



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Borxhi afatshkurtër shënoi një vlerë prej rreth 1.2 miliardë euro në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, nga rreth 1.1 miliard euro që ishte në fund të së njëjtës periudhë të një viti më parë. Gjatë vitit të fundit, pesha e borxhit afatshkurtër është rritur duke përfaqësuar mesatarisht 21.2% të totalit. Qeveria e përgjithshme dhe autoriteti monetar, zotërojnë vetëm borxh afatgjatë. Sektori bankar dhe sektorët e tjerë të ekonomisë kanë një portofol të larmishëm të përbërë si prej borxhit afatgjatë ashtu edhe atij afatshkurtër.

d) Borxhi i jashtëm sipas monedhës

Borxhi i jashtëm i Shqipërisë është në masën më të madhe i nominuar në monedhën e përbashkët evropiane Euro, i vlerësuar në rreth 56.0% të totalit, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013. Stoku i borxhit në SDR[9] ndaj totalit ka shënuar një rënie progresive gjatë tre viteve të fundit. Nga ana tjetër, përgjatë nëntë muajve të parë të vitit 2013, vihet re një rritje e ndjeshme e stokut të borxhit në dollarë amerikan, nga 5.0% në tremujorin e tretë të vitit 2012 në rreth 13.0% në tremujorin e tretë të vitit 2013.

e) Shërbimi i borxhit të jashtëm bruto sipas sektorëve

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, shërbimi total i borxhit (principal dhe interesa) nga të gjithë sektorët e ekonomisë shënoi vlerën 41.4 milionë euro. Nga kjo vlerë, rreth 82.6% shkoi për pagesa principali, ndërsa rreth 17.4% për shlyerjen pagesave të interesit. Në shërbimin e borxhit sipas sektorëve, pagesat e principalit përbëjnë pjesën më të madhe të pagesave.

Tabelë 1. Shërbimi i borxhit të jashtëm bruto sipas sektorëve

	T1 '13	T2 '13	T3 '13
Qeveria e përgjithshme			
Principal	11.7	33.6	13.9
Interesa	6.1	9.0	6.5
Borxh i ri	58.5	66.5	57.7
Privat (afatgjatë dhe afatshkurtër)			
Principal	27.0	15.0	11.0
Interesa	0.1	1.3	0.3
Borxh i ri	14.0	6.0	1.3
Bankat (afatgjatë dhe afatshkurtër)			

[9] *Të drejtat speciale të tërheqjes (SDR) janë mjete të rezervës, të krijuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për të plotësuar të tjera mjete të rezervës, që u jepen periodikisht anëtarëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, në përpjesëtim me kuotat e tyre respektive.*

Principal	13.5	16.8	5.7
Interesa	0.5	0.4	0.4
Borxh i ri	3.0	4.4	7.0
Shërbimi i borxhit total	62.9	76.3	41.4
Borxhi i ri total	74.7	95.2	26.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlera totale e tërheqjeve ose borxhit të ri për të gjithë ekonominë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, ishte rreth 26.9 milionë euro - që përfaqëson edhe vlerën më të ulët të shënuar që prej vitit 2010. Tërheqjet në trajtën e borxhit të ri u dominuan nga borxhi i qeverisë së përgjithshme (duke përfshirë edhe borxhin publik të garantuar), i cili përfaqësoi rreth 69.2% ndaj totalit të borxhit të ri të kësaj periudhe. Borxhi i ri (afatgjatë) i marrë nga sektori privat shënoi një nivel ndjeshëm më të ulët, krahasuar me tre vitet e fundit. Tërheqjet e reja të sistemit bankar u rritën ndjeshëm gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013 dhe u vlerësuan në rreth 7.0 milionë euro.

2. TREGUES TË QËNDRUESHMËRISË SË BORXHIT TË JASHTËM

Analiza e borxhit të jashtëm bruto bazuar në ecurinë kohore të nën zërave të tij sektorial, të ndarjes sipas instrumenteve dhe të ndarjes sipas maturitetit paraqet një vështrim dinamik mbi situatën dhe evoluimin e tij, pa arritur në vlerësime apo përfundime mbi qëndrueshmërinë e tij në kohë. Në funksion të një analize të tillë lipset krahasimi i prirjeve kohore të borxhit të jashtëm bruto kundrejt variablave të tjerë ekonomikë apo përdorimi i formave të ndryshuara të borxhit të jashtëm. Treguesit e përdorur për vlerësimin e qëndrueshmërisë së borxhit të jashtëm, në përgjithësi klasifikohen në dy kategori: tregues të cilët matin aftësinë ripaguese të vazhdueshme dhe të pandërprerë të një vendi ndaj kreditorëve të tij dhe tregues të cilët matin mjaftueshmërinë e likuiditetit në kushtet e domosdoshmërisë së ripagimit të detyrimeve imediate.

a) Tregues të aftësisë ripaguese

Eksporti i mallrave dhe i shërbimeve konsiderohet si një burim i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm i të ardhurave valutore nga jashtë në një ekonomi. Në të njëjtën kohë, nëse përqaset në kontekst krahasimor kundrejt borxhit të jashtëm bruto të denominuar në monedhe të huaj, ai mund të shërbejë si një tregues analitik, i cili përafron kapacitetin dhe potencialin afatgjatë ripagues të një vendi. Në të njëjtën kohë, denominimi në monedhë të huaj të përbashkët i të dy treguesve ndihmon në eliminimin e efektit të luhatjeve të kursit të këmbimit. Dukuria e zgjerimit të borxhit të jashtëm bruto me ritme më të përshpejtuara se eksporti total i mallrave e shërbimeve sinjalizon për një zvogëlim të kapacitetit ripagues të një vendi, i cili mund të prodhojë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale ndaj borxhit të jashtëm në periudhën afatgjatë. Të dhënat e borxhit të jashtëm bruto ndaj PBB-së nominale për Shqipërinë tregojnë një prirje të përafërt dhe në madhësi të njëjtë ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve, deri në tremujorin e parë të

vitit 2008[10]. Përtej këtij tremujori, ecuria e stokut të borxhit të jashtëm bruto ndaj PBB-së është karakterizuar nga një trend i përshpejtuar rritës, çka ka ndikuar në divergjencën në prirjen afatgjatë të këtyre dy treguesve, paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 7. Stoku i borxhi i jashtëm bruto dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve ndaj PBB-së nominale



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Divergjenca midis ecurive afatgjata të borxhit të jashtëm bruto dhe të eksportit të mallrave dhe shërbimeve konfirmohet edhe prej përkeqësimit të raportit të midis tyre. Kështu, ky tregues luhatet përreth vlerës 100% deri në tremujorin e parë të vitit 2008, duke sinjalizuar mjaftueshmërinë e flukseve hyrëse valutore primare prej eksportit vjetor të vendit. Në vijimësi, borxhi i jashtëm bruto regjistron një ritëm më të përshpejtuar rritës krahasuar me eksportin e mallrave dhe shërbimeve, ku tremujorët të cilët përfaqësojnë edhe pikën e kthesës në rritjen e këtij treguesi janë tremujori i parë i vitit 2008 dhe tremujori i parë i vitit 2011. Raporti i borxhit të jashtëm bruto kundrejt eksportit të mallrave dhe shërbimeve ishte rreth 168% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013. Krahasuar me pragjet e caktuara dhe të pranuara prej institucioneve ndërkombëtare financiare për këtë tregues, të cilët ndryshojnë sipas zhvillimit institucional të një vendi, ky raport vlerësohet të jetë disi më i lartë, krahasuar me pragun hipotetik optimal ku mund të klasifikohet vendi ynë[11]. Në kontekstin rajonal, ky tregues e klasifikon Shqipërinë nën mesataren e regjistruar gjatë vitit 2012, ku raporti i borxhit të jashtëm bruto dhe i eksportit të mallrave dhe shërbimeve luhatej nga 142.4% në Bullgari deri në 235.2% në Kroaci.

Grafik 8. Borxhi i jashtëm bruto ndaj eksportit të mallrave e shërbimeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht divergjencës së vërejtur më sipër, në një kohë të dytë, akumulimi i mëparshëm i borxhit të jashtëm mund të shoqërohet me rritje të përshpejtuar ekonomike të vendit, nëse flukset e tij arrijnë të kanalizohen në aktivitete investuese efikase apo prodhojnë vlerë të shtuar në ekonomi. Deri në tremujorin e tretë të vitit 2013, treguesi i diferencës midis ecurisë vjetore të borxhit të jashtëm bruto dhe PBB-së nominale nuk konfirmon ende një zhvillim të tillë. Duke veçuar vetëm vitin 2005 dhe tremujorin e dytë të vitit 2006, stoku i borxhit të jashtëm bruto është rritur me ritme më të përshpejtuara, krahasuar me PBB-në nominale. Në

[10] *Flukset hyrëse të eksportit të mallrave e shërbimeve dhe PBB-ja nominale tremujore janë transformuar në flukse vjetore, në mënyrë që raportet e tyre ndaj stokut të borxhit të jashtëm në fund të periudhës të bëhen të krahasueshme dhe konsistente. Të tre variablat janë të shprehura në euro.*

[11] *Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore.*

të njëjtën kohë, mesatarja kumulative afatgjatë[12] e treguesit të diferencës midis ecurisë vjetore të borxhit të jashtëm bruto dhe PBB-së nominale vlerësohet në rreth 10.7 pikë përqindjeje, në tremujorin e tretë të vitit 2013.

Grafik 9. Diferenca e rritjes vjetore midis borxhit të jashtëm bruto dhe PBB-së nominale sipas tremujorëve (majtas) dhe sipas mesatares kumulative afatgjatë (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit e mësipërm japin një tablo dinamike të evoluimit të aftësisë afatgjatë ripaguese të vendit tonë. Ndonëse vërehet një përkeqësim i lehtë që prej vitit 2008, ecuria në vijimësi e këtij të fundit është e lidhur ngushtë, si me performancën e ekonomisë vendase ashtu edhe me shpërndarjen në kohë të shërbimit të borxhit të jashtëm[13]. Në kushte optimale, shërbimi i borxhit të jashtëm nuk duhet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë të kahut negativ në ekonomi, i cili mund të vijnë prej alokimit të burimeve financiare drejt këtij funksioni ripagues. Në të njëjtën kohë, për të evituar një dukuri të tillë, një ekonomi duhet të jetë e aftë në çdo kohë të përmbushë detyrimet e saj imediate ndaj pagesave të principalit e të interesave të borxhit të jashtëm. Akumulimi i pagesave të prapambetura të shërbimit të borxhit të jashtëm apo edhe vonesat e vazhdueshme mund të rrisin primet e rrezikut në ekonomi dhe të ushtrojnë presion mbi aktivitetin ekonomik në një kohë të dytë. Për pasojë, lipset që një ekonomi të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur këto detyrime kontraktuale imediate apo për të mundësuar përballjen me çfarëdolloj shoku negativ që buron nga ekonomia e jashtme.

b) Tregues të mjaftueshmërisë së likuiditetit

Mjaftueshmëria e likuiditetit në funksion të aftësisë ripaguese të ekonomisë është e ndikuar në një masë të madhe nga varësia në financim të jashtëm afatshkurtër. Pra, nëse mbështetja në këtë formë financimi të jashtëm me

[12] *Ky tregues ndërtohet duke përdorur si mesatare kumulative rritjen vjetore për secilën periudhë të realizuar në kohen "T" dhe përpara saj. Supozojmë se në periudhën T12 ka 12 periudha kohore. Mesatarja e tyre jep mesataren kumulative të realizuar deri në T12. Kalimi në T13 bëhet duke shtuar vlerën e T13 dhe duke mesatarizuar përsëri.*

[13] *Nëse në të ardhmen regjistrohet ritëm i shpejtë i rritjes ekonomike dhe shpërndarja në kohë e shërbimit të borxhit të jashtëm është e njëtrajtshme, aftësia afatgjatë ripaguese e vendit tonë përmirësohet. Në kushte të anasjelltë, treguesit e aftësisë afatgjatë ripaguese përkeqësohen.*

maturitet maksimal njëvjeçar është e theksuar, detyrimet imediate ndaj borxhit të jashtëm vlerësohen të larta për periudhën njëvjeçare në vazhdim. Karakteri i financimit të jashtëm të Shqipërisë ka qenë i orientuar kryesisht ndaj borxhit afatgjatë. Ndërkohë, borxhi afatshkurtër është luhatur midis vlerës minimale 9% dhe vlerës maksimale 26% ndaj totalit të stokut të borxhit të jashtëm. Në të njëjtën kohë, flukset hyrëse vjetore të të ardhurave prej eksportit të mallrave e shërbimeve arrijnë të mbulojnë tërësisht stokun e borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Grafik 10. Borxhi i jashtëm bruto afatshkurtër ndaj totalit (majtas) dhe ndaj eksportit të mallrave e shërbimeve (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një ndër treguesit e tjerë më të rëndësishëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit në funksion të borxhit të jashtëm afatshkurtër është raporti i këtij të fundit me stokun e rezervës valutore. Në kushtet kur një vend ka depërtim të limituar në tregjet kapitale ndërkombëtare, prezenca e stokut të mjaftueshëm të rezervës valutore mund të ndihmojë në përballimin e detyrimeve afatshkurtra të borxhit të jashtëm. Ky tregues bëhet edhe më i rëndësishëm në prani të ambientit të jashtëm të vështirë financiar, i cili mund të rrisë mundësinë e goditjeve të kahut negativ nga jashtë dhe të pengojë aftësinë normale ripaguese të borxhit afatshkurtër. Stoku i rezervës valutore në vendin tonë vlerësohet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar një skenar të tillë. Pragu kritik i mbulimit të borxhit afatshkurtër prej stokut të rezervës valutore, i sugjeruar prej organizmave ndërkombëtare financiare[14], është 100% dhe raportet poshtë këtij pragu dëshmojnë për një pamjaftueshmëri të stokut të rezervës valutore. Në Shqipëri ky tregues, ndonëse ka qenë i luhatur, nuk është zvogëluar në asnjë periudhë poshtë nivelit 100%. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, stoku i rezervës valutore mbulonte rreth 173% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

[14] *IMF (2000),'Debt- and Reserve-Related Indicators of External Vulnerability', International Monetary Fund, Washington D.C.*

Matja e nivelit të borxhit të jashtëm në funksion të identifikimit të presioneve afatshkurtra që mund të gjenerohen si rrjedhojë e detyrimeve të pritshme plotësohet prej përftimit të borxhit të jashtëm neto dhe qasjes analitike ndaj tij. Kështu, borxhit të jashtëm bruto i zbritet vlera kumulative e mjeteve valutore neto dhe e rezervës valutore, të cilët përbëjnë burime likuiditeti të gatshme për të luftuar goditjet e paparashikuara afatshkurtra. Borxhi i jashtëm neto i vendit tonë vlerësohet të jetë relativisht i ulët, duke u luhatur nën kufirit 20% ndaj PBB-së nominale[15]. Një nivel i tillë vjen kryesisht si pasojë e rritjes së vazhdueshme të stokut të mjeteve valutore neto dhe rezervës valutore megjithë rritjen e përshpejtuar të borxhit të jashtëm bruto. Ky tregues ka qëndruar në territor pozitiv që prej tremujorit të parë të vitit 2008 dhe në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, është vlerësuar në nivelin 15.6% ndaj PBB-së nominale.

Grafik 11. Stoku i rezervës valutore kundrejt borxhit të jashtëm bruto afatshkurtër



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 12. Borxhi i jashtëm neto ndaj PBB-së nominale (majtas) dhe ndaj eksportit të mallrave e shërbimeve (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit e ndërtuar mbi bazën e fluksit të pagesave të principalit dhe të interesit paraqesin një tablo të burimeve financiare valutore të ekonomisë që përdoren rregullisht për shërbimin e borxhit të jashtëm bruto. Duke qenë se këto tregues arrijnë të veçojnë në mënyrë më të drejtpërdrejtë detyrimet imediate të borxhit të jashtëm, ata janë të rëndësishëm në monitorimin e presioneve afatshkurtra të shërbimit të tij dhe në mënjanimin e kalimit të paparashikuar të fondeve financiare prej aktiviteteve prodhuese në ekonomi drejt pagesave

[15] *Deri në fund të vitit 2012, borxhi i jashtëm neto i Shqipërisë, i vlerësuar në nivelin 17.2% ndaj PBB-së, ndodhej nën mesataren e regjistruar nëpër vendet e rajonit. Mesatarja e borxhit të jashtëm neto të vendeve të rajonit për vitin 2012 është 30.4% ndaj PBB-së dhe luhatet nga vlerat minimale -13% dhe 11.5% ndaj PBB-së në Kosove e në Maqedoni, në vlerat maksimale 59.8% dhe 50.6% ndaj PBB-së në Kroaci e në Malin e Zi.*

të pritshme për amortizimin e borxhit të jashtëm. Shërbimi i borxhit të jashtëm të Shqipërisë luhatet rreth vlerave 5% dhe 10% kundrejt eksportit të mallrave dhe shërbimeve, duke veçuar këtu vetëm tremujorin e katërt të vitit 2010. Raporti i lartë për këtë tremujor, i cili mund të konsiderohet lehtë si një rast i izoluar, është ndikuar prej detyrimit të lartë të principalit të borxhit të jashtëm publik. Raporti i regjistruar i këtij treguesi ndodhet nën pragut kritik prej 20% të sugjeruar prej organizmave financiare ndërkombëtare[16].

Në anën tjetër, treguesi i raportit të amortizimit të borxhit të jashtëm kundrejt tërheqjes së borxhit të ri mat zëvendësimin e fraksionit të borxhit të ripaguar me tërheqje të re borxhi. Për këtë tregues, raporti nën kufirin 100% tregon për një tërheqje më të përshpejtuar të borxhit të ri të jashtëm, krahasuar me pagesat për amortizimin e tij. Në rastin e Shqipërisë, raporti i zëvendësimit të pagesave të borxhit të jashtëm me borxh të ri, deri në tremujorin e fundit të vitit 2010, luhatej brenda nivelit 40-60%, duke përjashtuar tremujorët e katërt të vitit 2009 dhe 2010, të cilët vlerësohen si raste të veçuara. Përtej këtij harku kohor, ky raport ishte mesatarisht rreth 80%, duke reflektuar pagesat më të larta të shërbimit të borxhit mbas vitit 2011. Në tërësi, ky tregues dëshmon për tërheqje më të përshpejtuar të borxhit të ri të jashtëm, krahasuar me pagesat për amortizimin e tërheqjeve të mëparshme, çka sinjalizon detyrime më të larta për shërbimin e borxhit të jashtëm në periudhën në vazhdim.

Grafik 13. Shërbimi i borxhit të jashtëm ndaj eksportit të mallrave e shërbimeve (majtas) dhe ndaj tërheqjes së borxhit të ri (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[16] *IMF (2003), "External Debt Statistics: Guide for Compilers and Users", International Monetary Fund, Washington D.C.*

STUDIME E ARTIKUJ*

** Pikëpamjet e shprehura në këto materiale janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

SEKTORI I NDËRTIMIT DHE TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME: EVIDENCA NGA SHQIPËRIA

DELINA IBRAHIMAJ, GIANLUCA MATTAROCCI

ABSTRAKT

Ndërtimi është një industri e rëndësishme nëpër botë, me peshë të qenësishme në PBB-në e vendeve. Rëndësia e këtij sektori nuk është thjesht e lidhur me përmasat dhe peshën në ekonomi, por edhe me rolin e tij në gjenerimin e rritjes ekonomike. Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë përcaktuesit makroekonomikë të sektorit të ndërtimit në Shqipëri. Duke përdorur bazën e të dhënave të Bankës së Shqipërisë, do të analizohet marrëdhënia e këtyre treguesve me anë të testeve të shkakësisë Granger, si dhe analizës *Impulse Response*. Rezultatet tregojnë se në Shqipëri ashtu si dhe në ekonomitë e tjera në zhvillim, tregu i kredisë dhe vëllimi i remitancave janë burimi kryesor i ndryshimeve në ndërtim. Treguesit e tregut të pasurive të paluajtshme kanë veti shpjeguese në afatshkurtër dhe afatgjatë. Rezultatet e këtij studimi mund të përdoren nga politikëbërësit, si dhe nga makroekonomistët për të analizuar dinamikat e sektorit të ndërtimit, si dhe për të vlerësuar efektin e ndryshimeve makroekonomike në madhësinë e rritjes së këtij sektori në Shqipëri.

1. HYRJE

Sektori i ndërtimit prodhon të mira, të cilat i ofrohen individëve dhe kompanive të sektorit publik dhe privat. Literatura tregon se ecuria e sektorit të prodhimit lidhet ngushtë me ecurinë e PBB-së. Në periudha bumi ekonomik, zhvillimi i sektorit të ndërtimit stimulohet nga kërkesa e shtuar publike dhe private. Shpenzimet publike në sektorin e ndërtimit janë më të larta në këto periudha, duke u mbështetur në burimet e shtuara të financimit (Grebler and Burns, 1982). Roli i PBB-së në sektorin e ndërtimit vlerësohet të jetë i lartë në vendet e pazhvilluara, ndërsa kur shkalla e zhvillimit rritet, roli i PBB-së mund të jetë më i ulët dhe në disa raste edhe negativ (Crosthwaite, 2000).

Pasuritë e paluajtshme janë investime afatgjata. Ndërtuesit vendosin për rritjen e prodhimit të tyre duke u bazuar në kërkesën publike ose në porositë e reja në sektorin privat (Nicholson and Tebbut, 1979). Vëllimi i porosive të reja është i lidhur ngushtë me kushtet e tregut dhe mund të shpjegojë dinamikat e sektorit e ndërtimit. Kushte të përmirësuara të investimeve (të lidhura me rritjen e produktivitetit) në pasuri të paluajtshme duhet të çojnë në rritje të prodhimit në sektorin e ndërtimit.

Ky studim do të mundohet të analizojë marrëdhënien ndërmjet sektorit të ndërtimit dhe disa treguesve makroekonomikë të sugjeruar nga literatura.

Duke përfshirë indikatorë mbi eficiencën e tregut të pasurive të paluajtshme do të mundohemi të vlerësojmë kontributin e tyre në sektorin e ndërtimit. Më në detaj, ky studim do të mundohet të analizojë efektet e PBB-së reale (pa sektorin e ndërtimit) (GDP), normës së interesit të depozitave në lek (INT), kredisë për individë (CRE), indeksit të çmimeve të qirasë (RPI), indeksit të çmimeve të banesave (HPI), numrit të lejeve të ndërtimit të miratuara (No. LICENSES), remitancave (REM) dhe Tobin Q në prodhimin në sektorin e ndërtimit (CONS).

Fillimisht, studimi do të mundohet të kuptojë drejtimin e marrëdhënies, me anë të testeve të shkakësisë Granger. Me anë të analizave *Impulse Response* të modelit VAR, ne do të analizojmë efektet e disa prej këtyre variablave në sektorin e ndërtimit. Do të mundohemi të studiojmë efektin e një goditje strukturore të secilës prej variablave në model tek ecuria në kohë e sektorit të ndërtimit. Më pas, me anë të metodës së zbërthimit të variancës (Forecast Error Variance Decomposition), do të mundohemi të kuptojmë se cili nga faktorët shpjegues ka rëndësi në shpjegimin e variancës së sektorit të ndërtimit. Sa ndikohet ndryshimi në ecurinë e sektorit të ndërtimit nga një goditje në vetë serinë e ndërtimit apo nga goditje në treguesit e tjerë?

Studimi është i ndarë si më poshtë: në seksionin e dytë do të paraqesim vështrimin e literaturës mbi përcaktuesit makroekonomikë në rritjen dhe në madhësinë e sektorit të ndërtimit, duke marrë në konsideratë evidenca nga vendet e zhvilluara dhe në zhvillim; në seksionin e tretë do të përshkruajmë treguesit, metodologjinë dhe rezultatet e studimit; ndërsa në sektorin e katërt do të përmbledhim dhe analizojmë rezultatet.

2. VËSHTRIM I LITERATURËS

Madhësia e sektorit të ndërtimit ndikohet nga ecuria e ekonomisë. Rritja e të ardhurave të disponueshme të qytetarëve sjell rritjen e kërkesës për pasuri të paluajtshme. Marrëdhënia e kësaj rritjeje me rritjen e PBB-së nuk është lineare, literatura tregon se ajo merr formën e një S-je. Kjo marrëdhënie është: pozitive kur ekonomia është e pazhvilluar (LDE), inelastike kur ekonomia është në zhvillim (NIE); dhe negative kur ekonomia është e zhvilluar (AIE) (Crosthwaite, 2000). Rëndësia e rritjes ekonomike në ecurinë e sektorit të ndërtimit lidhet me kërkesën për banesa banimi në qytetet kryesore, e cila është në maksimum për LDE-të, e qëndrueshme për NIE-të dhe në rënie për AIE-të (Bonn, 1992).

Rritja e sektorit të ndërtimit mund të ndikohet ndryshe nga sektorë të ndryshëm ekonomik megjithatë, kërkesa më e madhe, si për ndërtime të reja dhe për rikonstruksione, është e lidhur kryesisht me degën e tregtisë (Bon dhe Pietroforte, 1993). Marrëdhënia e ndërsjellët ndërmjet sektorit të ndërtimit dhe sektorëve të tjerë të ekonomisë ndryshon në varësi të kohës. Reagimi i sektorit të shërbimeve ndaj investimeve në ndërtim në këtë sektor është i menjëhershëm, ndërkohë që degë si prodhimi, transporti dhe komunikimi ndikohen nga sektori i ndërtimit me një diferencë më të gjatë kohore (Lean, 2001).

Megjithëse çdo lloj ndërtimi është unik në llojin e tij dhe kostot për të realizuar çdo investim varen nga aftësitë, materialet dhe standardizimi i procesit të prodhimit (Ball, 1965), dinamikat e sektorit të ndërtimit mund të shpjegohen bazuar në diferencën ndërmjet çmimeve të shitjes dhe të kostove të ndërtimit. Kjo diference në literaturë përkufizohet si Tobin Q dhe llogaritet si raporti i çmimeve të shitjes me çmimet e ndërtimit. Vlera më e madhe se 1 justifikon rritje në afatshkurtër të ofertës së sektorit të ndërtimit (Barot and Yang, 2002), kurse në afatmesëm dhe afatgjatë oferta duket sikur nuk ndikohet më nga kostot e ndërtimit, të cilat shihen si kosto të pashmangshme (Dorward, Akintoye and Hardcastle, 1998).

Oferta e ndërtimeve për qëllime investimi ndikohet gjithashtu nga çmimet e qirave, nisur nga fitime më të larta (të ulëta) të lidhura me investimet. Kështu, shkalla e lartë (ulët) e dhënies me qira dhe/ose çmime më të larta (ulëta) të qirave kanë një impakt pozitiv (negativ) në zhvillimin e sektorit të ndërtimit. Kjo marrëdhënie është më e qartë në disa tipe investimesh, në pasuri të paluajtshme, si p.sh. zyra, për të cilat qiraja është e vetmja formë përfitimi për pronarët (McGough and Tsolacos, 1999).

Investimet në pasuri të paluajtshme, në shumicën e rasteve kryhen duke përdorur kredi, pra çdo lëvizje në normat e interesit duhet të ndikojë sektorin e ndërtimit. Nëse kërkesa është elastike, rritja e normave të interesit, të cilat i aplikohen ndërtuesve, ka një impakt negativ në zhvillimin e sektorit, nisur nga fakti se çmimet nuk mund të rriten mjaftueshëm për të mbuluar kostot ekstra të lidhura me financimin. Nga ana tjetër, nëse kërkesa është inelastike, impakti i rritjes së normës së interesit do të absorbohet nga çmimet, të cilat do të rriten për të mbuluar kostot e shtuara nga rritja e normave të interesit (Lewis, 2004). Rritja (ulja) e normës së kredisë për individë ose, në terma më të përgjithshëm, e investimeve në tregun e pasurive të paluajtshëm, do të kishte një efekt negativ (pozitiv) në kërkesën për pasuri të paluajtshme, e cila do te ndikonte vendimin për investime në periudhat e ardhshme të ndërtuesve, pra në afatmesëm do të ndikonte prodhimin në ndërtim (Ng, Fan dhe Wong, 2011). Pavarësisht nga kostot e kreditimit dhe oferta e shtuar e kredisë, ulja e standardeve në dhënien e kredisë do të kishte një efekt pozitiv në zhvillimin e sektorit të ndërtimit (Ozcelebi, 2011).

Qeveria është e interesuar të stimuloje zhvillimin e sektorit të ndërtimit sepse duke qenë sektori i cili përdor intensivisht burimet njerëzore, zhvillimi i tij mund të ndikojë uljen e papunësisë (Ramsaran and Hosein, 2006). Në vendet e pazhvilluara, një faktor tjetër që mund të ndikojë kërkesën për ndërtim është sasia e remitancave hyrëse, të cilat mbështesin rritjen e investimeve në banesa (Osili, 2004).

3. ANALIZA EMPIRIKE

3.1 KAMPIONI

Analiza empirike do të zhvillohet duke përdorur të dhëna nga tremujori i parë 2004 deri në tremujorin e dytë 2013. Zgjedhja e kohës u kushtëzua

nga të dhënat e PBB-së reale në dispozicion, seri e cila fillon në tremujorin e parë të 2004. Për qëllimet e studimit do të përdoren të dhëna tremujore nga INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. Treguesit e përzgjedhur janë paraqitur në tabelën 1.

Tabelë 1. Statistika deskriptive

Treguesi	Shkurtimi	Obs.	Mesatare	Mediana	Max	Min	St.Dev.
Prodhimi në ndërtim	CONS	38	10.24	10.26	10.69	9.69	0.24
PBB (pa ndërtimin)	GDP	38	12.09	12.09	12.33	11.75	0.15
Norma e interesit e depozitave	INT	38	1.77	1.77	2.02	1.52	0.12
Kredia për individë	CRE	38	11.37	11.84	11.95	9.65	0.73
Indeksi i çmimit të banesave	HPI	38	4.91	4.94	5.11	4.54	0.16
Lejet e ndërtimit	No_Lic	38	5.03	5.65	6.78	0.01	1.76
Remitanca	REM	38	5.24	5.29	5.69	4.66	0.25
Indeksi i qirave të banesave	RPI	38	4.93	5.01	5.20	4.42	0.22
Tobin Q	T_Q	38	0.33	0.34	0.52	0.01	0.12

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve.

Ku:

CONS-i është prodhimi në sektorin e ndërtimit, i publikuar me frekuencë tremujore nga INSTAT-i, i shprehur në terma realë dhe i rregulluar për sezonalitet.

GDP-ja është PBB reale (pa sektorin e ndërtimit), publikuar me frekuencë tremujore nga INSTAT-i, i shprehur në terma reale dhe i rregulluar për sezonalitet.

INT-ja është mesatarja e peshuar e normës së interesit të depozitave në lek, e publikuar me frekuencë mujore nga Banka e Shqipërisë. Për qëllimet e studimit, ne kemi përdorur mesataren tremujore.

CRE-ja është kredia për individë, e cila i referohet stokut të kredisë, e publikuar nga Banka e Shqipërisë me frekuencë mujore. Për qëllimet e studimit, kemi përdorur vlerën e muajit të fundit të tremujorit për të përafruar vlerën tremujore.

RPI-ja është indeksi i çmimeve të qirave, i cili publikohet në raportet e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë dhe llogaritet duke përdorur metoda Hedonike mbi bazën e të dhënave të njoftimeve të gazetës Çelësi.

HPI-ja është indeksi i çmimeve të banesave, i cili publikohet në Raportet e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë, i llogaritur përmes metodës Hedonike mbi bazën e të dhënave të njoftimeve të gazetës Çelësi.

No_Lic është numri i lejeve të banimit të aprovuara nga bashkitë, të publikuara nga INSTAT, me frekuence tremujore.

REM-I është seria e remitancave, e publikuar nga Banka e Shqipërisë.

T_Q është treguesi Tobin Q, i llogaritur nga autorët si raporti i indeksit të çmimeve të banesave me indeksin e kostove të prodhimit në ndërtim.

Të gjitha variablat janë të shprehura në logaritme natyrore për të analizuar elasticitetin e tyre (duke bërë përjashtim për normën e interesit). Tabela 1 përmbledh disa të dhëna statistikore për seritë e përzgjedhura.

Përpara përdorimit të të dhënave, mbi to u aplikua testi i rrënjës njësi. Hipoteza zero u testua për intervalet e tolerancës 1%, 5% dhe 10% dhe rezultatet janë të përmbledhura në tabelën 2.

Tabelë 2. Testet e rrënjës njësi

Treguesi	Shkurtimi	Numri i rrënjëve njësi	t stat	Prob
Ndërtimi	CONS	2 Diference	-24.19	0.00
PBB	GDP	1 Diference	-3.59	0.01
Interesi i depozitave	INT	1 Diference	-3.59	0.01
Kredia për individë	CRE	2 Diference	-10.69	0.00
Indeksi i çmimit të banesave	HPI	1 Diference	-6.05	0.00
Lejet e ndërtimit	No_Lic	Nivel	-5.66	0.00
Remitanca	REM	1 Diference	-10.18	0.00
Indeksi i çmimit të qirave	RPI	1 Diference	-6.35	0.00
Tobin Q	TQ	1 Diference	-6.12	0.00

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve.

Testi ADF test sugjeron se treguesit janë të integruar në nivele të ndryshme. Akademikë[1] të ndryshëm bien dakord se në analiza ekonometrike duhen përdorur të dhëna stacionare sepse të dhëna jostacionare mund të japin ekuacione të gabuara. Megjithatë, ka disa autorë të cilët e kundërshtojnë sa më sipër, duke argumentuar se diferencimi i serive hedh poshtë marrëdhënie kointegruese ndërmjet serive. (Sims et al 2000, Enders 1995, Doan 2004, Cooley and Leroy 1985). Enders (1995) shpjegon se Modeli VAR, i zhvilluar në diferencë, mund të shkaktojë humbje të informacionit të lëvizjeve paralele ndërmjet variablave. Duke qenë se seritë tona kohore janë të integruara në nivele të ndryshme, ne do të ndjekim metodën e propozuar nga Ozcelebi (2011) dhe do të përdorim modelin VAR në nivel.

3.2 METODOLOGJIA

Analiza e marrëdhënies së shkakësisë është kryer duke marrë në konsideratë marrëdhënien e dyanshme ndërmjet çdo variabli shpjegues të prodhimit në ndërtim. Testi i shkakësisë është kryer duke përdorur metodën e "Granger causality" (Granger, 1969), në formulat e mëposhtme:

$$\mathrm{CONS}_t = \alpha + \sum_{k=1}^{n} \beta_{i1} \mathrm{CONS}_{t-k} + \sum_{k=1}^{n} \beta_{i2} \mathrm{Factor}_{t-k} + u \qquad (1)$$

$$\mathrm{Factor}_t = \alpha + \sum_{k=1}^{n} \gamma_{i1} \mathrm{Factor}_{t-k} + \sum_{k=1}^{n} \gamma_{i2} \mathrm{CONS}_{t-k} + v \qquad (2)$$

[1] *Granger and Newbold, 1974, Phillips, 1986.*

ku CONS është prodhimi në sektorin e ndërtimit, dhe Factor janë faktorët e marrë në konsideratë: Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP), norma e interesit të depozitave (INT), kredia për individë (CRE), indeksi çmimit të banesave (HPI), numri i lejeve të ndërtimit (No_Lic), remitancat (REM), indeksi i qirave të banesave (RPI) dhe Tobin q (TQ). Nëse β_{i2} është stilistikisht i rëndësishëm dhe γ_{i2} nuk është stilistikisht i rëndësishëm, "Faktori" i testuar Granger shkakton prodhimin në ndërtim. Nëse të dy koeficientet β_{i2} dhe γ_{i2} janë stilistikisht të rëndësishëm, testi i shkakësisë Granger nuk na ndihmon të kuptojmë shenjën dhe fortësinë e shkakësisë sepse të dy faktorët e ndikojnë njëri-tjetrin.

Për të vlerësuar marrëdhënien e ndërsjellët ndërmjet variablave shpjeguese kemi përdorur dhe analizën VAR (Vector Autoregression Analysis), e cila i trajton të gjitha variablat endogjene në sistem si funksion të vlerave të tyre të prapambetura dhe të palidhura me variablat e tjerë. Në formulat si më poshtë:

$$\begin{array}{lll} CONS_t & CONS_{t-1} & CONS_{t-p} \\ GDP_t & GDP_{t-1} & GDP_{t-p} \\ INT_t & INT_{t-1} & INT_{t-p} \\ CRE_t & CRE_{t-1} & CRE_{t-p} \\ HPI_t = \alpha + \varphi_1 & HPI_{t-1} + ... + \varphi_p & HPI_{t-p} + \epsilon_t \\ No_Lic_t & No_Lic_{t-1} & No_{Lic_{t-p}} \\ REM_t & REM_{t-1} & REM_{t-p} \\ RPI_t & RPI_{t-1} & RPI_{t-p} \\ TQ_t & TQ_{t-1} & TQ_{t-p} \end{array} \qquad (3)$$

Duke u nisur nga këtu, ne do të kryejmë analizën *Impulse Response* për të gjurmuar efektin e një goditjeje në një variabël endogjene tek variablat e tjera. Një goditje në variabël nuk ndikon vetëm atë por transmetohet dhe tek të gjitha variablat e tjerë endogjenë, nëpërmjet strukturës dinamike të VAR (dynamic lag structure). Një funksion *Impulse Response* gjurmon efektin e një goditje të ndodhur një herë, në vlerat korrente dhe të ardhshme të variablave endogjenë. Ne do të përqendrojmë vëmendjen tonë në efektin që ka një goditje në të gjithë variablat e tjerë të konsideruar tek sektori i ndërtimit. Duke u nisur nga sistemi VAR, do të përdorim analizën *Impulse Response* për të gjurmuar efektet e një goditjeje në një variabël endogjen në prodhimin në ndërtim dhe do të identifikojmë kohën që do t'i duhet sektorit të ndërtimit për të amortizuar efektin e goditjes së marrë nga secili variabël. Më vonë do të përdorim *Variance Decomposition* (FVED) për të matur shkallën e rëndësisë që kanë variablat e ndryshëm në ndryshimin e sektorit të ndërtimit, në një horizont kohor prej 10 tremujorësh.

3.3 REZULTATET

Për të identifikuar përcaktuesit e sektorit të ndërtimit, paraprakisht u zhvillua analiza e *Granger causality*, për të identifikuar nëse ekziston ndonjë marrëdhënie unilaterale shkakësie ndërmjet çdo përcaktuesi dhe prodhimit në ndërtim (tabela 3).

Rezultatet e testit të shkakësisë ndërmjet serive me një lag kohor prej 4 tremujorësh janë paraqitur në tabelat e mëposhtme. Kemi zgjedhur të përdorim 4 kohë diferencë, bazuar në teste paraprake, të cilat tregojnë se rezultatet më të mira janë të lidhura me atë diferencë kohore.

Tabelë 3. Rezultatet e analizës Granger causality

		H_0: CONS i ndikuar nga factor		H_0: Factor i ndikuar nga CONS	
	Observime	Statistika F	Prob	Statistika F	Prob
GDP	34	6.92	0.00	7.63	0.06
INT	34	1.18	0.34	7.65	0.00
CRE	34	6.14	0.00	1.45	0.25
HPI	34	3.71	0.01	1.57	0.21
No_Lic	34	1.37	0.27	3.21	0.03
REM	34	4.42	0.01	0.37	0.83
RPI	34	1.65	0.19	2.62	0.06
TQ	34	1.75	0.17	3.74	0.02

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve.

Rezultatet tregojnë së PBB-ja pa ndërtimin (GDP) dhe prodhimi në ndërtim (CONS) kanë një raport shkakësie të ndërsjellë me njëri-tjetrin, ky rezultat është i ndryshëm nga skenari i pritur për ekonomitë e pazhvilluara.

Sa më sipër sugjeron se kredia për individë dhe remitancat (Granger) shkaktojnë dinamikat e sektorit të ndërtimit. Roli i kredisë për individë në sektorin e ndërtimit mund të shpjegohet duke u bazuar në teorinë e kërkesës, e cila lidh rritjen e vëllimit të kredisë me rritjen e prodhimit në ndërtim, si pasojë e fitimeve më të larta të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme (Elíasson and Pétursson, 2009).

Siç tregon teoria e vendeve në zhvillim, dhe në rastin e Shqipërisë, remitancat, duke ndikuar pozitivisht investimet në pasuri të paluajtshme (aktive të qëndrueshme), ndikojnë gjithashtu pozitivisht dhe prodhimin në sektorin e ndërtimit (Kagochi and Kiambigi, 2012).

Sektori i ndërtimit (Granger) shkakton ndryshimet në normat e interesit të depozitave, numrin e lejeve të akorduara të ndërtimit, indeksin Tobin Q dhe indeksin e çmimeve të banesave.

Ndikimi në normat e interesit vjen si pasojë e rënies së kërkesës për ndërtime. Nëse sektori i ndërtimit do të ndalojë së zhvilluari: numri i lejeve të ndërtimit do të bjerë; *Indeksi Tobin Q* do të bjerë nga rritja e kostove të ndërtimit (vëllimi i ndërtimit me i vogël sjell ekonomi shkalle më të vogla dhe kosto fikse më të larta për t'u shpërndarë për njësi të ndërtuar); dhe çmimet e qirave do të rriten, nisur nga oferta më e vogël e banesave.

Rezultatet e testit të shkakësisë *Granger Causality* janë të influencuara dhe nga korrelacioni ndërmjet variablave shpjegues, i cili nuk lejon të identifikosh saktësisht marrëdhënien ndërmjet variablave, duke marrë si hipotezë një marrëdhënie të thjeshtë bilaterale ndërmjet ndërtimit dhe çdo

përcaktuesi. Tabela më poshtë paraqet matricën e korrelacionit ndërmjet variablave (table 4).

Tabelë 4. Matrica e korrelacionit

	CONS	GDP	INT	CRE	HPI	No_Lic	REM	RPI	TQ
CONS	1.00								
GDP	0.33	1.00							
INT	0.25	-0.05	1.00						
CRE	0.41	0.82**	0.14	1.00					
HPI	0.47	0.73**	0.19	0.92**	1.00				
No_Lic	0.02	-0.06	0.19	-0.07	-0.05	1.00			
REM	0.39	-0.29	-0.05	-0.16	-0.12	0.14	1.00		
RPI	0.35	0.82**	0.13	0.96**	0.97**	-0.09	-0.26	1.00	
TQ	0.48	0.68	0.19	0.87*	0.99**	-0.05	-0.09	0.94**	1.00

*Shënim: * Korrelacioni i rëndësishëm në nivelin 95%* *** Korrelacion i rëndësishëm në nivelin 99%*
Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe të dhëna të përpunuara nga autorët.

Rezultatet e analizës së korrelacionit tregojnë se variablat nuk kanë korrelacion të lartë me prodhimin në ndërtim. Variablat me korrelacion më të lartë ndërmjet njëri-tjetrit janë kredia për individë me PBB-në dhe treguesit e tregut të pasurive të paluajtshme (HPI RPI dhe Tobin Q). Treguesit e pasurive të paluajtshme janë të llogaritur për Tiranën. Ky treg mund të konsiderohet si referencë për Shqipërinë, duke qenë se është tregu me numër më të madh shitblerjesh dhe kontrata qiraje. Shkalla e lartë e korrelacionit është pjesërisht pasojë e bumit demografik në qytetin e Tiranës. Rritja e PBB-së dhe e kredisë për individë në periudhën para krizës është në linjë me bumin demografik në qytetin e Tiranës, dhe ngadalësimi i këtyre indikatorëve është në linjë me përfundimin e lëvizjeve të mëdha demografike.

Rezultatet e analizës "impulse response" janë paraqitur në grafikun 1, më poshtë. Në modelin VAR janë përfshirë vetëm variablat që treguan rëndësi dhe qëndrueshmëri. Fillimisht u testua rëndësia. Variablat, goditja e të cilave jepte një përgjigje të rëndësishme në ndërtim, u testuan më tej për qëndrueshmëri. Qëndrueshmëria e rezultateve u testua duke ndryshuar renditjen e vendosjes në model. Treguesit që i kaluan fazat e përzgjedhjes janë vetëm: kredia për individë, numri i lejeve të ndërtimit, remitancat dhe indeksi i qirave. Në grafikun 1 është shfaqet paraqitja grafike e analizës "impulse response", pra impakti i një goditje në këto variabla tek sektori i ndërtimit.

Grafik 1. Analiza *Impulse Response*

Përgjigje ndaj Cholesky One S.D. Innovations ± 2 S.E.



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve.

Grafiku 1 tregon se një goditje pozitive prej një devijimi standard në kredinë për individë çon në rritje të aktivitetit të ndërtimit nga tremujori i dytë deri në tremujorin e katërt. Nga kjo analizë mund të themi se një goditje në kredinë për individë ka një efekt të qëndrueshëm në ndërtim, duke qenë se në afatgjatë sektori i ndërtimit qëndron në një ekuilibër të ri (më të lartë). Kjo tregon se kredia për individë e ndikon pozitivisht prodhimin në ndërtim dhe siç pritej, një sasi më e madhe të ardhurash në dispozicion sjell një nivel më të lartë oferte në ndërtim.

Një goditje pozitive prej një devijimi standard i numrit të lejeve të aprovuara nga bashkitë jep një ndikim të lartë pozitiv të sektorit të ndërtimit, por efekti është vetëm i përkohshëm, pasi në afatgjatë sektori i ndërtimit kthehet në ekuilibër përpara goditjes.

Përgjigja e sektorit të ndërtimit ndaj një goditjeje pozitive në remitanca është negative në tremujorin e dytë, por në afatgjatë reagimi kundrejt kësaj goditjeje e kthen prodhimin në ndërtim afër ekuilibrit të mëparshëm.

Një goditje pozitive prej një devijimi standard në çmimet e qirave sjell ngadalësim të sektorit të ndërtimit mbas dy tremujorësh. Në afatgjatë ky tregues ka tendencën të shkojë në ekuilibër. Shenja e këtij reagimi është e pritura. Një rritje në çmimet e qirave mund të vijë nga rritja e kërkesës për qira, që tregon për rënie të kërkesës për ndërtime të reja. Ky është një efekt nga ana e kërkesës që ndryshon ciklet e biznesit. Për këtë arsye, goditja jep një efekt të paqëndrueshëm dhe në afatgjatë variabli kthehet në ekuilibër.

Goditjet në variablat e tjera (GDP, INT, HPI, TOBIN_Q) nuk shfaqin reagime të qarta në prodhimin në ndërtim. Cilësia e dobët e të dhënave mund të jetë një nga shkaqet kryesore të mungesës së rëndësisë ekonomike ndërmjet të dhënave makroekonomike në analizë. Cilësia e dobët e të dhënave vjen si rezultat i: periudhës së tranzicionit në Shqipëri, e cila

është shoqëruar nga një shkallë e lartë informaliteti; si dhe i gjatësisë së serive. Gjatësia e lag-ut për t'u marrë në konsideratë në modelet VAR zakonisht vendoset nga kriteri Swartz. Si në studimin e Afonso et al (2011), në studimin tonë janë përdorur 2 kohë diferencë, ndryshe nga 4 kohët e sugjeruara nga kriteri Swartz. Një numër më i madh observimesh do të lejonte përdorimin e VAR me 4 kohë diferencë, dhe kjo do të reflektohej në një reagim më të mirë të sektorit të ndërtimit nga goditjet e treguesve makroekonomikë të lartpërmendur. Një tjetër mangësi e të dhënave janë thyerjet strukturore në to. Literatura sugjeron që seritë me thyerje struktrore nuk duhet të merren në konsideratë, ose duhet të merret në konsideratë vetëm periudha pas thyerjes strukturore, por edhe në këtë rast, seritë do të shkurtoheshin së tepërmi dhe nuk do të mund të kryenim asnjë analizë.

Roli i katër variablave të përzgjedhura si shpjeguesë të aktivitetit në ndërtim është analizuar më në detaj nëpërmjet metodës së zbërthimit të variancës (FVED). Analiza FVED tregon shkallën e rëndësisë së kredisë për individë, numrit të lejeve të ndërtimit, remitancave dhe indeksit të qirave të banesave në sektorin e ndërtimit për 10 tremujorët në vijim. Zbërthimi i variancës së ndërtimit në 10 tremujorët e ardhshëm sipas metodës FVED, është paraqitur në tabelën 6.

Tabelë 5. Rezultatet e FVED

	Periudha									
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
CONS	100	75.58	72.79	69.09	67.79	66.80	65.93	65.30	68.47	64.55
CRE	0.00	0.89	1.49	5.03	6.63	7.56	8.44	9.00	9.35	9.61
No_Lic	0.00	18.48	20.27	20.45	19.99	19.68	19.32	19.03	18.86	18.74
REM	0.00	0.61	0.77	0.93	1.16	1.60	1.96	2.28	2.53	2.71
RPI	0.00	4.44	4.67	4.48	4.43	4.36	4.36	4.38	4.39	4.40

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe të dhëna të përpunuara nga autorëve.

Analiza *FEVD* tregon se sa përqind e variancës së ndërtimit mund të shpjegohet nga çdo tregues makroekonomik në analizë. Tabela tregon se ndërtimi vetë shpjegon rreth 65% të variancës së tij. Rezultatet tregojnë se goditjet në numrin e lejeve të ndërtimit dhe indeksin e qirave të banesave shpjegojnë afërsisht 20% dhe 5% të variancës në sektorin e ndërtimit. Rezultatet tregojnë gjithashtu se rëndësia e kredisë për individë rritet gradualisht, kështu që rëndësia e këtij treguesi duhet të analizohet në afatgjatë. Analiza *FEVD* tregon se remitancat gjithashtu marrin rëndësi në afat të gjatë, gjithsesi rëndësia e këtij treguesi është e ulët krahasuar me treguesit e tjerë në model.

4. KONKLUZIONE

Ky studim analizon efektet e disa treguesve makroekonomikë në sektorin e ndërtimin, përfshirë dhe disa variabla të lidhur me tregun e pasurive të paluajtshme si numri i lejeve të ndërtimit të aprovuara, indeksi i çmimeve të

banesave dhe qirave në një vend në zhvillim si Shqipëria, ku sektori i ndërtimit nuk drejtohet vetëm nga rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Në këtë studim u analizua në mënyrë empirike marrëdhënia ndërmjet sektorit të ndërtimit dhe PBB-së pa ndërtim, norma e interesit të depozitave 12-mujore në lek, kredia për individë, indeksi i çmimeve dhe qirave të banesave, numri i lejeve të aprovuara në ndërtim, remitancat dhe Tobin Q. Qëllimi i studimit ishte të analizonim efektet e këtyre treguesve makroekonomikë në aktivitetin e sektorit të ndërtimit.

Analiza e treguesve që mund të drejtojnë ndryshimet në sektorin e ndërtimit tregon se tregu i kredisë dhe sasia e remitancave janë burimet kryesore të ndryshimeve në ndërtim. Rezultatet janë të qëndrueshme pasi investimet në tregun e pasurive të paluajtshme përdorin gjerësisht kapitalin dhe financimet që mund të vijnë nga kanali standard i kredisë, si dhe nga tregu informal (një nga përbërësit e të cilit janë dhe remitancat nga pjesëtarë të ndryshëm të familjes) (Jarvis, 2000). Analiza tregon se ndër përcaktuesit e zhvillimeve në sektorin e ndërtimit nga treguesit e tregut të pasurive të paluajtshme, janë numri i lejeve të ndërtimit të akorduara dhe indeksi i çmimeve të qirave. Rritja e numrit të lejeve të ndërtimit ka një efekt pozitiv në ofertë, pasi ndërtuesit përfitojnë nga çdo ndryshim rregullator (rritja e numrit të lejeve të dhëna), duke pasur sigurinë e kërkesës e cila nuk e ka arritur fazën e maturitetit. Rëndësia e indeksit të çmimit të qirave mund t'i atribuohet më shume sektorit privat (bizneseve) se sa individëve: në fakt, në tregun e banesave rëndësia e qirave është akoma e ulët (Kalia, 2013) ndërkohë që rëndësia e sektorit të tregëtimit me pakicë dhe zyrave ka ardhur në rritje nisur nga kërkesa vendase dhe e huaj, në rritje (Colliers, 2012).

Çmimet e banesave, ndryshe nga ç'pritej, nuk janë përcaktues të zhvillimit në sektorin e ndërtimit. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht nga burimi i të dhënave të cilat ndërtohen duke përdorur bazën e të dhënave të njoftimeve të gazetës Çelësi, të cilat jo domosdoshmërisht tregojnë për çmimin e vërtetë të transaksioneve. Megjithatë, çdo lloj indeksi i ndërtuar mbi të dhëna publike, do të ishte i pasaktë nisur nga shkalla e lartë e informalitetit në deklarimin e vlerës reale të transaksioneve (Thanasi and Hysi, 2013).

Ky artikull tregon se zhvillimet në sektorin e ndërtimit ndikohen nga kredia, si dhe nga dinamikat e tregut të pasurive të paluajtshme në një ekonomi në zhvillim si Shqipëria. Megjithatë, rritja e sektorit ndikohet gjithashtu nga mundësia e krijimit të kushteve të përshtatshme, të cilat mbështesin kërkesën për investime në atë kategori asetesh.

REFERENCA

Afonso, Antonio and Baxa, Jaromir and Slavik, Michal (2011) "Fiscal Developments and Financial Stress: A Threshold VAR Analysis", ECB Working Paper No. 1319

Ball, C.M. (1965), "Employment effects of construction expenditures", Monthly Labour Review, Vol. 88, No. 2, f. 154-158

Barot, B. and Zan, Y. (2002), "House Prices and Housing Investment in Sweden and the United Kingdom: Econometric Analysis for the Period 1970–1998", Review of Urban & Regional Development Studies, Vol. 14, No. 2, f. 189–216

Bon, R. (1992), "The Future of International Construction. Secular Patterns of Growth and Decline", Habitat International, Vol. 16, No. 2, f. 119-128

Bon, R. and Pietroforte, R. (1993), "New Construction Versus Maintenance and Repair Construction Technology in the US since World War II", Construction Management and Economics, Vol. 11, No. 2, pp.151-162

Colliers (2012), 2012 Eastern Europe Real Estate Review, available at http://www.colliers.com/ (accessed 01/01/2014)

Crosthwaite, D. (2000), "The Global Construction Market: a Cross-sectional Analysis, Construction Management and Economics", Vol. 18, No. 5, f. 619-627

Dorward, F., Akintoye, A. and Hardcastle C. (1998), "The Causal Relationship between Construction Workload and Construction Price", Applied Economic Letters, Vol. 5, No. 1, f. 15-18

Elíasson, L. and Pétursson, T.G. (2009), "The Residential Housing Market in Iceland: Analysing the Effects of Mortgage Market Restructuring", Housing Studies, Vol. 24, No. 1, f. 25-45

Giang, D.T.H and Pheng L.S. (2011), "Role of Construction in Economic Development: Review of Key Concepts in the Past 40 Years", Habitat International, Vol. 35, No. 1, f. 118-125

Grebler, L. and Burns L.S. (1982), "Construction Cycles in the United States Since World War II", AREUEA Journal, Vol. 10, No. 2, f. 123-151

Jarvis, C. (2000), "The rise and fall of Albania's pyramid schemes", Finance and Development, 37(1), f. 46-49

Kagochi, J.M. and Kiambigi, M. (2012), "Remittances' Influence on Housing Construction Demand in Sub-Saharan Africa: The Case of Kenya", African Development Review, Vol. 24, No. 3, f. 255-265

Kalia M. (2013), "The Factors that Influence Customer Behaviour in Housing Market in Tirana", Journal of Marketing & Management, Vol. 4, No. 1, f. 93-106

Lean, C.S. (2001), "Empirical Tests to Discern, Linkages between Construction and other Economic sectors in Singapore", Construction Management and Economics, Vol. 19, No. 4, f. 355-363

Lewis, M.T. (2004), "The Construction Industry in the Economy of Trinidad & Tobago", Construction Management Economics, Vol. 22, No. 5, f. 541-549

McGough, T. and Tsolacos, S. (1999), "Interactions Within the Office Market Cycle in Great Britain", Journal of Real Estate Research, Vol. 18, No.1, f. 219-231

Ng, S.T., Fan, R.Y.C. and Wong J.M.W. (2011), "An Econometric Model for Forecasting Private Construction Investment in Hong Kong", Construction Management and Economics, Vol. 29, No. 5, f. 519-534

Nicholson R.J. and Tebbutt S.O. (1979), "Modelling of new orders for private industrial building", Journal of Industrial Economics Vol. 28 Issue 2, f. 147-160

Ozcelebi, O. (2011), "Determinants of Costruction Sector Activity in Turkey: A Vector Autoregression Approach", International Journal of Economics and Finance, Vol. 3, No. 2, f. 130-139

Osili, U. (2004), "Migrants and Housing Investments: Theory and Evidence from Nigeria", Economic Development and Cultural Change, Vol. 52, No. 4, pp. 821-849

Ramsaran, R. and Hosein, R. (2006), "Growth, Employment and the Construction Industry in Trinidad and Tobago", Construction Management and Economics, Vol. 24, No. 5, f. 465-474

Thanasi M. and Hysi V. (2013), "Impact of the Model of Taxation on Transferring Properties in Immovable Property Market in Albania", Journal of Finance, Accounting & Management, Vol. 4, No. 2, f. 1-10

PERFORMANCA E EKSPORTEVE NË SHQIPËRI 2005-2012: PËRQASJE CMS

OLTI MITRE

HYRJE

Performanca e eksporteve është një faktor i rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë në vendimmarrjen e politikës ekonomike, veçanërisht në sfondin e një situate të pafavorshme në ekonominë botërore dhe në partnerët tanë tregtarë. Kriza financiare dhe ekonomike ka cenuar qëndrueshmërinë e deficiteve tregtare (e të llogarive korrente) të vendeve të rajonit, duke pakësuar burimet e qëndrueshme të financimit të jashtëm. Të paktën dy burime janë duke pësuar ndryshime drejt kahut rënës, IHD-të dhe remitancat. Studimi i performancës së eksporteve, kryesisht për shtete si Shqipëria, mund të jetë vendimtar për zgjedhjen e politikave të duhura që synojnë adresimin e zhbalancave në sektorin e jashtëm.

Ky studim tenton të vlerësojë performancën e eksporteve shqiptare gjatë periudhës 2005-2012. Duke analizuar konkurrencën me të cilën eksportet shqiptare – si dhe eksportet e vendeve të tjera në zhvillim – përballen në tregjet e huaja, performanca e eksporteve shqiptare mund të konsiderohet e kënaqshme për periudhën në analizë. Gjatë gjysmës së dytë të viteve '00, struktura gjeografike e destinacionit të eksporteve pësoi një ndryshim gradual, ku peshat e tregjeve të Kinës, Zvicrës, Turqisë, si dhe vendet anëtare të CEFTA-s[1] në eksportet totale shqiptare, pësuan rritje. Gjithashtu, kjo periudhë u karakterizua nga një specializim në mallra të ndryshëm i eksporteve të shteteve të Evropës Juglindore. Por në të njëjtën kohë, struktura e eksporteve në drejtim të shumëllojshmërisë dhe cilësisë mbeti një faktor kyç në performancën e eksporteve shqiptare.

Studimi është i organizuar si më poshtë. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare drejt tregtisë ndërkombëtare dhe veçanërisht struktura e eksporteve sipas mallrave dhe destinacionit, janë analizuar në pjesën e dyte. Pjesa e tretë konsiston në përdorimin e metodës CMS (Constant Market Share analysis), për të gjetur faktorët bazë në ndryshimin e eksporteve totale shqiptare. Pjesa e katërt përmbledh rezultatet dhe përfundimet e këtij studimi.

[1] *CEFTA 2006 - Marrëveshja e tregtisë së lirë ku bëjnë pjesë: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova.*

1. STRUKTURA E EKSPORTEVE SHQIPTARE DHE SHKALLA E EKSPOZIMIT TË EKONOMISË SHQIPTARE NDAJ TREGTISË NDËRKOMBËTARE

1.1 Struktura e eksporteve, sipas mallrave dhe destinacionit

Struktura e eksporteve shqiptare sipas mallrave dhe destinacionit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë periudhës 2005-2012. Rritjes së eksporteve gjatë periudhës në analizë, përveç kontributit të mallrave të përpunuar dhe atyre të tjera të përpunuar, iu shtuan dhe kontributi pozitiv në rritje i lëndëve djegëse minerale dhe lëndëve të para minerale[2]. Në të njëjtën kohë, eksportet shqiptare filluan të zhvendosen nga destinacioni i tyre kryesor, BE-ja, drejt vendeve anëtare të CEFTA-s dhe tregjeve të tjera të zhvilluara.

Struktura e eksporteve sipas produkteve (Klasifikimi Standard i Tregtisë së Jashtme, SITC[3]) tregon që pesha e kombinuar e kategorive "lëndë djegëse dhe energji" (kryesisht nafta bruto) dhe "mallra të përpunuara dhe mallra të tjera të përpunuara" (materialet e përpunuara të gizës dhe çelikut, si dhe produkte tekstile me karakter rieksportues) ka qëndruar mesatarisht rreth vlerës 80% të eksporteve totale shqiptare. Ndërkohë, një vështrim drejt strukturës së eksporteve të vendeve të Evropës Juglindore flet për një specializim në kategori të ndryshme. Ndonëse faktor i përbashkët mbetet pesha e lartë e kategorisë "mallra të përpunuara dhe mallra të tjera të përpunuara", shtete si Serbia, Kroacia dhe Bosnje-Hercegovina kanë shënuar rritje në peshën e kategorisë "makineri dhe pajisje", gjatë periudhës 2005-2012.

Grafik 1. Struktura e eksporteve shqiptare sipas produkteve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregu i gjerë i BE-së vijoi të mbetet destinacioni kryesor i produkteve shqiptare të eksportit, ndonëse pesha e tij në eksportet shënoi rënie nga 89% në vitin 2005, në 76% në vitin 2012. Procesi i ndryshimit të strukturës gjeografike të eksporteve u karakterizua nga rritja e peshave të vendeve anëtare të CEFTA-s dhe shteteve si Kina, Zvicra dhe Turqia, respektivisht nga 7% dhe 2.3% në vitin 2005, në 12% dhe 9.8% në vitin 2012. Tregjet e BE-së mbetën destinacion kryesor dhe për vendet e rajonit, ku pesha e tyre lëvizi rreth vlerës 50-60% të eksporteve totale të shteteve si Bosnje-Hercegovina, Serbia dhe Kroacia.

---

[2] *Bazuar në Indeksin e Çmimit të Metaleve, publikuar me frekuencë mujore nga FMN-ja, gjatë periudhës 2005-2011, ky indeks shënoi rritje të qenësishme, mesatarisht me rreth 18% në terma vjetorë.*

[3] *Kategoritë e produkteve të prezantuara në këtë studim i korrespondojnë kodeve njëshifrore të SITC si më poshtë:*
- *SITC 0,1 – Ushqime dhe kafshë të gjalla, pije e duhan;*
- *SITC 2,4 – Lëndë të para minerale, yndyra bimore dhe shtazore;*
- *SITC 3 – Lëndë djegëse dhe energji;*
- *SITC 5 – Produkte kimike;*
- *SITC 7 – Makineri dhe pajisje;*
- *SITC 6,8 – Mallra të përpunuar dhe mallra të tjerë të përpunuar;*
- *SITC 9 – Të tjera të paklasifikuara.*

Faktorët kyç në riorientimin e destinacionit të eksporteve shqiptare vlerësohet të kenë qenë: rritja e konkurrencës që eksportet hasën në tregjet e BE-së gjatë periudhës 2005-2012 nga eksportet e vendeve të tjera; ndikimi i krizës financiare në Eurozonë, duke sjellë rënien në kërkesën e brendshme të tregjeve të BE-së për produkte të huaja, dhe intesifikimin e proceseve integruese në kuadrin e CEFTA 2006.

Grafik 2. Struktura e eksporteve shqiptare sipas destinacionit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 Ekspozimi i ekonomisë shqiptare ndaj tregtisë së huaj

Gjatë dy dekadave të fundit, vende të ndryshme të Evropës Juglindore kanë zgjeruar gradualisht ekspozimin e ekonomive të tyre ndaj tregtisë së jashtme, nën ndikimin e disa faktorëve. Liberalizimi i tregtisë së huaj, kërkesat konsumatore në rritje për shumëllojshmëri produktesh, kostot më të ulëta të transportit dhe distancat më të vogla mes tregjeve, ndihmuan në rritjet e përshpejtuar të shkëmbimeve tregtare në mallra në këto vende.

Lidhja pozitive ndërmjet normave të rritjes ekonomike dhe ekspozimit ndaj tregtisë së jashtme është mbështetur nga një numër i konsiderueshëm studimesh empirike (Mckinnon (1973), Balassa (1985), Proudman et al. (1997), Vamvakidis (2002)). Megjithatë, indikatorët për tregtinë e huaj dhe eksportet totale të Shqipërisë shfaqin një panoramë mikse gjatë periudhës 2005-2012.

Grafik 3. Indikatorë mbi ekspozimin e ekonomisë shqiptare ndaj tregtisë së huaj*



Burimi: Banka e Shqipërisë.
*Indikatorët e përdorur:
Performanca e eksporteve = X/Y * 100 ku X – eksporti i mallrave dhe Y – PBB-ja nominale;
Shkalla e hapjes ndaj tregtisë së huaj = (Exp + Imp) / PBB nominale* 100;
Depërtimi i importeve = Imp/(PBB-Net Exp) * 100;
Ekspozimi ndaj tregtise së huaj = Perf e eksport + (1- Perf e eksport) * Depërtimin e importeve.

Paraqitur në grafikun 3, performanca e eksporteve të mallrave të Shqipërisë, gjatë periudhës 2005-2012, vlerësohet të jetë rritur, nga 8% në vitin 2005 në rreth 16% në vitin 2012, ndonëse këto vlera janë më të ulëta në krahasim me vendet e rajonit si Maqedonia, Serbia apo Kroacia, të cilat shënojnë respektivisht një raport prej rreth 43%, 27% dhe 19%, gjatë vitit 2011. Shkalla e hapjes ndaj tregtisë së huaj vlerësohet të ketë pasur një rritje të lehtë gjatë viteve të fundit, por përsëri nën mesataren e vendeve të rajonit. Në vazhdim, indikatori i depërtimit të importeve është i rëndësishëm për të kuptuar se në çfarë mase kërkesa e brendshme (diferenca midis PBB-së dhe eksporteve neto) plotësohet nga importet. Për ekonominë tonë, ky raport vlerësohet të ketë qenë mesatarisht rreth 30% gjatë periudhës në analizë, në vijë me vendet e rajonit. Të njëjtin trend ka shfaqur dhe indikatori i ekspozimit ndaj tregtisë së huaj, i cili është rritur nga 31.6% në vitin 2005, në 42.95% gjatë vitit 2012.

2. ANALIZA CMS (*CONSTANT MARKET SHARE*)

2.1 METODOLOGJIA

Analiza *Constant Market Share* (CMS) është një metodë dekompozimi që bazohet në supozimin se eksportet e një vendi mund të kenë sukses (ose jo) në rritjen më të shpejtë se mesatarja botërore për tre arsye: a) eksportet mund të përqendrohen në mallra, kërkesa e të cilave shënon rritje të shpejtë; b) eksportet mund të shkojnë drejt tregjeve dhe rajoneve që shfaqin rritje (ose stanjacion); c) eksportet e vendit në fjalë mund të kenë (ose të mos kenë) qenë në gjendje të konkurrojnë në mënyrë efektive me burime të tjera të eksporteve drejt tregjeve të huaja.

Pjesa në vijim do të shpjegojë metodën CMS, zhvilluar nga Leamer dhe Stern (1970). Simbolet e përdorura janë:

$V_{i.}$ – vlera e eksporteve të produktit i të vendit A në periudhën 1;
$V_{i.}'$ – vlera e eksporteve të produktit i të vendit A në periudhën 2;
$V_{.j}$ – vlera e eksporteve të shtetit A drejt vendit j në periudhën 1;
$V'_{.j}$ – vlera e eksporteve të shtetit A drejt vendit j në periudhën 2;
V_{ij} – vlera e eksporteve të produktit i të shtetit A drejt shtetit j në periudhën 1;
r – rritja në përqindje e eksporteve totale botërore nga periudha 1 në 2;
r_i – rritja në përqindje e eksporteve botërore të produktit i nga periudha 1 në 2;
r_{ij} – rritja në përqindje e eksporteve botërore të produktit i drejt shtetit j nga periudha 1 në 2.

Vlera e eksporteve të shtetit A në periudhën 1 është:

$$\sum_i \sum_j V_{ij} = \sum_i V_{i.} = \sum_j V_{.j} = V_{..} \quad (a)$$

Në nivelin e parë të analizës, ne mund të shikojmë eksportet si një të mirë të vetme për një treg të vetëm. Në këtë nivel analize, argumentohet se në qoftë se shteti A mban të njëjtin raport eksportesh në tregun botëror, atëherë eksportet do të rriten me $rV_{..}$ dhe për këtë arsye mund të shkruhet identiteti në vijim:

$$V'_{..} - V_{..} \equiv rV_{..} + (V'_{..} - V_{..} - r\,V_{..}) \quad (b)$$

Duke qenë se në identitetin (b) eksportet totale të vendit A janë një set i diversifikuar në i produkte të ndryshme, identitetet në vijim do të shkruheshin:

$$\begin{aligned} V'_{i.} - V_{i.} &\equiv r_i V_{i.} + (V'_{i.} - V_{i.} - r_i V_{i.})\, V'_{..} - V_{..} \\ &\equiv \sum_i r_i V_{i.} + \sum_i (V'_{i.} - V_{i.} - r_i V_{i.}) \\ &\equiv \underset{(1)}{(rV_{..})} + \underset{(2)}{\sum_i (r_i - r)\, V_{i.}} + \underset{(3)}{\sum_i (V'_{i.} - V_{i.} - r_i V_{i.})} \quad (c) \end{aligned}$$

Niveli i fundit i analizës konsiston në faktin që eksportet janë një set i diversifikuar në i produkte të ndryshme drejt j tregjeve (shteteve) të ndryshme, duke sjellë identitetet në vijim:

$$V'_{ij} - V_{ij} \equiv r_{ij} V_{ij} + (V'_{ij} - V_{ij} - r_{ij} V_{ij})\ V'_{..} - V_{..}$$

$$\equiv \sum_i \sum_j r_{ij} V_{ij} + \sum_i \sum_j (V'_{ij} - V_{ij} - r_{ij} V_{ij})$$

$$\equiv (rV_{..}) + \sum_i (r_i - r) V_{i.} + \sum_i \sum_j r_{ij} V_{ij} + \sum_i \sum_j (V'_{ij} - V_{ij} - r_{ij} V_{ij})$$

(1) (2) (3) (4)

(d)

Identiteti (d) paraqet nivelin e tretë të analizës CMS, duke treguar se rritja e eksporteve vjen pjesërisht nga: (1) rritja e përgjithshme e eksporteve botërore; (2) përbërja strukturore sipas mallrave e eksporteve të vendit A, gjatë periudhës 1; (3) shpërndarja sipas destinacionit e eksporteve të vendit A; dhe (4) pjesa e pashpjegueshme, efektet e konkurrencës që tregojnë dallimet midis rritjes aktuale të eksporteve dhe rritjes hipotetike, nëse vendi A do të kishte ruajtur pjesën e tij të eksportit të çdo produkti drejt çdo shteti.

2.2 PROBLEMET KRYESORE TË ZBATIMIT TË METODËS CMS

Zbatimi i metodës CMS përmban disa kufizime[4], të cilat radhiten më poshtë.

Interpretimi i përbërjes strukturore në mallra dhe shpërndarjes sipas destinacionit - Ndryshimi në strukturën e mallrave të eksporteve, lidhet kryesisht me preferencat e konsumatorit dhe me konkurrencën që haset nga shtete të treta në vendet e destinacionit. Ndryshimet në shpërndarjen gjeografike nga ana e kërkesës pasqyrohen kryesisht nga preferencat e konsumatorit dhe marrëdhëniet tradicionale midis dy vendeve (eksportues dhe destinacion). Në rastin e Shqipërisë, faktorët e mësipërm janë pasqyruar në rritjen e peshave të vendeve anëtare të CEFTA-s dhe rritjen e peshës të kategorisë "lëndë djegëse dhe energji" (kryesisht nafta bruto). Nga ana e ofertës, struktura gjeografike është e lidhur me produktivitetin, por dhe me politika monetare e fiskale të ndjekur nga vendi eksportues. Për të analizuar këtë efekt janë parë indikatorë si NEER, REER dhe produktiviteti i punës, të cilët janë vendosur në grafikun 4.

Përcaktimet e konkurrencës - Ndryshimi i eksporteve për shkak të konkurrencës vjen mbas zbritjes së tre termave të parë në identitetin (d). Pjesa residuale ose "efektet e konkurrencës", janë të llogaritura në çmime relative, duke përfshirë dhe faktorë joçmim si cilësia e produktit, koha e prodhimit apo kostot e ndërmarra.

Përcaktimi i kohës - Në qoftë se koha në identitetin (d) do të konsiderohej diskrete dhe jo e vazhdueshme, atëherë nuk do të ishte e arsyeshme të supozonim që struktura në mallra dhe në orietim gjeografik do të qëndronte e njëjtë për një periudhë të gjatë kohe.

[4] *Richardson (1971)*

2.3 SHËNIME HYRËSE

Katër komponentët e identitetit (d) u llogaritën për periudhën 2005-2008, 2008-2010, 2011 dhe 2012, duke përdorur peshat e kategorive të eksporteve në bazë të vlerave të raportuara për to. Llogaritjet janë bazuar në mesataren e ndryshimeve vjetore gjatë periudhës së shqyrtuar, duke mënjanuar problemin e kohës diskrete. Ato janë kryer edhe duke vendosur kohën diskrete, dhe rezultatet kanë qenë përafërsisht të ngjashme. Shpërndarja e eksporteve shqiptare u bë sipas kategorive kryesore SITC (Klasifikimit Standard të Tregtisë së Huaj) dhe sipas dy destinacioneve: tregut të BE-së; dhe të tjerë, ku përfshihen vendet anëtare të CEFTA-s, Kina, Zvicra, Turqi etj.

2.4 REZULTATET

Rezultatet e metodës CMS janë të përmbledhura ne tabelën 1. Në ndryshimin e eksporteve totale, efekt pozitiv kanë dhënë rritja botërore e eksporteve dhe konkurrenca e eksporteve. Struktura në mallra të eksporteve ka dhënë një efekt negativ gjatë periudhave 2005-2008, por ky efekt ka shënuar vlerë pozitive gjatë periudhës 2008-2010 dhe 2011. Gjatë vitit 2012, efekti i ndarjes strukturore vlerësohet të ketë dhënë një kontribut negativ. Orientimi gjeografik i eksporteve ka dhënë një kontribut negativ në rritje gjatë periudhave të lartpërmendura. Ndërsa, tre kategoritë kryesore të eksporteve (SITC 3,6,8) dhanë të njëjtin rezultat si eksportet totale, duke u ndikuar pozitivisht nga rritja botërore e eksporteve dhe efektet e konkurrencës. Ndërkohë, viti 2011 solli dhe një sërë efektesh pozitive. Rritja e eksporteve gjatë këtij viti, vlerësohet të jetë ndikuar pozitivisht nga të tërë komponentët e analizës, përveç orientimit gjeografik. Ecuria e vështirë ekonomike që partnerët tanë tregtare hasën gjatë vitit 2011 dhe 2012, vlerësohet të ketë sjellë një efekt negativ të orientimit gjeografik. Ndërsa pesha e efektit të konkurrencës u reduktua gjatë këtij viti, gjë që tregon për një rritje të konkurrencës të hasur nga mallrat e eksportit shqiptar në tregjet e huaja. Përmirësimi në vlerë i efektit nga struktura në mallra të eksporteve shqiptare, mund të shpjegohet nga pasojat që solli rritja e varietetit të tyre gjatë viteve të fundit, ndonëse në vitin 2012 ky efekt shënoi vlerë negative. Rritja në peshën e kategorive "lëndë të para minerale" dhe "lëndë djegëse dhe energji" ndihmoi në zbutjen e efekteve që dha kriza financiare gjatë viteve 2008-2009 në tregtinë e jashtme të vendit tonë në vlerë. Peshat në rritjet e lartpërmendura vlerësohet të kenë ndihmuar dhe në kontributin pozitiv të shfaqur gjatë vitit 2011, nga struktura në mallra e eksporteve totale.

Tabelë 1. Rezultatet e metodës CMS për eksportet shqiptare në mallra

	Eksporte totale							
	2005-2008		2008-2010		2011		2012	
	mil €	% total	mil €	% total	mil €	%total	mil €	%total
Nga rritja botërore	55.60	14.4%	52.22	20.4%	164.53	70.3%	121.39	101.1%
Nga struktura në mallra	-3.97	(1.0%)	9.54	3.7%	49.50	21.2%	-2.83	(2.4%)
Nga orientimi gjeografik	-1.78	(0.5%)	-29.24	(11.4%)	-19.32	(8.3%)	-38.43	(-32.0%)
Nga efektet e konkurrencës	335.83	87.1%	223.12	87.3%	39.32	16.8%	39.96	33.3%
Ndryshimi total	385.68	100%	255.64	100%	234.02	100%	120.09	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë, EuroStat, World Trade Organization, UN comtrade dhe llogaritje të autorit.

Në vazhdim, efekti negativ në rritje nga orientimi gjeografik tregon ndikimin e madh që kërkesa e huaj ka mbi produktet e eksportit në Shqipëri. Kriza ekonomike e financiare ndikoi tregjet e zhvilluara dhe partnerin tonë kryesor, BE-në. Në vitin 2009, rritja e PBB-së së vendeve anëtare të BE-së shënoi rënie me rreth 4% dhe recesioni solli një rënie të tregtisë së huaj me rreth 20% në vlerë. Si rrjedhojë, vendet e Evropës Juglindore u përballën me një ulje të kërkesës së huaj për mallra vendase. Gjithashtu, pesha e eksporteve totale shqiptare në tregjet e BE-së mbetet rreth 0.03% e totalit të importeve botërore të BE-së, duke vlerësuar se performanca e eksporteve tona vijon të cenohet nga ecuria ekonomike e partnerëve tanë tregtarë, si Italia e Greqia.

Një tjetër indikator që ndihmon në vlerësimin e orientimit gjeografik të eksporteve është indeksi TCI (*Trade-Complementarity Index*)[5], i cili i përgjigjet pyetjes se a duhet një vend eksportues të fillojë të prodhojë mallra të reja për eksport drejt një vendi të dhënë apo duhet të zgjerohet në tregjet ekzistuese ku eksporton. Ky indeks mat shkallën me të cilën modeli i eksporteve të një vendi përputhet me modelin e importeve të një vendi tjetër. Një shkallë e lartë e komplementaritetit supozohet të tregojë mundësitë më të favorshme për një marrëveshje të suksesshme tregtie. Ecuria e indeksit në kohë mund të tregojë nëse profilet e tregtisë të këtyre vendeve janë duke u bërë më shumë ose më pak të përputhshme. Indeksi është i ndërtuar si më poshtë dhe merr vlera nga 0-100:

$$C^{AB} = 100\left[1-\sum_{k}|m_k^A - x_k^B|/2\right]$$

m_k^A - pesha e produktit k në importet totale të BE-së;
x_k^B - pesha e produktit k në eksportet totale të Shqipërisë.

Për Shqipërinë, si vend eksportues drejt BE-së, ky indeks ka shfaqur rritje nga 41,7 në vitin 2005, në 54,5 në vitin 2012, duke shfaqur një përputhshmëri në rritje të strukturës së eksporteve shqiptare me strukturën e importeve të tregjeve të BE-së. Këto vlera në rritje të indeksit tregojnë për një mundësi të zgjerimit efikas të tregtisë së huaj midis Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së.

Efekti pozitiv që shfaq konkurrenca e eksporteve tona në tregjet e huaja, vlerësohet si pasojë e disa faktorëve. Këto faktorë mund të jenë të lidhur me çmimin e eksporteve ose me produktivitetin e punës në sektorin e tregtueshëm të ekonomisë vendase. Indekset NEER dhe REER shfaqin vlera në rritje, duke nënkuptuar një trend nënçmues për monedhën vendase. Ky trend nënçmues mund të ketë rritur kërkesën për eksportet "e lira" shqiptare në tregjet e huaja. Në vazhdim, Çeliku dhe Metani (2011), në llogaritjet e produktivitetit të punës për Shqipërinë gjatë periudhës 2003-2010, arrijnë në përfundimin se ky indeks dëshmon një prirje rënëse. Në ndarjen e ekonomisë sipas dy sektorëve, të tregtueshëm e të patregtueshëm, ky i fundit regjistron peshën më të lartë, duke ndikuar prirjen rënëse të PP-së gjatë periudhës në analizë. Mbetet për t'u theksuar që PP-ja në sektorin e tregueshëm vlerësohet me një prirje rritëse, trend që mund të shpjegojë efektin pozitiv të konkurrencës së eksporteve shqiptare.

[5] *Brenton and Newfarmer, 2009.*

Grafik 4. Indeksi NEER, REER dhe PP-ja për Shqipërinë (2006=100)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Indexi RCA (Revealed Comparative Advantage) i trajtuar nga Balassa (1965), gjithashtu ndihmon në vlerësimin e avantazhit krahasues që kanë eksportet e një vendi në kategori të caktuara eksporti. Indeksi formulohet si:

$$B_{ij} = \frac{x_{ij}/x_{wj}}{x_i/x_w}$$

ku: Xij – eksportet e produktit j të shtetit i; Xwj eksportet botërore të produktit j; Xi – eksportet totale të shtetit i; dhe Xw – eksportet totale botërore.

Ky indeks tregon që shteti i ka një avantazh krahasues në eksportet e produktit j, në qoftë se $x_{ij}/x_{wj} > x_i/x_w$, duke vlerësuar specializimin ndërkombëtar të një shteti në bazë të peshës së tregut që eksporti i produktit j zë në botë, kundrejt peshës së eksporteve totale të shtetit i në eksportet botërore. Mbetet për t'u theksuar që nëse një vend përqendrohet në kategori eksportesh me peshë të madhe brenda tij, por me peshë të vogël në kuadër botërore (siç ndodh jorrallë në rastin e ekonomive të vogla), rezultati do të jetë një indeks $Bij > 1$. Për të korrigjuar këtë efekt, është ndërtuar një indeks me shpërndarje simetrike[6]:

$$BL_{ij} = \frac{B_{ij}-1}{B_{ij}+1}$$

Ky indeks merr vlerat nga -1 në 1 dhe tregon se nëse $0 \leq BLij \leq 1$, atëherë vendi i ka avantazh krahasues në kategorinë j të eksportit. Tabela 2 tregon vlerat që këto indekse marrin për Shqipërinë dhe për vende të rajonit që kanë statusin e vendit kandidat nga BE-ja.

Rezultatet e mësipërme flasin për një avantazh krahasues të kategorive kryesore të eksporteve (SITC 3, 6, 8) të vërtetuar nga të dy indekset në analizë. Mbetet për t'u vlerësuar fakti se vlerat e indeksit Balassa (1965), për kategoritë SITC 6,8, janë më të lartat në rajon, duke treguar për një avantazh krahasues të lartë të këtyre produkteve.

Tabelë 2. Statistikat përshkruese për indeksin Bij (Shqipëri, Serbi, Kroaci)

Balassa 1965 -Shqip	2007	2008	2009	2010	2011	2012
SITC 3	0.6	0.5	0.8	1.2	1.2	1.4
SITC 6,8	2.7	2.8	2.6	2.4	2.3	2.1
Balassa 1965	Serbia					
SITC 3	0.2	0.2	0.3	0.3	0.2	0.2
SITC 6,8	1.9	1.9	1.6	1.7	1.7	1.5
Balassa 1965	Kroacia					
SITC 3	0.9	0.7	0.9	0.8	0.7	0.7
SITC 6,8	1.3	1.2	1.2	1.2	1.3	1.3
Laursen 1998	Shqipëria					
SITC 3	-0.3	-0.3	-0.1	0.1	0.1	0.2
SITC 6,8	0.5	0.5	0.4	0.4	0.4	0.4

Burimi: Banka e Shqipërisë, WTO.

[6] *Laursen (1998).*

3. PËRFUNDIMET

Ky studim synon të vlerësojë ecurinë e eksporteve shqiptare gjatë periudhës 2005-2012, duke studiuar, së pari, strukturën në mallra dhe orientimin gjeografik të tyre dhe së dyti, ekspozimin e ekonomisë shqiptare drejt tregtisë së huaj. Për të identifikuar faktorët kryesorë që kanë ndikuar strukturën degësore dhe gjeografike të eksporteve, është përdorur metoda CMS (Constant Market Share).

Duke pasur parasysh: shkallën e lartë të konkurrencës në tregjet ndërkombëtare; peshën e vogël të eksporteve totale shqiptare në tregjet e BE-së; shkallën në rritje të ekspozimit ndaj tregtisë së huaj dhe ndikimet e krizës ekonomike e financiare; performanca e eksporteve shqiptare vlerësohet të ketë qenë e kënaqshme për periudhën në analizë. Struktura në mallrat e eksporteve gjatë periudhës 2005-2008 dhe 2012, u vlerësua të ketë sjellë efekt negativ në rritjen totale të eksporteve. Megjithëse riorientimi i eksporteve shqiptare drejt vendeve anëtare të CEFTA-s vlerësohet të ketë qenë pozitiv, efekti i lartë i kërkesës së vendeve të BE-së për mallra të huaja, ka ndikuar negativisht ecurinë e eksporteve shqiptare gjatë periudhës në analizë.

Në vazhdim, efekti pozitiv i konkurrencës tregon për një performancë të kënaqshme të eksporteve tona në tregjet e huaja. Në mbështetje të rezultateve të mësipërme e duke marrë në konsideratë peshën e rëndësishme që produktet tekstile me karakter rieksportues, lëndët djegëse e ato minerale kanë në eksportet shqiptare, këto industri vlerësohen të zotërojnë potencialin e duhur për të tërhequr investime të huaja nga rajoni dhe vendet e zhvilluara. Për t'u theksuar mbetet ecuria ekonomike e partnerëve tanë ndërkombëtarë meqenëse kërkesa e huaj do të luajë një rol kryesor në ecurinë e eksporteve shqiptare.

REFERENCA

Athanasoglou, P.P. et al (2010) "Export performance, competitiveness and commodity composition" Bank of Greece Working Paper 114

Balassa, B. (1965), "Trade liberalization and revealed comparative advantages", The Manchester School of Economics and Social Studies, 32, 2, 99-123

Balassa, B. (1985), "Exports policy choices and economic growth in developing countries after the 1973 oil shock", Journal of Development Economics, May/June, 23- 35 Cadot, O. "A Guide To Trade Data Analysis", The World Bank

Çeliku, E. dhe Metani, I. (2011), "Pozicioni konkurrues i ekonomisë shqiptare në terma të produktivitetit e të kostos së punës", Banka e Shqipërisë

Dollar, D. (1992), "Outward-orientated developing countries really do grow more rapidly: Evidence from 95 LDC's, 1976-85", Economic Development and Cultural Change, 40, April, 523-544

Juswanto, W. P. Mulyanti (2003), "Indonesia's Manufactured Exports: A CMS analysis" World Bank papers on Trade Analysis

Leamer, E.E. and R.M. Stern (1970), Quantitative International Economics, Allyn and Bacon, Ch.7

Mckinnon, R. I. (1973) Money and Capital in Economic Development. Brooking Institution, Washington, D.C

Richardson, J. (1971), "Constant-market-share analysis of export growth" Journal of International Economics, 1, 2, 227-39

Vamvakidis, A. (2002). How Robust is the Growth-Openness Connection: Historical Evidence. Journal of Economic Growth, 7(1): 57-80

EFEKTI I MBARTUR NË ECURINË VJETORE TË PRODHIMIT TË BRENDSHËM BRUTO

IRIS METANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

Dinamika e ndryshimit vjetor të prodhimit të brendshëm bruto nga një vit në tjetrin përcaktohet si nga zhvillimet ekonomike që ndodhin gjatë vitit në analizë, ashtu edhe nga ecuria e PBB-së në vitin e mëparshëm. E shprehur ndryshe, norma mesatare vjetore e rritjes përcaktohet si nga normat tremujore të rritjes të shfaqura gjatë vitit në analizë, ashtu edhe nga ecuria e rritjes një vit më parë e njohur si efekti i mbartur[1]. Vlerësimi i këtij efekti ka rëndësi pasi ndan rritjen e realizuar gjatë një viti nga efekti mekanik statistikor i rritjes së shënuar vitin e mëparshëm. Gjithashtu, përtej vlerës informuese që ka në analizën ciklike të PBB-së, efekti i mbartur duhet të mbahet parasysh edhe në interpretimin e parashikimeve vjetore të rritjes ekonomike. Ky artikull shpjegon konceptin e efektit të mbartur, përshkruan mënyrën e llogaritjes dhe shqyrton në vite rëndësinë e tij për analizën dinamike të PBB-së.

Dimensioni teorik i konceptit të efektit të mbartur

Efekti i mbartur përfaqëson normën mesatare vjetore të rezultuar, nëse niveli i PBB-së së shënuar në tremujorin e katërt të vitit të parë mbetet konstant gjatë vitit të dytë. Kjo, e shprehur në terma të ndryshimeve tremujore, nënkupton që rritjet tremujore të PBB-së gjatë vitit të dytë të jenë 0. Duhet theksuar se koncepti i efektit të mbartur gjen zbatim në seri të treguesve me frekuencë tremujore ose mujore, si në rastin konkret ku trajtohet për serinë tremujore të PBB-së reale. Formula e mëposhtme llogarit dhe evidenton komponentin e efektit të mbartur për rritjen vjetore të PBB-së.

$$\frac{PBB_t}{PBB_{t-1}} = \frac{\sum_{i=1}^{4} PBB^{(i)}}{\sum_{i=1}^{4} PBB_{t-1}^{(i)}} = \frac{PBB^{(4)}_{t-1}}{\sum_{i=1}^{4} PBB_{t-1}^{(i)}/4} \times \frac{\sum_{i=1}^{4} PBB_t^{(i)}/4}{PBB_{t-1}^{(4)}}$$

ku PBB përfaqëson nivelin e PBB-së reale (fluks)[2] për tremujorin i të vitit t, të rregulluar për sezonalitet.

[1] *Carry over effect, koncepti i referuar në anglisht.*

[2] *Analiza në këtë artikull është e mbështetur mbi serinë e PBB-së reale tremujore, fluks dhe të rregulluar për sezonalitet, për periudhën e kohës 2005 T1 – 2013 T3. Rregullimi sezonal i serisë së PBB-së realizohet nga INSTAT me mënyrën indirekte. Fillimisht, bëhet rregullimi sezonal i vlerave të shtuara përkatëse sipas degëve të ekonomisë me metodën direkte. Për degë të caktuara zgjidhet working day adjustment, ndërsa për të tjera trading day adjustment. Më pas, vlerat e shtuara të secilës degë, të rregulluara për sezonalitet, mblidhen për të dhënë PBB-në totale për ekonominë, të rregulluar për sezonalitet.*

Formula tregon se indeksi vjetor[3] i PBB-së mund të ndahet në dy komponentë. Termi i parë vlerëson efektin e mbartur, të llogaritur si diferenca në përqindje e nivelit të PBB-së në tremujorin e katërt të vitit të parë me nivelin mesatar të PBB-së të shënuar në këtë vit. Termi i dytë tregon sa është rritur niveli mesatar i PBB-së në vitin e dytë, krahasuar me tremujorin e fundit të vitit të parë. Dinamika rritëse gjatë vitit të dytë përfaqëson diferencën midis normës mesatare vjetore të rritjes së PBB-së dhe efektit të mbartur.

Grafik 1. Ilustrim teorik i efektit të mbartur pozitiv dhe negativ



Efekti i mbartur mund të ketë ndikim pozitiv ose negativ në ecurinë vjetore të PBB-së. Kur vlera e fluksit të PBB-së në tremujorin e katërt të vitit të parë është më e lartë se fluksi mesatar i atij viti, efekti i mbartur në rritjen mesatare vjetore të vitit të dytë është pozitiv. Në të kundërt, efekti i mbartur është negativ kur niveli i PBB-së në fundin e vitit të parë është më i vogël se niveli mesatar i atij viti. Për sa i takon masës së efektit të mbartur, sa më e lartë norma tremujore e rritjes së PBB-së në fundin e vitit të parë, aq më i madh do të jetë efekti i mbartur. Supozimi që kushtet në ekonomi do të mbeten të pandryshuara, implikon që edhe norma mesatare vjetore e rritjes, gjatë vitit të dytë, mund të jetë e lartë.

Megjithatë, duke trajtuar lidhjen e normës vjetore të rritjes me normat tremujore qartësohet arsyeja përse zhvillimet në tremujorë të caktuar marrin rëndësi më të lartë. Për këtë ndiqet përqasja e A. J. Patton dhe A. Timmermann (2011), si edhe e Karl – Heinz Todter (2010). Sipas përafrimit të shpjeguar kryesisht nga Karl – Heinz Todter: le të jetë G_t norma vjetore e rritjes së PBB-së gjatë vitit t krahasuar me vitin paraardhës dhe $G_{t,i}$ norma tremujore e rritjes së PBB-së në tremujorin i të vitit t. Norma vjetore mund të llogaritet me anën e formulës së mëposhtme:

[3] *Duhet theksuar se normat vjetore të llogaritura mbi serinë e PBB-së vjetore të gjeneruar si shumë e PBB-së tremujore, të rregulluar për sezonalitet, kanë diferencë marxhinale nga normat vjetore të llogaritura mbi serinë e gjeneruar si shumë e PBB-së tremujore të parregulluar për sezonalitet'.*

$$G_t \approx \frac{1}{4} * \left(g_{t-1,2} + 2 * g_{t-1,3} + 3 * g_{t-1,4}\right) + \frac{1}{4} * \left(4 * g_{t,1} + 3 * g_{t,2} + 2 * g_{t,3} + g_{t,4}\right) \qquad (1)$$

Meqenëse efekti i mbartur nënkupton se normat tremujore gjatë vitit t janë 0, pasi PBB-ja supozohet të mbetet në nivelin e shënuar në tremujorin e fundit të vitit $t - 1$, ai shprehet:

$$U_t \approx \frac{1}{4} * \left(g_{t-1,2} + 2 * g_{t-1,3} + 3 * g_{t-1,4}\right)$$

Ndërkohë, dinamika rritëse e shënuar gjatë vitit t llogaritet me anën e formulës:

$$D_t \approx \frac{1}{4} * \left(4 * g_{t,1} + 3 * g_{t,2} + 2 * g_{t,3} + g_{t,4}\right)$$

Formula për llogaritjen e normës vjetore të rritjes dëshmon se ndryshimeve tremujore u atribuohen pesha të ndryshme. Peshën më të lartë në llogaritjen e efektit të mbartur e ka norma tremujore e tremujorit të fundit të vitit $t - 1$, ndërsa ndryshimi tremujor në tremujorin të parë të vitit t ka rëndësi më të lartë për dinamikën e rritjes gjatë vitit t.

Dekompozimi i mësipërm i normës vjetore tregon gjithashtu se informacioni i disponuar deri në tremujorin e katërt të një viti, ndihmon në parashikimin e normës vjetore të rritjes për vitin pasardhës me një shkallë relativisht të lartë besueshmërie. Gabimi në parashikimin e normës vjetore të PBB-së për një vit lidhet ngushtësisht me zhvillimet në tremujorin e katërt të vitit të mëparshëm dhe ato në tremujorin e parë të vitit që parashikohet. Nëse tremujori i fundit i vitit $t - l$ e tremujori i parë i vitit t parashikohen me një shkallë të lartë saktësie, si edhe të dhënat për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit $t - 1$ janë të njohura e nuk janë objekt rishikimi në masë të madhe, disponohet rreth 62.5%[4] e informacionit të domosdoshëm për të parashikuar relativisht saktë normën vjetore të rritjes gjatë vitit t.

Zbatimi i konceptit të efektit të mbartur në rritjen vjetore të PBB-së vendase

Për të kuptuar rëndësinë e dinamikës së rritjes gjatë vitit të parë për efektin e mbartur gjatë vitit të dytë, është llogaritur efekti mbi të dhënat tremujore të PBB-së vendase gjatë viteve 2006 – 2009. Kjo ilustrohet me anë të grafikut të mëposhtëm, ku pasqyrohet ecuria e PBB-së në nivel dhe në terma të ndryshimeve tremujore për periudhat 2006 – 2007 (1), 2007 – 2008 (2) dhe 2008 – 2009 (3). Masa e efektit të mbartur rezulton e ndryshme, në varësi të ecurisë së PBB-së gjatë vitit të parë. Kështu, efekti i mbartur llogaritet nga 1.5%, për periudhën (3), ku ecuria tremujore e PBB-së luhatet në vlera të ulëta gjatë vitit 2008, deri në 5.5% për periudhën (2), ku PBB shënon rritje tremujore më të lartë gjatë vitit 2007.

[4] *Kjo shifër llogaritet si raport i peshave përkatëse të katër normave tremujore të cilësuara më lart, me peshat e normave tremujore të përdorura për të llogaritur normën vjetore të rritjes,* $\frac{\frac{1}{4}*(1+2+3+4)}{\frac{1}{4}*(1+2+3+4+3+2+1)}$.

Grafik 2. PBB në nivel dhe normat tremujore gjatë 2006 – 2007 (1), 2007 – 2008 (2) dhe 2008 – 2009 (3)



Burimi: INSTAT.

Për të ilustruar më në detaje dekompozimin e normës vjetore të rritjes në efektin e mbartur dhe dinamikën rritëse vjetore, është trajtuar ecuria tremujore e PBB-së për periudhën 2011 T1 – 2013 T3. Vijat A dhe C në grafikun 3 paraqesin nivelin mesatar të PBB-së, përkatësisht gjatë viteve 2011 dhe 2012. Vijat B dhe D i korrespondojnë nivelit mesatar të PBB-së gjatë viteve 2012 dhe 2013, nëse flukset tremujore të PBB-së do të ishin ekuivalente me fluksin e regjistruar përkatësisht në tremujorët e katërt të viteve 2011 dhe 2012. Diferenca në përqindje midis A-së dhe C-së është norma mesatare vjetore e rritjes gjatë vitit 2012 (1.1%), ndërsa diferenca në përqindje midis A-së dhe B-së, si edhe C-së dhe D-së, tregon efektin e mbartur në vitin 2012 (0.1%) dhe në vitin 2013 (0.3%). Ndërkohë, diferenca në përqindje midis B-së dhe C-së përfaqëson dinamikën e rritjes gjatë vitit 2012 (1.0%).

Grafik 3. Ecuria e PBB-së në nivel gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013



Burimi: INSTAT.

Duke iu referuar llogaritjeve të pasqyruara në grafikun 4, norma mesatare vjetore e rritjes së PBB-së, 4.2%, për vitet 2006 – 2012, shpjegohet në masën 62% nga dinamika e rritjes së shfaqur në kohë, ndërsa rreth 38% i takon efektit të mbartur. Gjithashtu, vihet re se disponimi i të dhënave për PBB-në tremujore deri në 2013 T3 bën të mundur llogaritjen e efektit të mbartur për vitin 2013, rreth masës 0.3%. Kjo vlerë është objekt rivlerësimi për sa kohë publikimet ardhshme të PBB-së për tremujorët vijues përmbajnë jo vetëm të dhënat e reja, por edhe rishikim të serisë për tremujorët e mëparshëm. Disponibiliteti i serisë së PBB-së deri në 2013 T3 siguron rreth 93.75%[5] të informacionit

[5] *Kjo llogaritet si raport i peshave përkatëse të normave tremujore të vitit 2012 dhe atyre të disponuara për vitin 2013, me peshat e normave tremujore të përdorura për të llogaritur normën vjetore të rritjes,* $\frac{\frac{1}{4}*(1+2+3+4+3+2)}{\frac{1}{4}*(1+2+3+4+3+2+1)}$.

të nevojshëm për të parashikuar ecurinë vjetore të PBB-së për vitin 2013. Më konkretisht, duke përdorur formulën (1) dhe të dhënat deri në tremujorin e tretë të vitit 2013, PBB-ja për vitin 2013 rezulton të luhatet rreth normës mesatare vjetore të rritjes prej 0.35%. Kjo vlerë nuk përfshin normën tremujore për tremujorin e katërt, së cilës i takon një peshë e ulët rreth 25%, si edhe ajo mund të ndikohet nga rishikimi i serisë së PBB-së.

Konceptimi i normës mesatare vjetore të rritjes së PBB-së në dy komponentët e efektit të mbartur dhe dinamikës ekonomike gjatë vitit referues, përmirëson procesin e analizës së ecurisë të rritjes ekonomike dhe rrit shkallën e kuptueshmërisë për parashikimin e saj. Analiza evidenton se në varësi të ecurisë së rritjes, efekti i mbartur mund të variojë në mënyrë të konsiderueshme nga një vit në tjetrin. Megjithatë, mbetet e rëndësishme të kuptohet dhe të shqyrtohet sa informacion përmban efekti i mbartur për të parashikuar normën mesatare vjetore të rritjes së PBB-së, sa mund ai të reduktojë pasigurinë lidhur me parashikimin dhe sa efektiv mund të rezultojë ky efekt për parashikimet afatshkurta.

Grafik 4. Norma mesatare vjetore e rritjes së PBB-së e dekompozuar në efektin e mbartur dhe dinamikën rritëse gjatë vitit



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të autores.

REFERENCA

Deutsche Bundesbank. 2010. "Uncertainty of macroeconomic forecasts. The impact of quarterly rates on the annual rate of change in gross domestic product in 2009." Monthly report, June, f. 42 – 43

European Central Bank. 2001. "Carry – over effects on annual average growth rates of real GDP." Monthly Bulletin. Box 6. December, f. 47 – 48

European Central Bank. 2005. "The carry – over effect on annual average real GDP growth in 2005." Monthly Bulletin. Box 8, March, f. 59 – 60

European Central Bank. 2010. "The carry – over effect on annual average real GDP growth." Monthly Bulletin. Box 6. March, f. 66 – 67

Magyar Nemzeti Bank. 2013. "The role of the carry – over effect in this year's GDP developments." Quarterly report on inflation. Box 1 – 1, March, f. 17 – 19

Patton, Andrew J. and Allan Timmermann. 2011. "Predictability of output growth and inflation: A multi-horizon survey approach." Journal of Business Economics and Statistics. American Statistical Association. Vol. 29 (3). f. 397 – 410

Tödter, Karl – Heinz. 2010. "How useful is the carry – over effect for short – term economic forecasting?" Deutsche Bundesbank. Discussion Paper Series 1: Economic Studies. No. 21.

MBI NJOHJEN E INSTITUCIONEVE TË JASHTME TË VLERËSIMIT TË KREDISË (ECAI)

LINDITA VRIONI

1 HYRJE

Marrëveshja Basel II përfaqëson një risi të rëndësishme, e cila është reflektuar në rregulloren e re "Mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit" e nëse implementohet me rigorozitet, do të kontribuojë në realizimin e një sistemi bankar më të fortë dhe të qëndrueshëm. Rregullorja nr. 48 "Mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit", datë 31.0.2013, është publikuar dhe do të behet efektive në 31.12.2014. Kërkesat e reja lidhur me kapitalin janë më të larta, duke pretenduar nga bankat përdorimin e vlerësimeve të kredive (*credit rating*), të nxjerra nga ECAI-ja, për llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë.

Duke patur parasysh rëndësinë dhe impaktin që do sjellin këto ndryshime, në një moment kur kjo rregullore është në periudhë tranzitore, analiza jonë synon të trajtojë disa shqetësime në implementimin e kërkesave të reja për kapital dhe veçanërisht ato për rrezikun e kredisë.

Thelbi i kuadrit rregullativ të Baselit është ideja së kërkesat për kapital rregullator duhet të përcaktohen nga profilet e rreziqeve që bankat ndërmarrin. Në Evropë, Basel II është implementuar në formën e Direktivës për Kërkesat për Kapital dhe hyri në fuqi në korrik 2004. Në linjë me këtë direktivë është edhe rregullorja e Bankës se Shqipërisë "Mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit". Qasja e BSH-së për llogaritjen e kërkesave për kapital për rrezikun e kredisë është sipas Metodës Standarde, pra sipas asaj më të thjeshtës. Gjithsesi, referimi i rregullores tek agjencitë e vlerësimit ka rritur mbështetjen në vlerësimin e jashtëm të rrezikut të kredisë dhe njëkohësisht ka rritur dhe përgjegjësinë e rregullatorit në sigurimin e standardeve.

Direktiva evropiane, ashtu si dhe rregullorja e BSH-së, kërkon që për qëllime të llogaritjes së cilësisë së kredisë, bankat mund të përdorin vlerësime të jashtme të kredisë, të dhëna këto nga institucione të jashtme vlerësimi kredie, të cilat do të konsiderohen si "të pranuara" nga autoriteti rregullator. Institucionet që japin këto vlerësime duhet të njihen si të pranuara nga autoriteti për qëllimet e llogaritje se cilësisë se kredisë për efekt të llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit. Dhe kjo njohje jepet vetëm kur autoriteti mbikëqyrës gjykon se ECAI-a ka plotësuar kriteret e njohjes të parashikuara në rregullore.

Duke u nisur nga prezenca e agjencive të vlerësimit në tregun shqiptar, përdorimi i vlerësimit (*ratingut*) për qëllimet e rregullimit të kapitalit përballet me disa pengesa. Këto pengesa janë të lidhura me faktorët e nevojshëm

për një vlerësim të saktë të cilësisë së kredisë. Sidoqoftë, implementimi i rregullores së mësipërme kërkon punë përgatitore për organizimin e të dhënave të nevojshme për agjencitë e vlerësimit që ato të kryejnë detyrën e tyre, në mbështetje të rregullores.

Vlerësimet e jashtme duhet të sjellin më shumë saktësi në cilësinë e kredisë, e për rrjedhojë, edhe me shumë cilësi në kërkesat për kapital rregullator nën metodën standarde, por kjo do të varet shumë nga gjendja dhe cilësia e një numri të mjaftueshëm të dhënash të domosdoshme.

2. VLERËSIMI I KREDISË (*CREDIT RATING*) DHE ECAI-TË

2.1 PËRKUFIZIMI I VLERËSIMIT TË KREDISË

Theksimi i rëndësisë së agjencive të vlerësimit të kredive sipas Basel 2, kërkon prej autoritetit rregullues një njohje të mirë të punës dhe mënyrës së funksionimit të CRA-ve.

Karakteristikat e një vlerësimi kredie janë përmbledhur nga ONG (2002). Një vlerësim kredie është:

- një proces gjykimi i renditjes dhe klasifikimit të huave për kategori të ndryshme rreziku, që prezanton një deklaratë të qartë dhe të saktë të aftësisë kredimarrëse të një firme të vlerësuar, për çdo kategori;
- një proces parashikues rezultatesh të mundshme, të ardhshme, duke përdorur informacionin aktual të disponueshëm e të observueshëm;
- ku përfshihen elementë kyç si analiza sasiore (të tilla si analiza të raporteve të "*cash flows*", të industrisë, sektorëve dhe makroekonomike) ashtu dhe analiza cilësore (të tilla si qëndrueshmëria financiare, menaxhimi dhe qeverisja).

Termi "ECAI" është term i krijuar nga Basel 2. Credit Rating Agency (CRA) është përdorura për ato agjenci sipas përcaktimit IOSCO, të cilat përfshijnë:

- ato entitete të cilat si aktivitet primar të tyre kanë nxjerrjen e vlerësimeve të kredisë (credit rating) për qëllim të vlerësimit të rrezikut të kredisë;
- një organizatë vlerësimet e të cilës janë njohur për qëllime rregullative nga një autoritet rregullator financiar.

IOSCO (2004) e përcakton vlerësimin e kredisë si një "opinion parashikues për aftësinë kredimarrëse të një entiteti, një angazhimi kredie, një borxhi apo lëshues obligacionesh, i shprehur nga një sistem renditjeje funksional dhe i mirëpërcaktuar".

Pas konsultimit me faqet zyrtare të agjencive të vlerësimit, arrihet në përfundimin se agjencitë e vlerësimit përdorin qasje të ndryshme në formimin dhe publikimin e opinioneve të tyre rreth rrezikut të kredisë. Disa agjenci përdorin analiza, disa përdorin modele matematike dhe disa kombinimin

e të dyjave. Modelet e agjencive ndryshojnë sipas kritereve, proceseve, përkufizimeve e renditjeve që ato përdorin. Prandaj dhe përdoruesit e vlerësimeve duhet ti kenë parasysh ndryshimet midis tyre përderisa përdorin këto vlerësime si *benchmark*.

Ka dy qasje kryesore në funksionimin e CRA-ve, që janë "agjencitë e orientuara nga analiza dhe ato të orientuara nga modeli".

Standard & Poor's përdorin qasjen e orientuar nga analiza, ndaj dhe kanë punësuar analistë për të vlerësuar dhe shprehur një opinion në lidhje me aftësinë kredimarrëse të emetuesit. Në vlerësimin (*rating*) e një kërkuesi, analisti kryen një rishikim të performancës financiare, politikave dhe strategjive të menaxhimit të rrezikut, si dhe mjedisin ekonomik në të cilën kërkuesi operon. Përveç vlerësimit të të dhënave financiare, analisti i kredisë zakonisht peshon informacionin cilësor, si strategjitë afatgjata, përderisa vlerësohet edhe aftësia dhe vullneti i kërkuesit për të përmbushur detyrimet e tij financiare në kohe. Analistë të tjerë sjellin ekspertizën në industri të veçanta apo pjese specifike të tregut.

Një numër më i vogël agjencish vlerësimi përdorin qasjen e orientuar nga modeli, duke u fokusuar më tepër në të dhënat sasiore, të cilat i inkorporojnë në një model matematikor për të prodhuar vlerësimin e tyre që është në përgjithësi vlerësim "*point-in-time*". Kjo qasje vlerëson aftësinë kredimarrëse duke parë cilësinë e aseteve të entitetit, financimin dhe probabilitetin e dështimit, bazuar në numrat e pasqyrave financiare dhe në dosjet e rregulluesve. Formulat matematike përdoren për të matur aftësinë kredimarrëse dhe zakonisht janë shumë komplekse dhe private.

Duke pasur parasysh disponibilitetin e të dhënave historike në tregun shqiptar, pritshmëria është që agjencitë e vlerësimit, të gatshme për të aplikuar për njohje dhe pranim për qëllimet e kërkesave të kapitalit në Shqipëri, do të jenë ato të orientuara nga analiza.

Agjencitë e vlerësimit kanë përkufizimin e tyre për vlerësimin, si p.sh:

Përkufizimi i Standard Poor's: "Një vlerësim kredie është opinion mbi aftësinë kredimarrëse të një obliguesi, ose aftësinë kredimarrëse të një obligatori, në lidhje me një borxh të veçantë ose të tjera detyrime financiare, bazuar në faktorët e rrezikut të lidhur me të. Ai (vlerësimi/ratingu) nuk përbën ndonjë rekomandim (blerje shitje apo mbajtje e një titulli të caktuar) dhe as ndonjë koment mbi qëndrueshmërinë e një investimi të veçantë".

Përkufizimi i Moody's: Një vlerësim, sipas Moody's, është një "opinion lidhur me aftësinë kredimarrëse në të ardhmen, e përcaktuar nga analiza kredie thelbësore dhe shprehur nëpërmjet një sistemi me simbole AAA-C".

Përcaktimi i Moody's për dështimin (default) përfshin tre lloje ngjarjesh dështuese dhe konkretisht:

- ka mungesë ose vonesë pagese të kështit, përfshirë edhe vonesat në pagesat brenda periudhës "grace";
- emetuesi fillon procedurat e falimentit ose ato të kujdestarisë ligjore;
- kur ndodhin ngjarje stresuese në këmbim.

Nisur nga përkufizimet e mësipërme, mund të konkludohet që agjencitë e vlerësimit të kreditit CRA (Credit Rating Agencies) nxjerrin opinione mbi aftësinë kredimarrëse të një emetuesi të caktuar apo një instrumenti financiar në një datë të dhënë. Duke qenë një opinion që në vetvete nuk përmban një përgjegjësi (ato nuk përbëjnë një rekomandim brenda kuptimit të direktivës dhe, për më tepër, ato i referohen një kohe të përcaktuar).

Pavarësisht se vlerësimet e kredisë janë thjeshtë dhe vetëm vlerësime apo "opinione", ato përdoren rëndom dhe mbi to bazohen veprime sikur të ishin tregues plotësisht objektivë të rrezikut të kredisë. Në këtë rast, fakti që këto vlerësime mund të mos jenë të besueshme nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në kredibilitetin dhe reputacionin e këtyre agjencive dhe palët e treta i vuajnë më shumë pasojat.

Për të arritur në një vlerësim të caktuar, CRA-të analizojnë informacion publik, financiar dhe kontabël rreth kërkuesit, si dhe situatën makroekonomike dhe faktorë të tregut që mund të influencojnë rrezikun e kredisë së tij apo dhe të instrumentit të borxhit. Ky rrezik kredie është i përberë si nga rreziku financiar (politika financiare, rentabiliteti, menaxhimi i likuiditetit dhe i borxhit), ashtu dhe nga rreziku industrial/tregtar (rreziku i sektorit, pozicioni konkurrues, strategjia, projekte industriale dhe ristrukturime). Në përgjithësi, CRA-të komunikojnë me menaxhimin e kërkuesit, ndaj dhe ato e bazojnë vlerësimin e tyre dhe në informacion jopublik. Gjithsesi, CRA-të nuk verifikojnë saktësinë e informacionit kontabël apo financiar.

Çdo CRA përdor metodologjinë e saj të vlerësimit të rrezikut të kërdisë, e cila është bërë publike në faqen e saj zyrtare, ku shpjegohen faktorët sasiorë dhe cilësorë të përdorur në përcaktimin e vlerësimit të kredisë për çdo kategori borxhi. Edhe pse rëndësia e faktorëve që merren në konsideratë në procesin e vlerësimit është kryesisht subjektive, përsëri publikimi i metodologjisë së CRA-së mund të ndihmojë emetuesit dhe investitorët për të kuptuar më mirë procesin e vlerësimit.

2.2 DEBATET MBI RREGULLIMIN E CRA-VE PAS KRIZËS

Tendenca: Rritja e besueshmërisë dhe pakësimi i mbështetjes tek vlerësimi i kredisë

Para krizës financiare, aktiviteti i vlerësimi i kredisë mbështetej në modelin "përputh dhe shpjego" të një industrie vetërregulluese. Vetërregullimi është shpjeguar nga IOSCO nëpërmjet kodit të sjelljes, i publikuar për herë të parë në dhjetor 2004. Ky kod u rishikua në 2008, me qëllim adresimin e shqetësimeve mbi transparencën dhe perceptimet e tregut; pavarësinë dhe

shmangien e konflikteve të interesit, si dhe konkurrencën midis CRA-ve dhe ndërlidhjen e kësaj konkurrence me pavarësinë e tyre.

Kodi mbështetet mbi publikimin, si një mekanizëm përputhshmërie. Duke bërë publik individualisht kodin e tyre të sjelljes, pjesëmarrësit e tregut mund të vlerësojnë se si CRA-ja ka inkorporuar këtë kod në standardet e saj të brendshme. Shumica e CRA-ve e kanë adaptuar këtë kod dhe IOSCO monitoron implementimin e tij.

Rekomandimet e propozuara fokusohen më së shumti në rregullimin e CRA-ve sipas modelit "e mbikëqyrur". Rregullorja e rekomanduar synon pakësimin e konfliktit të interesit dhe promovon konkurrueshmëri më të lartë në industrinë e CRA-ve. Këto synime janë në konsistencë me dy objektivat kryesore të rregullimit financiar dhe konkretisht: 1) mbrojtja e investitorëve nga sjellje oportuniste; dhe 2) përmirësimi i efektivitetit të sistemit financiar. Shembull i kësaj është dhe deklarata e drejtuesve të G20 (Samiti i Londrës, 2 prill 2009) që propozon: "... një zgjerim të rregullimit dhe regjistrimit të CRA-ve për të qenë të sigurt që ato përmbushim kodet ndërkombëtare të praktikave më të mira dhe veçanërisht për të parandalua konflikte interesi të papranueshme"

Aktualisht CRA-të nuk janë nën rregullim, por kriza ka kërkuar që ato të jenë të regjistruara dhe të mbikëqyrura.

Grupi De Larosière (2009) rekomandoi të kryet një rishikim thelbësor i modelit të biznesit të CRA-ve, financimit të tij dhe ndarjen e aktivitetit të vlerësimit nga aktiviteti këshillues. Ai gjithashtu rekomandoi pakësimin e përdorimit të vlerësimit në rregullimin financiar. Grupi theksoi që ndryshimet rregullative të shoqërohen me rritjen e "due diligence" dhe të gjykimit nga ana e investitorëve, si dhe përmirësimin e mbikëqyrjes financiare në përgjithësi.

Pra, ndërsa disa rregullatorë janë duke bërë përpjekje për të ulur referimin ndaj vlerësimit në legjislacion dhe në rregullim, përsëri CRA-të janë një mekanizëm i rëndësishëm i tregut, e paraqiten shumë të integruara në kuadrin e sotëm financiar. Do të jenë të nevojshme përpjekje për edukimin e tregut shqiptar mbi qëllimet dhe kufizimet e vlerësimit.

Në përmbledhje të këtij debati mund të themi se: Opinionet në vetvete, nuk mund të jene "të sakta", por kjo nuk nënkupton që ato janë të rastësishme dhe të paarsyeshme dhe se CRA-të nuk kanë përgjegjësi për procesin që kryejnë dhe publikojnë. Pra, ndodhemi para faktit që një entitet i parregulluar ka të drejtën të japë opinione të rëndësishme dhe delikate për entitete të rregulluara. Ndaj kërkohet që autoriteti rregullues të sigurohet për besueshmërinë e vlerësimit të kredisë.

2.3 SHQETËSIMET RRETH VLERËSIMIT TË KREDISË

CRA-të nuk bëjnë vetëm vlerësim kredie por edhe përkufizojnë se çfarë nënkupton rreziku i kredisë në kontekstin e një entiteti të veçantë, i cili mund

të jetë i ndryshëm nga përkufizimi i autoritetit rregullator. Dhe është pikërisht mungesa e një përkufizimi të rrezikut të kredisë dhe mënyra e matjes së tij që e bën rregullimin e vlerësimit të kredisë të vështirë në këtë fazë.

Qartazi agjencitë e vlerësimit e ngrenë gradën e vlerësimit të kredisë së huamarrësve në kohë bumi ekonomik dhe e ulin atë në kohë vështirësish ekonomike. Kjo i lejon bankave të ulin kërkesat për kapital në kohën e expansionit ekonomik, por kërkojnë një rritje të kërkesave për kapital në kohën e ngadalësimit ekonomik. Dhe kjo nuk është ajo çka ekonomistët financiarë sugjerojnë si një qasje optimale për standardet e kapitalit.

Me sa duket, bankat mund të përfshijnë në kontratat e huasë shkakun e nisjes së vlerësimit (*rating trigger*) dhe të marrin të drejta automatike në rastet e dështimit të huamarrësit, bazuar vetëm në vlerësim, duke neglizhuar një monitorim të afërt, si të rrezikut të kredisë ashtu dhe të rreziqeve të tjera.

Por CRA-të nuk kanë të njëjtën incentivë për të monitoruar huamarrësit siç kanë bankat, pasi ato nuk kanë rrezik financiar në rast dështimi të huamarrësit. Prandaj, pavarësisht saktësisë së vlerësimit, funksioni unik i bankave në vlerësimin nga afër dhe në mënyrë të vazhdueshme të strukturës së përgjithshme financiare të huamarrësit, si dhe rreziqeve me të cilat përballet, mund të mos plotësohet në rastet e vlerësimit nga CRA-të.

Për më tepër, kur bankat do të përdorin vlerësimin e kredisë për qëllime llogaritjeje të kërkesave për kapital, ato do të jenë të motivuara të zgjedhin huamarrësit me vlerësim më të lartë, pasi kështu do të ulin kërkesat rregullative për kapital. Dhe nëse vlerësimi i kredisë nuk do të reflektojë realisht rrezikun e kërdisë, struktura e kapitali të bankës do të ketë një përshtypje të gënjeshtërt mbi faktin se kjo strukturë ka mjaftueshëm mbrojtje kundrejt rrezikut, dhe mund të krijojë shqetësim në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar.

Pavarësisht këtyre shqetësimeve në lidhje me vlerësimin, tashmë është gjerësisht e pranuar që investitorët, bankat dhe rregullatorët mbështeten në vlerësimin e kredisë për qëllime të ndryshme e në rritje, si: i) për përcaktimin e kërkesave për kapital; (ii) për identifikimin dhe klasifikimin e aktiveve zakonisht në kontekstin e investimeve të lejueshme apo për lejimin e përqendrimit të aktiveve; për të dhënë një vlerësim të besueshëm për rrezikun e kredisë që i shoqërohet blerjes së aseteve si pjesë e ofertës së titullzimit apo ofertës për bonde të mbuluara; për përcaktimin e kërkesave të publikimit (*disclosure*) dhe për të përcaktuar prospektet legjitime në shitjen dhe blerjen e titujve.

3. NJOHJA E ECAI-S

Basel 2 ka vendosur gjashtë kritere të pranimit të ECAI-ve (pothuajse të njëjtat kritere janë vendosur në rregulloren e BSH-së, përafrim i CDR).

Edhe pse kriteret në disa raste kanë emra të ndryshëm, ato janë të njëjta në thelb. Ndryshimi midis Basel 2 dhe direktivës ka të bëjë me katër kriteret shtesë të kësaj të fundit, e që lidhen me metodologjinë e ECAI-ve.

Direktiva, në ndryshim nga Basel 2, ka shtuar dhe kërkesat e mëposhtme.

- Vlerësim i bazuar në kombinimin e të dy qasjeve, si asaj sasiore dhe asaj cilësore.
- Specifikimin e *benchmark*-ve.
- Disa detaje në publikim (*disclosure*): përkufizimi i dështimit (default), horizonti kohor dhe kuptimi i çdo kategorie vlerësimi, matrica e tranzicionit.

Këto kërkesa shtesë, në përgjithësi, e bëjnë vlerësimin e ECAI-ve më të drejtpërdrejt e të shprehur më qartë. Duke vendosur kritere për aprovimin e listës së ECAI-ve të njohura, autoriteti rregullator padyshim që influencon ECAI-të, por megjithatë kjo nuk është ekuivalente me rregullimin.

Janë dy mënyra për njohjen e ECAI-ve nga autoriteti, të parashikuara në direktivë, dhe që të dyja mënyrat janë procedura të miratuara dhe në rregulloren e re të BSH: njohje direkte dhe njohje indirekte.

Në njohjen direkte, mbikëqyrësit bëjnë vlerësimin e tyre mbi plotësimin e kritereve të njohjes nga një ECAI, ndërsa në njohjen indirekte, mbikëqyrësit e njohin një ECAI bazuar në njohjen e saj nga një vend anëtar i BE-së, pa bërë procesin e tij të vlerësimit.

Qëllimi kryesor në kushtet e njohjes së ECAI-ve është identifikimi i asaj ECAI-e që prodhon një vlerësim të jashtëm kredie me cilësi dhe vazhdimësi, të përshtatshme për t'u përdorur nga institucionet për qëllimet e kapitalit rregullator, sipas metodës standarde.

Procesi i njohjes fillon kur aplikimi:

- kërkohet nga një ECAI;
- kërkohet nga një institucion financiar;
- fillohet nga BSH-ja, gjatë procesit të identifikimit të agjencive që përmbushim kushtet e njohjes së ECAIA-së.

Procesi mund të ndahet në tre pjesë:

a) kushtet dhe pritshmëritë e autoritetit mbikëqyrës;
b) dokumentet e nevojshme, me qëllim që autoriteti të jetë në gjendje të vlerësojë nëse janë përmbushur kushtet;
c) pyetjet kryesore për përfaqësuesit e ECAI-ve.

Pas një vlerësimi të suksesshëm të ligjshmërisë së një ECAI-e, autoriteti e përfshin atë në listën e ECAI-ve të njohura dhe të pranuara. Autoriteti njofton aplikuesin dhe ECAI-në për rezultatin e procesit.

3.1 PENETRIMI I CRA-VE NË TREG

Aktiviteti i CRA-ve vazhdon pavarësisht njohjes së tyre nga autoriteti për qëllim të kapitalit rregullator. Aprovimi i një ECAI-e nga organi kompetent për qëllim mjaftueshmërie kapitali, mund të konsiderohet si një zgjerim i përdorimit të vlerësimit.

Në treg janë vetëm tre agjenci ndërkombëtare vlerësimi: Moody's, Standard & Poor's (S&P) dhe Fitch. Të tria këto mbulojnë shumë vlerësime individuale dhe kanë historik të gjatë të dhënash. Ato gjithashtu kanë grupe të mjaftueshme analistësh me eksperiencë që mundësojnë rishikim të vazhdimësi. Por, çka është më kryesorja, këto agjenci janë njohur dhe pranuar nga pjesëmarrësit në treg.

Penetrimi i Agjencive të Vlerësimit të Kredititi në Shqipëri është i kufizuar në disa degë të bankave të huaja dhe institucioneve financiare si:

- Banka Procredit sh.a. - vlerësuar nga "*Fitch Ratings*";
- Banka Kombëtare Tregtare sh.a. - vlerësuar nga JCR-ER;
- Banka Société Générale Albania sh.a. - vlerësuar nga Moody's;
- Banka Credins sh.a. - vlerësuar nga Moody's;
- gjithashtu të vlerësuara nga Moody's janë të gjitha bankat greke që operojnë në Shqipëri: Banka Alpha Albania sh.a, Banka Crédit Agricole Shqiperi sh.a, Banka NBG Albania sh.a, Banka Tirana sh.a.;
- Vienna Insurance Group – vlerësuar nga Standard & Poor's.

Tregu shqiptar për agjencitë e vlerësimit sapo është krijuar dhe i mungojnë të dhëna afatshkurtra mbi vlerësimin dhe vështirë të flitet për historik afatgjatë të dhënash. Me sa duket, procesi i njohjes së ECAI-ve si të pranuara do të jetë relativisht i thjeshtë, pasi kryesisht do të jetë një proces indirekt njohjeje (agjencitë e pranishme në treg janë të njohura nga vendet e BE-së). Ka dhe disa agjenci më të vogla dhe të specializuara, të cilat ofrojnë vlerësim dhe shërbime të tjera këshillimi.

3.2 A ËSHTË NJOHJA DHE PRANIMI I ECAI-SË I MJAFTUESHËM PËR NJË VLERËSIM KREDIE TË BESUESHËM?

Kushtet që një CRA duhet të plotësojë për të qenë një ECAI e pranuar i japin siguri autoritetit kur i lejon institucionet financiare të përdorin këto vlerësime për qëllime të llogaritjes së kapitalit rregullator.

Rregullorja "Mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit" është aprovuar dhe është në linjë me direktivën evropiane. Pavarësisht vullnetit për implementimin, detyrimi ligjor i rregullores kufizohet nga disa kritere teknike, të tilla si specifikimi i faktorëve sasiorë dhe cilësorë, *benchmark*-et, *mapping*.

Me qëllimin ilustrimin e implementimit praktik të kritereve teknike po shpjegoj më në detaje, duke filluar me *mapping*.

Për qëllime të kërkesave të kapitalit, rregullatorët janë shumë të rreptë në kërkesat për përcaktimin e kategorisë së vlerësimit, ashtu si dhe shprehet neni i direktivës, të krahasohet me kuptimin e shkallëve të cilësisë së kredisë të përcaktuara nga autoriteti.

" Article 11 - Meaning and relative position of a rating category
1. The meaning of a rating category established by the ECAI shall be

defined according to the following charac të ristics of the capacity of financial commitments as reflected in the i të ms assigned such rating category, being honored, and more in particular by:

(a) its degree of sensitivity to the economic environment;

(b) its degree of proximity to the default situation.

2. The meaning of a rating category shall be compared to the one established for each credit quality step, as specified in Article 16.

3. The meaning of a rating category shall be considered in combination with its relative position within the rating scale established by the ECAI."

Neni i mësipërm i direktivës kërkon që, në mënyrë që procesi i njohjes së ECAI-ave të jetë i komplementuar, domethënia e shkallëve të cilësisë së kredisë duhet të jetë e përcaktuar nga mbikëqyrja, ashtu siç e kërkon edhe rregullorja e mëposhtme.

"Banka e Shqipërisë, duke marrë parasysh kriteret teknike të përcaktuara në këtë nënkre për njohjen e ECAI-ve, përcakton lidhjen (korrespondencën, mapping) ndërmjet shkallës (kategorisë, klasës) së cilësisë së kredisë, të përcaktuar në nënkreun I të këtij kreu dhe vlerësimeve përkatëse të kredisë, të një ECAI-e të njohur".

Nënkapitulli i përmendur përshkruan shkallët e cilësisë së kredisë dhe peshat e rrezikut korrespondues, por siç edhe rregullorja e kërkon, është e nevojshme dhe domethënia e shkallëve të cilësisë së kredisë.

Rregullorja përcakton që:

"Banka e Shqipërisë krahason normat e dështimit (default), për çdo vlerësim të rrezikut të kredisë, të realizuar nga një ECAI, me një standard të ndërtuar mbi bazën e përvojës së normave të dështimit (default), nga ECAI të tjera, për një kategori të emetuesve me një nivel të barasvlershëm rreziku kredie."

Kjo nënkupton që, për të llogaritur normën e dështimit, janë të nevojshme të dhëna historike të vlerësimit të kredisë për një periudhë kohe për të njëjtën kategori huaje dhe për të njëjtin nivel rreziku.

Mbase në lidhje me këtë kërkesë së rregullores, një mbledhës qendror i vlerësimit të kredisë është i nevojshëm për implementimin e kësaj rregulloreje.

Kur vlerësojnë nivelin e rrezikut pas çdo vlerësimi kredie, ECAI-ve u kërkohet prej rregullatorit të sigurojnë gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të. Gjithashtu, ato duhet të kenë sisteme për të kapur të dhënat e duhura sapo ato bëhen të disponueshme. Këto të dhëna do të tregojnë në praktikë nëse parashikimet e agjencive të vlerësimit kanë qenë të sakta (kompani të cilat kishin vlerësim më të lartë dështuan më pak se ato që kishin vlerësim më të ulët). Këtu ngrihet pyetja: a mundet që një ECAI të sigurojë të dhënat mbi falimentin për çdo segment të tregut të kredisë në Shqipëri?

Duket se kostot kryesore të përmbushjes së kësaj rregulloreje do të bien mbi ECAI-të, pasi janë ato që duhet të sigurojnë të dhëna të cilat mungojnë për

tregun shqiptar. Këto të dhëna janë *input* i domosdoshëm për metodologjinë e ECAI-ve në përcaktimin e vlerësimeve të kredisë. Metodologjia është bazuar në kombinimin e faktorëve sasiorë dhe cilësorë në përcaktimin e vlerësimit të kredisë për çdo kategori kredie: një faktor sasior është norma e akumuluar e dështimit për një periudhë trevjeçare, që do të thotë shuma e të gjithë normave të dështimeve të ndodhura në një periudhë trevjeçare, për të gjithë zërat e gradës së vlerësimit që i përkasin të njëjtit grup.

Pra, vetëm për vlerësimin e rrezikut të kredisë janë të nevojshme këto të dhëna të hollësishme: të dhënat e huamarrësit, të dhënat e garantuesit, të dhëna të veçanta mbi asetin, të dhënat e normave të dështimit, të dhënat mbi "recoveri", të dhëna mbi vlerësimin dhe migrimin, të dhëna mbi industri të veçanta, të dhëna makro, të dhëna të korreluara.

Për bankat, kostot e përmbushjes së rregullores janë të papërfillshme, përderisa tabelat e mappingut për çdo ECAI do të bëhen publikisht të disponueshme dhe do të jetë e lehtë përdorimi i tyre në procesin e llogaritjes së kërkesave për kapital.

Duhet të bëhen përpjekje me qëllim lehtësimin sa më të madh të barrës së kësaj rregulloreje mbi ECAI-të, në të kundërt ato mund të mos jenë të interesuara të përfshihen në këtë proces. Këto përpjekje janë të rëndësishme, jo vetëm në drejtim të kostove të përputhshmërisë me rregulloren por, çka është më e rëndësishme, për të shmangur incentiva të padëshiruara nga bankat, të tilla si preferenca për t'u dhënë hua kompanive të pavlerësuara (*unrated*), pasi nën Metodën Standarde kompanitë e pavlerësuara do të kenë të njëjtën peshë rreziku si dhe në Basel I.

PËRFUNDIME

ECAI-të kanë një rol më të rëndësishëm në kuadrin rregullativ të Basel 2, dhe veçanërisht për bankat që përdorin Metodën Standarde. Me qëllim që procesi i njohjes së ECAI-ve të plotësohet ashtu si e parashikon rregullorja, janë të nevojshme realizimet e disa kritereve teknike. Këto kritere janë mjaft të rëndësishme. Për implementimin në praktikë të vlerësimit të kredisë (credit rating) me Metodën Standarde të dhëna të plota dhe të sakta janë një domosdoshmëri (të dhënat e huamarrësit, të dhënat e garantuesit, të dhëna të veçanta mbi asetin, të dhënat e "default", të dhënat mbi "recoveri", të dhëna mbi "rating" dhe migrimin, të dhëna mbi industri të veçanta, të dhëna makro, të dhëna të korreluara).

Metoda Standarde sjell ndjeshmëri ndaj rrezikut vetëm nëse të gjitha kompanitë janë të vlerësuara (rated) dhe nëse vlerësimi (rating) reflekton profilin tyre të rrezikut.

REFERENCA

BASEL COMMITTE ON BANKING SUPERVISION (2000): Working Papers No. 3: "Credit Ratings and Complementary Sources of Credit Quality Information"

BASEL COMMIT TË E ON BANKING SUPERVISION (2004): "International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards". Revised framework. Also available at: www.bis.org

ONG, M. K. (2002): "Credit Ratings: Methodologies, Rationale and Default Risk". London ISBN 1-899-332-69-3

De Larosière, 2009, Report of The High-Level Group on Financial Supervision in the EU, chaired by Jacques de Larosière, Brussels, 25 February

http://www.bankofalbania.org/web/Rregullore_ldquo_Per_Raportin_e_Mjaftueshmerise_se_Kapitalit_rdquo_6786_1.php?kc=0,28,0,0,0

Freixas Xavier and J. Shapiro, 2009, "The Credit Rating Industry: Incentives, Shopping, and Regulation" 18 March 2009, VoxEU, http://www.voxeu.org/index.php?q=node/3286

IOSCO (2003b): "Statement of Principles Regarding the Activities of Credit Rating Agencies". Also available at: www.iosco.org

IOSCO (2004): "Code of Conduct Fundamentals for Credit Rating Agencies". Also available at: www.iosco.org

MOODY'S INVESTORS SERVICE (2001b): "Rating Methodology". Also available at: www.moodys.com

MOODY'S INVESTORS SERVICE (2003): "Moody's Rating Symbols & Definitions". Also available at: www.moodys.com

STANDARD & POOR'S (2005): "Corporate Ratings Criteria". Also available at: www.standardandpoors.com

NERA Economic Consulting (2003), "Credit ratings for structured products: A Review of analytical Methodologies, Credit Assessment Accuracy, and Issuer Selectivity among the Credit Rating Agencies", available http://www.nera.com/image

Tabakis, E. and A. Vinci (2002), "Analyzing and combining multiple credit assessments of financial institutions", working paper # 123, European Central Bank

KURSI REAL EFEKTIV I KËMBIMIT PËR VENDET E RAJONIT: NDËRTIMI I NJË BAZE TË DHËNASH

JONIDA BOLLANO, DELINA IBRAHIMAJ

1. HYRJE

Shqipëria cilësohet si një ekonomi e vogël dhe e hapur, në të cilën kursi i këmbimit luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e nivelit të çmimeve dhe në bilancin e pagesave.

Kursi real efektiv i këmbimit (REER), i cili mat zhvillimet e vlerës reale të monedhës së një vendi kundrejt shportës së partnerëve tregtarë të atij vendi, ka gjetur një përdorim të gjerë si në hulumtimet teorike ashtu edhe në ato praktike. Ky tregues është përdorur për vlerësimin e shmangieve të kursit nga nivelet "ekuilibër", vlerësimin e faktorëve orientues të flukseve tregtare, si dhe analizën e dinamikës së konkurrueshmërisë bazuar në çmime kosto etj.

Qëllimi i këtij studimi është të propozojë krijimin e një baze të dhënash mbi ecurinë e kursit real efektiv të këmbimit për Shqipërinë dhe disa vende të Ballkanit dhe Evropës Juglindore, bazuar në një metodologji të unifikuar. Përdorimi i të njëjtës metodologjie krijon një mundësi më shumë për të shpjeguar performancën tregtare të vendeve të ndryshme, si dhe për të krahasuar vendet e analizuara në terma të konkurrueshmërisë ndërkombëtare. Paraqitja e indekseve të Produktiviteti të Punës dhe ecurisë së eksporteve ndër vite, për vendet në analizë, është një tjetër vlerë e shtuar për studimin. Matja e çmimeve dhe e kostos së prodhimit janë ndër faktorët standardë të përdorur për vlerësimin e profilit konkurrues të një vendi.

Në këto kushte, ndonëse nuk synohet të kryhet një analizë e plotë e profilit konkurrues për vendet në studim, kërkohet të paraqiten disa konkluzione paraprake rreth: a) rolit të regjimit të kursit të këmbimit në performancën e REER-it dhe absorbimin e goditjeve të jashtme; dhe b) pozicionimit të Shqipërisë krahas vende të rajonit dhe ato më të zhvilluara të Evropës Jugqendrore në terma të REER-it.

2. LITERATURA

Literatura tregon se përcaktuesit e konkurrueshmërisë së jashtme të një vendi, mund të klasifikohen si faktorë strukturorë të lidhur ose jo, me çmimet/kostot. Faktorët strukturorë, të lidhur me çmimet, janë të domosdoshme për të matur konkurrueshmërinë, ndonëse rëndësia e këtyre faktorëve varet nga elasticiteti i kërkesës në lidhje me çmimet. Leichter et al, në vitin 2010, shprehet se faktorët strukturorë të çmimeve janë zakonisht të kushtëzuar

nga: eficienca në prodhim, shpërndarje dhe shitje; kursi i këmbimit ndërmjet vendeve eksportuese dhe vendeve importuese; si dhe strategjitë e aplikuara nga shoqëritë në tregjet ndërkombëtare. Faktori i parë mund të matet me produktivitetin. Durand et al (1992) shprehet se faktorët e parë dhe të dytë janë kombinuar për të ndërtuar një tregues të agreguar të kompetivitetit si REER-i. Faktori i fundit mund të matet nga çmimet relative të disagreguara të eksporteve.

Nga ana tjetër, faktorët të cilët nuk lidhen me çmimet, janë të vështirë për t'u vlerësuar, pasi bazohen kryesisht në të dhëna cilësore. Megjithatë, sipas OECD (2008), të gjithë treguesit e produktivitetit të matur nga faktorët e *inputit*, si dhe faktorët totalë të produktivitetit janë me interes për konkurrueshmërinë. Produktiviteti i punës mund të matet duke konsideruar faktorë të ndryshëm të prodhimit: PBB-në, të ardhurat e disponueshme, PBN-në të vlerësuar mbi orët e punës ose numrin e personave të punësuar.

Për rastin e Shqipërisë, Çeliku dhe Metani në vitin 2011 studiuan profilin konkurrues të ekonomisë vendase, nëpërmjet treguesve relativë të PP-së dhe të KPNj-së (kosto për njësi). Sipas tyre, burimet e diferencave ndërmjet KPNj-ve të një ekonomie krahasuar me ekonomi të tjera mund të rrjedhin prej një sërë faktorësh, shpeshherë të vështirë për t'u identifikuar, matur e analizuar. Ky studim mbështet nivelin e brishtë të përparësive konkurruese të ekonomisë tonë, në raport me panelin e ekonomive të tjera të marra në studim. Disavantazhet konkurruese burojnë kryesisht nga diferencat e larta ndërmjet PP-së së ekonomisë vendase dhe atyre të ekonomive krahasuese, si edhe nga pesha e ulët e sektorit të tregtueshëm në ekonomi.

Ndryshimet në produktivitetin e shteteve japin një informacion të dobishëm për konkurrueshmërinë. Megjithatë, në analizën e konkurrueshmërisë është shumë e rëndësishme të analizohet kursi i këmbimit, i cili zakonisht matet me REER. Për matjen e REER-it, duhet një bazë e gjerë të dhënash si: numri i shteteve me të cilat do të matet konkurueshmëria; indekset e kostove/çmimeve; kursi i këmbimit nominal; peshat për agregimin e të dhënave.

Studimi i REER-it dhe ndikimit i tij në ekonominë shqiptare ka ngjallur interes për shumë studiues.

Tentativa e parë për të matur REER në Shqipëri është bërë nga Vika (2006), i cili ka ndërtuar REER-in duke konsideruar partnerët kryesorë tregtarë, për të parë tendencën mbiçmuese apo nënçmuese në terma realë të lekut dhe sa i luhatshëm ka qenë ai. Vika ka ndërtuar REER-in duke u bazuar në indeksin e çmimeve të konsumit dhe në raportin e çmimeve relative të mallrave e shërbimeve të tregtueshme ndaj atyre të patregtueshme. Ai ka ndërtuar dy indekse sipas dy shportave të ndërtuara me 5 dhe me 16 vende. Rezultatet e studimit tregojnë se këto dy indekse janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe se zgjedhja midis tyre nuk përbën ndonjë problem të rëndësishëm.

Po në vitin 2006, Shtylla dhe Sojli kanë kombinuar efektet e çmimeve relative dhe të kursit të këmbimit mbi flukset tregtare në një variabël të vetëm të

kursit real të këmbimit, duke mos bërë kështu asnjë dallim midis elasticiteteve të tyre. Ato gjetën se ndikimi afatgjatë i kursit real efektiv të këmbimit mbi vëllimin e importeve është disi më i lartë sesa ai i PBB -së vendase.

Hoda (2012) , në studimin e tij mbi rolin e kursit të këmbimit në shkëmbimet tregtare në Shqipëri, tregoi se ndërsa të ardhurat përbëjnë nxitësin kryesor të flukseve tregtare në Shqipëri, kursi i këmbimit luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e rritjes së eksporteve dhe në zëvendësimin e importeve.

Pllaha (2012) studioi ndikimin e kursit të këmbimit në flukset tregtare dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve kryesorë tregtarë, përkatësisht: Eurozonës, Italisë, Greqisë, Gjermanisë, Kosovës dhe Turqisë. Një nga gjetjet kryesore të këtij materiali është fakti se hipoteza e "kurbës – J" gjen mbështetje vetëm në rastet e tregtisë me Italinë dhe Turqinë.

Literatura ekonomike propozon disa teori me të cilat mund të argumentohen ndryshimet në REER si efekti i Balassa-Samuleson, konvergjenca në nivelin e çmimeve, ndryshimet në produktivitetin e shteteve bazuar në fazat e ndryshme të cikleve të biznesit, ndryshimet e qëndrueshme në produktivitet, shpërndarjen optimale të burimeve ndërmjet sektorëve prodhues.

3. MATJA E REER-IT

Ndërtimi i indeksit REER bazohet në llogaritjen e kursit nominal efektiv dhe një indeksi të dytë, i cili shpreh çmimin ose koston relative ndërmjet vendit në studim dhe partnerëve të tij tregtarë. Në praktikë, ka disa indekse çmimesh të cilat mund të përdoren për matjen e kursit real të këmbimit: indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), indeksi i çmimeve të eksportit (IÇX), indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP), deflatori i PBB-së (DPBB), dhe indeksi i kostos së punës për njësi (ULC) (Chinn, 2002). Në këtë studim kemi zgjedhur të përdorim indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK). Megjithëse ky indeks është një matës më i mirë i fuqisë blerëse se sa i konkurrueshmërisë, ai përdoret gjerësisht për llogaritjen e kursit real të këmbimit, pasi është lehtësisht i disponueshëm për të gjitha vendet.

Kursi real efektiv i këmbimit (REER) është llogaritur si mesatarja gjeometrike e ponderuar e indeksit të çmimeve vendase, krahasuar me çmimet në vendet partnere tregtare:

$$\mathrm{REER} = \prod \left[\frac{Ç_h \times K_n}{Ç}\right]^{W_n}$$

ku $Ç$ dhe $Ç_h$ janë indekset e çmimeve vendase dhe të huaja; W_n është pesha përkatëse e vendit partner n në tregtinë vendase; kurse K_n është kursi nominal i këmbimit për monedhën vendase dhe të huaj, i shprehur si çmimi i një njësie të valutës së huaj ndaj asaj vendase. Bazuar në këtë përkufizim, një rënie e indeksit do të shprehte një mbiçmim real, ndërsa rritja e tij do të tregonte një nënçmim real të monedhës vendase.

Peshat e përdoruara për ndërtimin e indeksit REER, janë bazuar në flukset e tregtisë dypalëshe[1], të cilat janë llogaritur sipas formulës së mëposhtme:

$$W_{ij} = \frac{M_i}{M_i + X_i} m^i_j + \frac{M_i}{M_i + X_i} x^j_i$$

ku M_i dhe X_i përfaqësojnë importet dhe eksportet e vendit i; m^i_j është pesha e importeve të vendit i me origjinë nga vendi j; dhe x^i_j është pesha e eksporteve të vendit i në vendin j (Zanello & Desruelle, 1997). Në llogaritjen e mësipërme duhet treguar kujdes në ndryshimin e peshave relative të tregtisë dypalëshe në periudha të ndryshme. Luhatjet në fluksin e import-eksporteve bëjnë që peshat e vendeve partnere të ndryshojnë, duke sjellë nevojën për një përditësim të tyre në kohë. Për këtë arsye, Ellis (2001) propozon që ndërtimi i indeksit REER në kohën t, të llogaritet si produkti i REER-it në periudhën përpara prezantimit të peshave të reja $W(\tau\text{-}B)$, me raportin e kurseve reale dypalëshe BRER, për vendet i, të matura sipas mesatares gjeometrike në periudhën bazë B dhe korrente t, duke përdorur peshat korrente τ:

$$REER_t = REER_{\tau\text{-}B} \times \frac{\prod_i BRER_{i,\tau}^{w(i,\tau)}}{\prod_i BRER_{i,\tau\text{-}B}^{w(i,\tau)}} \qquad \text{ku } t \geq \tau.$$

4. TË DHËNAT

Duke u bazuar në kriterin e ngjashmërisë midis ekonomive, vendosëm të studiojmë ecurinë e kursit real të këmbimit për Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Bullgarinë, Hungarinë, Republikën Çeke, Maqedoninë, Kroacinë, Poloninë, Rumaninë, Serbinë dhe Turqinë.

Rumania, Serbia, Polonia, Turqia, Republika Çeke dhe Hungaria, njësoj si Shqipëria, kanë një regjim kursi të luhatshëm, ndërkohë që ekonomitë e vendeve të tjera, edhe pse kanë një regjim fiks të kursit të këmbimit, konsiderohen strukturalisht të ngjashme me atë shqiptare.

Të dhënat mujore të indekseve të çmimeve të konsumit janë marrë nga Eurostat dhe *Global Economic Monitor*[2] dhe institutet statistikore lokale. Viti bazë për të gjitha të dhënat është marrë viti 2005. Në rastin e Malit të Zi, në mungesë të të dhënave, për periudhën 2005-2007, IÇK-ja është përafruar me indeksin e tregtisë me pakicë. Në rastin e Serbisë, në mungesë të të dhënave për vitin 2005, IÇK-ja është barazuar me 100 për të gjithë muajt.

Vlerat mesatare mujore të kurseve të këmbimit për vendet në studim janë marrë nga *PACIFIC Exchange Rate Service dhe Global Economic Monitor*. Për të ndërtuar kurset e këmbimit kemi supozuar që shkëmbimet tregtare me

[1] *Një disavantazh i metodës se zgjedhur, është se ajo nuk merr parasysh konkurrencën e dy vendeve në tregjet e treta. Megjithatë, kjo metodologji është përdorur edhe nga FMN-ja për të llogaritur peshat e konkurrencës për 35 anëtarë "të rinj" të fondit nga Evropa Lindore, përfshirë Shqipërinë dhe vendet e ish-Bashkimit Sovjetik (Zanello & Desruelle, 1997).*

[2] *Bazë të dhënash e World Bank.*

partnerët tregtarë evropian kryhen në euro, ndërkohë që shkëmbimet tregtare me partnerët tregtarë joevropianë (përfshirë këtu dhe Turqinë) zhvillohet në dollarë amerikanë.

Për të gjitha vendet në analizë, janë përzgjedhur 15 partnerët tregtarë më të rëndësishëm që, në çdo rast, përbëjnë mbi 75% të totalit të shkëmbimeve të tyre tregtare.

Për ndërtimin e peshave janë përdorur të dhënat e http://www.trademap.org/. Të dhënat e përdorura janë vjetore. Peshat janë mbajtur të pandryshuara gjatë vitit. Për vitin 2013 janë përdorur peshat e vitit 2012, pasi të dhënat për vitin 2013 nuk janë publikuar ende.

Në këtë studim, produktiviteti i punës (PP) është llogaritur si raport i vlerës reale të PBB-së dhe numrit të personave të punësuar në një ekonomi (Morgese et.al. 2008). Sigurisht që ndërtimi i PP-së, i llogaritur si njësi e prodhuar ndaj orëve totale të punuara, do të ishte më frytdhënës, pasi do të kishte mundësi të shprehte dhe dallimin në orë pune ndërmjet vendeve (po të kemi këtu parasysh edhe dallimin e orëve të kryera në bazë të një kontrate me kohë të plotë ose të pjesshme). Megjithatë, në mungesë të të dhënave për shtetet në krahasim, analiza është kryer në bazë të numrit të të punësuarve. Për ndërtimin e PP-së, për të gjitha vendet në krahasim, është shfrytëzuar *The Conference Board Total Economy Database*, publikuar në janar 2014. Për të gjitha vendet në studim, vlera reale e PBB-së është shprehur në milion dollarë ndaj nivelit të çmimeve të 2013 dhe e korrektuar nga treguesi i paritetit të fuqisë blerëse (PFB) për 2005, ndërtuar mbi bazën e modelit të zhvilluar nga Elteto, Koves dhe Schultz[3].

5. REZULTATE

Vlerësimet mbi ecurinë e çmimeve dhe kostos së prodhimit janë ndër faktorët standardë të përdorur për vlerësimin e profilit konkurrues të një vendi. Në përgjithësi, mbiçmimi i monedhës vendase ose rritja e shpejtë e çmimeve, vlerësohet të sjellë rënie në kapacitetin e një vendi për të konkurruar në tregjet e huaja. Në këtë studim, rritja e REER-it vlerësohet si nënçmim real i monedhës vendase, ndërsa tkurrja e tij vlerësohet si mbiçmim.

Megjithatë, vlen të përmendet që një përkeqësim i treguesve të çmimeve dhe të kostos mund të jetë një element që shoqëron procesin e konvergjencës (në përputhje me efektin Balassa-Samuelson) dhe kjo nga ana tjetër, mund të shoqërohet me përmirësimin e konkurrencës jo në profilin e çmimeve[4]. Pavarësisht këtij aspekti, i cili me siguri që kërkon një studim më të thelluar, analiza e mëposhtme kërkon të sjellë një paraqitje në mënyrë të unifikuar të ecurisë së kursit real të këmbimit dhe të produktivitetit të punës për disa vende të Ballkanit dhe të Evropës Jugqendrore.

[3] *E njëjta metodologji përdoret edhe nga OECD-ja dhe Eurostat.*

[4] *Balassa, B. (1965), "Trade liberalisation and revealed comparative advantage", The Manchester School, Vol. 33:2, pp. 99-123.*

Siç është paraqitur edhe në grafikët e mëposhtëm, gati të gjitha vendet kandidate[5] të BE-së, përveç Shqipërisë, kanë përjetuar një rënie të indeksit REER gjatë periudhës para krizës (para vitit 2008), duke shfaqur mbiçmim të konsiderueshëm në terma realë të monedhave të tyre. Një ecuri e ngjashme vihet re edhe për vendet anëtare të BE-së[6].

Grafik 1. Ecuria e REER-it për vendet e rajonit dhe vendet e Evropës Jugqendrore*



Burimi: Llogaritje të autoreve.

*Për grupimet Serbi/Turqi, Bosnje-Hercegovinë/Maqedoni/Kroaci dhe vende anëtare të BE-së është llogaritur mesatarja e thjeshtë aritmetike e indeksit.

Në harkun kohor 2005-2008, indeksi REER për Shqipërinë vlerësohet të ketë qëndruar në nivele të ngjashme, për t'u rritur më pas ndjeshëm në fillim të vitit 2009.

Që nga fillimi i krizës globale (viti 2008 e/ose 2009), monedhat e vendeve kandidate me regjim të luhatshëm të kursit të këmbimit janë nënçmuar ndjeshëm në krahasim me vendet kandidate të BE-së me regjim fiks të kursit të këmbimit (si Bosnje-Hercegovina dhe Maqedonia), duke rritur profilin e tyre konkurrues në krahasim me këto vende. Për të njëjtën periudhë, vihet re se vendet anëtare të BE-së kanë shfaqur luhatje të monedhave përkatëse në terma realë, por me një amplitudë më të ulët.

Ky zhvillim ka qenë veçanërisht më i theksuar në rastin e Shqipërisë dhe të Serbisë, ku indeksi REER u rrit me 13% dhe 9% për periudhën 2008-2010, për shkak të nënçmimit në terma nominalë të monedhave vendase, përkatësisht me 12% dhe 18%. Në mënyrë të ngjashme, edhe në rastin e Turqisë, treguesi REER u zgjerua me 9.6% në 2011 në krahasim me 2008, duke reflektuar kryesisht nënçmimin e monedhës vendase me 16% për të njëjtën periudhë. Nga kjo perspektivë, vlerësohet se regjimi i luhatshëm i kursit të këmbimit duket të ketë pasur një rol mbrojtës ndaj krizës financiare gjatë këtyre viteve të fundit.

[5] *Me termin "vende kandidate" i referohemi vendeve të cilat janë në proces anëtarësimi për hyrje në Bashkim Evropian: Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Serbi, Maqedoni, Turqi, Kroaci.*

[6] *Në këtë studim vendet anëtare të BE-së janë konsideruar shtetet e rajonit: Poloni, Rumani, Hungari, Bullgari dhe Republika Çeke. Kroacia është konsideruar si vend kandidat për shkak anëtarësimit të saj në BE vetëm në korrik të vitit 2013.*

Grafik 2. Ecuria e PP relative për vendet kandidate dhe anëtare në BE*



Burimi: The Conference Board Total Economy Database.
*PP-relative është llogaritur si logaritmi natyror i ndryshimit të mesatares së thjeshtë aritmetike të indekseve për grupimet e konsideruara dhe indeksit për Shqipërinë.

Në linja të përgjithshme, si rezultat i këtij studimi mund të thuhet se përpara fillimit të krizës financiare, vendet kandidate të BE-së duket të kenë përjetuar një humbje të konkurrueshmërisë në krahasim me vendet e Evropës Qendrore. Në këto vende, pas vitit 2009, vërehet një përmirësim i konkurrueshmërisë në terma të REER-it, veçanërisht për ato shtete që ndjekin një regjim të luhatshëm të kursit të këmbimit.

Në një paraqitje grafike të produktivitetit të punës së Shqipërisë ndaj vendeve kandidate për në BE dhe vendeve tashmë anëtare, vlerat e PP-së për Shqipërinë janë më të ulëtat[7].

Pavarësisht kësaj, PP-ja është rritur në të gjitha vendet kandidate të BE-së, gjatë periudhës në studim. Produktiviteti i punës është rritur vazhdimisht në këto vende që nga fillimi i krizës, por kryesisht si rezultat i rënies së punësimit dhe jo për shkak të rritjes së PBB-së, ritmi i të cilit ka lënë pas atë të punësimit. Kështu, vendet e rajonit si Serbia e Maqedonia kanë shfaqur një përmirësim të PP-së, ndikuar kryesisht nga ritme të ulëta të normës së punësimit. Në të kundërt, në rastin e Turqisë, produktiviteti i punës në rritje ka qenë kryesisht për shkak të rritjes së PBB-së reale, e cila qëndroi mbi rritjen e punësimit në vitin 2010 dhe 2011. E njëjta sjellje, ndonëse në ritme më të buta, është vërejtur edhe për Shqipërinë për periudhën 2010-2011.

Pa dyshim që krahasimi i këtyre indekseve me kostot e punës për njësi do të ofronte një analizë më të gjerë dhe më të plotë të profilit konkurrues për vendet në studim. Pikërisht në këtë drejtim, si dhe në zgjerimin e mëtejshëm të këtyre të dhënave, do të përqendrohen studimet e ardhshme.

6. PËRFUNDIME

Ndërtimi i një baze të dhënash mbi ecurinë e kursit real efektiv të këmbimit për Shqipërinë dhe disa vende të rajonit, bazuar në një metodologji të unifikuar, është i dobishëm jo vetëm për studimin në kohë të trendeve të konkurrueshmërisë por edhe për një krahasim ndërmjet shteteve në studim.

Rezultatet e paraqitura tregojnë se pas vitit 2009, monedhat e vendeve kandidate me regjim të luhatshëm të kursit të këmbimit janë nënçmuar ndjeshëm, në krahasim me vendet kandidate të BE-së me regjim fiks të kursit të këmbimit, duke luajtur kështu një rol mbrojtës ndaj krizës financiare të viteve të fundit.

Produktiviteti i punës, që nga fillimi i krizës, është rritur vazhdimisht për të gjitha vendet në analizë. Ky rezultat ka ardhur kryesisht për shkak të rënies së punësimit dhe jo për shkak të rritjes së PBB-së, ritmi i të cilit ka lënë pas atë të punësimit.

[7] *Rezultatet janë në linjë edhe me përfundimet e Çeliku e Metani, 2011.*

Grafik 3. Shtete kandidate për në BE (2005=100)*



Burimi: Llogaritje të autoreve dhe The Conference Board Total Economy Database.
*Të dhënat për vitin 2013 i referohen mesatares deri në muajin shtator.

Grafik 4. Shtete anëtare të BE-së (2005=100)



Burimi: Llogaritje të autoreve dhe The Conference Board Total Economy Database.

BIBLIOGRAFIA

Balassa B., (1965), "Trade liberalisation and revealed comparative advantage", The Manchester School, Vol. 33:2,f. 99-123

Chinn M., (2002), "The Measurement of Real Effective Exchange Rates: Survey and Applications to East Asia", University of California, Santa Cruz

Darvas Z., (2012), "Real Effective Exchange Rates for 178 countries: a new database", Bruegel Working Papers 2012/06

Ellis L., (2001), "Measuring Real Exchange Rate: Pitfalls and Practicalities", Reserve Bank of Australia, Research Discussion Paper, 2001-04

Morgese B.M., Polgár E. K. and Zlate A., (2008), "Real convergence and the determinants of growth in EU candidate and potential candidate countries: a panel data approach", ECB Occasional Paper, No 86

Vika I., 2006, " Kursi Real Efektiv i Këmbimit në Shqipëri. Konceptet dhe matja e tij", Banka e Shqipërisë, Material Diskutimi Nr. 2 (18)/06

Zanello A., and Desruelle D., (1997), "A Primer on the IMF's Information Notice System", IMF WP/97/71

Leichter J., Mocci C., and Pozzuoli S. (2010), "Measuring External Competitiveness: An Overview", Government of the Italian Republic, Ministry of Economy and Finance, Department of the Treasury Working Paper No. 2

Durand M., Simon J., and Webb C., (1992) "OECD's Indicators of international trade and competitiveness " OECD Economics Department Working Paper No. 120

Celiku E., Metani I., (2011), "Pozicioni konkurrues i ekonomisë shqipëtare në terma të produktivitetit të punës", Banka e Shqipërisë, Material Diskutimi

Pllaha A., (2012), "J-curve effect in bilateral trade between Albania and its main trading partners", Banka e Shqipërisë, Material Diskutimi

Hoda B., (2012), "Role of exchange rate in trade flows: does M-L condition hold?", Banka e Shqipërisë, Material Diskutimi

Shtylla D., Sojli E., (2006), "Parashikimi i Bilancit të Pagesave," Banka e Shqipërisë, Material Diskutimi

http://www.trademap.org/

http://data.worldbank.org/data-catalog/global-economic-monitor

http://fx.sauder.ubc.ca/data.html

http://www.conference-board.org/data/economydatabase/

Shtojcë 1. Ecuria e NEER dhe REER në terma tremujorë (2005=100)

Burimi: Llogaritje të autoreve.

Shtojcë 1. Ecuria e NEER dhe REER në terma tremujorë (2005=100)



Burimi: Llogaritje të autoreve.

VLERËSIME TË KONSUMIT DHE INVESTIMEVE PRIVATE NË SHQIPËRI: SI KANË ECUR ATO?

ILIR VIKA, ESIDA ABAZAJ
DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

HYRJE

Ky material synon të ndihmojë procesin e rivlerësimit të modelit makroekonometrik për ekonominë shqiptare (MEAM), i cili përdoret në vendimmarrjen e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Një kusht i domosdoshëm në këtë proces rivlerësimi është pasurimi i bazës së të dhënave të modelit, me frekuencë tremujore. Aktualisht, simulimet në model mbështeten në periudhën 1996 T1 – 2009 T4, ndërkohë që parametrat e modelit janë vlerësuar deri në vitin 2006. Përditësimi i bazës së të dhënave me të dhëna më të fundit dhe me frekuencë tremujore është një detyrë sfiduese, duke patur parasysh që disa prej treguesve të kërkesës agregate, sipas metodës së shpenzimeve janë të disponueshme nga INSTAT-i deri në vitin 2008 dhe me frekuencë vjetore. Pra, aktualisht ka një vonesë kohore prej 20 tremujorësh në publikimin e të dhënave të aktivitetit ekonomik sipas metodës së shpenzimeve. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur rivlerësimin e ekuacioneve sjellore për konsumin dhe investimet private, që ndodhen në bllokun e kërkesës në makromodelin MEAM, dhe rrjedhimisht nuk lejojnë mbylljen e modelit si një të tërë.

Që prej vitit 2007, MEAM është përdorur kryesisht për përgatitjen e skenarëve apo simulimeve të ndryshme, të cilat shoqërojnë projeksionet ekonomike, duke përgatitur variante të ndryshme që mbartin risk në një projeksion qendror. Gjithashtu, makromodeli MEAM ka ndihmuar edhe në përgatitjen e projeksioneve të kushtëzuara për treguesit kryesorë makroekonomikë. Megjithatë, gjenerimi i këtyre projeksioneve nuk është i drejtpërdrejtë, duke marrë parasysh që modeli përdor të dhëna tremujore deri në fund të vitit 2009. Rezultatet e marra nga makromodeli, të shprehura si devijim në përqindje nga baseline-i i modelit, i aplikohen vlerave më të fundit për treguesin e marrë në konsideratë, për të gjeneruar parashikimin e këtij treguesi. Duke synuar që në të ardhmen makromodeli të gjenerojë parashikime të mirëfillta dhe direkte, është e rëndësishme që të gjitha seritë kohore të modelit të jenë të zgjatura mundësisht deri në periudhën aktuale.

Pavarësisht qëllimit fillestar për makromodelin, matja e konsumit dhe investimeve është e rëndësishme edhe për raportet e politikës monetare, të cilat bëjnë vazhdimisht supozime mbi zhvillimet në konsumin dhe investimet private, duke u mbështetur në ecurinë e disa treguesve ekonomikë e financiarë.

Një paraqitje grafike e komponentëve të kërkesës agregate për periudhën 1996-2008 tregon se konsumi privat zë peshën më të madhe me rreth 81%,

Grafik 1. Ecuria e komponentëve të kërkesës agregate, si përqindje ndaj PBB-së, 1996- 2012



Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe llogaritje të Sektorit të Modelimit Makroekonomik, Dep. Kërkimeve.

Grafik 2. Ecuria e totalit të konsumit plus investimet



Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe llogaritje të autorëve.

ndërsa përpjesa e investimeve private gjatë kësaj periudhe është mesatarisht 26% (grafik 1).

Konsumi dhe investimet private analizohen zakonisht të marra së bashku, të përllogaritura si mbetje nga përqasja e shpenzimeve për matjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Për periudhën 1996-2008, konsumi përbënte tre-të-katërtat e totalit të këtyre dy treguesve. Megjithatë, kjo përpjesë nuk ka qenë konstante gjatë periudhës. Kështu, në vitin 1996 raporti i konsumit privat ndaj shumës së konsumit dhe investimeve private ishte rreth 85.6%, ndërsa në vitin 2008 ky raport u ul në vlerën 73.4% (garfik 2). Aktualisht, në raportet periodike të Bankës së Shqipërisë, tendenca e ecurisë së konsumit dhe investimeve private bazohet në ecurinë e një sërë treguesish të tërthortë, të cilët janë të disponueshëm me frekuencë më të lartë dhe në kohë më të shpejtë. Megjithatë, në këto raporte nuk jepet një vlerësim pikësor për këta dy tregues për periudhën pas vitit 2008. Gjithashtu, nuk identifikohet se cili prej këtyre treguesve të tërthortë është më i rëndësishëm në përcaktimin e ecurisë së konsumit apo investimeve private. Për këtë arsye, ky material synon të japë jo vetëm vlerësime pikësore për ecurinë e konsumit dhe investimeve private për periudhën pas 2008-ës, por gjithashtu të identifikojë se cili nga treguesit e tërthortë është më i (pa) rëndësishëm në shpjegimin e ecurisë së K dhe I.

Pjesa tjetër e materialit është organizuar si vijon. Seksioni në vijim shtron metodologjinë e përdorur dhe liston treguesit e tërthortë që mund të jenë kandidatë të mundshëm për përcaktimin e ecurisë së konsumit dhe investimeve private për periudhën pas vitit 2008. Ndërsa seksioni tjetër paraqet rezultatet e marra nga vlerësimi empirik, thekson çështjet apo problemet empirike që hasen gjatë vlerësimit, dhe së fundmi ofron disa konkluzione.

METODOLOGJIA DHE TREGUESIT E TËRTHORTË

Problemi i serive kohore që publikohen me frekuencë jo të rregullt dhe me vonesë kohore të konsiderueshme është prezent dhe mjaft shqetësues për pjesën më të madhe të ekonomive në zhvillim. Përqasja e ndjekur për trajtimin e problemeve me mungesën e të dhënave konsiston në metodologji të ndryshme, si: modelet autoregresivë, modelet "urë", VAR me dy treguese, analiza e komponentëve kryesorë, VAR bajezian apo modelet e faktorëve dinamikë (Liu et al., 2011).

Metodologjia e përdorur në këtë studim është ajo Autoregressive Distributed Lag (Vonesa Autoregresive e Shpërndarë) me dy tregues, ku Yt është treguesi që duam të parashikojmë (konsumi ose investimet private); ndërsa Zt është një prej treguesve të tërthortë të përzgjedhur si shpjegues të mundshëm për ecurinë e konsumit apo investimeve private.

Janë përdorur gjithsej 6 specifikime të ndryshme të modelit *Autoregressive Distributed Lag*, të cilët janë grupuar në dy kategori: specifikimet që përfshijnë vonesa kohore të treguesit të varur dhe specifikimet që nuk përfshijnë vonesa kohore (tabela 1).

Tabela 1. Specifikimet e Autoregressive Distributed Lag

Tipi i modelit	Ekuacioni
Specifikimet që përfshijnë vonesat kohore të treguesit të varur	
Autoregressive Distributed Lag (ADL)	$y_t = \alpha_o + \sum_{i=1}^{p} \beta_y y_{t-i} + \sum_{i=0}^{q} \beta_z z_{t-i} + \varepsilon_t$
Reduced Form / Dead Start (RF)	$y_t = \alpha_o + \sum_{i=1}^{p} \beta_y y_{t-i} + \sum_{i=1}^{q} \beta_z z_{t-i} + \varepsilon_t$
Partial Adjustment (PA)	$y_t = \alpha_o + \sum_{i=1}^{p} \beta_y y_{t-i} + \beta_z z_t + \varepsilon_t$
Specifikimet që nuk përfshijnë vonesat kohore të treguesit të varur	
Distributed Lag (DL)	$y_t = \alpha_o + \sum_{i=0}^{q} \beta_z z_{t-i} + \varepsilon_t$
Leading Indicator (LI)	$y_t = \alpha_o + \sum_{i=1}^{q} \beta_z z_{t-i} + \varepsilon_t$
Static Regression (SR)	$y_t = \alpha_o + z_t + \varepsilon_t$

Zgjedhja paraprake e treguesve proxy për parashikimin në kohë më të shpejtë të serisë së konsumit dhe investimeve private është bërë mbi bazën e intuitës ekonomike, statistikave përshkruese apo gjykimit të ekspertëve. Lista e plotë e treguesve paraprakë të përzgjedhur paraqitet në tabelën 2.

Tabela 2. Treguesit e tërthortë të konsideruar për konsumin dhe investimet private

TREGUESI E TËRTHORTË PËR KONSUMIN PRIVAT	Periudha/Frekuenca	Burimi
(+) Importi i mallrave të konsumit	2004-2012/Mujore	BSH
(+) Indeksi i volumit në tregtinë me pakicë	1999-2012/Mujore	INSTAT
(+) Tatimi mbi vlerën e shtuar	1996-2012/ Mujore	INSTAT
(+) Indeksi i besimit të konsumatorëve	2003-2012/Tremujore	BSH
(+) Flukset hyrëse të remitancave	1993-2012/Mujore	BSH
(+) Kredia akorduar për qëllime konsumi	2006-2012/Mujore	BSH
TREGUESIT E TËRTHORTË PËR INVESTIMET PRIVATE		
(+) Vlera e ndërtimeve të reja	2004-2012/Tremujore	INSTAT
(+) Investimet e huaja direkte	1993-2012/Mujore	BSH
(+) Kredia akorduar për qëllime investimi	2006-2012/Mujore	BSH
(+) Importi i makinerive dhe pajisjeve	1993-2012/Mujore	INSTAT
(+) Importi i mallrave të kapitalit	2004-2012/Mujore	BSH
(+) Shpenzimet për investime të sektorëve të ekonomisë	2006-2011/Vjetore	INSTAT
(+) Të ardhurat nga tatim fitimi	1996-2012/Mujore	MF
(-) Indeksi i kushteve monetare	1996-2012/Mujore	BSH
(+) Indeksi i besimit të bizneseve	2002-2012/Tremujore	BSH
(+) Flukset hyrëse të remitancave	1993-2012/Mujore	BSH

**Treguesit e theksuar janë ato të përfshirë në vlerësimin empirik.*

Kriteret kryesore në përzgjedhjen e treguesve të tërthortë finalë të përfshirë në vlerësimin empirik sipas tabelës 1 janë: së pari, seritë kohore të këtyre treguesve duhet të mbulojnë një periudhë kohore të mjaftueshme për të bërë një regresion; së dyti, seritë kohore duhet të kenë frekuencë mujore ose tremujore; dhe së treti, treguesit duhet të tregojnë një shkallë të konsiderueshme asociimi me konsumin apo investimet private, si dhe lidhja ndërmjet tyre të jetë/rezultojë me shenjën e pritshme.

Siç tregon tabela 2, remitancat janë përzgjedhur si tregues i tërthortë për të dy seritë e kërkesës agregate. Kjo përzgjedhje është bërë jo vetëm mbi disponibilitetin e serisë së remitancave për një periudhë të gjatë kohe dhe me frekuencë tremujore, por edhe mbi rëndësinë që kanë remitancat në mbështetjen e konsumit apo investimet private, të identifikuar në vrojtime të ndryshme. Sipas Gëdeshi (2009) dhe vrojtimit të Bankës së Shqipërisë realizuar gjatë vitit 2008[1], një pjesë e konsiderueshme e dërgesave të emigrantëve (rreth 65 - 70%) shkon për plotësimin e nevojave bazike të përditshme (ushqim apo veshmbathje), për përmirësimin e kushteve të jetesës (mobilim apo ndërtim-riparim shtëpi/ apartament), për investim në pasuri të patundshme dhe investim për biznes.

Indeksi i volumit në tregtinë me pakicë konsiderohet tregues i mirë i konsumit nisur nga vetë mënyra si ndërtohet ky indeks. Sipas INSTAT-it, indeksi i volumit të tregtisë me pakicë mat ndryshimin në kohë të shifrës së afarizmit që konsiston në totalin e të ardhurave që realizon ndërmarrja gjatë muajit nga shitja e mallrave, produkteve të veta dhe shërbimeve përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar.

Investimet e huaja direkte gjithashtu janë përzgjedhur si shpjegues i përshtatshëm për ecurinë e investimeve private. Theksojmë se hyrjet e IHD-ve nuk janë domosdoshmërisht formim kapitali sipas raportit të IHD-ve (2011), dhe rrjedhimisht vetëm ajo pjesë që shkon për investim (formim kapitali) regjistrohet si investim.[2] Gjithashtu, tatimi mbi fitimin besohet të jetë tregues i mirë për ecurinë e investimeve private, duke patur parasysh që burimi kryesor i financimit të investimeve private për kompanitë në Shqipëri është i brendshëm (Anketa e Ndërmarrjeve, IFC, 2007).

Metodologjia e ndjekur për vlerësimin në kohë reale të treguesve të konsumit dhe investimeve private konsiston në disa hapa. Së pari, seritë e konsumit dhe investimeve private për periudhën 1996-2008, të publikuara nga INSTAT-i me frekuencë vjetore, interpolohen në frekuencë tremujore. Kjo është realizuar duke marrë përpjesën e tyre nga të dhënat vjetore dhe zbatuar në mënyrë konstante shumës aktuale tremujore të tyre të përllogaritur si mbetje në identitetin e PBB-së sipas metodës së shpenzimeve. Duke ndjekur përqasjen nga e përgjithshme-në-specifike, çdo specifikim i metodës ADL fillon të vlerësohet duke përfshirë vonesa kohore deri në 12 tremujorë, që zvogëlohet me nga një njësi, ndërsa kontrollojmë për shenjën e koeficientit

[1] *Shih Buletinin Ekonomik, Banka e Shqipërisë, Vëll. 12, Nr. 3.*

[2] *Në raportin e INSTAT-it: "PBB-ja nominale sipas metodës së shpenzimeve", formimi bruto i kapitalit vlerësohet në bazë të anketimit me ndërmarrjen, por nuk raportohet vendas apo i huaj.*

para treguesit shpjegues, kriteret e informacionit Schwartz dhe Akaike, testet diagnostikuese për korrelacionin dhe heteroskedasticitetin, si dhe për cilësinë e parashikimit brenda kampionit (*in-sample*) në një periudhë trevjeçare, 2006-2008 (RMSE, MAPE, Theil, Bias, Variance, dhe Cov. Proportion). Kjo procedurë përsëritet për gjashtë specifikimet e ndryshme të ADL-së për secilin prej treguesve shpjegues Z_t (katër për konsumin privat dhe gjashtë për investimet private). Duke gjykuar mbi të gjitha testet diagnostike, zgjedhim specifikimin më të mirë të ADL-së nga secili grup: grupi i specifikimeve që përfshijnë vonesat kohore të treguesit të varur; dhe grupi i atyre specifikimeve që nuk përfshijnë vonesat kohore të treguesit të varur.

Pasi është bërë përzgjedhja e specifikimeve më të mira të ADL-së përftojmë parashikimet për konsumin dhe investimet private nga secili specifikim për periudhën vitin 2009, me frekuencë tremujore. Këto parashikime peshohen më tej në bazë të RMSE-së (rrënjës katrore së mesatares së katrorëve të gabimeve) të çdo specifikimi për të përftuar një parashikim të vetëm. Pas peshimit dhe përftimit të një vlere të vetme për konsumin dhe investimet private, shuma e tyre krahasohet me shumën aktuale të marrë si mbetje nga metoda e shpenzimeve. Vlerat e parashikuara për konsumin dhe investimet axhustohen në mënyrë të tillë që shuma e tyre të barazohet me vlerat aktuale. Ky proces përsëritet më pas për secilën periudhë në vazhdim.

Për të kontrolluar fortësinë e rezultateve të përftuara nga përqasja metodologjike e shpjeguar më lartë, provohen gjithashtu kombinime të tjera të specifikimeve të ADL-së, siç janë: zgjedhja e specifikimit më të mirë të ADL-së (1 për çdo tregues shpjegues), ose zgjedhja e të gjitha specifikimeve të vlerësuara.

REZULTATE DHE DISA ÇËSHTJE EMPIRIKE

Para realizimit të vlerësimit empirik, seritë kohore të konsumit dhe investimeve private dhe e gjithë treguesve të tjerë shpjegues janë testuar nëse janë stacionare apo jo, duke përdorur tre teste: Augmented Dickey Fuller (ADF), Phillips Perron (PP) dhe Kwiatkowski-Phillips-Schmidt-Shin (KPSS), për periudhën 2000-2008. Pjesa më e madhe e specifikimeve janë vlerësuar mbi këtë periudhë, me përjashtim të atyre specifikimeve ku treguesi shpjegues është i disponueshëm për një periudhë më të shkurtër kohore. Përgjithësisht është preferuar që periudha përpara vitit 2000 të lihet jashtë kampionit, për shkak të paqëndrueshmërisë së lartë të regresioneve të vërejtura gjatë provave të vlerësimit.

Testet e rrënjës njësi tregojnë se seritë kohore të marra në konsideratë janë në përgjithësi të integruara sipas rendit I(1) (tabela A në shtojcë), pra kërkohet të kthehen në diferencë të parë në mënyrë që të jenë stacionare për të hyrë në regresion.

Tabela 3 paraqet specifikimet përfundimtare për ekuacionet e vlerësimit të konsumit dhe të investimeve. Rezultatet për disa prej tyre nuk janë prezantuar,

për shkak se lidhja midis variablave rezultonte me shenjë kontradiktore me pritjet. Në rastin e regresioneve që përjashtojnë futjen e vonesave kohore të vetë ndryshores së varur (ek. 1-3), rezulton se specifikimi më i pranueshëm sipas kritereve të përmendura më sipër është ai i formës distributed lag për konsumin dhe leading indicator për investimet. Ndërsa në grupin e regresioneve që përfshijnë vonesat kohore të këtyre treguesve (ek. 4-6), forma e plotë ADL duket se është më e përshtatshme, sidomos për investimet.

Tabela 3A. Konsumi privat: specifikime të modeleve ADL (p, q) të përzgjedhura

Tipi i Modelit	IBK	Remitancat	Tregtia me pakicë	TVSH
1. Static regression	-	SR(0,0)	SR(0,0)	SR(0,0)
2. Distributed lag	DL(0,1)	DL(0,1)	-	DL(0,10)
3. Leading indicator	-	-	-	-
4. Partial adjustment	-	PA(3,0)	PA(5,0)	PA(7,0)
5. Reduced form	RF(1,1)	-	-	-
6. Autoregressive Distributed Lag (ADL)	ADL(1,1)	ADL(1,1)	ADL(9,9)	ADL(4,4)

Shënim: Specifikimet e hijezuara shënojnë ekuacionet më të mira, sipas aftësisë parashikuese për secilin grup të specifikimeve, me dhe pa vonesat kohore të treguesit të varur.

Tabela 3B. Investimet private: specifikimet e modeleve ADL (p, q) të përzgjedhura

Tipi i Modelit	IHD	IBB	Im. Makineri	Remitancat	Tatim fitimi
1. Static regression	SR(0,0)	-	SR(0,0)	SR(0,0)	SR(0,0)
2. Distributed lag	DL(0,2)	DL(0,1)	DL(0,2)	DL(0,3)	DL(0,11)
3. Leading indicator	LI(0,2)	LI(0,1)	LI(0,7)	-	LI(0,11)
4. Partial adjustment	PA(1,0)	-	PA(1,0)	PA(1,0)	PA(1,0)
5. Reduced form	RF(11,11)	RF(6,6)	RF(12,12)	RF(12,12)	RF(11,11)
6. Autoreg. distributed lag	ADL(11,11)	ADL(6,6)	ADL(12,12)	ADL(12,12)	ADL(11,11)

Shënim: Specifikimet e hijezuara shënojnë ekuacionet më të mira, sipas aftësisë parashikuese për secilin grup të specifikimeve, me dhe pa vonesat kohore të treguesit të varur.

Kriteri kryesor në përzgjedhjen e këtyre specifikimeve, si në rastin e konsumit ashtu dhe në rastin e investimeve private, lidhet me performancën e parashikimit brenda periudhës 2006-2008.Testi LM për autokorrelacionin sugjeron për një prani të fortë të këtij problemi në ekuacionet e përzgjedhura për të dy treguesit, K dhe I (shih tabelat B dhe C në shtojcë), i cili i bën parashikimet e tyre joeficiente. Megjithatë, për nga ndërtimi, një pjesë e mirë e tyre ruan konsistencën dhe paanshmërinë e rezultateve. Gjithashtu, nisur nga provat e shumta, ne gjykojmë se në pjesën më të madhe të rasteve autokorrelacioni mund të ishte rezultat i "dinamikave jo të mirëspecifikuara" për shkak të përfshirjes së vonesave kohore të treguesit të varur si variabël shpjegues, dhe jo prej ndonjë karakteristike të brendshme të termit të gabimit. Përpjekjet për të korrigjuar korrelacionin serial duke përdorur procedura statistikore të vlerësimit çojnë në imponimin e kufizimeve jolineare në modelin "e vërtetë". Në fakt, përpjekjet tona përfundonin në atë që pjesa më e madhe e teksteve ekonometrike sugjerojnë: se kura është thuajse gjithmonë më keq se sëmundja. Për më tepër, testi LM i autokorrelacionit mund të mos jetë shumë bindës si test diagnostikues për regresionet tona të vlerësuara (me periudhë të shkurtër kohore dhe shumë koeficientë), sepse është një test që përdoret për kampione të mëdha dhe kërkon të paktën tre shkallë lirie për të patur kuptim (Yin-FenGau, 2002).

Duke gjykuar mbi peshën që merr çdo tregues shpjegues në bazë të RMSE-së përkatëse, duket se indeksi i volumit në tregtinë me pakicë ka rëndësinë më të madhe në shpjegimin e ecurisë së konsumit privat (me një total prej 29%), ndërkohë tre treguesit e tjerë - indeksi i besimit të konsumatorëve, remitancat dhe tatimi mbi vlerën e shtuar - janë thuajse barabar të rëndësishëm në informacionin që përftojmë mbi ecurinë e konsumit (me peshë totale afër 24%). Ndërsa, në rastin e investimeve private, rezultatet nxjerrin se treguesi më i mirë shpjegues është indeksi i besimit të bizneseve (me peshë totale 26%), i ndjekur nga tatimi mbi fitimin (23%), remitancat (21%), importi i makinerive dhe pajisjeve (17%), dhe investimet e huaja direkte (13%) (shih tabelat B dhe C në shtojcë).

Tabela 4 paraqet performancën e parashikimeve të totalit të konsumit dhe investimeve (K+I), për periudhën 2009-11[3]. Performanca është matur nëpërmjet treguesit *Mean Percentage Error*, MPE (shqip: Gabimi Mesatar në Përqindje), i cili ekzaminon madhësinë e devijimeve të parashikimeve të shprehura në përqindje, si dhe reflekton tendencën e tyre për mbivlerësuar (nënvlerësuar) kur devijimi është pozitiv (negativ). Vlerësimi i parashikimeve është bërë për dy grupe, ku i pari (kolona A) përfshin modelet më të mira të parashikimit nga të dy grupet, me dhe pa vonesat kohore të treguesit të varur; ndërsa i dyti (kolona B) konsiston në modelet më të mira për çdo tregues shpjegues, d.m.th katër në rastin e konsumit dhe pesë për investimet.

Tabela 4. Performanca e parashikimeve të totalit të konsumit dhe investimeve (K plus I)

	Gabimi Mesatar në Përqindje (MPE)	
Periudha	(A) Modelet më të mira nga secili grup	(B) Modelet më të mira për secilin tregues shpjegues
2009	0.0	0.7
2010	-0.2	-1.0
2011	0.2	-1.0
MPE (2009- 2011)	0.0	-0.5

Vlerësimi i parashikimeve për periudhën 2009-2011 tregon se devijimet në rastin e kolonës A me modelet nga secili grup, marrin vlerat në intervalin [-0.2: 0.2], me një mesatare (MPE) të barabartë me 0% për këto tre vite. Ndërsa në rastin e kombinimit në kolonën B, madhësia e devijimeve është më e lartë, si dhe vihet re një shkallë nënvlerësimi (undershooting) e vazhdueshme në vitet 2010-11, duke rezultuar në një MPE rreth vlerës -0.5% për të gjithë periudhën. Bazuar mbi rezultatet e gabimit mesatar në përqindje, kombinimi i parë sipas modeleve më të mira nga secili grup rezulton si vlerësimi më i kënaqshëm për parashikimin e konsumit dhe investimeve private.

Grafiku 3 paraqet zhvillimet aktuale të totalit të këtyre dy treguesve, të cilët ecin shumë pranë parashikimeve të përftuara nga kombinimi i ekuacioneve

[3] *Publikimet flesh të PBB-së për vitet 2012-13 nga INSTAT kanë pësuar revizionime të konsiderueshme, të cilat ndikojnë performancën e parashikimeve për këtë periudhë. Ndërsa të dhënat deri në vitin 2011, edhe pse akoma jopërfundimtare apo paraprake, kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme.*

në kolonën A, tabela 4. Ndërsa grafiku 4 tregon ecurinë e serive finale të konsumit privat dhe investimeve private, në përqindje ndaj PBB-së.[4] Vlerësimet tona sugjerojnë se, raporti i konsumit privat ndaj PBB-së në periudhën 2009-11 mund të ketë njohur një rritje të konsiderueshme, nga 79.4% që ishte në vitin 2008, në 87.7% në vitin 2011. Ndërkohë, përpjesa e investimeve private ka ndjekur një ecuri të kundërt me atë të konsumit privat, duke u tkurrur me mbi 7 pikë përqindje gjatë këtyre viteve, në 21.2% të PBB-së.

Grafik 3. Totali i konsumit dhe investimeve private (K+I) nominale, miliardë lekë



Burimi: Llogaritje të autorëve dhe INSTAT.

Grafik 4. Konsumi dhe investimet private seritë finale, në përqindje të PBB-së



Burimi: Llogaritje të autorëve dhe INSTAT.

Një pyetje që ngrihet në adoptimin e metodës së matjes më lart është nëse do ishte më e saktë të vlerësohej njëri prej komponentëve (të themi, konsumi), dhe tjetri (investimi) të llogaritej si mbetje nga shuma aktuale e tyre. Kështu, ne mund të dimë më shumë nëse modelet e parashikimit të konsumit performojnë më mirë se ato të investimeve dhe anasjelltas. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje i jemi referuar treguesve statistikorë të variacionit, pasi MPE-ja (apo çdo matës tjetër i tillë për aftësinë parashikuese) nuk mund të llogaritet për vlerësimet si mbetje. Tabela 5 tregon se si mesataret ashtu dhe variacionet rreth tyre janë mjaft të përafërta midis dy mënyrave të vlerësimeve. Kjo nënkupton se niveli i performancës së modeleve të përdorura për parashikimin e konsumit privat nuk dallon nga ai për investimet private, që mund të lejojë zgjedhjen e vlerësimit të vetëm njërit prej treguesve, dhe tjetri të llogaritet si mbetje[5]. Megjithatë, kjo mënyrë vlerësimi nuk na mundëson më të matim aftësinë e modeleve për të parashikuar, prandaj vlerësimi i të dy treguesve, i konsumit dhe investimeve, në mënyrë individuale është i nevojshëm.

[4] *PBB-ja nominale është e disponueshme nga INSTAT-i deri në vitin 2011, me frekuencë vjetore. Zgjatja pas vitit 2011 dhe interpolimi i saj është përllogaritur nga Sektori i Modelimit Makroekonomik, në Departamentin e Kërkimeve.*

[5] *Kjo ka qenë mënyra e përdorur nga INSTAT. Për seritë e publikuara deri në vitin 2008, janë shfrytëzuar të dhëna të ndryshme për investimet private, ndërsa konsumi i popullatës është llogaritur si mbetje.*

Tabela 5. Treguesit kryesorë statistikorë të parashikimeve të ndryshme, 2009- 2011.

	Konsumi	Investimet	Konsumi	Investimet
	Vlerësuar individualisht		Vlerësuar si mbetje	
Mesatarja	1,020,374.88	282,719.87	1,020,625.02	282,970.02
Devijimi standard	107,374.65	12,522.92	106,891.54	12,428.98
Koeficienti i variacionit	0.11	0.04	0.10	0.04

Shënim: Parashikimet për modelet më të mira në të dy grupet (me dhe pa vonesat e variablit të varur).

Së fundi, vlerësimet tona për konsumin dhe investimet private gjatë viteve 2009-11 janë krahasuar me ato të Bankës Botërore dhe të Ministrisë së Financave[6] (grafik 5), ku vihen re se tendencat e vlerësuara për këto dy tregues në raport me PBB-në janë të ngjashme, por madhësia e ndryshimeve është e ndryshme. Sipas Bankës Botërore, raporti i konsumit privat ndaj PBB-së shënon një rritje graduale nga 85.2% në vitin 2008 në 89.5% në vitin 2011; ndërsa raporti i investimeve private ndaj PBB-së ulet nga 23.5% në vitin 2008, në 20.5% në vitin 2009, për të qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel dhe në dy vitet pasardhëse.[7] Ngjashëm, vlerësimet e Ministrisë së Financave sugjerojnë një rritje të raportit të konsumit ndaj PBB-së në vlerën 82.5% në vitin 2011, dhe rënie të investimeve private në vlerën 25.8%.

Grafik 5. Krahasimi i vlerësimeve për konsumin dhe investimet private (si % e PBB-së), 2009T1- 2011T4



Burimi: Llogaritje të autorëve, INSTAT, Ministria e Financave dhe Banka Botërore.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE

Gjetjet tona sugjerojnë se konsumi është rritur në terma të PBB-së për periudhën 2009-11, ndërsa përpjesa e investimeve private ka vijuar në rënie. Raporti i konsumit ndaj PBB-së në vitin 2011,vlerësohet të ketë shënuar rritje me 8.7pp krahasuar me vitin 2008, duke arritur vlerën 87.8%, ndërsa raporti i investimeve private gjatë vitit 2011 vlerësohet rreth 21.2%, duke qenë rreth 7.4pp më poshtë se raporti i vitit 2008. Këto tendenca vihen re edhe në vlerësimet e paraqitura në raportet e Bankës Botërore dhe në Vendimet e Këshillit të Ministrave (2013), edhe pse madhësia e këtyre zhvillimeve është e ndryshme midis materialeve.

Megjithëse vlerësimi i parashikimeve sipas gabimit mesatar në përqindje tregon se modelet kanë aftësi të kënaqshme për të parashikuar totalin e konsumit dhe investimeve private, zhvillimet e tyre individuale duhen konsideruar me kujdes, për sa kohë prezenca e autokorrelacionit në disa ekuacione sugjeron matje jo tërësisht eficiente.

[6] *Vlerësimet e Bankës Botërore janë marrë nga databaza e tyre në linkun http://databank.worldbank.org/data/views/reports/tableview.aspx , shkarkuar në datë 6 shkurt 2014. Ndërsa vlerësimet e Ministrisë së Financave janë marrë nga kuadri i miratuar për treguesit ekonomik në raportin "Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016".*

[7] *Në të vërtetë, raportet e këtyre treguesve të matur nga Banka Botërore janë të ndryshme nga ato të institucioneve shqiptare për të gjithë periudhën.*

REFERENCAT

Antipa, P. dhe K. Barhoumi, V. Brunhes-Lesage, O. Darne (2012), "Nowcasting German GDP: a comparison of bridge and factor models", Banque de France, Document de travail n. 401

Arnostova, K. dhe D. Havrlant, L. Ruzicka, P. Toth (2010), "Short-term forecasting of Czech quarterly GDP using monthly indicators", Czech National Bank, workingpaper 12/2010

Gëdeshi, Ilir(2009), "Effects of the global crisis on migration and remittances in Albania", CESS, Albania

Hendry, D. F. dhe K. Hubrich (2006), "Forecasting economic aggregates by disaggregates", ECB Working Paper Seriesno. 589 / February 2006

Lahiri, K., dhe G. Monokroussos, Y. Zhao (2012), "Forecasting consumption in real time: the role of consumer confidence surveys", Department of Economics, University of Albany, NY

Lee, J. dhe P. Rabanal (2010), "Forecasting US investment", IMF workingpaper WP/10/246

Liu, P. dhe M. Troy, R. Romeu (2011), "Real-time forecasts of economic activity for Latin American Economies", IMF Working Paper,WP/11/98

Yin-FenGau (2002), Econometrics Lecture Notes 10 on Serial Correlation

SHTOJCË

Tabela A. Testet e rrënjës njësi

Rezultatet e testit Augmented Dickey Fuller						
	në nivel			në diferencë të parë		
Treguesit	Konstante	Konstant edhe trend	Asnjë	Konstante	Konstante dhe trend	Asnjë
Indeksi i volumit në tregtinë me pakicë (2001T2:2008T4)	0.6471	0.0304	0.8692	0.0000	0.0053	0.0000
Tatimi mbi vlerën e shtuar (2000T3: 2008T4)	0.3024	0.9996	0.9644	0.0000	0.0000	0.0000
Indeksi i besimit të konsumatorëve (2003T4: 2008T4)	0.1205	0.4814	0.3814	0.0007	0.0241	0.0000
Flukset hyrëse të remitancave (2000T3: 2008T4)	0.0005	0.0001	0.8719	0.0000	0.0000	0.0000
Investimet e huaja direkte (2000T3: 2008T4)	0.8222	0.0020	0.8990	0.0000	0.0000	0.0000
Importi i makinerive dhe pajisjeve (2000T3: 2008T4)	0.9726	0.5228	0.9913	0.0000	0.0000	0.0000
Të ardhurat nga tatim fitimi (2001T1: 2008T4)	0.3839	0.9995	0.9472	0.0000	0.0000	0.0000
Indeksi i kushteve monetare (2000T3: 2008T4)	0.4717	0.4707	0.4448	0.0007	0.0040	0.0000
Indeksi i besimit të bizneseve (2003T4: 2008T4)	0.0341	0.0068	0.0114	0.0005	0.0252	0.0000
Rezultatet e testit Phillips- Perron						
	në nivel			në diferencë të parë		
Treguesit	Konstante	Konstante dhe trend	Asnjë	Konstante	Konstante dhe trend	Asnjë
Indeksi i volumit në tregtinë me pakicë	0.8052	0.0499	0.9902	0.0000	0.0000	0.0000
Tatimi mbi vlerën e shtuar	0.1647	0.4792	0.9836	0.0000	0.0000	0.0000
Indeksi i besimit të konsumatorëve	0.1468	0.5857	0.4430	0.0005	0.0000	0.0000
Flukset hyrëse të remitancave	0.0005	0.0000	0.7241	0.0001	0.0000	0.0000
Investimet e huaja direkte	0.1015	0.0019	0.8911	0.0000	0.0000	0.0000
Importi i makinerive dhe pajisjeve	0.6309	0.0002	0.9993	0.0001	0.0000	0.0000
Të ardhurat nga tatim fitimi	0.4828	0.6061	0.9759	0.0000	0.0000	0.0000
Indeksi i kushteve monetare	0.0046	0.0074	0.3511	0.0000	0.0000	0.0000
Indeksi i besimit të bizneseve	0.0341	0.0772	0.0013	0.0005	0.0029	0.0000
Rezultatet e testit KPSS						
	në nivel			në diferencë të parë		
Treguesit	Konstante	Konstante dhe trend	Asnjë	Konstante	Konstante dhe trend	Asnjë
Indeksi i volumit në tregtinë me pakicë	0.6593	0.1265		0.3448	0.2388	
Tatimi mbi vlerën e shtuar	0.5808	0.1906		0.5000	0.2273	
Indeksi i besimit të konsumatorëve	0.3519	0.1884		0.3738	0.5000	
Flukset hyrëse të remitancave	0.6387	0.2804		0.2383	0.2588	
Investimet e huaja direkte	0.5970	0.2009		0.4076	0.5000	
Importi i makinerive dhe pajisjeve	0.7829	0.1631		0.2391	0.2189	
Të ardhurat nga tatim fitimi	0.6084	0.1835		0.5000	0.2479	
Indeksi i kushteve monetare	0.5825	0.0678		0.1588	0.0630	
Indeksi i besimit të bizneseve	0.4051	0.0624		0.1002	0.0752	

Tabela B. Konsumi privat: Testet diagnostike dhe peshat për modelet më të mira

Treguesi shpjegues	IBK	Remitancat	Tregtia me pakicë	TVSH	IBK	Remitancat	Tregtia me pakicë	TVSH
	Modelet me vonesat kohore të variablit të varur				Modelet pa vonesat kohore të variablit të varur			
Tipi i modelit	RF(1,1)	PA(3,0)	ADL(9,9)	ADL(4,4)	DL(0,1)	DL(0,1)	SR(0,0)	DL(0,10)
Shuma e koef.	0.597	0.062	0.217	0.497	0.766	0.134	0.078	0.803
Kriteri Akaike			-3.447				-2.689	-2.978
Kriteri Schwartz	-2.564	-2.717		-2.799	-2.039	-2.220		
Normal. JBtestprob.	0.673	0.325	0.748	0.429	0.771	0.892	0.857	0.745
Autokorrel. LM test prob.	0.669	0.394	0.000	0.671	0.042	0.002	0.017	0.084
Heterosked. BPG test prob.	0.586	0.276	0.353	0.621	0.258	0.190	0.076	0.875
Aftësia parashikuese për periudhën 2006T1:2008T4 (12 obs.)								
RMSE	7852.0	7562.8	4304.1	6861.1	8947.9	11301.9	21244.0	10745.3
Theil	0.020	0.019	0.011	0.017	0.023	0.029	0.052	0.027
Peshat, bazuar në RMSE								
Ekuacionet më të mira (8/14) për secilin grup	0.130	0.135	0.238	0.149	0.114	0.090	0.048	0.095

Tabela C. Investimet Private: Testet diagnostike dhe peshat për modelet më të mira

Treguesi shpjegues	IHD	IBB	Imp_Makineri	Remitancat	Tatimi-Fitimi	IHD	IBB	IMP_Makineri	Remitancat	Tatimi-Fitimi
	Modelet me vonesat kohore të variablit të varur					Modelet pa vonesat kohore të variablit të varur				
Tipi i modelit	ADL(11,11)	RF(6,6)	ADL(12,12)	ADL(12,12)	ADL(11,11)	SR(0,0)	LI(0,1)	LI(0,7)	DL(0,3)	LI(11,11)
Shuma e koef.	0.069	0.407	1.434	2.387	2.092	0.028	0.042	0.482	0.307	0.855
Kriteri Akaike	-2.609	-2.518	-2.707	-3.553	-2.644	-2.348	-1.902	-2.359	-2.351	-2.278
Kriteri Schwartz	0.412	0.907	0.715	0.526	0.966	0.347	0.831	0.846	0.631	0.550
NormalityJBtestprob.	0.412	0.907	0.715	0.526	0.966	0.347	0.831	0.846	0.631	0.550
Serialcorr. LM test prob.	0.000	0.036	0.000	0.000	0.000	0.828	0.218	0.542	0.020	0.017
Heterosked. BPG test prob.	0.583	0.236	0.746	0.577	0.439	0.057	0.091	0.315	0.144	0.121
Aftësia parashikuese për periudhën 2006T1:2008T4 (12 obs.)										
RMSE	5241.0	2791.2	4506.1	2831.7	4043.4	9393.5	3949.3	6044.7	7529.5	3411.5
Theil	0.036	0.019	0.029	0.019	0.026	0.059	0.027	0.039	0.048	0.023
Peshat, bazuar në RMSE										
Ekuacionet më të mira (10/27) për secilin grup	0.082	0.154	0.096	0.152	0.106	0.046	0.109	0.071	0.057	0.126

A PARAQESIN AVANTAZHE KONKURRUESE EKSPORTET SHQIPTARE? ECURIA E EKSPORTEVE VENDASE GJATË VITEVE TË FUNDIT; ZHVENDOSJET NË GRUPMALLRA DHE PARTNERË TREGTARË

ALBAN PLLAHA, SHKURT 2014

Sektori i Kërkimeve Metodologjike në të Dhëna Mikro

ABSTRAKT

Ky artikull analizon ecurinë e eksporteve shqiptare gjatë viteve të fundit. Artikulli trajton ecurinë e eksporteve në këndvështrim të disagreguar - sipas vendeve partnere dhe sipas grupmallrave. Indeksi e avantazheve krahasuese të demonstruara dhe indeksi i specializimit në eksporte përdoren për të vlerësuar konkurrueshmërinë dhe avantazhet e eksporteve vendase. Analizat sugjerojnë se gjatë viteve të fundit eksportet shqiptare kanë ndryshuar në strukturë dhe në destinacion (duke gjetur edhe partnerë të rinj tregtarë, përveç atyre historikë). Indekset tregojnë se 3 nga 4 grupmallrat kryesore të eksportuara nga Shqipëria kanë avantazh krahasues të demonstruar. Shqipëria gjithashtu karakterizohet nga specializimi në eksporte drejt Italisë për grupmallrat "tekstile dhe këpucë".

1. HYRJE

Tregtia e jashtme luan një rol të rëndësishëm në një "ekonomi të vogël të hapur" pasi është një tregues i rëndësishëm i aftësisë prodhuese dhe fuqisë ekonomike të një vendi, duke ndikuar në punësimin në ekonomi dhe në mirëqenien e ekonomisë. Pesha e treguesit "eksporte" merr një rol akoma më të madhe kur merren në konsideratë rastet e ekonomive të vogla në zhvillim, si rasti i ekonomisë shqiptare. Ndaj dhe një analizë e detajuar e eksporteve shqiptare drejt partnerëve kryesorë tregtarë do të ndikonte pozitivisht në evidentimin e kujdesshëm të karakteristikave dhe tipareve specifike të eksporteve. Bazuar në këto gjetje mund të sugjerohen sektorë specifikë të cilët përbëjnë prioritet për ekonominë shqiptare ose sektorë niveli i konkurrencës ndërkombëtare i të cilëve lë për të dëshiruar.

Në mënyrë të ngjashme me ekonomitë e tjera tranzitore të vendeve të rajonit të Ballkanit (nga ekonomi të centralizuara të sistemit komunist në ekonomi të tregut të lirë), ekonomia shqiptare është karakterizuar nga një bilanc tregtar negativ, gjatë periudhës 2005 – 2013. Tregtia e jashtme e Shqipërisë është karakterizuar nga një rritje e vazhdueshme e flukseve tregtare nga viti në vit (importe dhe eksporte). Megjithatë, tregtia është dominuar në mënyrë të vazhdueshme nga importet, duke thelluar në mënyrë të vazhdueshme bilancin tregtar negativ deri në vitin 2008 (grafiku 1). Në vitin 2009, tregtia e jashtme shqiptare, për herë të parë që prej vitit 2005, shfaq shenja të përmirësimit të deficitit tregtar. Gjatë periudhës 2009 - 2013 ecuria e import - eksporteve

shqiptare ka shfaqur një trend përmirësimi të deficitit tregtar, duke ngushtuar kështu diferencën ndërmjet import-eksporteve. Përmirësimi i bilancit vjen përgjithësisht për shkak se eksportet shqiptare kanë përshpejtuar ndjeshëm ritmin e rritjes në vitet e fundit. Kjo tendencë e re e eksporteve shqiptare vlen të analizohet më në detaj, duke synuar evidentimin e sektorëve specifikë dhe partnerëve tregtarë që kanë ndikuar këtë orientim të ri të tregtisë së jashtme.

Grafiku 1. Bilanci tregtar i mallrave, 2005-2013 (në milion Lekë)



Burimi: INSTAT, 2014.

Nëpërmjet ndërtimit të indekseve mbi tregtinë me jashtë: a) indeksi i avantazheve krahasuese të demonstruara (Revealed Comparative Advantage index, ose RCA Index); dhe b) indeksi i specializimit në eksporte; ky artikull synon gjithashtu të evidentojë nëse sektorë specifikë të ekonomisë shqiptare kanë avantazhe konkurruese në eksportin e mallrave, krahasuar me vendet e tjera.

Vijimi i këtij artikulli ka strukturën e mëposhtme: seksioni 2 trajton ecurinë e eksporteve shqiptare sipas partnerëve dhe grupmallrave; seksioni 3 trajton avantazhet konkurruese, produktivitetin dhe ndikimin në ekonomi; seksioni 4 përmbledh dhe konkludon gjetjet kryesore.

2. ECURIA E EKSPORTEVE SIPAS PARTNERËVE DHE GRUPMALLRAVE

Për të analizuar më në detaj ecurinë e eksporteve shqiptare, gjatë viteve të fundit, vlen të analizojmë eksportet drejt pratnerëve tregtarë për të përcaktuar zhvendosjet e mundshme që mund të kenë pësuar eksportet gjatë viteve të fundit. Italia dhe Greqia kanë qenë partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, ku eksportet shqiptare vetëm drejt këtyre dy partnerëve tregtarë kanë përbërë mbi 80% të totalit të eksporteve shqiptare deri në vitin 2006. Megjithatë, duke analizuar me kujdes grafikun 2 vërehet se pas vitit 2006 eksportet drejt këtyre dy vendeve (si raport ndaj totalit të eksporteve shqiptare) kanë shfaqur tendencë rënëse nga viti në vit. Kështu, eksportet vendase drejt Italisë në vitin 2006 përbënin rreth 72% të totalit të eksporteve, ndërkohë në vitin 2012 ato janë reduktuar ndjeshëm, duke arritur në rreth 51% të totalit të eksporteve, tkurrje kjo prej 20 pikë përqindjeje në vetëm 6 vitet e fundit. Një situatë ngjashme vërehet edhe nëse shqyrtohen eksportet drejt Greqisë. Në 2005, eksporet vendase drejt Greqisë përbënin mbi 10 % (ndaj totalit), ndërkohë që në 2012 eksportet drejt këtij partneri tregtar janë më shumë se përgjysmuar dhe vihet re se eksportuesit shqiptarë gjatë viteve të fundit kanë gjetur tregje të reja për produktet e tyre, duke synuar diversifikimin e tregut të tyre. Në grafikun 2 vërehet se niveli i flukseve tregtare drejt partnerëve si Gjermania dhe Maqedonia ka mbetur thuajse në nivele të njëjta apo me luhatje të vogla përgjatë periudhës 2005 - 2012. Ndërkohë, nëse analizojmë partnerë tregtarë

Grafiku 2. Eksportet sipas vendeve partnere si % ndaj totalit (2005-2012)



Burimi: INSTAT, 2014.

Grafiku 3. Eksportet sipas 9 grupmallrave kryesore të peshuara ndajt totalit 2005-2013



Burimi: INSTAT, 2014.

si Turqia, Kosova apo Spanja, vërejmë një tendencë krejtësisht të ndryshme nga ajo e trajtuar më sipër për partnerët tradicionalë të eksporteve shqiptare. Kështu, eksportet drejt Turqisë kanë shfaqur një stabilitet me shumë pak luhatje përgjatë periudhës 2005 - 2009. Megjithatë, vërehet se mbas vitit 2009 eksportet Shqiptare drejt Turqisë janë rritur në mënyrë të konsiderueshme. Nga niveli (mesatarisht) rreth 1.6% e totalit të eksporteve përgjatë periudhës 2005 - 2009 në mesatarisht rreth 6.5% të totalit të eskporteve për periudhën mbas viti 2009 (nga përllogaritjet, ky trend rritës vazhdon edhe përgjatë gjysmës së parë të vitit 2013). Eksportet drejt Kosovës gjithashtu kanë shfaqur një tendencë rritëse nga viti në vit përgjatë gjithë periudhës nën shqyrtim. Kështu, në 2005 eksportet e Shqipërisë drejt Kosovës përbënin vetëm 4.1% të totalit të eksporteve, ndërkohë që në 2012 eksportet vendase drejt Kosovës arritën në 8.2% të totalit. Në një periudhë prej 8 vitesh, Shqipëria ka dyfishuar eksportet drejt Kosovës, duke e shndërruar tashmë Kosovën një ndër nga partnerët më të rëndësishëm tregtarë për ekonominë shqiptare. Eksportet drejt Spanjës, gjatë periudhës 2005 - 2008, kanë qenë thuajse joekzistuese. Ndërkohë që nga viti 2009 e në vazhdim këto eksporte kanë njohur një rritje shumë domethënëse, e cila ka vazhduar të rritet me ritme të shpejta nga viti në vit. Kështu, eksportet drejt Spanjës për vitin 2012 arritën në 9.2% ndaj totalit të eksporteve shqiptare, duke bërë që, për 2012, Spanja të shndërohet në partnerin e dytë për nga rëndësia e eksporteve shqiptare, mbas Italisë.

Nga analiza e mësipërme mund të dilet në përfunimin se eksportet vendase në vitet e fundit kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme, si në volum ashtu edhe në destinacion. Gjatë viteve të fundit (sidomos nga fillimi i krizës ekonomike globale e në vazhdim) vërehet një rënie e peshës së eksporteve vendase drejt dy partnerëve tregtarë historikë (Italisë dhe Greqisë). Vlen për t'u konsideruar gjithashtu se pikërisht këto dy ekonomi kanë qenë edhe 2 nga vendet më të prekura nga kriza ekonomike gjatë viteve të fundit. Analiza e mëposhtme e eksporteve sipas partnerëve kryesorë dhe grupmallrave na jep një panoramë më të plotë të këtyre zhvillimeve.

Grafiku 3 ofron zhvillimet e eksporteve vendase përgjatë periudhës 2005 - 2013, sipas nëntë grupmallrave kryesore. Duke synuar evidentimin e grupmallrave që zënë peshën më të madhe të eksporteve shqiptare (mbi 80% të totalit), mund të thuhet se kategoritë me peshë më të madhe ndaj totalit,

të renditura sipas rëndësisë për periudhën në shqyrtim, janë: "tekstile dhe këpucë" (mesatarisht 43%), "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" (mesatarisht 20%), "materiale ndërtimi dhe metale" (mesatarisht 17%) dhe "ushqim pije dhe duhan" (mesatarisht 7%). Megjithatë, nëse analizohen sipas ecurisë së tyre ndër vite, vërehet se pesha e grupmallrave të caktuara ndaj totalit ka pasur ecuri të ndryshme për grupmallra të ndryshme. Kështu, ecuria e "tekstile dhe këpucë", grupmallrash ky i cili, në vitin 2005, përbënte rreth 60% të totalit të eksporteve shqiptare, ka pësuar një rënie të konsiderueshme nga viti në vit, duke u pozicionuar nën kuotën 30% të totalit të eksporteve në vitin 2013. Ndërkohë, grupet "materiale ndërtimi dhe metale" dhe "ushqim, pije dhe duhan" kanë ngelur në kuota thuajse të njëjta përgjatë periudhës 2005 - 2013. Duke analizuar ecurinë e grupit të eksporteve "minerale, lëndë djegëse, energji elektrike", vërehet se kjo kategori grupmallrash ka shfaqur një tendencë rritëse pozitive të vazhdueshme gjatë periudhës në shqyrtim.

Kështu, në vitin 2005, ky grup mallrash përbënte vetëm 5.2% të totalit të eksporteve shqiptare, ndërkohë që në 2013, grupmallrat e kategorisë "minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" përbënin rreth 40% të totalit të eksporteve, duke u shndërruar kështu në zërin kryesor të eksporteve shqiptare.

Analiza në vijim fokusohet në ecurinë e eksporteve sipas partnerëve kryesorë tregtarë dhe grupmallrave të eksportuara drejt tyre. Duke iu referuar analizës së mësipërme për ecurinë e eksporteve gjatë periudhës 2005 - 2013, evidentohen tre kategori kryesore partnerësh tregtar: a) partnerët eksportet ndaj të cilëve kanë shfaqur tendencë rënëse (pesha e këtyre partnerëve për periudhën 2005-2013, është mesatarisht 69%); b) partnerët eksportet ndaj të cilëve janë rritur (mesatarisht rreth 12%, të peshuara ndaj totalit të eksporteve); si dhe c) partnerët eksportet ndaj të cilëve nuk kanë shfaqur ndonjë tendencë rritëse apo rënëse (mesatarisht rreth 8%, të peshuara ndaj totalit të eksporteve për periudhën nën shqyrtim). Sipas kësaj ndarje, analiza në vijim do të fokusohet në dy kategoritë e para të partnerëve tregtarë, partnerë ndaj të cilëve eksportet vendase kanë shfaqur edhe dinamika të konsiderueshme.

Në paraqitjet grafike 4 dhe 5 më poshtë, ofrohet ecuria e eksporteve drejt dy partnerëve tregtarë - përkatësisht Italisë dhe Greqisë - sipas nëntë grupmallrave kryesore për periudhën 2005 - 2013, në milion lekë.

Grafiku i mëposhtëm sugjeron se vlera e eksporteve drejt Italisë, sipas 9 grupmallrave kryesore, është karakterizuar nga një trend pozitiv rritës për thuajse të gjitha kategoritë e grupmallrave. Rritja e eksporteve drejt Italisë konstatohet si në vlerë ashtu edhe në volum (peshë neto). Ndërkohë, nëse i referohemi analizës së bërë më sipër në grafikun 2, vërehet se eksportet drejt Italisë (partneri kryesor tregtar), si raport ndaj totalit të eksporteve shqiptare, kanë pësuar një tkurrje të konsiderueshme, sidomos mbas vitit 2008 (fillimi i krizës ekonomike globale). Rënia e peshës se eksporteve drejt Italisë ndaj totalit të eksporteve shqiptare, e konstatuar në grafikun 2, shpjegohet nga fakti se ekonomia vendase, vitet e fundit, ka rritur eksportet jo vetëm drejt Italisë por edhe drejt partnerëve të rinj tregtarë. Mbas 2008, eksportuesit

Grafiku 4. Eksportet drejt Italisë sipas 9 grupmallrave, në mil Lek



Burimi: INSTAT, 2014.

Grafiku 5. Eksportet drejt Greqisë sipas 9 grupmallrave, në mil Lek



Burimi: INSTAT, 2014.

vendas kanë synuar gjetjen e tregjeve të reja për produktet vendase, duke reduktuar varësinë nga partnerët historikë (Italia dhe Greqia).

Të analizuara sipas grupmallrave, vërehet se eksportet e "tekstile dhe këpucë" (mesatarisht rreth 59%), "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" (mesatarisht rreth 12%) dhe "materiale ndërtimi dhe metale" (mesatarisht 12%) janë grupmallrat kryesore që dominojnë eksportet drejt Italisë. Ecuria e kategorisë "materiale ndërtimi dhe metale" ka qëndruar thuajse konstante përgjatë periudhës nën shqyrtim. Ndërkohë që, grupi i mallrave "tekstile dhe këpucë" që dominojnë eksportet drejt Italisë kanë shfaqur trend të qëndrueshëm rritës përgjatë 2005 - 2013. Vlen të theksohet fakti se, sidomos mbas vitit 2008, eksporti i grupmallrave "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" ka shfaqur një hov të madh rritës.

Në paraqitjen grafike nr. 5 vërehet se grupmallrat kryesore që kanë dominuar eksportet shqiptare drejt Greqisë (rreth 4.4% e totalit të eksporteve shqiptare në 2013) për periudhën 2005 - 2013 janë: "tekstile dhe këpucë" (mesatarisht rreth 41%), "materiale ndërtimi dhe metale" (mesatarisht rreth 23%), "ushqim, pije dhe duhan" (mesatarisht rreth 13%). Grupi i mallrave "tekstile dhe këpucë" që ka dominuar eksportet shqiptare drejt Greqisë ka shfaqur tendencë rënëse, sidomos gjatë viteve të fundit (nga rreth 59% në 2005, në rreth 24% në 2013).

Ndërkohë që eksportet e grupmallrave "materiale ndërtimi dhe metale" dhe "ushqim, pije dhe duhan" kanë shfaqur tendencë rritëse, duke shënuar përafërsisht 35% dhe 19%, të peshuara ndaj totalit të eksporteve drejt Greqisë për vitin 2013.

Grafikët 6, 7 dhe 8, ofrojnë paraqitjen grafike të ecurisë së eksporteve sipas grupmallrave drejt partnerëve "të rinj" tregtarë: Turqisë, Kosovës dhe Spanjës. Në grafikun 2, vihet re se eksportet drejt këtyre partnerëve tregtarë, si përqindje ndaj totalit të eksporteve, ka ardhur në rritje përgjatë periudhës 2005 - 2013, e sidomos mbas vitit 2008.

Duke analizuar eksportet sipas grupmallrave, drejt Turqisë (rreth 6.3% e totalit të eksporteve shqiptare në 2012) për periudhën 2005 - 2013, treguesi më i dallueshëm është fakti se eksportet drejt Turqisë dominohen vetëm nga

dy grupmallra kryesore: "materiale ndërtimi dhe metale" (mesatarisht rreth 49%) dhe "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" (mesatarisht rreth 28%). Eksporti i shtatë grupmallrave të tjera drejt Turqisë është thuajse joekzistues, edhe pse eksportet vendase drejt Turqisë, në vitet e fundit, kanë arritur mesatarisht rreth 6.5% si raport ndaj totalit të eksporteve.

Eksportet e grupmallrave drejt Spanjës (rreth 9.2% e totalit të eksporteve shqiptare në 2012) reflektojnë një situatë të përngjashme me atë të eksporteve drejt Turqisë. Grupmallrat e vetme që dominojnë eksportet drejt Spanjës janë ato të "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike", eksporti i të cilave përbën mbi 90% të eksporteve vendase drejt këtij partneri tregtar. Lehtësisht të konsiderueshëm dhe me trend rritës shfaqen eksportet e grupit "tekstile dhe këpucë", ndërkohë që eksporti i grupmallrave të tjera drejt Spanjës është i pakonsiderueshëm. Edhe pse në vitin 2012 eksportet drejt këtij vendi bënë që Spanja të shndërrohet në partnerin e dytë kryesor tregtar të Shqipërisë, tregtia e vetëm një grupi mallrash drejt këtij vendi sugjeron se eksportet drejt Spanjës duhen parë me kujdes.

Eksportet drejt Kosovës (rreth 8.2% e totalit të eksporteve shqiptare në 2012) ofrojnë një tjetër situatë. Në dallim nga dy partnerët e sipërpërmendur (Turqia dhe Spanja), eksportet drejt Kosovës dominohen nga grupmallra të ndryshme: "materiale ndërtimi dhe metale", "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike", "ushqime pije dhe duhan" dhe "makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi". Përgjithësisht, thuajse të gjitha kategoritë e grupmallrave të eksportuara drejt Kosovës kanë shfaqur tendencë rritëse përgjatë viteve 2005 - 2013. Nga përfundimet e mësipërme mund të thuhet se Kosova po shndërrohet në një partner të rëndësishëm tregtar për eksportet e Shqipërisë, të cilat janë të mirëshpërndara në disa kategori grupmallrash.

3. EKSPORTET DHE AVANTAZHET KONKURRUESE

3.1 .Konkurrueshmëria dhe avantazhet konkurruese

Grafiku 6. Eksportet drejt Turqisë sipas 9 grupmallrave, në mil Lek



Burimi: INSTAT, 2014.

Grafiku 7. Eksportet drejt Spanjës sipas 9 grupmallrave, në mil Lek



Burimi: INSTAT, 2014.

Grafiku 8. Eksportet drejt Kosovës sipas 9 grupmallrave, në mil Lek



Burimi: INSTAT, 2014.

Nga analizat e mësipërme, lind natyrshëm pyetja nëse rritja e eksporteve shqiptare gjatë viteve të fundit është rezultat i avantazheve konkurruese që ofrojnë eksportet shqiptare, apo është kjo rritje është e ndikuar nga faktorë të tjerë rrethanorë. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje të rëndësishme, vlen të merret nën shqyrtim vlerësimi i avantazheve konkurruese të eksporteve shqiptare sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Indeksi i avantazheve krahasuese të demonstruara (Revealed Comparative Advantage index, ose RCA Index) është një nga mjetet më të aplikuara nga studiuesit e tregtisë ndërkombëtare, kur bëhet fjalë për konkurrueshmërinë e sektorëve të ekonomisë në tregtinë me jashtë. Ky indeks u sugjerua fillimisht nga Balassa (1965), duke gjetur një aplikim të gjerë që prej asaj kohe e në vazhdim. Në këtë artikull, ne do të aplikojmë një formë të përshtatur të indeksit të avantazheve krahasuese të demonstruara, i cili quhet indeksi i specializimit në eksporte. Ky indeks realizon vlerësimin e specializimit në eksporte, ku emëruesi zakonisht vlerësohet duke ju referuar tregjeve ose partnerëve specifikë. Ky indeks tregon specializimin e eksporteve të një vendi drejt një partneri specifik. Indeksi i specializimit në eksporte përllogaritet si raporti i pjesës së një produkti të eksportuar ndaj totalit të eksporteve të këtij vendi, ndaj pjesës që zë ky produkt në importet e partnerit specifik. Në formë ekuacioni, ky indeks mund të shprehet si më poshtë:

$$ES = (x_{ij}/X_{it}) \ / \ (m_{kj}/M_{kt})$$

ku, x_{ij} qëndron për vlerat e eksporteve të vendit, i për eksportin e produktit j (Shqipëria në rastin tonë), X_{it} qëndron për totalin e eksporteve të vendit i. m_{kj} qëndron për vlerat e importit të produktit j drejt tregut k (pjesa tjetër e botës) dhe M_{kt} tregon importin total në tregun k.

Nëse rezultatet e indeksit të specializimit për sektorë të ndryshëm të ekonomisë (Leromain & Orefice, 2013) tregojnë vlera mbi 1, atëherë kjo tregon se ky sektor i eksporteve është i specializuar, duke përbërë një avantazh konkurrues. Ndërsa vlera të indeksit të specializimit më të vogla se vlera 1 tregojnë se ky sektor i ekonomisë nuk është i specializuar sa duhet, duke mos ofruar avantazh konkurrueshmërie për eksportet drejt partnerit specifik.

Analiza jonë është fokusuar në analizën e indeksit të specializimit në eksporte, për 4 grupmallrat kryesore të eksportuara nga ekonomia shqiptare: "tekstile dhe këpucë", "minerale, lëndë djegëse, energji elektrike", "materiale ndërtimi dhe metale" dhe "ushqim, pije, duhan".

Rritjen më të madhe gjatë viteve të fundit, e ka shënuar kategoria "lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre" (rreth 27% e totalit të gjithë eksporteve në vitin 2013, mbi 80% destinuar kryesisht drejt Italisë dhe Spanjës). Ky zë i eksporteve është përgjithësisht i përbërë nga eksporti bruto (të papërpunuara) i nënprodukteve të naftës. Nënproduktet e tjera minerale si kromi, nikeli, giza dhe çeliku (eksporti i të cilave ka njohur rritje gjatë viteve të fundit) eksportohen gjithashtu përgjithësisht në formë bruto të papërpunuar. Këto lloj eksportesh (të papërpunuara) njihen si eksporte bruto,

të cilat shumë pak ndikojnë në vlerën e shtuar të eksporteve dhe produktivitet.

Ndërkohë, kategoria e eksporteve me karakter "fason", e cila përveç efekteve në punësim, përpunim të materialeve bazë dhe totalit të eksporteve, ndikon gjithashtu edhe në rritjen e vlerës së shtuar dhe produktivitet, duke shndërruar materialet bazë në produkte finale për konsumatorët. Pikërisht kjo kategori eksportesh - "tekstile dhe këpucë" - ka njohur një tkurrje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit (nga rreth 60% e totalit të eksporteve në 2005, në rreth 30% të totalit të eksporteve në 2013). Ndikim të konsiderueshëm ka pasur kriza ekonomike që ka përfshirë partnerët historikë tregtarë të ekonomisë shqiptare - Italinë dhe Greqinë (dy ekonomitë e Bashkimit Evropian më të prekura nga kriza ekonomike).

Seritë e analizuara (burimi *UNCOMTRADE*) për importin total të këtyre produkteve përfaqësojnë totalin e importeve botërore si partner tregtar. Synimi është të analizohen avantazhet krahasuese të demonstruara nga katër kategoritë kryesore të eksporteve shqiptare drejt botës.

Grafik 9. Indeksi i avantazhit krahasues të eksporteve shqiptare me botën



Burimi: Përllogaritjet e autorit duke përdorur të dhëna nga UN Comtrade Database.

Indeksi i avantazheve krahasuese të demonstruara i eksporteve shqiptare drejt botës tregon se për eksporte e "tekstile dhe këpucë" të eksporteve shqiptare kanë avantazh konkurrues, të krahasuara me vendet e tjera të botës. Indeksi shënon vlera mbi 1, duke treguar avantazh konkurrues të këtyre eksporteve. Megjithatë, vlerat e këtij indeksi për eksportet "tekstile dhe këpucë" kanë shfaqur trend rënës prej vitit 2006 deri më 2012. Indeksi i eksporteve të "minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" ishin nën vlerën 1 deri në vitin 2008, duke mos shfaqur ndonjë avantazh krahasues të kësaj kategorie eksportesh. Megjithatë, nga 2009 e në vazhdim, indeksi shfaq vlera mbi 1, duke treguar avantazh krahasues të këtyre eksporteve drejt botës.

Indeksi tregon vlera mbi 1 përgjatë 2005 - 2012 edhe për eksportet e kategorisë "materiale ndërtimi dhe metale". Pra, ekonomia shqiptare përsëri paraqet avantazh krahasues në eksportin e materialeve të ndërtimit dhe metaleve drejt botës.

Indeksi tregon të kundërtën përsa i përket avantazhit krahasues të eksporteve të kategorisë "ushqim, pije, duhan" (kategoria e katërt për nga rëndësia e grupmallrave të eksporteve shqiptare jashtë). Edhe pse vlera e këtij indeksi kanë qenë mbi 1 për vitet 2005 - 2006, ky indeks ka rënë nën këtë vlerë për vitet në vazhdim, duke shfaqur më pak avantazhe krahasuese nga kjo kategori eksportesh.

Duke qenë se Italia përbën partnerin kryesor tregtar të vendit tonë dhe se eksportet kryesore drejt këtij partneri janë kategoria e tekstileve dhe këpucëve, ky artikull gjithashtu analizoi specializimin e ekonomisë shqiptare në këtë

Grafik 10. Indeksi i specializimit në tekstile dhe këpucë



Burimi: Përllogaritjet e autorit duke përdorur të dhëna nga UN Comtrade Database.

sektor eksportesh. Ashtu siç vërehet edhe nga grafiku i mësipërm, duket se ekonomia shqiptare është e specializuar në eksportimin e grupmallrave tekstile dhe këpucë, megjithatë trendi i indeksit shfaqet në rënie.

4. PËRMBLEDHJE DHE PËRFUNDIME

Bilanci tregtar gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri është karakterizuar nga dominimi i importeve. Prej vitit 2008 e në vazhdim, deficiti tregtar ka shfaqur shenja të qëndrueshme përmirësimi, të ndikuara ndjeshëm nga rritja e eksporteve. Analizat tregojnë se mbas vitit 2008 eksportet shqiptare kanë ndryshuar destinacion, duke gjetur partnerë të rinj tregtarë si Turqia, Kosova dhe Spanja, dhe duke reduktuar eksportet drejt Greqisë (vend i përballur fuqishëm me krizën ekonomike).

Eksportet drejt Turqisë dhe Spanjës janë të fokusuara vetëm në 1 apo 2 kategori kryesore grupmallrash - "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" dhe "materiale ndërtimi dhe metale" - duke mos pasur një shpërndarje të mirë të eksporteve drejt këtyre partnerëve tregtarë. Eksportet drejt Kosovës duken të mirëshpërndara në disa kategori grupmallrash dhe me një tendencë të qëndrueshme rritëse.

Eksportet drejt Italisë kanë vazhduar të rriten, duke bërë që Italia të vazhdojë të mbetet partneri kryesor tregtar për Shqipërinë (edhe pse pesha e eksporteve drejt Italisë, në raport me totalin e eksporteve, ka rënë mbas vitit 2008).

Rritja e totalit të eksporteve është ndikuar nga kategoria e grupmallrave, "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike", e cila, në 2012, u shndërrua në kategorinë dominuese të eksporteve vendase.

Indeksi i avantazheve krahasuese të demonstruara tregon se ekonomia shqiptare paraqet avantazhe krahasuese në të paktën tre nga katër grupmallrat kryesore të eksportuara.

Gjithashtu, indeksi i specializimit në eksporte sugjeron se Shqipëria është e specializuar në eksportin e kategorisë "tekstile dhe këpucë" drejt partnerit kryesor tregtar, Italisë.

REFERENCAT

Balassa, B. (1965), "Trade liberalization and Revealed Comparative Advantage", The

Manchester School of Economic and Social Studies 33: 92-123

Batra & Khan (2005), "Revealed comparative advantage: An analysis for India & China"

Bernatonyte & Normantiene (2009), "Estimation of Trade Specialization: the Case of the Baltic States"

Bernatonyte (2011), "Export productivity and specialization patterns of Lithuania"

Latruffe (2010), "Competitiveness, Productivity and Efficiency in the Agricultural and AgriFood Sectors" OECD

Leromain & Orefice (2013), "New Revealed Comparative Advantage Index: dataset and empirical distribution"

Mikic (2005), "Introduction to trade research II: Trade data and statistics; commonly used trade indicators", ARTNeT Capacity Building Workshop on Trade Research, March 2005 UNESCAP

INSTAT (2014), "Të punësuar gjithsej sipas aktivitetit ekonomik (NVE) sipas Aktiviteti ekonomik"

UN Comtrade Database (2013-2014)

Utkulu & Seymen (2004), "Revealed Comparative Advantage and Competitiveness: Evidence for Turkey vis-à-vis the EU/15"

BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR KORRIK-DHJETOR 2013

Mbi vizitën zyrtare të Presidentit të Bankës Qendrore të Gjermanisë, z. Jens Weidmann, pranë Bankës së Shqipërisë

Në datën 21 gusht 2013, me ftesë të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, Presidenti i Bankës Qendrore të Gjermanisë (Bundesbank), z. Jens Weidmann, zhvilloi një vizitë zyrtare pranë Bankës së Shqipërisë.

Në takimin me anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe drejtuesit e departamenteve të Bankës së Shqipërisë, z. Weidmann diskutoi rreth zhvillimeve më të fundit në vend, në rajon dhe në Eurozonë.

Guvernatori Fullani e njohu Presidentin Weidmann me ecurinë e ekonomisë shqiptare dhe veçanërisht me zhvillimet në sistemin bankar. Ai prezantoi masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për forcimin e kushteve makroekonomike dhe garantimin e stabilitetit financiar të vendit. Gjithashtu, ai e njohu homologun gjerman me punën e Bankës së Shqipërisë për plotësimin e kritereve ligjore dhe ekonomike që burojnë nga kuadri i përafrimit me Bashkimin Evropian, si dhe me përpjekjet e saj për të nisur dhe nxitur bashkëpunimin rajonal ndërmjet bankave qendrore të rajonit.

Presidenti Weidmann vlerësoi punën e Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit.

Bundesbank është ofruese e rëndësishme e asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë, ndërkohë që Presidenti Weidmann u shpreh për një rritje të mëtejshme të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet institucioneve.

Mbi paketën e re mësimore "1, 2, 3… derrkuci Çufo mëson të kursejë"

Në çeljen e vitit shkollor 2013-2014, Banka e Shqipërisë prezantoi paketën mësimore "1, 2, 3… derrkuci Çufo mëson të kursejë".

Kjo paketë i dedikohet edukimit financiar të nxënësve që ndjekin klasën I, II dhe III, të shkollës 9-vjeçare. Ajo pritet të përdoret në orët e lira mësimore, në orët dedikuar projekteve shkollore apo si projekt ndërlëndor.

Teksti i paketës mësimore "1, 2, 3… derrkuci Çufo mëson të kursejë", është ideuar dhe hartuar në përputhje me praktikat më të mira didaktike për fëmijët e grupmoshës 7 deri në 9 vjeç. Tematikat e trajtuara në të janë përzgjedhur në mënyrë që të përputhen me eksperiencën e përditshme të nxënësve me paranë dhe financat personale.

Materialet e përfshira në paketë janë përgatitur nga Banka e Shqipërisë me bashkëpunimin e autorit të mirënjohur të librave për fëmijë, Gaqo Bushaka, i cili ka vendosur në dispozicion të bankës personazhet e veprës së tij "Çufo dhe bubi Kaçurrel".

Paketa mësimore përbëhet nga libri me përrallëza "1, 2, 3... derrkuci Çufo mëson të kursejë", nga fletët e punës, si dhe nga udhëzuesi për mësuesit.

Qëllimi i këtyre materialeve është edukimi financiar i nxënësve të klasave I, II dhe III, për të nxitur te ata ndjenjën e kujdesit ndaj parasë, dëshirën për të kursyer, si dhe të menduarit aktiv mbi paranë dhe çmimet.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës vendosi të zhvillojë projektin në 30 shkolla 9-vjeçare pilot, fillimisht në qytetet Tiranë, Vlorë e Shkodër. Ajo u mundësohet të gjithë nxënësve tërësisht falas.

Mbi konferencën me temë "Forcimi i lidhjeve në Evropën Juglindore. Ankorat politike dhe perspektivat e biznesit"

Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Universitetin e Oksfordit, organizoi në datë 19 shtator 2013, konferencën me temë: "Forcimi i lidhjeve në Evropën Juglindore. Ankorat politike dhe perspektivat e biznesit".

Në këtë konferencë ishin të pranishëm Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, përfaqësues nga rrethet akademike në vend, në rajon, e më gjerë, përfaqësues nga sistemi bankar, institucione shtetërore, organizma ndërkombëtarë në Shqipëri, si dhe nga Banka e Shqipërisë. Kjo konferencë u organizua si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bankës së Shqipërisë dhe Universitetit të Oksfordit.

Temat kryesore që u diskutuan gjatë punimeve të konferencës u përqendruan kryesisht mbi zhvillimet më të fundit ekonomiko-financiare ne vendet e rajonit, si dhe sfidat me të cilat këto ekonomi po përballen. Gjatë konferencës Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Fullani, nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me përfaqësuesin e Universitetit të Oksfordit, z. Othon Anastasakis, për një periudhë tjetër trevjeçare.

Marrëveshjen e parë me Universitetin e Oksfordit, Banka e Shqipërisë e nënshkroi në shtator të vitit 2010. Qëllimi i bashkëpunimit është kryerja e kërkimeve shkencore për nxitjen dhe thellimin e njohurive mbi politikat ekonomike dhe sfidat me të cilat përballet Shqipëria dhe rajoni, si dhe vlerësimi i mundësive politike për nxitjen e rritjes së qëndrueshmërisë ekonomike në rajon, si dhe integrimi në Bashkimin Evropian.

Mbi takimin teknik për nxitjen e bashkëpunimit rajonal në kuadër të Nismës së Vjenës 2.0

Në datën 3 tetor 2013, Banka e Shqipërisë organizoi një takim teknik për nxitjen e bashkëpunimit rajonal në kuadër të Nismës së Vjenës 2.0, ku ishin të ftuar drejtues nga banka qendrore të rajonit dhe më gjerë.

Gjatë takimit, pjesëmarrësit diskutuan mbi efektet e uljes së levës financiare (deleveraging) në vendet e rajonit, mekanizmat që duhen zbatuar për të rikthyer mbështetjen e huadhënies ndaj ekonomisë së këtyre vendeve, si dhe rolin që autoritetet e Bashkimit Evropian dhe grupet bankare duhet të luajnë në këtë kontekst. Diskutimet u fokusuan dhe mbi efektet që pritet të ketë në ekonomitë e rajonit, kuadri i ri mbikëqyrës i Bashkimit Evropian. Në këtë aspekt, pjesëmarrësit i kushtuan një rëndësi të veçantë rritjes së bashkëpunimit ndërmjet vendeve pritëse jashtë Bashkimit Evropian, si dhe forcimit të aftësive të tyre negociuese kundrejt autoriteteve të Bashkimit Evropian.

Në fillim të vitit 2013, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, u zgjedh anëtar i Komitetit Drejtues të Nismës së Vjenës 2.0.

Në kushtet kur Shqipëria është i vetmi vend joanëtar i Bashkimit Evropian, me anëtarësi në Komitetin Drejtues të Nismës së Vjenës, ajo është angazhuar të përfaqësojë në këtë nismë edhe interesat e vendeve të tjera joanëtare, me shtrirje gjeografike në Evropën Qendrore dhe veçanërisht në atë Juglindore.

Nisma e Vjenës 2.0 vijon aktivitetin e saj mbi suksesin e Nismës së Vjenës 1.0, krijuar në kulmin e krizës financiare globale të periudhës 2008/2009. Ajo vazhdon të përdorë platformën privat-publik, që mbledh institucione financiare ndërkombëtare të rëndësishme, Komisionin Evropian dhe institucione të tjera të BE-së, grupet bankare ndërkombëtare kryesore, si dhe autoritetet e vendeve të origjinës dhe pritëse, në plotësim të nismave të tjera.

"Banka për Shqipërinë është i dyti fitim, pas lirisë.." - 100 vjet rrugëtim i bankingut qendror shqiptar

Banka e Shqipërisë kremtoi këtë vit një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e bankingut qendror të vendit tonë: 100 vjetorin e nënshkrimit të aktit të parë koncesionar për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqypërisë.

Me këtë rast, në datë 4 tetor 2013, Banka e Shqipërisë organizoi ekspozitën me vlera numizmatike: "...Banka për Shqipërinë është i dyti fitim, pas lirisë...".

100 vjet më parë, më 4 tetor 1913, themeluesi i shtetit modern shqiptar, Ismail Qemal bej Vlora, nënshkroi në emër të qeverisë shqiptare, koncesionin e parë për krijimin e një banke kombëtare shqiptare. Marrëveshja e koncesionit u nënshkrua me përfaqësuesit e dy prej grupeve financiare më të mëdha të kohës austriake-hungareze dhe italiane. Hartimi i këtij koncesioni shënon gurin e themelit në ndërtimin e bankingut qendror shqiptar.

Ekspozita e çelur në kujtim të kësaj date të rëndësishme historike synoi të njohë publikun me rrugëtimin e parasë në trojet shqiptare dhe historinë e formimit të institucionit të bankës qendrore në vendin tonë.

Përveç materialeve historike mbi bankingun qendror dhe shumëllojshmërisë së monedhave dhe kartëmonedhave tona kombëtare, në ekspozitë u paraqitën dhe nismat më të fundit të Bankës së Shqipërisë të ndërmarra në kuadër të edukimit financiar të publikut.

Ekspozita u çel nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, në praninë e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, si dhe të stërnipit të Ismail Qemal Bej Vlorës, z. Nedim Vlora. Të ftuar në këtë aktivitet qenë përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në vendin tonë, të sektorit bankar, të studiuesve të fushës, të medias dhe të publikut të gjerë.

Mbi prezantimin e platformës për adresimin e kredive me probleme

Banka e Shqipërisë, në vazhdën e një sërë iniciativash ligjore dhe rregullative me synim uljen e numrit të kredive me probleme dhe nxitjen e procesit të kreditimit në vend, në 16 tetor 2013, zhvilloi një tryezë diskutimi mbi prezantimin e platformës për adresimin e kredive me probleme, me pjesëmarrjen e drejtuesve të sistemit bankar në Shqipëri dhe përfaqësuesve të Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Platforma u hartua nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrën Këshilluese të Sektorit Financiar (FinSAC) të Bankës Botërore me qendër në Vjenë. Qëllimi i kësaj platforme është adresimi dhe përmirësimi i kredive me probleme.

Bashkëpunimi i ngushtë me ekspertët e Qendrës Këshilluese të Sektorit Financiar synon një ristrukturim më të thellë dhe profesional, e përmirësim të administrimit të kredive me probleme. Qendra Këshilluese e Sektorit Financiar (FinSAC) është themeluar nga Banka Botërore dhe ka për qëllim të ofrojë asistencë teknike lidhur me çështje të rregullimit dhe të mbikëqyrjes së sektorit financiar, për bankat qendrore dhe rregullatorët financiarë në Evropë dhe në Azinë Qendrore.

Mbi takimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, me gazetarë, analistë dhe drejtues të mediave

Në datë 20 dhjetor 2013, me rastin e mbylljes së vitit, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, zhvilloi një takim me gazetarë të medias të shkruar dhe asaj elektronike, analistë të politikës dhe të ekonomisë, drejtues dhe përfaqësues të tjerë të mediave në Shqipëri.

Takimi u çel me fjalën e mbajtur nga Guvernatori Fullani, i cili iu përcolli të pranishmëve urimet më të përzemërta për një vit sa më të mbarë dhe të suksesshëm, si dhe vlerësoi rolin e gazetarëve dhe kontributin e tyre në përmbushjen e mandatit kryesor të Bankës së Shqipërisë, ruajtjes dhe garantimit të stabilitetit të çmimeve.

Gjatë takimit të fundvitit me median, Guvernatori Fullani prezantoi dhe kalendarin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2014, kushtuar produkteve bujqësore, duke theksuar rëndësinë që ka për ekonominë e vendit zhvillimi i sektorit të bujqësisë.

Në përfundim të aktivitetit, Guvernatori Fullani ndau tre çmimet për fituesit e konkursit të hapur "Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë" 2013, të vlerësuar si më poshtë:

Çmimi i parë iu dha zj. Eda Dokle, nga Universiteti Charles, Republika Çeke, për temën e saj të masterit "Inflacioni i shënjestruar në ekonomi të dollarizuara".

Çmimi i dytë iu dha z. Minella Kalluci, nga Universiteti i Boconit, Itali, për temën e tij të diplomës "Kritikat kryesore të agjencive të rankingut të kredive dhe përcaktuese të ratingut të borxhit sovran: Evidencë nga Eurozona".

Çmimi i tretë iu dha z. Ergi Take, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, për temën e tij të diplomës "Mbi vlefshmërinë e Ligjit të Okun-it në ekonominë shqiptare (1980-2012)".

Ky konkurs i përvitshëm i dedikohet studentëve shqiptarë të diplomuar gjatë vitit, brenda dhe jashtë vendit, për punë kërkimore-shkencore në çështje të lidhura me ekonomiksin monetar e ndërkombëtar, stabilitetin e çmimeve

dhe atë financiar, integrimin ekonomik të vendeve të Ballkanit në Evropë, veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, mbi sistemin financiar shqiptar, rolin dhe sjelljen e bankave në ekonominë shqiptare, si dhe çështje që kanë të bëjnë me aspekte të tjera makro dhe mikroekonomike të ekonomisë në përgjithësi.

Seminari i të Premtes

Departamenti i Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë organizon dy herë në muaj "Seminarin e së Premtes". Kjo nismë fton nëpunësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare dhe kërkimore, të prezantojnë dhe të diskutojnë materialet e tyre kërkimore, teorike dhe empirike.

Gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2013, në aktivitetin "Seminari i së Premtes", janë prezantuar 6 punime nga punonjësit e Bankës së Shqipërisë dhe pjesëmarrësit e ardhur nga bota akademike.

Materialet e prezantuara në aktivitetin kërkimor shkencor kanë trajtuar çështje të ndryshme me në qendër të analizës efektin e goditjeve në ciklet e biznesit dhe në trendin e rritjes ekonomike, inovacionin financiar, sjelljen e investitorëve në tregun primar të letrave me vlerë, inflacionin e importuar, ndikimin e tij në inflacionin kombëtar etj.

"Seminari i së Premtes" për 6-mujorin e dytë të vitit 2013, u hap me një punim të Bledar Hodës nga Departamenti i Kërkimeve me temë: "Efekti i goditjeve nominale në ciklet e biznesit dhe në trendin e rritjes ekonomike". Luhatshmëria e prodhimit dhe tendenca afatgjatë në të ardhurat për frymë, kanë qenë kohët e fundit në fokus të politikëbërjes në të gjithë botën. Identifikimi i rolit të goditjeve nominale, monetare apo të goditjeve mbi normat e interesit, në zbutjen e cikleve të biznesit është duke u kthyer në një temë që zgjon mjaft interes. Fokusi kryesor i këtij studimi është ndikimin i goditjeve monetare apo i normave të interesit në prodhim dhe tregues të tjerë të llogarive kombëtare, si një mjet i stabilizimit të ciklit të biznesit. Punimi synon të ngrejë një sistem të përbërë nga raporti konsum/prodhim dhe ai investim/prodhim, si dhe një funksion të kërkesës për para në një model me tre ekuacione. Ndërsa, goditjet monetare dhe të normave të interesit janë përdorur si faktorë potencialë alternativë për të shpjeguar lëvizjet e treguesve të sektorit real. Gjetjet identifikojnë masën në të cilën secili tregues nominal mund të përdoret për të ndikuar këto të fundit.

Prezantimi tjetër i mbajtur në këtë seminar është ai me temë: "Financimi i inovacionit dhe inovacioni në financë", nga Grid Thoma, Asistent Profesor për Ekonomi dhe Administrim pranë Universitetit të Camerinos, Itali. Ky studim analizon të dhënat e përftuara nga procesi i regjistrimit të patentave financiare në Evropë, numri të cilave ka ardhur në rritje paralelisht me ndryshimet domethënëse në sistemin financiar dhe atë të pagesave. Duke bërë një analogji me patentat jofinanciare, me të dhëna të marra nga Zyra Evropiane e Patentave (EPO), analiza ndjek ecurinë e vlerës së tregut të patentave financiare në dinamikë. Autorët gjejnë se firmat që veprojnë në sektorët jofinanciarë dhe që kanë një portofol patentash të diversifikuar,

zotërojnë një pjesë të madhe të patentave në EPO, ndërkohë që evoluimi i tyre ngjason me zhvillimet në tregun amerikan të patentave. Gjetjet e studimit ofrojnë një informacion të vlefshëm për menaxherët e pronës intelektuale mbi inovacionet financiare dhe patentat.

Një tjetër prezantim i mbajtur në këtë seminar ishte ai me temë: "Analizë e sjelljes së investitorëve në tregun primar të letrave me vlerë", nga Elisa Pazaj, Departamenti i Operacioneve Monetare. Ky material synon të paraqesë evidencat empirike mbi mënyrën e reagimit të investitorëve ndaj zhvillimeve të ndryshme në tregun primar të letrave me vlerë. Bazuar në të dhëna të detajuara mbi kërkesa të dorëzuara në ankande, gjatë periudhës janar 2010 - dhjetor 2012, rezultatet e kësaj analize tregojnë se pasiguria në treg shoqërohet me yield-e më të larta për bonot e thesarit. Gjithashtu, rezultatet tregojnë se sjellja e investitorëve në formate të ndryshme ankandesh është shumë e ndryshme.

"Zbatueshmëria e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në vendet në zhvillim, rasti i Shqipërisë", është një tjetër prezantim i mbajtur nga Dr. Dritan Fino, pedagog pranë Universitetit "Marin Barleti". Ky material synon të analizojë zbatueshmërinë e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar në vendet në zhvillim, si dhe rolin që ato luajnë në zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve. Materiali bën një përshkrim të avantazheve dhe disavantazheve që mund të sjellë adaptimi i këtyre standardeve dhe njëkohësisht të sfidave, me të cilat ndeshet sistemi i kontabilitetit në Shqipëri. Autori arrin në përfundimin se raportet financiare të përgatitura mbi bazën e standardeve ndërkombëtare japin informacion më të besueshëm, që lehtëson vendimmarrjen financiare. Rrjedhimisht, vendi ynë duhet të përfitojë nga zbatimi i tyre, por duke mbajtur parasysh mjedisin dhe fazën përkatëse të zhvillimit ekonomik. Adaptimi i standardeve ndërkombëtare në Shqipëri do të rriste krahasueshmërinë, transparencën dhe përgjegjshmërinë e informacionit financiar të raportuar, por ky është një proces i vështirë dhe varet së tepërmi edhe nga aftësia e autoriteteve kombëtare të kontabilitetit.

Një material tjetër i prezantuar është ai me temë: "Inflacioni i importuar i mallrave të konsumit dhe kontributi në inflacionin e Shqipërisë", nga Lorena Skufi dhe Enian Çela, Departamenti i Kërkimeve. Duke qenë një ekonomi e vogël e hapur, vlerësohet se Shqipëria ndikohet nga presionet e huaja inflacioniste, të cilat veprojnë në inflacionin e përgjithshëm të vendit. Materiali synon të kuantifikojë inflacionin e importuar për një kampion mallrash konsumi, të cilët përbëjnë 60% të shportës së IÇK-së (indeksit të çmimit të konsumit). Gjithashtu, studimi përpiqet të dekompozojë inflacionin total të shportës së IÇK-së, sipas kontributeve të brendshme dhe të jashtme, duke zbatuar metoda kontabiliste për periudhën 2008-2012. Rezultatet shfaqin kontribute të vogla të inflacionit të importuar.

Materiali përmbyllës i serive të "Seminarit të së Premtes" për 6-mujorin e dytë të vitit 2013, është ai me temë: "Si të shkruajmë dhe të vlerësojmë një artikull akademik", nga Margerita Topalli, Departamenti i Kërkimeve. Materiali trajton, në vija të përgjithshme, mënyrën se si realizohet procesi

i një kërkimi shkencor, në të gjitha fazat e tij, si dhe mënyrën e të shkruarit të një punimi kërkimor. Në fokus të materialit të prezantuar është njohja me procedurat e publikimit të një punimi, fazën e publikimit dhe procesin e rishikimit të tij, procese këto që zgjasin nga disa muaj deri në 2-3 vjet.

VENDIMET E POLITIKËS MONETARE

31 korrik 2013

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindjeje normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjellta).

Norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga 3.75 për qind bëhet 3.50 për qind.

28 gusht 2013

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjellta), në nivelin 3,50 për qind.

25 shtator 2013

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjellta), në nivelin 3,50 për qind.

30 tetor 2013

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjellta), në nivelin 3,50 për qind.

27 nëntor 2013

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindjeje, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjellta).

Norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga 3.50 për qind bëhet 3.25 për qind.

16 dhjetor 2013

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindjeje, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjellta).

Norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga 3.25 për qind bëhet 3.0 për qind.

NGJARJET JURIDIKE, GJASHTËMUJORI II 2013

POLITIKA MONETARE

Në datën 31.07.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 46 "Deklaratën e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013". Sipas kësaj deklarate, muajt e parë të vitit 2013 kanë dëshmuar për rritje të ngadaltë të ekonomisë shqiptare dhe për presione të ulëta inflacioniste. Aktiviteti ekonomik në vend vazhdon të vuajë nga ecuria e dobët e kërkesës agregate. Inflacioni i tremujorit të dytë rezultoi mesatarisht në nivelin 2.2%, duke u reduktuar në krahasim me tremujorin e parë. Të dhënat e INSTAT-it tregojnë se rritja ekonomike e tremujorit të parë rezultoi rreth 1.7%, duke mbetur në linjë me nivelin e regjistruar në fundin e vitit të kaluar. Projeksionet e Bankës së Shqipërisë për ecurinë e ekonomisë në të ardhmen mbështesin vlerësimin për një rritje të ngadaltë të aktivitetit ekonomik gjatë tremujorëve në vazhdim, në nivele të krahasueshme me ato të gjysmës së parë të vitit.

Në datën 31.07.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 47 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes". Nëpërmjet këtij vendimi, Banka e Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindje normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, nga 3.75 në 3.50 për qind.

Në datën 30.10.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 61 "Raportin e politikës monetare për tremujorin e tretë të vitit 2013". Sipas këtij raporti, ekonomia shqiptare është karakterizuar nga rritja e ngadaltë ekonomike dhe nga presione të ulëta inflacioniste gjatë vitit 2013. Rritja ekonomike u ngadalësua në 1,1% në tremujorin e dytë të vitit, ndërkohë që informacionet e disponuara sugjerojnë për një aktivitet të dobët ekonomik edhe gjatë tremujorit të tretë. Konsumi dhe investimet e sektorit privat vlerësohen të kenë pasur një ecuri të dobët, ndërsa kërkesa e huaj ka vijuar të frenohet nga situata ekonomike e partnerëve tanë tregtarë. Pasiguria e agjentëve privatë mbi të ardhmen është reflektuar në gatishmëri të ulët për të shpenzuar dhe në kërkesë të ulët për kredi. Gjithashtu, edhe politikat konservatore të sistemit bankar kanë ruajtur kushte të shtrënguara kreditimi dhe kanë penguar funksionimin normal të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare.

Në datën 27.11.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 78 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes

dhe të anasjellta të riblerjes". Nëpërmjet këtij vendimi, Banka e Shqipërisë ul me 0.25 pikë përqindje normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjellas), e cila nga 3.50 për qind bëhet 3.25 për qind.

Në datën 16.12.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 81 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes". Nëpërmjet këtij vendimi, Banka e Shqipërisë ul me 0.25 pikë përqindje normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, nga 3.25 në 3.00 për qind.

MBIKËQYRJA BANKARE

Në datën 31.07.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 48 rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit". Kjo rregullore ka për synim të përcaktojë kriteret dhe rregullat për llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të nivelit minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë. Sipas rregullores, Bankat llogarisin mjaftueshmërinë e kapitalit si raport ndërmjet shumës së kapitalit rregullator me shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, e shprehur në përqindje, në baza individuale dhe të konsoliduara. Ato sigurojnë që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, i llogaritur sipas kritereve të përcaktuara në rregullore, të jetë jo më i vogël se 12%.

Në datën 28.08.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 55 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit". Ndryshimet e parashikuara në këtë vendim, prekin nenet e rregullores që rregullojnë procedurat dhe dokumentacioni për identifikimin e klientit për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, strukturat përgjegjëse të subjekteve, raportimin tek autoritetet përgjegjëse lidhur me këto lloj aktivitetesh etj.

Në datën 30.10.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 63 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Raiffeisen sh.a". Nëpërmjet këtij vendimi, Banka e Shqipërisë i jep Bankës Raiffeisen sh.a. miratimin paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime.

Në datën 30.10.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 64 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.". Nëpërmjet këtij vendimi, Banka e Shqipërisë i jep Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a. miratimin paraprak për kryerjen e veprimtarive financiare shtesë të ofrimit të garancive dhe marrjen e angazhimeve, si dhe veprimtarinë e tregtimit për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë edhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar ose ndryshe letra me vlerë të transferueshme.

EMISIONI

Në datën 31.07.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 49 "Rregulloren për trajtimin e kartëmonedhave dhe të monedhave euro e të tjera të huaja të dyshuara si të falsifikuara". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave të huaja, të dyshuara si të falsifikuara, me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen nga falsifikimi. Subjekte të kësaj rregulloreje janë Banka e Shqipërisë, bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë.

Në datën 31.07.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 50 "Për miratimin e një ndryshimi në rregulloren "Për eksport-importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare". Ndryshimi i parashikuar në këtë vendim prek nenin 6 të rregullores, nen i cili përcakton rastet në të cilat lejohet eksporti i monedhave shqiptare me kurs ligjor jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në datën 11.09.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 57 rregulloren "Për këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dëmtuara". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kritereve dhe procedurave për këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dëmtuara dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi. Subjekte të saj janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë.

Në datën 11.09.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 58 rregulloren "Mbi punën për këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave të dëmtuara". Nëpërmjet miratimit të kësaj rregulloreje synohet përcaktimi i rregullave dhe procedurave për këmbimin e kartëmonedhave të dëmtuara në Bankën e Shqipërisë. Në nenet e saj përcaktohen kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësohen për këmbimin, analiza teknike, vlerësimi dhe komisioni, etj.

Në datën 25.09.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 60 "Për ekspozimin e monedhave me metal të çmuar në ekspozitat që do të organizojë Banka e Shqipërisë". Nëpërmjet këtij vendimi miratohet ekspozimi i vlerave numizmatike, për monedhat nga fondi numizmatik prej ari dhe argjendi, në ekspozitat që do të organizojë Banka e Shqipërisë në kuadër të përkujtimit të 100-vjetorit të nënshkrimit të koncesionit bankar për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, më 4 tetor 2013.

Në datën 16.12.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 82 "Për një ndryshim në rregulloren "Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare". Nëpërmjet këtij ndryshimi, afati i përshtatjes së makinerive të trajtimit të kartëmonedhave

të instaluara përpara hyrjes në fuqi të rregullores për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara prej saj, shtyhet nga jo më vonë se 9 muaj, në jo më vonë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e saj.

STABILITETI FINANCIAR

Në datën 11.09.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 56 "Raportin mbi stabilitetin e sistemit financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013". Sipas këtij raporti, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013, gjendja dhe ecuria e sektorit bankar dhe e sistemit financiar u paraqit e qëndrueshme. Treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë bankare ishin në nivele të kënaqshme, ndonëse fitimi i veprimtarisë ishte në nivele më të ulëta. Vëllimi i aktivitetit vijoi të ngadalësohej në kushtet e rritjes më të ngadaltë të depozitave dhe rritjes së dobët të kreditimit. Cilësia e portofolit të kredisë ka vijuar të përkeqësohet dhe një pjesë e rëndësishme e fitimit operativ të sektorit ka shkuar për krijimin e fondeve të nevojshme rezervë për mbrojtjen nga rreziku i kredisë. Vëllimi i aktiveve të institucioneve financiare u rrit me rreth 2.1% krahasuar me një gjashtëmujor më parë, dhe rreth 5.1% krahasuar me një vit më parë. Sektori bankar mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar, aktivet e të cilit përfaqësojnë rreth 92.6% të totalit të aktiveve të sistemit financiar në tërësi dhe rreth 88.9% të PBB-së.

OPERACIONET MONETARE

Në datën 30.10.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 66 "Për një ndryshim në rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimit valutor". Ndryshimi i parashikuar në këtë vendim prek nenin 16 të rregullores, nëpërmjet të cilit rregullohet njoftimi dhe publikimi i ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor.

POLITIKA EKONOMIKE

Në datën 03.07.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 573 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi". Me miratimin e këtij vendimi, paga bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, e detyrueshme të zbatohet për çdo person juridik a fizik, vendas apo të huaj, të jetë 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë. Kjo pagë jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Ndërsa, paga bazë minimale orare do të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë.

Në datën 10.07.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 591 "Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013". Ky vendim parashikon, ndër të tjera, ngurtësimin e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes të njësive të qeverisjes qendrore në masën 20%, si dhe reduktimin e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta jashtë vendit për njësitë e

qeverisjes së përgjithshme, duke financuar vetëm udhëtimet e rëndësisë së veçantë.

Në datën 17.07.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 583 "Për rritjen e pensioneve". Ky vendim parashikon rritjen me 4% të kategorive të pensioneve që rregullohen përmes ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe të ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, rritje në të njëjtën masë përfitojnë pensionet e posaçme shtetërore dhe shtesat mbi to, shtesat mujore të përftuara nga invalidët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë, pensionet e caktuara për trajtimin e ushtarakëve, trajtimeve të veçanta financiare për kategori të ndryshme të forcave të armatosura etj.

Në datën 17.07.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 663 "Strategjinë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe të terrorizmit, 2013-2020, dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016". Strategjia ka si qëllim të konsolidojë përparimin e bërë në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, të arritura deri tani, si dhe të përcaktojë politikat, prioritetet strategjike në këtë fushë, objektivat e institucioneve shtetërore që marrin detyrime në të, si dhe ngrejë në një shkallë më të lartë koordinimin ndërinstitucional të punës për arritje e objektivave strategjike për vitet 2013-2020.

Në datën 17.07.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 581 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"". Ky vendim parashikon, ndër të tjerë, që paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, nga muaji gusht e në vazhdim, të jetë jo më pak se 19 130 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë. Ndërsa, shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, duke nisur nga kjo periudhë, të jetë 5 308 (pesëmijë e treqind e tetë) lekë.

Në datën 17.07.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 600 "Statusin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë". Sipas përcaktimeve të këtij vendimi, Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor është person juridik publik, autonom, me qendër në Tiranë dhe me zyra vendore në të gjithë territorin. Ai ofron dhe administron i vetëm sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, duke qenë organ i specializuar financiar që menaxhon skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.

Në datën 24.07.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 640 raportin vjetor "Për ndihmat shtetërore të vitit 2012". Në këtë raport

paraqiten të dhëna dhe informacione të detajuara të ndihmës shtetërore lidhur me dhënësin, përfituesit, si dhe vlerën për secilën kategori të ndihmës, me përjashtim të sektorëve të bujqësisë dhe të peshkimit, të cilët janë jashtë fushës së zbatimit të ligjit mbi ndihmën shtetërore. Vlera e ndihmës shtetërore të dhënë në Shqipëri, gjatë viteve 2007-2012, është 83 523,75 milionë lekë (≈631 milionë €). Ndihma shtetërore për vitin 2012, duke përfshirë të gjithë sektorët, arrin në vlerën 21 480,77 milionë lekë (154,49 milionë €), të barabarta me 1,6% e të PBB-së të vendit. Në raport janë pasqyruar edhe të dhënat për ndihmën shtetërore për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, në mënyrë që të analizohet ecuria e kategorive të ndryshme të ndihmës.

Në datën 30.07.2013, Ministria e Financave miratoi udhëzimin nr. 23 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.6.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar". Ndryshimet prekin tabelën e tatimit mbi të ardhurave personale nga punësimi, si dhe nenin që rregullon të ardhurat e përjashtuara nga tatimi. Kështu, pas miratimit të këtij vendimi, ndër të tjera, do të konsiderohen të ardhura të përjashtuara të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për familjet dhe individët pa të ardhura apo me të ardhura të ulëta; bursat e nxënësve dhe studentëve, pavarësisht nga burimi i financimit, sipas specifikimeve; shpërblimet e marra për rastet e sëmundjeve apo fatkeqësive etj.

Në datën 31.07.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 636 "Marrëveshjen e grantit suedez nr. TF014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBDR), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Suedia, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes". Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), që vepron si administrator i fondeve të dhëna nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) (Donatori), propozon dhënien e një granti në një shumë që nuk kalon 4,675,000 $ (katër milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë dollarë amerikanë) me qëllim bashkëfinancimi i një projekti për burimet ujore dhe ujitjes.

Në datën 31.07.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 712 "Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë". Ky vendim ka për qëllim sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet tij përcaktohen rregullat, kriteret dhe procedurat për aplikimin për leje peshkimi, mënyra e zhvillimit të konkurrimit publik, si dhe zbatimi korrekt i kushteve të dhënies së lejes.

Në datën 23.08.2013, Ministria e Financave miratoi udhëzimin nr. 8/2 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 "Për taksat

kombëtare", të ndryshuar". Ky ndryshim parashikon që, në rastin kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin që ai ka nxjerrë nga nëntoka apo nënproduktin e prodhuar nga ky mineral, ai paguan taksën e rentës minerare në çastin e bërjes së deklaratës doganore. Po ashtu, kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin e nxjerrë nga miniera apo nënproduktin e prodhuar nga ky mineral, nëpërmjet një subjekti tjetër të vetëm eksportues, renta paguhet si nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, ashtu edhe nga eksportuesi.

Në datën 18.09.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 833 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë". Sipas këtij vendimi, Ministria e Energjisë dhe Industrisë harton dhe zbaton politika që synojnë garantimin e furnizimit me energji të vendit, shfrytëzimin e burimeve energjetike e minerare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe dobishmërisë publike, si dhe nxitjen e zhvillimit industrial me standarde sa më miqësore për mjedisin. Ajo ushtron veprimtarinë e saj në fusha përgjegjësie shtetërore, në sektorin e energjisë elektrike, atë të hidrokarbureve (naftë dhe gaz), të minierave dhe gjeologjisë, si dhe të industrisë joushqimore.

Në datën 18.09.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 835 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes". Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën ekonomike, të tregtisë dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim rritjen ekonomike të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, të konvergimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës dhe shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen.

Në datën 27.09.2013, Këshilli i Ministrit miratoi vendimin nr. 841 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave". Në këtë vendim përcaktohet që misioni i Ministrisë së Financave është arritja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit të financave publike me efektshmëri dhe transparencë. Ajo e ushtron veprimtarinë në fusha përgjegjësie shtetërore të tilla si: politika makroekonomike dhe fiskale, administrimi i të ardhurave dhe i buxhetit të shtetit, menaxhimi i borxhit publik, menaxhimi financiar dhe kontrollit etj.

Në datën 27.09.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 845 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë". Sipas këtij vendimi, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka si mision garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror, përkujdesje sociale dhe shanse të barabarta, garantimin e lirisë së besimit fetar e të barazisë së bashkësive fetare. Ajo është përgjegjëse për zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e punësimit, arsimit dhe formimit profesional, politikave në fushën e marrëdhënieve të punës, inspektimit, sigurisë dhe shëndetit në punë, etj.

Në datën 30.09.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 880 "Për një shtesë në vendimin nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave "Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013". Nëpërmjet kësaj shtese, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm dhe strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga disa prej kushtëzimeve të përcaktuara në vendimin nr. 591 "Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013". Në vendim specifikohen aktivitetet e këtyre institucioneve, të cilat nuk preken nga masat disiplinuese.

Në datën 04.10.2013, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr. 6 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013". Ndryshimet që pësON ligji nëpërmjet këtij akti, ndër të tjera, përcaktojnë që të ardhurat e buxhetit për vitin 2013 në nivelin 321 919 (treqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) milionë lekë, shpenzimet 405 408 (katërqind e pesëmijë e katërqind e tetë) milionë lekë, ndërsa deficiti 83 489 (tetëdhjetë e tremijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) milionë lekë.

Në datën 09.10.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 939 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave". Sipas këtij vendimi, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka për mision zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, sigurisë ushqimore e mbrojtjes së konsumatorit, administrimit të ujërave, peshkimit dhe akuakulturës. Ajo është përgjegjëse, ndër të tjera, për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore, si dhe përgatitjen e strategjive dhe planeve kombëtare të veprimit lidhur me çështje e fushave të sipërpërmendura.

Në datën 09.10.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 944 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit". Sipas këtij vendimi, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit harton dhe zbaton politika që synojnë modernizimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban, strehimit, legalizimit e integrimit të ndërtimeve informale dhe turizmit. Ajo e ushtron veprimtarinë e saj, ndër të tjera, në fushën e planifikimit të zhvillimit urban, administrimit të tokës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të kontrollit të territorit, si dhe në fushën e zhvillimit të turizmit.

Në datën 10.10.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit". Ky ligj përcakton masat kundër financimit të terrorizmit, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, miratimin, kontrollin dhe zbatimin e tyre. Ai ka për qëllim parandalimin dhe goditjen e veprimeve të terroristëve dhe atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin, apo atyre për të cilët ka dyshime të bazuara që kanë kryer, po kryejnë ose kanë qëllim të kryejnë veprimtari të tilla, nëpërmjet sekuestrimit të fondeve e pasurive të tyre, në zbatim të rezolutave e marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Në datën 17.10.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me

ligjin nr. 162/2013 "Marrëveshjen për kryerjen e shërbimit të auditimit të borxhit të ministrive kundrejt biznesit vendas dhe të huaj". Objekt i këtij ligji është nxjerrja e rezultateve aktuale dhe reale të borxhit të akumuluar në vite, që ministritë kanë ndaj biznesit dhe sipërmarrjes së lirë për punët e kryera, shërbimet e mallrat e blera, si dhe përpunimi i politikave të menaxhimit për shlyerjen e këtij borxhi, nëpërmjet kryerjes së procedurave të një auditimi të thelluar dhe gjithëpërfshirës. Subjekte të tij janë të gjitha institucionet shtetërore qendrore, që zotërojnë të dhëna apo që mund të përdorin të dhëna të lidhura me borxhin, objekt të këtij ligji, si dhe audituesi i autorizuar që do të kryejë shërbimin e auditit në zbatim të këtij ligji.

Në datën 25.10.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 976 "Marrëveshjen e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për asistencën teknike për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2 – mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë". Marrëveshja e miratuar me këtë vendim siguron asistencë teknike nga ana e Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2 – mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë, në shumën 1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) euro.

Në datën 31.10.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 167/2013 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Indisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionin fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin". Marrëveshja do të zbatohet për persona, të cilët janë rezidentë të një ose dy shteteve nënshkruese, mbi tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, të vendosura në emër të një shteti kontraktues ose të nënndarjeve politike apo autoriteteve të tij lokale.

Në datën 14.11.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me ligjin nr. 170/2013 "Marrëveshjen e asistencës së shërbimit doganor". Objekti i këtij ligji është miratimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë "Crown Agents Limited". Ai ka për qëllim ofrimin e asistencës ndaj administratës doganore, sipas standardeve të Bashkimit Evropian dhe sipas praktikave më të mira të rajonit, për përmirësimin e performancën, rritjen e të ardhurave dhe luftën ndaj korrupsionit në administratën doganore të Republikës së Shqipërisë.

Në datën 26.11.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me ligjin nr. 171/2013 "Buxhetin faktik të shtetit për vitin 2012". Me miratimin e këtij ligji, ndër të tjera, përcaktohen të ardhurat e buxhetit të shtetit në nivelin 274 260 (dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) milionë lekë, ndërsa shpenzimet në 306 298 (treqind e gjatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) milionë lekë.

Në datën 02.12.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 185/2013 "Për buxhetin e vitit 2014". Sipas këtij ligji, të ardhurat për buxhetin e vitit 2014 do të jenë 364 704 (treqind e gjashtëdhjetë e katër

mijë e shtatëqind e katër) milionë lekë, shpenzimet 456 404 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e katër) milionë lekë, ndërsa deficiti 91 700 (nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind) milionë lekë.

Në datën 04.12.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1039 "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave në këtë këshill". Ky vendim e përcakton Këshillin Kombëtar të Punës si një organ konsultativ trepalësh, me përfaqësues të Këshillit të Ministrave dhe të organizatave të punëdhënësve e të punëmarrësve. Ai zhvillon këshillime, merr vendime me konsensus dhe i bën rekomandimet përkatëse Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Në datën 05.12.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.173/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin". Kjo marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që vendosen në emër të një shteti kontraktues ose ndërvarje të tij politike apo autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën vendosen. Ajo vepron mbi personat rezidentë të një ose të dy shteteve palë në marrëveshje.

Në datën 05.12.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 174/2013 "Marrëveshjen e ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për forcimin e shtetit të së drejtës, qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse". Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e mirëkuptimit ndërmjet palëve nënshkruese në ndërmarrjen e një sërë hapash për realizimin e objektivave të saj. Kontributi total i llogaritur i USAID-it për arritjen e objektivave do të jetë 28 544 000 $ (njëzet e tetë milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë dollarë amerikanë), të cilat do të jepen në mënyrë shtuese dhe në bazë të disponueshmërisë së fondeve.

Në datën 14.12.2013, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr. 7 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", të ndryshuar". Përmes këtij akti normativ, ndër të tjera, ndryshojnë të ardhurat e buxhetit për vitin 2013, në 325 918 (treqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) milionë lekë, shpenzimet në vlerën 409 408 (katërqind e nëntë mijë e katërqind e tetë) milionë lekë, ndërsa deficiti në 83 490 (tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë) milionë lekë.

Në datën 28.12.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 177/2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar". Ndryshimet e parashikuara në këtë ligj, prekin nenet që rregullojnë të ardhurat e përjashtuara, fushat e veprimit të tatimit mbi fitimin, rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit, shkallën tatimore dhe mbajtjen e tatimit në burim, regjistrimin, deklarimin dhe pagesën. Pas miratimit të këtij ligji, tatimi mbi fitim bëhet 15%.

Në datën 28.12.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 178/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar". Ndryshimet e miratuara me këtë ligj prekin, ndër të tjera, nenet që rregullojnë nivelet e taksave kombëtare, deklaratën për pagesën e rentës minerare, transferimin e të ardhurave nga taksat kombëtare në drejtorinë rajonale tatimore dhe llogaritë e njësive qeverisëse, si dhe komisionet që përftojnë agjentët e taksave. Disa nga nivelet e taksave që ndryshojnë me këtë ligj janë, niveli i taksës së ambalazheve plastike, ai i taksës së ambalazheve të qelqit dhe i taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin.

Në datën 28.12.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 179/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Me miratimin e këtij ligji, pësojnë ndryshime nenet që rregullojnë fushën e veprimit, zyrat e qeverisjes vendore, çregjistrimin tatimor, pagesat me para në dorë, njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor, detyrimet tatimore të paguara më tepër, raportin përfundimtar të kontrollit tatimor, rimbursimin e detyrimit tatimor, pagesat e kamatëvonesës dhe e gjobës etj.

Në datën 28.12.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 180/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar". Këto shtesa dhe ndryshime prekin nenet që rregullojnë akcizën dhe trajtimin e kafesë dhe pijeve energjetike, prodhimin klandestin të duhanit dhe nënprodukteve të tij, shmangien e verifikimit nga pagimi i akcizës për duhanin, për kafen e pijet energjetike, tepricat ose mangësitë në mjediset e pritësve të regjistruar.

Në datën 28.12.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 181/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar". Këto shtesa e ndryshime prekin nenet që rregullojnë, ndër të tjera, tatimin e thjeshtuar mbi fitim për biznesin e vogël, shkallën tatimore, shpenzimet e njohura dhe ato të panjohura, mbajtjen e regjistrave, deklarimin, administrimin e tatimit, taksat mbi ndërtesat, taksat e përkohshme dhe tarifat vendore.

Në datën 28.12.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 182/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar". Disa nga nenet që pësojnë ndryshime me miratimin e këtij ligji janë ato përgjegjëse për rregullimin shkallës tatimore, furnizimeve të përjashtuara, barnave dhe shërbimeve shëndetësore, si dhe rimbursimeve.

Në datën 31.12.2013, Ministria e Financave miratoi udhëzimin nr. 32 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël". Ky udhëzim ka për qëllim të sigurojë qartësimin e kuptimit të rregullimeve që lidhen me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, për të garantuar zbatimin korrekt dhe në mënyrë uniforme për të gjithë tatimpaguesit dhe për të gjitha drejtoritë

rajonale tatimore. Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël janë ato biznese të cilat realizojnë gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë.

DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË, 31 DHJETOR 2013

KËSHILLI MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI	Kryetar
ELISABETA GJONI	Zëvendëskryetare
ADRIAN CIVICI	Anëtar
DHORI KULE	Anëtar
ELA GOLEMI	Anëtare
ERMELINDA MEKSI	Anëtare
PETRAQ MILO	Anëtar
ARJAN KADAREJA	Anëtar (deri më 11.12.2013)
HALIT XHAFA	Anëtar (deri më 11.12.2013)

GUVERNATORI

ARDIAN FULLANI

ZËVENDËSGUVERNATORËT

ELISABETA GJONI — Zëvendësguvernator i Parë

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

ELIVAR GOLEMI

KABINETI I GUVERNATORIT

GENC MAMANI

DREJTUES PËR KOORDINIMIN PRANË KABINETIT TË GUVERNATORIT

GRAMOZ KOLASI

SEKRETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ELVIS ÇIBUKU

DEPARTAMENTET DHE NJËSITË E TJERA

DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	*Roden Pajaj*
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE	*Erald Themeli*
DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE	*Altin Tanku*
DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE	*Marjan Gjermeni*
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES	*Indrit Banka*
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR DHE I STATISTIKAVE	*Klodion Shehu*
DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	*Mariglen Biti*
DEPARTAMENTI I EMISIONIT	*Dorian Çollaku*
DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE DHE I KONTABILITETIT DHE FINANCËS	*Anjeza Harizaj*
DEPARTAMENTI JURIDIK	*Altin Naqe*
DEPARTAMENTI I KONTROLLIT	*Elivar Golemi*
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT	*Agron Skënderaga*
DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE MBROJTJES	*Eduard Sinani*

DEGËT

Shkodër	*Ermira Istrefi*
Elbasan	*Thoma Rula*
Gjirokastër	*Anila Thomaj*
Korçë	*Liljana Zjarri*
Lushnje	*Shpresa Meço*

BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË, DERI NË 31 DHJETOR 2013

1. BANKA RAIFFEISEN SH.A.
Licenca Nr. 2/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998
Çertifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: *Christian CANACARIS*
Adresa: *Bulevardi "Bajram Curri", Qendra Tregtare Evropiane, Tiranë*
Telefon: *+355 4 2274 910*
Faks: *+355 4 2275 599*
E – mail: *info@raiffeisen.al*
Website: *www.raiffeisen.al.*

2. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.
Licenca Nr. 3/1998, datë 11.01.1999
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, datë 11.12.1998
Çertifikata nr. 3 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: *Emina ŠIŠIĆ*
Adresa: *Rruga e Durrësit, sheshi tek Zogu i Zi, Godina Teknoprojekt, P.O. BOX 128, Tiranë*
Telefon: *+355 4 2404 575.*
Fax: *+355 4 2228 460, 2228 387.*
E mail: *info@ubaal.com*
Website: *www.uba.com.al*

3. VENETO BANKA SH.A.
Licenca Nr. 5/1998, datë 11.01.1999
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 11.12.1998
Certifikata nr.4 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: *Lucio Luigi GAITA*
Adresa: *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Ndërtesa Kullat Binjake, Tiranë*
Telefon : *+355 4 2280 555*
Faks: *+355 4 2280 356*
E – mail: *info@venetobanka.al*
Website: *www.venetobanka.al*

4. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.
Licenca Nr. 6/1998, datë 11.01.1999
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, datë 11.01.1999
Certifikata nr.5 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: *Seyhan PENCABLIGIL*
Adresa: *Bulevardi "Zhan Dark" Tiranë*
Telefon: *+355 4 2250 955*
Faks: *+355 4 2250 956*
E – mail: *info@bkt.com.al*
Website: *www.bkt.com.al*

5. BANKA TIRANA SH.A.
Licenca Nr. 07,datë 12.09.1996
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996
Certifikata nr.6 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: Savvas THALASSINOS
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë
Telefon: +355 4 2269 616, 2233 441
Fax: +355 4 2233 417/2369 707
E – mail: info@tiranabank.al
Website: www.tiranabank.al

6. BANKA NBG ALBANIA SH.A
Licenca Nr. 08, datë 25.11.1996
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4. datë 14.03.1996
Certifikata nr.7 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: Ioannis KOUGIONAS
Adresa: Rruga e Durrësit, Godina Comfort, Tiranë
Telefon: +355 4 2274 802, 2274 822
Faks: +355 4 2233 613
E – mail: nbgalbania@icc-al.org
Website: www.nbgbank.al/

7. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A.
Licenca Nr.09, datë 20.02.1997
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 30.04.1996
Certifikata nr.8 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: Gideon van den BROEK
Adresa: Qendra e Biznesit, Rruga "Murat Toptani", Tiranë
Telefon: +355 4 2254 372, 2256 254
Telfax: +355 4 2254 368
E – mail: info@icbank-albania.com
Website: www.icbank-albania.com/

8. BANKA ALPHA ALBANIA SH.A.
Licenca Nr.10, datë 07.01.1998
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.01/03/96, datë 27.12.1997
Certifikata nr.9 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: Periklis DROUGKAS
Adresa: Rruga e Kavajës, G – KAM Business Center, kati II, Tiranë
Telefon: +355 4 2278 500
Telfax: +355 4 2232 102
E – mail:
Website: www.alphabank.al

9. BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.
Licenca Nr.11, datë 10.08.1998
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë 10.08.1998
Certifikata nr.10 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: Silvio PEDRAZZI
Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27, P.O. BOX 8319, Tiranë
Telefon: +355 4 2248 753 / 4 / 5 / 6, 2276 000
Fax: +355 4 2248 762

E – mail: *helpdesk@intesasanpaolobank.al*
Website: *www.intesasanpaolobank.al*

10. BANKA PROCREDIT SH.A.
Licenca Nr. 12, datë 15.03.1999
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 03.03.1999
Certifikata nr.11 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: *Flutura VEIPI*
Adresa: *Rruga "Dritan Hoxha", Nd. 92, H. 15, Njësia Bashkiake nr. 11, Kodi Postar 1026, Tiranë*
Telefon: *++355 4 2389 300*
Fax: *++355 4 2233 918*
E mail: *info@procreditbank.com.al*
Website: *www.procreditbank.com.al*

11. BANKA CREDIT AGRICOL SHQIPËRI SH.A.
Licenca Nr. 14, datë 28.10.1999
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999
Certifikata nr.13 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: *Luc BEISO*
Adresa: *Rruga e Kavajës, nr. 59, "Tirana Tower", Tiranë*
Telefon: *+355 4 2258 755 / 56 / 57 / 58 / 59 / 60*
Fax: *+355 4 2258 752*
E – mail:
Website: *www.credit-agricole.al*

12. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr. 15, datë 28.08.2002
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 28. 08. 2002
Certifikata nr.14 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: *Sherine KAMEL*
Adresa: *Rruga Perlat Rexhepi, Al-Kharafi Group Administration Building, Kati 1&2, Tiranë*
Telefon: *+355 4 2272 168, 2272 162*
Fax: *+355 4 2272 162*
E-mail: *creditbkalb@icc-al.org*
Website: *www.creditbankofalbania.al/*

13. BANKA CREDINS SH.A.
Licenca nr. 16, datë 31.3.2003.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 26.03.2003
Certifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: *Artan SANTO*
Adresa: *Rruga "Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë*
Telefon: *+355 4 2234 096*
Fax: *+355 4 2222 916*
E –mail: *info@bankacredins.com*
Website: *www.bankacredins.com*

14. BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.
Licenca nr. 17, datë 16.02.2004
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 06, datë 11.02.2004

Certifikata nr. 16 " Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: Frederic BLANC
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati i 9-të, Tiranë
Telefon: +355 4 2280 442/3
Fax: +355 4 2280 441
E-mail: info@societegenerale.al
Web site: www.societegenerale.al

15. BANKA UNION SH.A.
Licenca nr. 18, datë 09.01.2006
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 101, datë 28.12.2005
Certifikata nr. 17 " Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: Gazmend KADRIU
Adresa: Bulevardi "Zogu I", pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë
Telefon: +355 4 2250 653, 2258 081
Fax: +355 4 2272 880
E – mail: info@unionbank.com.al
Website: www.unionbank.com.al

16. BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.
Licenca nr. 19, datë 06.07.2007
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 35, datë 27.06.2007
Certifikata nr. 12 " Për sigurimin e depozitave"
Drejtori: Bozhidar TODOROV
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë
Telefon: +355 4 2276 702/3
Fax: +355 4 2280 210
E – mail: -
website: www.fibank.al

Banka e Shqipërisë ka licencuar deri më 31 Dhjetor 2013 edhe subjektet e mëposhtme:

Nr.	Subjekte
21	SUBJEKTE JOBANKA
333	ZYRA TË KËMBIMIT VALUTOR
2	UNIONE TË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT
121	SHOQËRI TË KURSIM-KREDITIT
1	ZYRË E PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA

PUBLIKIME TË BOTUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË GJATË GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2013

Kjo listë përpilohet për të informuar lexuesit mbi botimet e Bankës së Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2013. Duke vizituar faqen tonë zyrtare të internetit (www.bankofalbania.org) mund të plotësoni e dërgoni formularin në public@bankofalbania.org ose në faks + 355 4 2419408 dhe të regjistroheni për t'u bërë pjesë e listës së shpërndarjes së botimeve të Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, ju mund të përfitoni nga shërbimi i njoftimeve automatike të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet këtij shërbimi, çdo mesnatë, sistemet e Bankës do t'ju njoftojnë në postën tuaj elektronike rreth ndryshimeve apo të rejave në argumentet që keni përzgjedhur.

Më poshtë mund të gjeni titujt e publikimeve të Bankës së Shqipërisë të botuara gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2013. Kjo listë nuk përfshin vrojtimet e kryera nga Banka e Shqipërisë, të cilat publikohen vetëm në formë elektronike (http://www.bankofalbania.org/web/vrojtime_3405_1.php).

RAPORTET PERIODIKE TË POLITIKËS MONETARE

Raporti i Politikës Monetare për tremujorin e tretë të vitit 2013

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Raporti i Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013

BOTIME PËR STATISTIKAT

Raporti Mujor Statistikor (Botohet çdo muaj të vitit)
Raporti Statistikor - Maj '13
Raporti Statistikor - Qershor '13
Raporti Statistikor - Korrik '13
Raporti Statistikor - Gusht '13

BULETINI ZYRTAR

Buletini Zyrtar - Vëllimi 15, nr. 5
Buletini Zyrtar - Vëllimi 15, nr. 6
Buletini Zyrtar - Vëllimi 15, nr. 7
Buletini Zyrtar - Vëllimi 15, nr. 8
Buletini Zyrtar - Vëllimi 15, nr. 9

Buletini Zyrtar - Vëllimi 15, nr. 10
Buletini Zyrtar - Vëllimi 15, nr. 11

BULETINI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Buletini i Bankës së Shqipërisë - Gjashtëmujori i parë 2013

BOTIME STRATEGJIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Libri i punimeve të Konferencës X të Bankës së Shqipërisë "Politika Monetare në Shqipëri: Nga e shkuara në të tashmen"

MATERIALE DISKUTIMI

Ndikimi i tregtisë mbi rritjen ekonomike: Një model i bazuar në instrumentet e gravitetit për Evropën post-komuniste - nga Endrit Yzeiraj

Performanca e parashikimit të inflacionit dhe vendimmarrja e politikës monetare gjatë periudhës 2011-2012 – nga Evelina Celiku dhe Genti Hashorva

Përcaktuesit e kredisë bankare për sektorin privat: Rasti i Shqipërisë - nga Gerti Shijaku dhe Irini Kalluci

Density estimation for economic variables – a genuine application – nga Altin Tanku dhe Kliti Ceca

Kultura financiare në Shqipëri: Rezultatet e vrojtimit për matjen e nivelit të njohurive financiare të popullatës, 2011" – nga Kliti Ceca, Arlinda Koleniço, Egnis Isaku dhe Borana Haxhimusaj

Efekti i "kurbës-J" në tregtinë dypalëshe: Ndikimi i nënçmimit të monedhës në bilancin tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve kryesorë tregtarë – nga Alban Pllaha

Modeli financiar në Shqipëri: Qasje ndaj të dhënave të panelit – nga Elona Dushku dhe Vasilika Kota

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë, Nr. 10

BOTIME EDUKATIVE-INFORMATIVE

Paketa mësimore për fëmijë "1, 2, 3 ... derrkuci Çufo mëson të kursejë"

Udhëzuesi i mësuesit të paketës mësimore "1, 2, 3 ... derrkuci Çufo mëson të kursejë"

Fletëpalosja "...Banka për Shqipërinë është një i dyti fitim, pas lirisë..."